

**DRITERO
AGOLLI**

BIBLIOTEKA

8JH-31

A 37

INVERITO

ME TOP

ROMAN



D. Xhafa
Xhafa

DRITERO AGOLLI

NJERIU ME TOP

— ROMAN —

SHTËPIA BOTUESE «NAIM FRASHËRI»

KAPITULLI I PARË

Në grykën e shpellës nuk vinin më gjësimet e topit dhe krismat e pushkëve. Mato Gruda e mori me mend se ushtarët italianë do të ishin sprapsur përtej kodrës. Ai u ngrit dhe doli nga shpella. Mushka e tij përpiqte këmbët nën degët e lisit të madh pranë vandakut të druve të prera. Me ta vënë re të zotin, kafsha filloi të tundte kokën dhe të rrëmonte tokën me këmbën e parë. Burrit i shkriu gjaku, mushka ishte shëndoshë e mirë. Nga mijëra plumba që fluturuan në korije, asnjë nuk mundi dot ta qëllonte. Sikur t'i kishte ndodhur gjë mushkës, atij do t'i mbetej brengë për tërë jetën. Ç'i shkrepri të vente për dru atë ditë pranë llogoreve të ushtarëve italianë? Sa mbaroi së preri drutë, u derdhën partizanët nga mali dhe filloi përleshja. Mirë që u ndodh shpella, se mund të ishte vrarë në mes të korijes.

Kjo shpellë ka qenë si një shtëpi e dytë e fshatit në kohëra lufte. Këtu futeshin njerëzit dhe le të binin mbi tavanin e saj jo gjyle, por edhe bomba disatonëshe. «Gjithnjë do të na duhet kjo shpellë» — mendoi Mato Gruda.

Mato Gruda iu afrua ngadalë mushkës. Sytë e saj të xhamtë u kthyen nga i zoti dhe qëndruan për një çast të palëvizur.

— U trembe, lozanjare? A, ti kujtove se unë ika e të lashë vetëm? Ku të lë Matua ty, moj e zezë! Ç'të bëjë Matua pa ty?

Mushka teshtiu.

— Shëndet! — tha Mato Gruda.

Ai u ul dhe e zgjidhi. I hodhi një vështrim vandakut të druve dhe mendoi ta ngarkonte kafshën e trembur. Megjithatë ishte me dy mendje: t'i merrte drutë që atë ditë, apo t'i linte për të nesërmen. Tek mendonte, i shkuan sytë në llogoret në faqen e kodrës. Tre italianë po shtynin një top. Ata shkisin herë-herë dhe binin në tokën e lagur nga shirat e parakohshme të shtatorit. Topi mezi lëvizte. «Janë topa të vegjël këta malorët, po prapë mezi shtyhen, të nëmurit» — mendoi Mato Gruda me kapistallin e mushkës në dorë.

Në këtë çast u dëgjua një batore pushkësh. Italianët e lëshuan topin. Atëherë Mato Gruda futi gishtat në gojë dhe fërshëlleu. Pastaj bërtiti me zë të lartë, si për të trembur ndonjë ujk. Ushtarët ia mbathën me të katra. Topi mori më tatëpjetë dhe u përplas në trupin e një lisi të prerë. «Aha, ata nuk mund të kthehen. Ikën» — tha me vete Mato Gruda.

Që nga gryka e shpellës, ku qëndronte Mato Gruda, topi mezi dukej. Po të mos i kishte parë ushtarët kur e shtynin, nuk të shkonte mendja për topin e gremisur në trungun e lisit të madh. «Sikur të shkoj e ta shoh se ç'mall është?» — mendoi ai.

Nga gryka e shpellës dukeshin edhe shkëmbinjtë binjakë, diku larg xhadesë që përdridhej në faqen e malit. Në mes të dy shkëmbinjve, që qëndronin pranë njëri-tjetrit, ishte një lëndinë e vogël. Ai për herë të parë atje kishte takuar Zarën. «Në atë lëndinë ta kishin vënë topin, budallenjtë! Ajo është si istikam. Që andej edhe xhadenë e ke si në pëllëmbë të dorës, edhe këmbët e Kokallës i ke si në pëllëmbë të dorës! Nuk janë të mëngëm këta ushtarët italianë» — mendoi Mato Gruda.

E lidhi përsëri mushkën pas lisit dhe u ul në vandakun e druve. Mendjen tani e kishte te topi. E harroi edhe mushkën, edhe drutë. E pushtoi një dëshirë e marrë. Nga kjo dëshirë ndjeu se fytyra po i skuqej. «S'ma merr mendja që në këtë rrëmujë ta kërkojë njeri topin

e gremisur. Vetëm unë e di se ku ndodhet dhe do ta marr...»

Mushka shfrynte dhe i binte tokës me këmbë. Mato Gruda vazhdonte të rrinte në vandakun e druve. Në këmbë të kodrës dukej tymi i oxhakut të shtëpisë së tij; tutje në grykë të përroit zbardhte mes degëve të lisave shtëpia e Fizëve. Vetëm ato dy shtëpi ishin ngulur nga kjo anë e kodrës që dhjetëra e dhjetëra viet më parë dhe secila bënte jetën e saj të pavarur. Të dyja shtëpitë nuk kishin asnjë lidhje me njëra-tjetrën. Nuk kishin as hyrje, as dalje nga shkaku i një hasmërie të vjetër. Herë pas here kjo hasmëri fillonte e lëvizte dhe i ngacmonte burrat e moshuar dhe djemtë e rinj.

Në korije dalngadalë filloi të thyhej dita. Kishte kohë që nuk dëgjohej asnjë pushkë, asnjë mitraloz. Mato Gruda përsëri e zgjidhi mushkën dhe mori tatëpjetë du-shqeve. Kafsha e ndiqte duke përpjekur thundrat në gurët e lagur.

Me të zbritur në përrua, ai ndjeu të zhurmonin drizat. Mendja i shkoi për të keq: «Mos ka mbetur ndonjë italian?» Mekanikisht u fsheh prapa një lisi me kapistallin e mushkës në dorë. Por, pas pak, para këmbëve të tij u hodh diçka e murme.

— Tyt, drej, se më trembe! — thirri Mato Gruda.

Dy hapa larg tij qëndronte Baloja. Qeni, siç dukej, e kishte ndier vonesën e të zotit dhe kishte dalë ta kërkonte nëpër korije. Këtë qen ai e kishte gjetur në një hendek një mbrëmje ku kthehej nga ara. I vockël sa një mi dridhej në fund të hendekut e nxirrte një angullimë të pafuqishme që të therte në shpirt. E kishin hedhur fshatarët bashkë me tre-katër këlyshë të tjerë. Të vegjlit e tjerë kishin ngordhur. Mato Gruda e mori, e mbështolli në cep të xhaketës dhe e shpuri në shtëpi. Për fat të këlyshit ato ditë kishte pjellë lopa dhe ai u rrit me qumështin e saj. Ndoshta prandaj Baloja e donte lopën dhe kaun e nuk lejonte pranë tyre bile as edhe një galë. Por më shumë nga të gjithë ai donte Mato Grudën.

Njeriu me mushkë e me qen, pasi zbriti në përrua,

filloi të ngjitej në faqen e kodrës. Drurët dhe drizat ende nuk i kishte veshur cipa e muzgut, prandaj mund të lëvizje lirisht në korije. Përpara Mato Grudës ecte qeni, sikur ta dinte që më parë qëllimin e këtij udhëtimi.

— Kështu, Balo, — i tha Mato Gruda, — do të çuditesh edhe ti, kur të shohësh se çfarë kemi gjetur. Që thua ti, Balo, ai nuk është ndonjë nagant i vogël sa një bluashkë, me një tytë sa një gisht... Ai e ka tytën sa të futesh ti i tëri brenda. Po ti ke vetëm një grusht tru dhe nuk merr vesh nga këto punë...

Qeni qëndroi, sikur donte të shkoqiste fjalët e të zotit.

Ndoshta ai ishte mësuar me tonin e fjalëve të të zotit. Sa herë që Mato Gruda fliste në rrugë, Baloja e ndiente se kujt i drejtoheshin këto fjalë, prandaj e kishte bërë zakon të qëndronte e të mbante vesh.

Dushqet u rralluan. Gjashtë-shtatë hapa para Mato Grudës qëndronte topi. Njëra rrotë ishte ngritur lart dhe ishte mbështetur në trung të lisit, kurse gryka kishte zënë në tokë, sikur donte të kulloste në lëndinën e korijes.

Mato Gruda e la mushkën dhe iu afrua topit. U ul më gjunjë dhe i vuri të dyja pëllëmbët në tytën e ftohtë. Pastaj e hoqi njëren dorë dhe e futi në grykën e çeliktë. Edhe Baloja qëndronte më bisht pas të zotit dhe shikonte grykën e topit. Edhe ai bëri si i zoti. Zgjati këmbën e parë dhe e futi në grykën e topit.

— Nuk qenka i madh, Balo! Epo topat malorë nuk duhet të jenë të mëdhenj, e di unë. Kështu, kështu!

Ai u ngrit dhe doli nga ana e pasme e topit. Përsëri u ul më bisht dhe filloi të shikonte shtratin e topit. «Hëm, kjo është si oshta e qerres. Demek, këtë e lidhin në makinë dhe e tërheqin. Po unë kam parë që rrotat i ngarkojnë edhe në mushkë. Edhe tytën në mushkë. Xhanëm edhe mund ta tërheqin me makinë. Në xhade, xhanëm, në xhade. Kur s'ka xhade, në mushkë...» Dhe Mato Gruda i hodhi një vështrim mushkës së tij.

Nuk mund të rrinte Mato Gruda pa i prekur me dorë gjithë pjesët e topit. E pushtoi me të dy krahët rrotën e ngritur dhe u mundua ta ulte. Topi lëvizti. Për-

sëri e tërhoqi me forcë rrotën dhe e uli ngadalë në tokën e lagur. Topi tani qëndroi në të dyja rrotat si qerre. Tyta e tij u ngrit dhe mbeti e drejtuar mbi korije. Mato Gruda qëndronte para topit, si një artilier i jashtëzakonshëm, i vetmuar në faqen e kodrës. Në këtë çast atij i hipi një e qeshur. E qeshura në fillim ishte e lehtë, pastaj dalngadal gjëmoi nëpër korije... Këtu qeni nuk u përmbajt dhe lehu me të madhe. Mato Gruda erdhi në vete.

«Budalla, — tha me vete — sikur s'ke parë top! — Pastaj ju drejtua qenit: — Balo, mbylle gojën!»

Pas kësaj së qeshure, Mato Grudës i hipi një trishitim. E zuri me dorë mjekrën e parruar dhe ra në një heshtje të thellë. E, ja, e gjeti këtë top, pastaj? A mund ta shpinte dot vetë në shtëpi? Të ishte mitraloz, mund ta merrte në krahë e mund ta shpinte jo në shtëpi, po edhe prapa diellit. Sikur ta linte topin në korije, do të vinin të tjerët e do ta merrnin.

«Sikur të pres ca degë dushku e ta fsheh? Demek ta mbuloj!» — mendoi Mato Gruda.

Po edhe ky mendim nuk iu duk me vend. Pranë topit lisat ishin të rrallë dhe degët e dushkut të hedhura mbi të, do ta vinin në dyshim edhe kalimtarin më të thjeshtë.

Duke u menduar, diçka iu kujtua dhe ia dha përsëri të qeshurit. Qeni filloi prapë të lehte.

— Balo, të thashë, mbylle gojën! — e kërcënoi Mato Gruda qenin. — Këtë babaxhan ne do ta tërheqim nëpër korije dhe do ta fshehim.

E zuri mushkën për kapistalli, diçka foli nëpër dhëmbë dhe u mat të nisej për në shtëpi. Ishte lodhur dhe vendosi të hipte në mushkë. Papritur i erdhi diçka në mend dhe i ra me pëllëmbë ballit: «Tutkun, ti harrove gjylet!»

E la kafshën dhe u ngjit me vrap në llogore. Me siguri atje duhej të kishte gjyle. «Ç'ta duash topin pa gjyle? Të rroftë topi!» — mendoi ai.

Fundi i llogores së parë ishte tërë llucë të verdhë. Këmbët e tij u futën gjer në gju dhe ndjeu një rrëqethje.

Kur hodhi hapin e dytë, maja e opingës i zuri në një send të fortë. Kujtoi se ishte gjyle dhe futi krahun në baltën e verdhë. Gishtërinjtë i zunë në diçka të lëmuar. Me ta ngritur, e kuptoi se sendi që kërkonte nuk ishte gjyle, po gëzhgjë.

Me këmbë e krahë tërë baltë, Mato Gruda doli nga llogorja e parë. Përplasi në lëndinë opingat për të shkundur llucën dhe shau nëpër dhëmbë. Ndërkohë qeni angulliu me një zë të vajtuar, sikur të ndillte ndonjë kob të madh, dhe u hodh nga ana e sipërme e llogores. Mato Gruda e mori me mend se qeni diçka duhej të kishte vënë re dhe u mat ta ndiqte pas. Por e largoi këtë mendim, pasi dyshoi se mos kishte mbetur në korije ndonjë ushtar i plagosur dhe mund të hante papritur ndonjë plumb qorr.

«Dhe shkon si qeni në vreshtë» — mendoi ai.

Ndoshta ulërima e kobshme e qenit e bëri Mato Grudën të pendohej për udhëtimin e tij gjer te ky top.

«E fundja ç'më duhet topi? Një copë hekur është!»

Por pastaj qeshi me vete: «Si s'm'u dashka? Me këtë tytë të hekurt unë do të bëj atë që s'e ka bërë asnjeri nga fisi ynë! E keqja është se nuk gjej dot gjyle.»

Qeni kërceu nga drizat në këmbë të të zotit. Pastaj ktheu kokën nga dushqet dhe filloi përsëri të angullinte dhe të drejtohej andej nga erdhi. Mato Gruda vendosi të shkonte pas qenit.

Ngadalë, duke përgjuar nga e djathta e nga e majta, si një vjedhës, ai hyri në korije. Qeni ecte dhe qëndronte, sikur të kishte frikë se mos e humbiste të zotin nëpër driza.

Dy hapa larg një grope, pas trungut të një lisi, qeni qëndroi në bisht dhe filloi përsëri të angullinte. Mato Gruda u drodh. Para tij shtrihej trupi i një ushtari të vrarë. Ushtari dukej sikur flinte. Bile ai ishte kthyer në krah dhe kishte vënë kokën në pëllëmbë të dorës. Mato Gruda u përkul mbi italianin dhe ia futi dorën në brez. Ia zbërtheu ngadalë rripin dhe e tërhoqi me forcë. Në rrip varej një kobure. Burri zbërtheu këllëfin, e nxori armën dhe filloi ta shikonte me kujdes, si një koleksioner

i dashuruar pas gjërave të rralla. E mbajti sa e mbajti në dorë dhe e futi përsëri në këllëf.

Tek qëndronte para italianit, i shkuan sytë në xhakëtën ngjyrë bari.

— Ç'e do këtë xhakëtë, more derdimen! Ti as ngrin, as vapë nuk ke!

U përkul prapë mbi italianin dhe ia zhveshi xhakëtën e lagur nga shiu e nga gjaku.

Në këtë kohë iu duk sikur italiani lëvizi krahun që kishte nën kokë dhe ndjeu një gjë të pështirë.

Si ia zhveshi xhakëtën, u hodhi një vështrim këpuçëve dhe pantallonave të ushtarit. Në krahasim me opingat e tij e me pantallonat e shajakta me mballoma, veshja e italianit atij iu duk si një veshje princërore.

— Meqë ti nuk ndien as të ftohtë, as të ngrohtë, dhe meqë unë ndiej edhe të ftohtë, edhe të ngrohtë, po t'i marr edhe këpucët, edhe pantallonat. Këmishën dhe të mbathurat po t'i lë, se nuk dua të të shoh lakuriq, — i tha Mato Gruda trupit të ushtarit.

Kur filloi ta zgjidhte njërën këpucë, Mato Gruda ndjeu në lukth të gjoksit një lëmsh të rëndë e të hidhur. Kurrë nuk kishte zbathur këpucë nga këmba e një të vdekuri. Prandaj i erdhi ndoht për punën që kishte nisur. Sado që u mundua të ngushëllonte veten, se demek, për italianin njëlloj ishte, si me këpucë, si pa këpucë, nga ankthi që i ishte mbledhur në lukth të gjoksit, iu drodhën gishtërinjtë. Për këtë arsye, u ngrit pa i zgjidhur springat e këpucës, bëri një shenjë me dorë dhe ktheu krahët, duke marrë me vete vetëm xhakëtën.

— Këpucët po t'i lë. Për xhakëtën do të më falësh. o njeri i mbetur! — i tha ai trupit.

Kur përgatitej të ikte, Mato Gruda vuri re pranë llogores së tretë katër arka të mëdha. «Me gjyle duhet të jenë» — mendoi dhe iu afrua njërës. Arka ishte e hapur dhe në fund të saj zverdhnin gjylet.

U hodhi një vështrim të tjerave, por ato ishin të mbyllura. Zgjati duart dhe provoi ta ngrinte njërën prej tyre. «Hë, — tha ai — duhet bërë një punë më nge.»

Aty për aty i erdhi një mendim që iu duk i drejtë.
«T'i mbuloj me degë dushku» — tha me vete.

Tanimë muzgu kishte rënë në dushqet e në drizat. Ndihej era e ftohtë e natës. Mato Gruda priste dushqet dhe i bënte vandak. Herë-herë thyente me dorë degë lisi, që të mos dëgjohej krisma e sëpatës.

Më në fund ai mori degët e prera dhe i hodhi mbi arkat e gjyleve. Pastaj mbushi edhe një krah tjetër me degë dhe u drejtua nga trupi i ushtarit. Duke ndenjur më bisht, filloi të radhiste dushqet mbi të vdekurin. Gjithë trupi i italianit tani u fsheh nën fletët. Vetëm këpucët i kishin mbetur jashtë. Mato Gruda u ngrit dhe qëndroi një copë herë para ushtarit të mbuluar me gjethe. Sytë përsëri i shkuan në këpucët.

— Fundja, — tha Mato Gruda, — ti i vdekur që i vdekur je. Pse i vdekuri të mbajë këpucë dhe i gjalli opinga? E, ç'të duhen ty këpucët?

U ul përsëri, nxori thikën nga xhepi dhe i preu lidhkat e këpucës së parë. I preu edhe të së dytës dhe, ngadalë, sikur mos i shkaktonte dhembje në këmbë italianit, e tërhoqi këpucën e parë. E tërhoqi edhe të dytën...

«Ashtu!...» — tha me vete Mato Gruda dhe filloi t'i shikonte këpucët nëse ishin të reja.

— Nuk i ke mbajtur shumë në këmbë, o mavri! — i tha ai trupit.

Mori edhe nja dy degë, ia hodhi në këmbët e zbathura dhe u largua.

Mushka priste te topi.

— Shkojmë? — i tha mushkës dhe e zuri për kapis-talli.

E vështroi edhe një herë topin dhe mori tatëpjetë korijes.

KAPITULLI I DYTË

Mato Gruda e futi mushkën në qilarin e errët dhe e lidhi në grazhd. Nëpër errësirë ai dëgjoi të përtypurat e kaut të vetëm të tij. Kau, me të ndier frymën e të zotit, nisi të kruante kokën në grazhd e të pëlliste. I zoti e kuptoi. Kishte ardhur ora për t'i hedhur jonxhë. Shkoi pranë kafshës, ia vuri dorën në kurriz dhe e përkëdheli:

— Të mori uria, Kazil? Mos u mërzit, të jep xhaxhai jonxhë, — tha Mato Gruda dhe doli nga qilari.

Në plevicë mbushi krahun me jonxhë dhe hyri prapë në qilar. Gjysmën ia hodhi në grazhd mushkës dhe gjysmën Kazilit.

— Që thua ti, Kazil, unë u vonova pak, se ashtu ishte puna. Ti do të habitesh se çfarë kam gjetur në koriye. Ne të dy do të shkojmë ta marrim e ta sjellim këtu. E? Ç'do të bëjmë ne me atë? Do ta marrësh vesh më vonë se ç'do të bëjmë me atë babaxhan që na pret në koriye. Po ha tani, ha! — tha Mato Gruda.

Kau e ngriti kokën dhe Mato Gruda ndjeu në dorë gjuhën e ashpër të kafshës. Kazili e lëpinte. Një dashuri e madhe rodhi në gjoksin e Mato Grudës nga kjo përkëdhelje e papritur e kaut. Dhe ai e vuri faqen në kurriz të Kazilit, i mbylli sytë dhe qëndroi ashtu i palëvizur. Në faqe të tij erdhi ngrohtësia e ëmbël e qenies së gjallë. Nëpër lëkurën e kaut vinin të përtypurat e tij dhe Mato Gruda i ndiente. Kazili hante jonxhë.

— Ti mua më rrite dy fëmijë, Kazil! Unë të kam

marrë ty që atë mot, kur ishe një dem i vogël. Të ushqeva, të kreuha mëngjes për mëngjes dhe ti u bëre i madh. Pastaj të vura në zgjedhë dhe bashkë lëruam shumë. Të dy jetuam me nder, Kazil. Po, që të kemi më shumë nder, ne duhet ta marrim edhe atë që e kemi lënë në koriqe... — tha Mato Gruda pa e hequr faqen nga kurrizi i kaut.

Nga ana tjetër e murit ai ndjeu kollën e Larës, të lopës së tij. Mbushi edhe një krah jonxhë dhe ia vuri në grazhd. Lopa ia rrëmbeu nga dora dhe filloi të për-typej.

— Ti, Larë, duhet të hash, se do të na bësh një viç të bukur. Edhe ti, Larë, më rrite dy fëmijë me qumështin tënd. Unë t'i shita viçat, fëmijët e tu, se nuk kisha ç'të bëja. Kanë qenë viça të bukur. Po t'i kisha, do të ishte mbushur plot qilari dhe ti do të rrije mes tyre si zonjë. Po a mund t'i mbaja dot, moj Larë? Ha, se je shtatzënë, ha, Larë, ha! — tha Mato Gruda dhe e lëmoi në kurriz.

Ai u vërtit edhe nja dy herë nëpër qilar dhe doli në oborr. Ishte një natë e errët dhe e qetë. Në dritaren e odës përdhese nuk kishte dritë.

U ul në trarin rrëzë avllisë, nxori kutinë e duhanit dhe drodhi një cigare. Në oborr u përhap era e eshkës. I ulur në tra, me cigare në buzë, Mato Gruda filloi të mendonte për topin:

«Po të vjen koha, o babaxhan, po të vjen! Unë që sonde do të të marr e do të të sjell këtu, se gjer nesër kushedi ç'ndodh!»

Si e piu cigaren, u ngrit. Hyri përsëri në qilar dhe mori koburen e italianit që e kishte lënë bashkë me xhaketen e këpucët në një qoshe.

Në oborr i thirri qenit:

— Balo, ç'u bëre, o pizeveng?

Pa mbaruar fjalën e fundit, qeni iu hodh përpara këmbëve. Mato Gruda e lëmoi me dorë në kokë:

— Hajde të shkojmë te Murati.

E hapi ngadalë portën dhe doli në rrugë.

— Nuk vonohemi. Do t'ia marrim kaun e do të

kthehemi shpejt. Nuk kemi se ç'bëjmë, o Balo! Atë baba-xhan nuk mund ta lëmë në koriye. More vesh?

Muratin ai e kishte mikun më të ngushtë në gjithë fshatin. I pëlqente, se ishte njeri i urtë e zemërbardhë. Të dy kishin nga një ka dhe e ndihmonin shoku-shokun. Një javë punonte njëri me të dy qetë, një javë tjetri. Ishin ortakë të mirë dhe kurrë nuk kishin këmbyer ndonjë fjalë të keqe.

Po Mato Gruda kishte vënë re te shoku i tij, kohët e fundit, një gjë të papëlqyer. Murati, megjithëse ishte në hasmëri me Fizët, kishte filluar të hynte e të dilte në shtëpinë e tyre. Mato Gruda nuk i donte Fizët, veçanërisht, plakun Mere. Edhe të dhjetë stërnipërit e tij i urrente. Jeta e tyre i dukej si pus. Brenda këtij pusi, sipas Mato Grudës, zienin shumë gjëra të këqija. Por këto gjëra të këqija nuk i shihte Murat Shtaga. Ai donte që edhe Fizët t'i bënte për vete e t'i hidhte nga ana e partizanëve, siç kishte bërë me Maton.

Habitej Mato Gruda me këtë njeri! Mendje çilimiu kishte, a mendje të lojturi kishte... Komunizma që na qenka kaq e drejtë, si u futka në shtëpinë e Fizëve? Më thoni, more të bekuar, me ç'mendje vete ky Murat Shtaga? Edhe mua më flet të njëjtat gjëra që u flet edhe Fizëve! Murat Shtaga e ka lënë edhe parmendën, edhe mushkën, edhe bagëtinë dhe merret me komunizmën.

Kështu mendonte Mato Gruda në rrugë. Kur pushonte së menduari, i ndiente gjunjët të lodhur e të këputur. Pastaj shikonte qenin dhe thoshte:

— Ti nuk lodhesh sa unë, o Balo! Lodhesh, xhanëm, lodhesh, po jo sa unë!

Më në fund iu afrua shtëpisë së Muratit. Ishte për t'u habitur se në atë orë të gjitha dritaret ndritnin.

«Paska mysafirë ky!» — tha Mato Gruda.

Mori një gur para portës dhe trokiti. Asnjëri nuk iu përgjigj. Trokiti përsëri. Heshtje. Trokiti edhe një herë dhe filloi të thërriste:

— O Murat, o Murat!

— Kush është? — u dëgjua zëri i gruas së Muratit.

— Jam Mato Gruda! Thuaji Muratit të dalë.

Pas pak në oborr u dëgjuan hapa dhe Murati e çeli portën.

— Hajde, Mato!

— Nuk vij, Murat. Mysafirë paske?

— Partizanë, — tha Murati. — Do të vinin edhe në shtëpinë tënde, po e ke larg dhe e ke të veçuar nga fshati, dreqi të marrtë. Gjithë fshati është plot, vetëm te ti dhe tek Fizët nuk erdhën dot!

Mato Grudës iu përpëliti diçka në lukth të gjoksit. Mendja i fluturoi te topi.

«Po nuk e hoqa sonte nga koriija, nesër ata do të ma marrin.»

— Hajde pi një kafe, — e ftoi Murati.

— Nuk vij dot. Janë shumë?

— Në shtëpinë time janë nja dhjetë shpirt.

Murati heshti. Gjer në oborr dëgjoheshin këngët e mysafirëve, sikur të ishte dasmë. Mato Gruda ishte mbështetur në kanatin e portës dhe dëgjonte.

— Këndojnë! — tha i menduar.

— E more vesh? — pyeti Murati. — Italia ra.

— Si ra?

— U dorëzua. Kapitulloi. Një batalion i tërë italian u dorëzua te partizanët.

«Prandaj e lanë edhe topin» — mendoi Mato Gruda, pastaj tha ngadalë:

— Demek, u çliruan!

— Ç'u çliruan, more Mato vëllai! Na hynë gjermanët...

— Ç'thua?! — tha Mato Gruda sikur të kishte marrë mandatën e një gjëme të madhe. Ai kishte dëgjuar se gjermanët ishin të egër dhe mund të të vritnin si duke qeshur.

— E kemi bela edhe me këta italianët që u dorëzuan. Po i zunë gjermanët, i vranë në vend.

— Po ti na ke thënë se italianët janë miq me gjermanët, — tha Mato Gruda.

— Miq ishin sa s'kishte rënë Italia. Tani i vrasin, se nuk duan t'i kenë si barrë në shpinë. Katilë, ore, katilë. Pas këtyre fjalëve për një çast ata heshtën. Mato

Grudës i dukeshin të ngatërruara këto punë. Ai tani e harroi edhe topin, edhe kaun. Po ndodhte një gjëmë e padëgjuar...

— Ca italianë do t'i mbajmë në fshatin tonë. Do t'i veshim me rrobat tona, do t'u vëmë në kokë nga një qeleshe dhe le të rrinë me ne. Do t'i dërgojmë me bagëti në mal, do t'u japim edhe parmendën dhe bashkë do të lërojmë arat. Kur të mbarojë lufta, do t'i dërgojmë përsëri në Itali... — tha Murati.

— Ashtu? Kush tha? — u hodh Mato Gruda.

— Na porositi i dërguari Xhabir, — tha Murati.

Mato Gruda e vështroi Muratin si për ta pyetur nëse i dërguari Xhabir ndodhej në këtë darkë atje në odë. Ai kishte dëgjuar për të dërguarin Xhabir, bile njëherë e kishte parë edhe me Muratin. Ky ishte një njeri me trup të madh e me vetulla të trasha e të zeza si dy thëngjij të shuar. Njerëzit thoshin se shoku Xhabir ishte i dërguar i Partisë...

— I dërguari Xhabir na foli edhe për gjermanët. Na tha edhe se duhen mbledhur të gjitha armët e italianëve e duhen nisur për në mal me kuaj e me mushka... — tha Murati.

— Ashtu? — pyeti Mato Gruda.

— Italianët do t'i mbajmë, armët do t'i nisim! Nesër do të vish edhe ti me mushkën.

Mato Gruda e kapi me dorën e majtë mjekrën dhe filloi ta fërkonte sikur të provonte nëse ishte i parruar. Në këto çaste mendimet iu përqëndruan te një italian, që e krijoi me imagjinatën e vet. «Italiani — mendoj ai — hyn në plevicën time. Unë heq një vandak kashte dhe nga kjo kashtë del gryka e topit.

— E sheh këtë babaxhan, — i them, — do të laj disa hesape me këtë unë. He, he! Pastaj do ta gradojmë dhe do ta ulim e do ta ngremë tytën.»

Ai qeshi papritur. As vetë nuk e kuptoi se si qeshi.

— Pse qesh? — pyeti Murati.

— Më qeshet me këta të zes italianë. Demek do t'u vëmë qeleshe...

Më vonë Mato Grudës iu kujtua se për ç'arësye kishte vajtur:

— Dëgjo, Murat, kam ardhur të të marr kaun. Nesër do të ngrihem pa zbardhur dita e do të lëroj atë shullërin në brinjë, — tha ai.

— Po ne do të shkojmë të mbledhim armët e italinëve për t'i shpënë në mal te partizanët... — tha Murat Shtaga.

Mato Gruda ndjeu se u skuq, por e mblodhi veten.

— Do të ngrihem herët. Lëroj ca, pastaj vij me ju... — tha ai.

Murati nuk foli menjëherë. Atij i erdhi keq për shokun e vet, që në këto kohë të vështira mendonte vetëm për arat dhe qetë. I dukej marrëzi që, pas atyre ngjarjeve, të vente e të lëronte arat. «Njerëzit mendojnë se si t'u bëjnë ballë gjermanëve, që mund të vijnë nesër a pasnesër, ndërsa ky kërkon të mbrejë qetë e të shkojë të lërojë. Hajde, Mato, hajde!» — tha me vete Murati.

— Apo nuk do të ma japësh? — pyeti Mato Gruda.

— Kaun? Merr po të duash edhe mushkën, — u përgjigj Murati dhe në zërin e tij u ndien nota zemërimi.

— Jo po thashë, — tha Mato Gruda.

Murati ktheu krahët dhe u drejtua për në qilar. Pas pak u dëgjua zëri i tij i trashë. I fliste kaut.

Mbështetur pas kanatit të portës, Mato Gruda dëgjonte këngën e mysafirëve të shokut të vet. Isoja e këngës vinte e zgjatur dhe herë pas here ndërpritej nga ca «oi, oi» të forta. «Këndojnë» — tha me vete dhe pshe-rëtiu.

Në oborr trokitën thundrat e kaut.

— Hidhi pak jonxhë, Mato, se ësh'ë i uritur, — tha Murati.

Mato Gruda doli pas kaut, i ra me pëllëmbë në vithë dhe kapërceu pragun e shtëpisë. Kau ecte ngadalë si i përgjumur dhe herë pas here tundte kokën me brirët e gjatë. Këtë ka Mato Gruda e mbante mend që herët. Murati e bleu atë, kur u kthye nga Tirana, ku kishte shkuar të punonte në kantierin rrugor të firmës Puriçeli. Atëherë ai mblodhi ca para dhe ia bleu një fshatari për-

tej malit Kokallë. Mato Gruda ia pëlqente brirët, se i kishte të hollë e të gjatë si dy kama. Por tani ai ishte plakur. Njëherë, duke lëruar të dy me Muratin, parmenda e tyre zuri në një gjë të fortë dhe qetë ndalën. Mato Gruda e tërhoqi parmendën, por ajo nuk dilte. Atëherë mori kazmën dhe gërmoi dheun rreth plorit. Plori kishte zënë në një hekur në formën e tubit. Ata e nxorën hekurin e ndryshkur dhe Murati tha se ishte një grykë topi nga më të lashtët. Ai pastaj tha se këta topa mbusheshin nga gryka me rruzuj të hekurt. «Sa njerëz shkelën në këtë dhe! — i kishte thënë Murati. — Lindën, vdiqën. Parmenda jonë zë ndonjëherë në një gjë të fortë dhe nxjerr mbi ugar një vazo, një jatagan, një sahan. E kush ka ngrënë në atë sahan? E kush ka prerë me atë jatagan? E? E sheh si nxorëm një grykë topi?» Mato Gruda e kujtoi atë grykë topi duke ecur pas kaut të Muratit. «Si gryka e topit që gjeta në koriye ishte, por më e shkurtër e më e gjerë. Ku ta dish! Edhe topin që gjeta unë, po ta lije në koriye e po të mos e merrte njeri, nga shirat do të ndryshkej, nga rrëshqitjet e tokës do të mbulohej me dhe. Pas qindra vjetësh njerëzit, kur të bënin qilizëm, do ta gjenin siç e gjeta unë në arë grykën e ndryshkur. Kështu janë punët!» — tha Mato Gruda me vete.

Ai bashkë me kaun u kthye në shtëpi. E futi në plevicë, e lidhi pas direktut dhe i vuri përpara gjysmë vandaku jonxhë dhe shkoi në shtëpi për të marrë një sy gjumë.

Gruan e gjeti në odë të zbetë nga pritja e gjatë.

— Sa më bëre merak! Ke ikur që në pikë të saba-hut! — tha ajo.

— U vonova ca. — Ai u ul dhe e ngriti jorganin, që djali i madh në gjumë e sipër e kishte flakur në fund të këmbëve. — Zbulohet shejtani e pastaj fillon e kollitet.

— Na ngrive gjakun. Thamë se mos të kishte ndodhur gjë në koriye. Gjithë ato pushkë ranë.

— Ranë ca... — tha Mato Gruda.

— Do të hash? — pyeti gruaja.

— Nuk kam uri. Udhës hëngra bukën që më kishe

vënë ti në torbë. Më mirë të fle. U lodha, — tha Mato Gruda dhe filloi të zhvishej.

Zara e vështroi me frikë të shoqin. Ai rrallë ndonjëherë binte të flinte pa darkë. Mos vallë ishte i sëmurë? Ajo ngriti me gjilpërë fitilin e kandilit për t'ia parë më mirë fytyrën burrit. I hodhi përsëri sytë nga ai dhe u drodh.

— Ç'më shikon kështu? — tha Mato Gruda.

— Mos je pa qejf? — pyeti Zara.

— Nuk jam pa qejf, po jam i lodhur, — tha Mato Gruda dhe u shtri në dyshek.

Zara u ul te koka e të shoqit dhe ia vuri pëllëmbën në ballë. Ngadalë filloi t'ia shtrëngonte tëmthat me gishtërinjtë e saj të plasur.

— Më dukesh si i nxehtë!

— E kam nga udha, grua. Po shtrëngomi pak tëmthat, se më vjen mirë.

Gruaja ia fërkonte ballin dhe ai tulatej nën jorgan i butë si qengj. Në këto çaste ai e ndiente gjakun tek zbriste gjer poshtë në thonjtë e këmbëve e tek ngjitej gjer lart në thonjtë e duarve. Nga këto duar të Zarës sikur buronte një hirësi e rrallë. Që nga thellësitë e ndërgegjes së tij filloi t'i shfaqej një mendim, që ia hidhte poshtë tërë punën dhe mundimin e asaj dite: «E ç'më duhet ai drejt top? Kush rri e fillon kokëçarjet?»

— Halla doli e të kërkoi nëpër koriye. Shkoi gjer andej nga istikamet... — tha Zara, duke ia shtrënguar tëmthat.

Mato Gruda përnjëherësh u ngrit:

— Dhe e gjeti topin në istikame?

Zara e vështroi me habi:

— Ç'është ky top?

— Jo, thashë se mos u fut andej nga italianët, — tha Mato Gruda dhe u shtri përsëri.

— Nuk kishte as italianë, as topa, — tha gruaja.

— E, mirë, fli tani!

Zara e shoi kandilin dhe u shtri pranë burrit. Odën e mbështolli errësira. Dëgjohej vetëm frymëmarrja e Zigurit dhe e Sadikut, dy djemve të tyre. Burri ia ktheu

kurrrizin së shoqes dhe u mundua të flinte, por gjumi, ca nga lodhja e tepërt e ca nga andrallat e ditës, nuk po e zinte. Mendja i fluturonte nëpër koriye pranë topit. I doli përpara syve edhe italiani që e kishte mbuluar me dushqe...

Gruas nuk ia kishte treguar as topin, as plaçkat që ia kishte marrë italianit të vrarë, se nuk kishte dëshirë ta shqetësonte e ta linte pa gjumë «Le të flejë njëherë, pa shohim e bëjmë.»

Mato Gruda u kthye përsëri në kurrriz, por edhe kë-shtu nuk mundi të flinte. Gruaja e ndiente shqetësimin e tij, por nuk i bënte zë. Më në fund ajo i foli:

— Pse nuk fle? Mos ke siklet?

— Nuk kam siklet, por, ngaqë jam lodhur më tepër-seç duhet, nuk më merr gjumi, — tha Mato Gruda.

— Ti nuk fle, se ke parë llahtari në koriye, — tha Zara.

— Edhe nga ajo nuk fle...

— Po të kesh parë llahtari, mos më trego, se kam frikë, — tha Zara dhe heshti.

Mato Grudës aty për aty iu qesh. E dinte se Zara i zinte veshët me gishtërinj sa herë që ai matej të tregonte ndonjë ngjarje të frikshme a të shëmtuar. Nuk e kuptonte Mato Gruda se kujt i kishte ngjarë Zara me këtë shpirt kaq të butë e kaq të brishtë. Prindërit e saj kanë qenë njerëz të ashpër dhe kanë jetuar buzë shkëmbinjve. Për nënën e Zarës tregojnë se si ka shtënë me dyfek mbi hasmin që nga frëngjitë e katit të dytë të shtëpisë së gurtë. Çudi e madhe! Pse, xhanëm, Zara të jetë kaq e butë?

Atij iu rënduan qepallat. E pushtoi një gjumë i thellë, të cilin do të ishte vështirë ta shkundte nga supet herët në mëngjes. Në ëndërr pa Zarën, koriyen, topin, këmbët e zbathura të italianit nën lisiin e madh mbi llogoret e mbushura me ujë e llucë të verdhë. Pa në ëndërr edhe Muratin dhe ndjeu në ëndërr edhe zërin e të dërguarit Xhabir, edhe këngët e mysafirëve...

KAPITULLI I TRETË

Mato Gruda bërtiti në gjumë. Ai pa në ëndërr sikur plaku Mere i Fizëve kishte shkuar në koriqe dhe vërtitej rreth topit. Plaku Mere kishte marrë një çekan të madh sa një varë dhe i binte tytës së topit për ta thyer... «Plaku Mere, mos ma thyej tytën!» — thirri Mato Gruda dhe plaku u zhduk nëpër koriqe në dushqe e në dëllinja. Dhe këtu Mato Gruda u zgjua i djersirë.

Zara flinte, edhe fëmijët flinin. Burri u ngrit ngadalë, zbuloi zjarrin në vatër, mori një thëngjill, i fryu dhe ndezi kandilin.

Drita e kandilit ra në fytyrën e Zarës dhe Mato Grudës i erdhi keq ta zgjonte. Veshi xhaketën, mbathi çorapet dhe qëndroi në mes të odës me duar të kryqëzuara në gjoks. «Fill i vetëm në koriqe nuk shkoj dot. Duhet një farë ndihme» — mendoi ai me vështrim nga gruaja.

Më në fund vendosi. Iu afrua gruas dhe e shpoi pak me gishtin tregues:

— Zarë, ngrehu, se u gdhi... Zarë!...

Zara hapi sytë. Ende nuk po e kuptonte përse burrit i kishte shkrepur të ngrihej aq herët. Megjithatë nuk e kundërshtoi, por e flaku jorganin dhe brofi më këmbë. Ajo ishte e gjatë, me këmbë të drejta e të bukura. Çuditërisht gjithë linjat e trupit të saj ishin të holla e të hijshme, sikur të mos qe një shtëpiake e thjeshtë, por një femër e rritur mirë qyteteve. Mato Gruda e vështroi

dhe ndjeu, si dikur një rrëqethje të këndshme. «Ti, Zarë, — tha ai me vete — më bëre mua dy djem, por as djemtë, as mundimi nuk ta prishën as bukurinë e trupit, as bukurinë e fytyrës. Unë të kam mbajtur mirë ty, po edhe ta kam prishur gjakun dhe do të ta prish gjakun përsëri sonte...»

— Për ku je nisur? — pyeti Zara.

— Do të nisemi të dy. Do ta marrim edhe Zigurin që të na ndihmojë, — tha Mato Gruda.

Gruaja ia hodhi sytë burrit si për t'ia kuptuar mendimet:

— Punë e zezë është, apo punë e bardhë, Mato?

— Punë e bardhë është, Zarë; do të shkojmë në korie e do të marrim një plaçkë që e kam fshehur. Është plaçkë që na duhet e që na nderon.

— Ç'është kjo plaçkë?

— Nuk ta shkoqit dot, se duhet ta shohësh vetë e të kandisesh, — tha Mato Gruda.

Ai ia ngriti jorganin Zigurit dhe e tundi për supesh, por djali nëpër gjumë kërkoi me duar mbulesën.

— Zigur, ngrehu, biri i babait!

Djali nuk dëgjonte.

— Lëre Zigurin, Mato! Nuk më duket punë e bardhë kjo që ke nisur, se, po të ishte punë e bardhë, ti do ta filloje kur drita të zbulonte majën e Kokallës, — tha Zara.

Mato Gruda hapi sytë para gruas. Ai bile u pre në fytyrë, se iu duk sikur Zara me fjalët e saj ndillte një të keqe. Por e mblodhi veten.

— Se është punë e bardhë, prandaj dua ta filloj parë në diell, — dhe iu kthye të birit: — Zigur, ngrehu!

Ziguri fërkoj sytë me duar dhe u ngrit. Edhe ai i shëmbëllente s'ëmës. Dymbëdhjetëvjeçar ishte, por kishte një trup të gjatë dhe një fytyrë burorëre. Ishte një nga djemtë më të bukur të fshatit dhe Zara mburrej me të birin. Nga i ati kishte marrë vetëm atë të çarën e vogël në mes të buzës së poshtme, e cila i jepte një hijeshi akoma më të madhe.

— Vishu, Zigur, vishu, — tha e ëma dhe ia ngriti balluken, që i kishte rënë në ballë.

— Ku të vemë? — pyeti ai.

— Babai ka punë në koriye dhe ne do ta ndihmojmë, — tha Zara.

Në këtë kohë në odë hyri halla me leshra të lëshuara e me cigare në buzë.

— Ç'është kështu? Si lugetërit qenki ngritur! Ku vini?

— Do të marrim një plaçkë në koriye. Do të mbrej edhe qetë, se më krahë nuk e sjellim dot. Zara e Ziguri do të më ndihmojnë. Ti, hallë Esmë, rri me Sadikun, se mos zgjohet e trembet, — tha Mato Gruda.

— Plaçkën italianët e kanë lënë në koriye? — pyeti halla.

— Ata e kanë lënë.

— Plaçka e mirë është për shtëpinë? — pyeti përsëri Esmaja.

— E mirë është.

— Kam shype se mos na dalë ters e mos na marrin vesh e mos na bastisin, — tha halla.

— Nuk na marrin vesh.

— Ti je burrë, ti e di. Po shiko se mos na hapësh ndonjë plagë në shtëpi, se shtëpia jonë ka pasur shumë plagë dhe mezi janë mbyllur; dhe unë mezi të kam rritur, që kur Fizët të groposën babanë, nënën, xhaxhallarët, vëllanë e ç'kish e ç'nuku kish shtëpia. Po të kishte kopsa barku im e po të shkopsitej, do të dukej i zi nga hallët, — tha Esmaja me flokë të lëshuar, të zinj si dhjetë e ca vjeç. Mato Gruda me gruan e djalin dëgjonin trazonte jakën e xhaketës, Ziguri kopsiste e shkopsiste mintanin.

— Hiç mos ki shype, hallë Esmë, — tha Mato Gruda, — plaçka është e mirë.

— Dhëntë zoti të jetë e mirë! Uh, ç'më dhemb i tërë trup! Nuk e di ç'kam. Mos më zërë gripi, — tha hallë Esmaja dhe u ul pranë shtratit të Sadikut.

Mato Gruda qeshi:

— E di, hallë Esma? E zuri gripi dervishin. Iu kujtua dervishit një ilaç. Mori fiq, i mbushi me piper të kuq. Mori çaj, e zjeu. Ha fiq të mbushu me piper të kuq e pi çaj dhe u ngrit në mëngjes i shëndoshë. Ja, kështu janë punët, që thua ti.

— Më marrtë pleshtat dervishi! — tha halla dhe u shtri pas Sadikut.

Mato Gruda me Zarën e Zigurin dolën nga oda.

Oborri ishte i errët, por në qiell ndritnin yjet. Nuk frynte as erë dhe nuk regëtinte asgjë. Ata të heshtur shkuan të merrnin qetë e të niseshin në korije...

KAPITULLI I KATËRT

Tërë udhës nuk folën. Vetëm kur iu afruan vendit të caktuar, Mato Gruda tha se plaçka do të ishte prej hekuri dhe do të rëndonte shumë. Zara kujtoi se do të kishte të bënte me ndonjë tra hekuri nga ata të ushtrisë dhe e qortoi me vete burrin se ç'i duhej një mall i tillë, kur çatia e shtëpisë mund të mbahej fare bukur edhe me trarë druri. Por ajo heshti. Ziguri ngiste qetë dhe mendonte se ç'do të ishte kjo plaçkë hekuri. Ndryshe nga e ëma, ai kujtonte se plaçka do të ishte ndonjë sënduk i madh prej çeliku, si hambar.

Kur iu afruan lisit, Mato Gruda tha:

— Këtu është!

Qetë qëndruan. Mato Gruda bëri tri-katër hapa përpara, pastaj qëndroi dhe i ra me pëllëmbë tytës së topit. Nëpër mugëtirën e dendur Zara dëgjoi tingullin e hekurt. Bashkë me Zigurin ajo iu afrua të shoqit. Në fillim grua-ja vuri re grykën e topit, pastaj rrotat. Zara kurrë nuk kishte parë kaq afër një top, por nga tregimet e burrave e kishte përfytyruar në mendjen e saj. Përkundrazi, Ziguri këtë armë ua kishte parë italianëve në rrugë dhe bile e kishte prekur me dorë.

— Ky është! — tha Mato Gruda me pëllëmbë në tytë.

Fjalët «ky është» u përhapën nëpër koriye në errësirën e natës. Era i shpuri gjer në përrua të Fizëve e gjer në lumën Krak. Këto fjalë shkuan gjer në fshatin Arun, por askush nuk i dëgjoi dhe askush nuk do t'i

dëgjonte për një kohë të gjatë. Në fshatin Arun era shpinte fjalët «ky është». Topi vinte pas fjalëve... Ai hëpërhë qëndronte atje te lisi. Mato Gruda vinte pëllëmbën e dorës në grykën e ftohtë të tij, sikur të betohej për diçka të lartë e solemne. Ky ishte një betim i heshtur.

Zara ngriu. Trupi u bë mornica-mornica. Me zë të ulët, që i shembëllente një pëshpëritjeje, ajo tha:

— Top!

— Top! — tha edhe Ziguri, por me zërin e një të mituri që ndodhet para një lodre. Të vegjëlit, siç dihet, i kanë qejf armët. Atij i shkëlqyen sytë nëpër errësirë.

— Do ta marrim, baba? — pyeti i gëzuar.

— Mato, më qafsh, hajde të ikim që këtej! Lëre këtë kukudh! — thirri Zara gati si duke bërtitur.

Mato Gruda e hoqi dorën nga gryka e topit dhe shkoi pranë gruas. Po atë dorë ia vuri në sup së shoqes dhe ndjeu se trupi i saj dridhej. Atij i erdhi keq për Zarën, por në të njëjtën kohë ndjeu edhe një farë trishtimi. Zara nuk i ngjante s'ëmës. Zara trembej nga një top i heshtur. Zara nuk i sheh dot armët. Eh, e ëma e saj ka shtënë me armë dhe u ka zënë pritë hasmëve dhe, po të gjente një top, edhe me atë do të qëllonte... Një grua të tillë do të donte të kishte Mato Gruda. E ç'e do bukurinë në një zemër pule?

Pastaj trishtimi në zemrën e Mato Grudës u rrit. «Mos vallë Zara trembet ngaqë e nuhat se përse më duhet mua topi? Ajo nuk do që unë topin ta përdor për atë punë... E qartë, e ka nuhatur» — mendoi Mato Gruda.

— Ikim, Mato! Nuk na duhet neve ky hekur! — u lut Zara.

— Na duhet, grua, na duhet, — tha Mato Gruda, **duke hequr dorën nga supi i së shoqes.**

— Merri vetëm rrotat, t'ia vëmë qerres, Mato. Ti do të kesh qerren më të mirë të fshatit dhe nuk do të të priset kurrë, — tha Zara. — Ne do të vozitim me këtë qerre grurë e misër nga ara. Nuk do të lodhemi duke ngarkuar mushkën. Pastaj do të blejmë edhe një ka dhe do ta mbrejmë. Ne do të kemi qetë tanë dhe qerren tonë. Do të sjellim me qerre edhe dru nga korija dhe do të

kemi shumë dru për dimër. Ti nuk do të lodhesh me mushkën, duke e ngarkuar dhe shkarkuar.

Mato Gruda, megjithëse ishte në një gjendje aq të mërzitur, qeshi me të madhe:

— Uh, moj Zarë! Ku të shkon mendja! Unë kurrë nuk e kisha menduar që rrotat e topit mund të bëheshin rrota qerreje. Uh, moj Zarë!

Këtu qeshi edhe Ziguri me zërin e tij të hollë:

— E bëjmë qerre, baba?...

Atëherë burri heshti. I la edhe fjalët e tepërta, edhe shakatë. Doli me hosten përpara qeve dhe i drejtoi nga shtrati i topit. Qetë në fillim u trembën dhe nuk donin të bindeshin, por në këtë punë ndihmoi edhe Ziguri, duke i ngarë nga pas me shufër. Kur kafshët erdhën në vendin ku i duheshin Mato Grudës, burri ngrii ngadalë pjesën e fundit të shtratit të topit dhe e lidhi me litar në kulacin e zgjedhës. Topi tani i shembëllente qerres, vetëm se ishte prej hekuri dhe kishte një të zgjatur si qyngj, që quhej tytë.

Mato Gruda i ngau qetë dhe kjo qerre e jashtëzakonshme u nis nëpër koriye duke zhurmuar.

Në fshatin Arun vinte topi. Fshati Arun flinte. Kurrë nuk kishte ndodhur që në rrugët e tij qetë të vozitnin një top. Njerëzit e Arunit flinin, kur në zgjedhën e qeve lidhej shtrati i tij. Ka pasur e kishte në fshat thika, jatananë, shpata, dyfekë e kobure, por top kurrë nuk kishte pasur. Topat kanë kaluar në xhade, janë futur në ara, kanë qëndruar në koriye, por nuk kanë mbetur në fshatin Arun. Por fshati Arun hëpërhë rrinte indiferent, i mbuluar me cipën e natës, indiferent nga kjo ngjarje e madhe, indiferent se nuk dinte asgjë.

Qerrja ecte. Zara zuri sytë me duar.

— Zarë, hajde, se u vonuam! — urdhëroi burri.

Zara pa folur filloi të ecte pas topit e lodhur dhe e trishtuar.

Korija ishte e kredhur krejt në errësi. Nëpër udhëzën e ngushtë, përpara qeve, çapitej Mato Gruda. Gruaja dhe i biri venin në gjurmët e rrotave. Andej, në grykë të përroit në këmbë të Kokallës, lehte qeni i Fizëve dhe

në një dritare të vogël ndriste një dritë e zbetë. Mato Gruda ktheu kokën nga Ziguri, që vinte pas topit. Ai kishte një zakon që fliste me vete. Kur fliste me vete, të tjerët heshtnin. Ata nuk ia dëgjonin fjalët, por e merrnin me mend se diçka fliste. Topi ecte, ai fliste:

— Jeton plaku Mere Eizja, o biri im Zigur, jeton! Gjithnjë ndezur e ka mbajtur natën kandilin. Njëqind a dyqind vjet vajti, ku ta dish? Nuk gjen njeri që ta dijë, ç'mban rrëza e Kokallës dhe ç'lag lumi Krak. Dhe në brez plaku Mere ka të varur çelësat e kovçekëve e çelësat e dollapëve e çelësat e qilarçeve. Dhe rri shtrirë plaku Mere dhe rrallë ngrihet e ecën nëpër oda me duar pas e me tespihe pas. Shumë djallëzi ka numëruar plaku Mere me ato tespihe, që janë aq të vjetra sa edhe rruazat e kërbishtit të tij. Edhe tespihet thonë se i ka prej koske dhe thonë se i ka bërë vetë që kur ka qenë i vogël. Po asnjeri nuk e mban mend atë të vogël, se të gjithë vërsnikët e tij i ka përcjellë në botën tjetër. Me thikë i ka gdhendur tespihet dhe me tel të nxehtë i ka shpuar kokrrat për t'i shkuar në spango. Kështu thotë hallë Esmaja. Hallë Esmasë ia ka treguar gjyshe Nafia; gjyshe Nafies ia ka treguar nëna e saj, Dafina; Dafinës ia ka treguar tezja e saj, Zengjineja... Nuk mbahet mend që kur është plaku Mere! Thonë se i ranë dhëmbët dhe i dolën përsëri, dhe i ranë përsëri ata që i kishin dalë dhe i dolën përsëri të tjerët, si kokrrat e tespiheve. Thonë se ka zot. Hiç s'ka zot! Po të kishte zot, do ta kishte marrë plakun Mere. Po ai rron dhe kandilin e ka në dritare. Edhe ditën thonë se e mban ndezur, po ne s'e shohim, se s'na lë drita e diellit. E mban të ndezur, thonë, se shpirtin e ka atje në kandil dhe nuk vdes po s'ia përpoqe kandilin në shkëmb të Kokallës, atje në majë fare, ku s'ka as bar, ku s'ka as pemë, ku s'ka as myshk, po ka vetëm një shkëmb... Kështu thonë. Në ëndërr e kanë parë plakun Mere dhe në ëndërr e shohin plakun Mere.

Tregojnë se plaku Mere njëherë kishte vdekur e pastaj ishte ngjallur. Njerëzit betohen se

kjo që rrëfëhet në fshatin Arun, nuk është përrallë, por e vërtetë si nata. Ai vdiq. Të afërmit e tij u mblodhën, e qanë, e mbështollën me qefin, e vunë në tabut dhe e morën për ta shpënë në varre. Binte dëborë dhe ishte ftohtë. Në mes të rrugës që nga tabuti u dëgjua një zë.

— Allah belaversën! Ç'është ky kiamet e kjo e ftohtë kaq me llahtari! Allah, largoje prej meje Shimbër Jezit Shimbërllarin.

Ata që e mbanin, kur dëgjuan zërin e të vdekurit, u llahtarisen, e lëshuan dhe ia dhanë vrapit. Vetëm xherahu i fshatit, Xheladin Durballia, që mbante një gunë të madhe, nuk lëvizti vendit.

— O i madhi i më të madhit, ç'po kurdis me mua shejtan Mulahimi dhe Jeziti? — thirri plaku Mere dhe u ngrit, duke shqyer qefinin.

Ai rrotulloi sytë në bardhësinë e ftohtë dhe vuri re vetëm xherah Xheladin Durballinë me këmbë të ngulura në dëborë.

— O hak i madh! Cili është ky? Xherah Xheladin Durballia, apo vetë shejtan Mulahimi?

— Jam unë xherah Xheladin Durballia, i biri i Xhevatit dhe i nipi i Abdiressulavziut, — tha xherahu dhe ia hodhi me vrap gunën në supe.

Ashtu të mbështjellë me gunë e shpuri gjer në shtëpi. E veshi me rrobat që mbante kur ishte gjallë, ia ndezi kandilin dhe e vuri në dyshek që të vinte në vete. Njerëzit e shtëpisë ishin zhdukur dhe kishin mbetur vetëm pleqtë e plakat, se kujtonin se gjyshi i madh ishte bërë lugat. Plakut Mere i shërbente vetëm xherah Xheladin Durballia. Ai i tregoi edhe për ata që kishin ardhur në shtëpi për ngushëllim, edhe për ata që nuk e kishin ngushëlluar.

— Demek filani e filani nuk më dashkan! — e ngriti kokën nga jastëku plaku Mere.

— Ashtu del, — tha xherah Xheladin Durballia.

— Kush u gëzua me vdekjen time? — pyeti plaku Mere.

— Filani e filani, — tha xherah Xheladin Durballia.

— O hak i madh! T'i bësh hi, e t'i heqësh zvarrë, e t'i shposh në fytyrë e t'u lësh vrima atyre që s'më duan! O hak i madh, — mallëkoi plaku Mere.

Kështu tregojnë e këto nuk janë përralla, po të vërteta si netët.

Gjithë fshati Arun, e gjithë kazaja ç'merr mali i Kokallës e ç'zë lumi Krak u habitën me këtë ngjarje të padëgjuar ndonjëherë dhe thanë se tani do t'i vinte fundi botës. Pastaj njerëzit u mësuan, se plaku Mere jetonte me kandil të ndezur dhe pohuan se edhe fundi i botës nuk qenkësh gjë! Prandaj ngritën edhe një këngë që nuk dihet se kush e ka kënduar i pari. Kënga thotë:

Ty, mor plaku Mere,
në tabut të vunë,
të xhumanë e zezë
në varre të shpunë.

Po ti seç u ngrite,
thirre nga tabuti,
gjilpëra-gjilpëra
ç'na u bë vuxhuti.

Në tabut të lanë,
këmbët dhë s'u zunë,
Xheladin xherahu
të futi në gunë.

Xheladin xherahu,
më t'u thaftë dora,
s'e le plakun Mere
ta hante dëbora.

*Xherah Xheladini,
Xheladin xherahu,
ç'e solle lugatin,
më t'u thaftë krahu!*

Topi lëkundej nëpër koriye. Tri veta, një burrë, një grua e një djalë i vogël, ecnin të heshtur. Fshati Arun flinte. Shtëpia e Fizëve, përveç plakut Mere, flinte. Plakut Mere i therrnin koskat. Rrinte zgjuar, si dëshmitar i të gjitha gjërave. Ka kohë që është dëshmitar. Në atë odë ku rri plaku Mere, ka ndenjtur Duda, stërmbesa e tij. Papritur në atë dhomë e në atë shtëpi dikur pati çelur një lule dashurie. Bile kjo nuk ishte lule, po një kërcell i gjelbër, që sapo kishte filluar të dilte në mes të plisave të errët. Plisat e errët u shtrënguan pranë njëri-tjetrit dhe kërcelli i imtë mezi rritej. Ky kërcell i vogël ishte Duda, vajza e bukur e Fizëve. Ajo ra në dashuri me Ramizin, të vëllanë e babait të Mato Grudës. Ky ishte një djalë i pashëm dhe merrej me libra. Vetë kishte mësuar të lexonte e të shkruante dhe numërohej i pari në fshatin Arun mes njerëzve të zgjuar. Gjithë letrat që vinin dhe që dilnin, ai i lexonte dhe ai i shkruante. Duda ra në dashuri me këtë njeri të çuditshëm, që kishte mësuar shumë gjëra nga ca letra të shkruara, nga ca letra të qëndisura si ata qilimët që thurte ajo vetë në odën e shtëpisë. Plaku Mere nuk e donte këtë njeri. Thoshte se atij i kishte hyrë në bark shejtani Mulahimi dhe me ndihmën e shpirtit të lig i zgjidhte edhe mendimet që shkruheshin nëpër letra.

Ramizi e kërkoi vajzën, po nuk ia dhanë. Atëherë ai në një natë të errët u takua me të, e mori dhe iku nga fshati Arun. Njerëzit thoshin se ai kishte ikur në malet e Kelmendit. Plaku Mere dërgoi dy stërnipër bashkë me xherah Xheladin Durballinë gjer në malet e Kelmendit për ta vrarë. Stërnipërit e plakut Mere u veshën si lypës që të mos njiheshin, xherah Xheladin Durballia kishte marrë me vete brisqe e nishadër. Dy vjet të tërë u vërtitën nëpër Kelmend, por nuk i gjetën as Dudën, as Ramizin.

Ndërsa andej kërkoheshin Ramizi e Duda, këtej kishte plasur sherri. Shtëpia e Fizëve me shtëpinë e Grudëve kishte rënë në hasmëri. Plaku Mere mblodhi nipërit e stërnipërit rreth kandilit të tij dhe u tha duke numëruar tespihet: «Një kokërr nga tespihet e Grudëve të këputet. Ëndrra më thotë që të këputet kokrra që e quajnë Sulë, se Sula e ka shtyrë Dudën në mëkat, se Sula e ka lajmëruar Dudën të takohet me Ramizin.»

Katër stërnipër të plakut Mere i zunë pritë Sulës, vëllait të dytë të babait të Mato Grudës, dhe e vranë në arë tek hidhte farë. Kjo ishte e shtëna e parë në mes të dy fiseve në fshatin Arun. Më vonë u dëgjuan të shtëna të tjera më të rrepta, më të llahtarshme. Në përgjithësi në fshatin Arun janë vranë për dy gjëra: për gruan dhe për arën. Arën donin ta grabitnin, vriteshin. Gruan e dashuronin, vriteshin. Ara dhe gruaja ishin kthyer në legjenda në fshatin Arun. Për të dyja tregoheshin rrëfime dhe këndoheshin këngë. Shumica e këtyre rrëfimeve dhe këngëve ishin rrëqethëse, por kishte edhe gazmore. Rrëqethëse ishin kur arat grabiteshin dhe kur gratë dashuroheshin e iknin. Gazmore ishin kur arat jepnin grurë dhe gratë ishin të bukura dhe bënë dashuri të fshehur... Fshati Arun ishte nga fshatrat më të çuditshme të krahinës. Të çuditshëm e gjente edhe topi që futej brenda në fshat mes errësirës së natës. Edhe futja e atij topi ishte e çuditshme, e padëgjuar dhe e paparë. Para topit ecte Mato Gruda. Ai shtrëngoi ballin me dorë dhe psherëtiu:

— Ndririt kandili i plakut Mere, ndrit dhe nuk vdes plaku Mere. A një qind vjet është, a dyqind vjet është, asnjëri nuk e di, — tha ai me vete.

Ai nuk e vuri re një gropë në udhë. Qetë kaluan, po njëra rrotë shkau dhe topi mbeti i anuar. Zara thirri, pasi kujtoi se topi do të përmbysesj dhe do të pëlciste... Ajo e pushtoi me krahë të birin dhe e fshehu në gjoks.

— Mato, plasi! — thirri ajo.

Burri u zemërua:

— Budallaqe! Plaska topi pa gjyle!

Ai pastaj e urdhëroi të birin të dilte para qeve dhe vetë kaloi nga prapa. I bëri me kokë Zarës:

— Hajde ta shtyjme!

I qetë vuri duart në topin e anuar dhe i dha tërë trupit përpara. Edhe Zara shtynte me gjoks hekurin e ftohtë. Qetë lëvizën dhe topi ngadalë doli nga gropa. Mato Gruda përpoqi shuplakat për të shkundur dheun e lagur.

— Na prishi mendsh ky i mallëkuar! — shau Zara.

Njeriu me top shpejtonte tatëpjetë korijes. Çdo fëshfërimë dushku bënte që zemra e tij të trokiste më fort. Vetëm kësaj nate ai nuk donte të takonte njeri, nuk donte që dikush ta përgjonte që prapa dushqeve. Atij i vinte mirë që mëngjesi ishte ende larg dhe nata ishte e dendur. «Vallë do të ketë njeri tjetër në këtë natë, në botë, që të ecë kështu si unë me një top, si qerre? Xhanëm, që ka njerëz duke shtyrë topa, ka, po nuk ka të tillë si unë: me qe, me grua, me djalë... Hëm... Po Fizët flenë, ama!... Dëgjoni këtu, o Fizë!...» — thoshte me vete Mato Gruda.

Kur zbritën në fund të korijes dhe iu afruan shtëpisë, filluan të këndonin këndesat e parë. «Këndesat e mi! — tha Mato Gruda me vete. — Tani këndoni. Po ju vjen edhe ky babaxhani, o këndesa! Ju do të hipni në tytën e tij dhe do t'ia merrni këngës!»

Por Mato Gruda ende nuk kishte mbaruar punët. Me ta shpënë topin në shtëpi, do të shkonte përsëri në korije të ngarkonte mushkën me gjyle. Edhe këtë nuk ia kishte thënë Zarës. Ai e kishte zakon që gruas nuk ia tregonte gjërat përnjëherësh, por një nga një e dalngadalë. Këtë e bënte edhe për gjërat e ngatërruara e të frikshme, siç ishin gjylet.

Topi filloi të ngjitej në bregoren e shtëpisë. E tërhiqnin ngadalë Kazili i tij dhe Balashi i Muratit. «Tërhiqeni, o vëllezër, tërhiqeni! Ju m'i keni mbjellë arat shumë herë dhe keni qenë gjithnjë të papërtuar. Edhe unë ju kam dashur. Sonte më keni bërë një punë, që kurrë nuk ju ka shkuar në mend as juve, as mua!» — mendoi Mato Gruda, duke iu drejtuar shtëpisë.

Disa hapa larg shtëpisë kodra vinte e bëhej shumë e pjerrët dhe Mato Gruda filloi ta shtynte topin për t'ua lehtësuar barrën qeve. Edhe Zara e heshtur u përkul dhe vuri duart në tytë. Topi ngjitej ngadalë në kodër dhe qetë shtrëngoheshin dhe përkulnin kurrizët si hark. Duke u ngjitur topi, i ngjitej edhe Zarës ankthi në zemër. Po hynte në shtëpi një ezhderha që do t'ua prishte përgjithnjë gjumin dhe qetësinë. Ajo më shumë trembej për dy të bijtë, që i kishte aq të mirë dhe aq të bukur. Zara i ruajti ata nga sëmundjet — të dy i ruajti dhe i rriti. Kur binin të flinin, ajo shtrihej e veshur buzë dyshekut të tyre dhe përpiquej t'u këndonte këngë të lashta, gjersa t'i zinte gjumi. Ja, tani në këtë botë të hyn edhe një top! Ajo e merrte me mend se Mato Gruda diçka do të bënte me këtë top, diçka të tmerrshme, të padëgjuar... Po si, vallë, nuk mundi t'ia mbushte mendjen që të mos e sillte në shtëpi?

Zara nuk e ndjeu lehtësinë e peshës dhe vazhdoi të shtynte topin.

— Lëre, ç'e shtyn! — tha Mato Gruda. — Nuk e sheh se e ngjitëm?

Vërtet, topi kishte ardhur gjer te dera e plevicës. Zara i hoqi duart nga hekuri. Qetë qëndronin të lodhur.

Mato Gruda e zgjidhi litarin nga kulaçi i zgjedhës dhe pjesa e fundit e shtratit të topit zuri në tokë. Atëherë tyta e tij mbeti e ngritur, sikur po bëhej gati të hidhte diku larg ndonjë gjyle. Mato Gruda e lëmoi me pëllëmbë tytën e tha:

— Ka tytë të bukur!

Zara për herë të parë e pa me përbuzje të shoqin; iu afrua të birit, e përqafoi dhe ia lëmoi flokët.

— Ti, Mato, kurrë nuk i ke përkëdhelur fëmijët. Dhe ti nuk i do fëmijët... — tha ajo papritur.

Burrit i ra si rrufe kjo fjalë! Ç'hyjnë, xhanëm, këtu fëmijët?

— Ti s'je në vete, — tha ai, — nuk mendon se ç'flet!

Gruaja nuk iu përgjigj të shoqit, por iu kthye të birit:

— Zigur, shko fli, të keqen nëna!

— Jo, jo, s'është kohë gjumi! Ta futim topin në plevicë! — tha Mato Gruda.

Ai e ngriti pjesën e fundit të shtratit dhe e ktheu nga dera e plevicës.

— Shtyjeni tani! — urdhëroi burri.

Topi ngadalë u fut në derën e gjerë.

— Edhe pak! Ta shpiem rrzëzë murit.

Rrotat kërcitën dhe topi ndali rrzëzë çatmës. Mato Gruda mbushi një krah kashtë dhe ia hodhi përsipër për ta mbuluar. Ziguri e ndihmoi të atin.

— Tytën jashtë do t'ia lëmë? — pyeti Ziguri.

— Jo, bir, do t'ia mbulojmë, që të mos duket. Dhe dëgjo këtu. As një fjalë për topin... Askush s'duhet ta dijë...

— Po hallë Esmaja? — pyeti i biri.

— As ajo s'duhet ta dijë... Vetëm ne të tre duhet ta dimë. Ti je burrë tani dhe mund ta dish...

— Po ç'do t'i themi hallës, kur të na pyesë se ç'sollëm nga korija?

— Atje në qilar kam një palë këpucë, një xhaketë e një kobure, që ia mora një italiani të vrarë. Merri ato dhe tregoja hallës dhe thuaji se janë plaçkat që sollëm nga korija, — tha Mato Gruda.

Zigurit i ndritën sytë, kur dëgjoji për koburen, ndër-sa Zara u pre në fytyrë.

— Ke zhveshur një të vrarë?

— E ç'ë se kam zhveshur? Pse të kalbeshin bashkë me të edhe rrobat? E?...

— Sa ndoht, Mato, sa ndoht! — tha Zara.

— A ç'më çan kokën! — u nxeh Mato Gruda dhe iu kthye të birit: — Tani shko merr mushkën në qilar, se do të vemë përsëri në korije...

Zara u tremb:

— Ç'do të bëni në korije?

— Do të ngarkojmë ca arka, — tha Mato Gruda.

— Ç'janë ato arka?

— Xhephane... Gjyle... Ke parë ndonjë top të punojë pa gjyle? — tha Mato Gruda.

— Pupu! — bëri Zara. — Mato, Mato, po na e bën shtëpinë istikam!...

— A, ti dashke ta mbushim shtëpinë me qofte, me presh, me plënca e me bajga! Me gjyle do ta mbush, me topa do ta mbush, — thirri Mato Gruda, duke iu marrë fryma.

— Po të ndodhë ndonjë zjarr në plevicë, ku do të futemi? Gjylet do të na bëjnë hi! — tha e tronditur Zara.

— Ters të vete gjuha! — tha Mato Gruda dhe doli në oborr.

Ziguri solli mushkën. Mato Gruda i tha të birit që të hipte në samar, se do të qe lodhur më shumë, por djali nuk pranoi.

— Hip ti, baba! Unë nuk jam lodhur.

— E, mirë, rrugës shohim e bëjmë...

Atë e bir u nisën. Akoma mëngjesi nuk kishte zbardhur. Maja e Kokallës nxinte.

Zara i përcolli të shoqin dhe të birin me sy dhe e lodhur u drejtua për në shtëpi. Në shkallë ajo ndjeu zërin e hallës:

— Ç'u bëtë, moj nuse?

Gruaja ngjiti shkallët e heshtur. Kudo ishte errësirë.

KAPITULLI I PESTË

Mato Gruda punonte në kopsht me bel, Zara thurte një gardh atje ku kishte rënë muri. Përballë saj ishte plevica. Sa herë ngrinte kokën dhe shikonte plevicën, i therte zemra. Nën kashtën e grurit fshihej ai, fshihe-shin arkat. Pastaj ngrinte kokën nga oxhaku. Ai ishte larg plevicës, por ajo kishte frikë nga ndonjë shkëndijë. Tani edhe në oxhak nuk vinte shumë dru. Bile Mato Gruda një mbrëmje u zu me të.

— Pse nuk i hedh dru zjarrit? — pyeti ai.

— Është ai në plevicë... — tha ajo.

— Cili? — pyeti Mato Gruda.

Në këtë çast ai e kishte harruar atë. Po Zarës i erdhi mirë. Ajo donte që i shoqi ta harronte.

— Zjarr them unë! — shfryn Mato Gruda.

— Mjaft zjarr ka... Pastaj del ndonjë shkëndijë dhe bie në plevicë. — tha Zara.

Atëherë Mato Gruda u kujtua. E vështroi gruan me sytë e futur nën vetullat e dendura dhe tundi kokën. Ç'ishte kjo punë? Gjëja e fshehur në plevicë tani do ta linte pa zjarr? Po ç'ishte ky zi që kishte rënë në shtëpi? Njerëzit nuk flitnin si më parë, nuk qeshnin, nuk tregonin ngjarje. Vetëm hallë Esmaja qeshte. Ajo nuk kishte ndrysnuar. Por ajo nuk e dinte që në plevicë fshihej ai.

Tek thurte gardhin, Zara mendonte për shtëpinë, për

djemtë e saj, Zigurin dhe Sadikun. Në mes të tyre kishte ngritur grykën topi. Vërtet ai ishte i mbuluar me kashtë, por ajo e shikonte. Ai nxirrte tym, tym, tym... Le të kishte i shoqi njëzet kobure e njëzet pushkë e njëzet bomba, po vetëm këtë top të mos e kishte. Ta zëmë se Mato Gruda do të dilte partizan. E ç'e donte topin në mal? Ajo nuk kishte parë në fshatin Arun ndonjë partizan me top. Ku ta dish përse e do? Ndoshta do t'ua shpjerë topçinjve të malit? T'ua shpjerë atëherë një sahat e më parë, ta heqë që këtej.

— Zarë, pse s'flet? — tha Mato Gruda me bel në dorë.

Zara thuri shufrën që kishte në dorë dhe ngriti kokën nga i shoqi:

— Ç'të flas, Mato?

— Ç'tha halla? — pyeti Mato Gruda.

— I pa ato që ia kishe marrë të vrrarit dhe tha se për këto pak gjëra paskëshim shkuar në koriye të tre?

— Po ti ç'i the? — pyeti ai.

— I thashë se shkua për të parë istikamet italiane e për të kërkuar ndonjë plaçkë.

Mato Gruda qeshi. Pastaj e këshilloi gruan të kishte mendjen dhe të heshtte për topin. Gruaja iu afrua të shoqit, ia hodhi duart në qafë dhe rëndoi me tërë trupin e saj. Ai ia lëmoi me dorë flokët e saj të butë dhe të dy heshtën për një çast. Rreth tyre kopshti binte erë tokë të lagur. Mato Gruda lëmonte flokët e gruas. Beli ishte ngulur në kopsht pranë tyre. Bishti i tij i lëmuar ndriste nga rrezet e diellit, që kishte dalë nga një e çarë reje. Zara ngriti kokën nga gjoksi i të shoqit dhe e vështrroi me sytë e saj të mëdhenj të mbushur plot trishtim.

— Mato, — tha ajo, — pse e solle atë nga koriya? Ç'na duhet?

— Le të ndodhet, — tha Mato Gruda.

— Ç'të ndodhet? Ti nuk je në ushtri që të të duhet një top. Murati, Pertefi, Nevzati nuk kanë topa në shtëpitë e tyre. Me partizanët janë dhe s'kanë topa... Nuk e marr vesh, Mato, përse të duhet...

— Duhet, — tha Mato Gruda i menduar.

Ndërkohë në kopsht vrapoi Ziguri.

— Ç'ke? — pyeti Mato Gruda.

— Adnan Pinxhua vrau në arë të vëllanë e Ali Marukës. U zunë për sinorin... Adnan Pinxhua e kishte shtyrë sinorin tri hapa brenda arës së Aliut. U zunë... — tha Ziguri.

— E zeza e ëma! — tha Zara.

— Eh, krisi edhe një sherr tjetër! — psherëtiu Mato Gruda.

Po, krisi edhe një armë hakmarrjeje në fshatin Arun. Kishte ca muaj që këto krisma kishin heshtur. Njerëzit kishin halle të tjera dhe dukej sikur e kishin harruar hakmarrjen. Por ja, papritur, përsëri gjëmoi zëri i saj i lashtë.

Mato Gruda ra në mendime. Ai heshtte. Por Zara dhe Ziguri e kuptonin që ai fliste me vete, se lëvizte ngadalë buzët pa vështruar asnjeri.

— Ta kish Aliu atë që kam unë në plevicë, pa ta merrte vesh Adnan Pinxhua! — Mato Gruda këto fjalë i tha me zë të lartë. Zara dhe Ziguri shikuan njëri-tjetrin.

— Këta Pinxhot janë shumë të këqij, — tha Zara.

«Ata po shtyjnë sinorët në tokat e të tjerëve. Në pak vjet janë bërë pasanikë. Janë edhe tregtarë të pangopur. Xhanëm, i pasuron edhe ai dyqani» — mendoj Mato Gruda.

— Duhet të vemë te Aliu për ngushëllim, — tha Zara.

— Doemos, — ia ktheu burri.

Atyre tani nuk u punohej në kopsht.

Pas pak u ngjitën në odë dhe i treguan për gjëmën hallë Esmasë. Ajo, me të dëgjuar, hapi krahët dhe filloi të përplaste duart duke i pleksur dhe shpleksur gishtërinjtë, siç e kanë zakon plakat në raste gjëmash.

— I ziu Ali! E kishte më të mirin vëlla! Më trimin e më nikoqirin!

Hallë Esmaja filloi të vishej me rrobat e saj të zeza dhe të hidhte në kokë shaminë e re. Edhe Zara lidhi në kokë çemberin e zi, megjithëse nuk kishte dëshirë të

vente në shtëpitë që kishin gjëmë, se i dukej sikur ndillin ditë të zeza.

Të tre, Mato Gruda me hallën dhe gruan u nisën për në shtëpinë e Ali Marukës që mbante gati një orë larg.

Kur iu afruan shtëpisë gjëmëmadhe, dëgjuan kuje e ulërime të llahtarshme: «O derëziu, o! O i shuari, o!...»

Oborri gumëzhinte nga njerëzit. Burrat ishin të heshtur, gratë lebetiteshin. Nga oda e grave, ku ishte edhe meiti, dëgjoheshin ligjet e nënës së tij.

*Tre plumba të nxehtë mu në gjoks të ranë,
bir Kamberi i nënës, bir pëllumbi i bardhë.
Nëna mban qirinë, motrat po të qajnë,
më qafë të paçin Pinxhot me Adnanë.
S'të ndezi koburja, ndaj s'e more hakun,
me shami të kuqe nëna të mbledh gjakun...*

Mato Gruda u nda nga halla dhe nga gruaja dhe hyri në odën e burrave. Sipas zakonisht ai përqafoi Aliun dhe vëllezërit e tjerë dhe u ul në postiqe, si të gjithë. Në mes të burrave ai vuri re edhe Murat Shtagën, që mbante sytë përdhe i menduar. «Kudo do ta gjesh këtë Muratin» — tha me vete Mato Gruda.

— Kjo është një gjëmë e madhe për shtëpinë tuaj, vëllezër, — tha Murat Shtaga. — Edhe për fshatin tonë! Gjëra të tilla është turp të ndodhin. Ne kemi vetëm një hasm. Zaptuesin e kemi hasm!

Murat Shtaga u ngrit i zymtë dhe i pikëlluar.

— Unë po shkoj te Pinxhot. Dhëmbët kam për t'ia nxjerrë Adnanit. Dhëmbët, — shtoi ai

«E gjeti kohën — mendoj Mato Gruda. — Hë, dhëmbët! Nuk shkon t'ia numërojë në ballë, por në dhëmbët.»

Ali Maruka heshtte. Edhe ai do të donte që Murat Shtaga të mos i thoshte këto fjalë. Në qoftë se ai ishte burrë, duhej të shkante te Pinxhot dhe të bënte atë që i ka hije një burri: të nxirrte koburen që mbante në brez dhe t'ia hidhte trutë në erë.

Ndërkohë u dëgjua përsëri vajtimi i nënës:

*Bir Kamberi i nënës, bir pëllumb i bardhë,
nëna mban qirinë, motrat po të qajnë...*

Ali Marukës i shpëtuan lotë nga sytë. Ktheu kokën mënjanë dhe i fshiu.

— Qaj, e zeza nënë, qaj! — tha ai. — Po mos ki merak. Edhe unë do t'ua përvëloj shpirtin nënave e motrave e vëllezërve të asaj shtëpie!

Murat Shtaga, që ishte nisur për të ikur, qëndroi dhe ktheu fytyrën nga Aliu:

— Ajo nuk duhet të ndodhë! — tha ai dhe doli nga dera.

Mato Gruda qëndroi gjer vonë, shkoi edhe në varrim.

KAPITULLI I GJASHTË

Pas dy ditëve, filloi të binte shi me uturimë. Një shi i tillë nuk mbahej mend. Gjëmonte qielli e toka. Rrëketë e vogla zbritnin nga bregoret me rrëmbim dhe gjersa arrinin poshtë bëheshin si përrenj. Edhe oborri i Mato Grudës ishte mbushur me ujë dhe ishte bërë si gjol. Mato Gruda qëndronte në shkallë e shikonte shiun. Duke vështruar, i erdhi në mend italiani i vrrarë. Pastaj mendja i shkoi te topi dhe në shpirt ndjeu një lehtësi. Pas këtij shiu gjurmët e rrotave të topit duhej të ishin fshirë nga faqja e dheut. Asnjëri nuk mund të merrte vesh se ku u zhduk e ç'u bë topi.

— Bëri mirë që ra ky shi! — tha Mato Gruda me zë të lartë, po për vetë.

Zara kujtoi se i foli asaj.

— E ç'mirë bëri? Na mbyti arat, atë bëri! — tha ajo.

— I mbuloi edhe gjurmët e atij... — tha Mato Gruda.

— Nuk i mbulon dot gjurmët e atij. Gjurmët i thelloi më shumë.

— Mos fol budallallëqe! Edhe braza sikur të ishin, do të mbuloheshin — tha Mato Gruda.

— Ç't'i bëj se nuk digjet, se do ta kisha djegur dhe do t'ia kisha mbuluar mirë gjurmët, — tha Zara.

— Cilin?

— Topin, cilin tjetër! — tha Zara.

— E po ja që nuk është prej druri, — qeshi Mato Gruda.

— Mato, trego, përse e more topin? Ç'të duhet? Pse nuk llafosesh me ne si njeri?

Mato Gruda, nuk u përgjigj menjëherë. Ai e shikoi të shoqen drejt e në sy, pastaj uli kokën. Nuk donte as të përgjigjej, as të fliste për topin. Por gruaja donte një farë përgjigje.

— Të ndodhet. Njeriu është më i sigurt, kur ka një armë në shtëpi. Kohë luftime. Lufta do armë... — tha ai pa përcaktuar asgjë.

Zara nuk e besoi.

— Gënjen ti, Mato, gënjen, — tha ajo dhe kryqëzoi duart në gjoks.

— Kur nuk beson vetë, të duket sikur gënjejnë të tjerët.

— Ty të ka shtyrë Murati. Ai ta dha edhe kaun për ta sjellë atë ezhdërha në shtëpi, — tha Zara.

— Murati nuk di asgjë! Dhe shiko hap sytë se mos i llapësh gjë!

Zara iu afrua të shoqit dhe ia vuri dorën në sup:

— Mato, hajde të hapim një gropë të madhe e ta mbulojmë në selishtë!

— Ama llaf! E mbuluakemi topin...

— Do të vijnë gjermanët e do të na e gjejnë. Gjithë shtëpinë do të na e shuajnë... — tha Zara dhe buza e poshtme iu drodh.

— Gjepura! E ku u bie në mend gjermanëve se Mato Gruda paska një top! Hajde, kokë, hajde!

— Ata hyjnë nëpër plevica dhe kërkojnë bar për kuajt... — tha Zara.

— Ai është i mbuluar. Edhe të hyjnë në plevicë, do të marrin jonxhë e do të ikin...

— Po ata marrin edhe kashtë për t'ua shtruar kuajve. Kur të marrin kashtën, do ta zbulojnë edhe topin... — tha Zara.

Mato Gruda u drodh. Atij nuk i kishte shkuar në mend, se mund të ndodhte kështu siç thoshte Zara. Një gjë e tillë ishte e mundshme. Ndoshta për herë të parë ai u tremb për topin dhe filloi të mendonte seriozisht. Por e

mblodhi veten dhe e kuptoi se gruaja fliste me të vërtetë budallallëqe.

— Tutkune! — thirri ai. — E ku ke parë ti që kali të shtrihet e të flerë si lopa e si delja? Kali fle më këmbë. Ç'e do kashtën, kur qëndron më këmbë? Tutkune!

Zara u skuq. Ajo me gjithë mend gaboi dhe i erdhi inat me veten. Tërë jetën ka qenë e lidhur me kafshët dhe nuk e dinte se si fle kali.

Burri qëndroi sa qëndroi dhe zbriti poshtë shkallëve.

— Ku shkon? — pyeti Zara.

— Në plevicë! Ta shoh njëherë se mos është zbuluar, — tha ai.

Në fund të shkallëve Mato Gruda zbathi këpucët e çorapet dhe ngriti paçet e pantallonave për të kaluar nëpër ujën e oborrit. Shiu binte me rrëmbim. Ai vrapoi për të mos u lagur. Zara e shikonte nga kreu i shkallëve burrin që çapitej nëpër shi e pushtuar nga një trishtim i thellë. Asaj tani Mato Gruda i dukej njeri tjetër. Sipas mendimit të saj, ai gjithë kujdesin e dashurinë e kishte përqëndruar te topi. Disa herë hynte në plevicë dhe rrinte me orë të tëra. Në shtëpi fliste pak dhe gjithnjë mendohej. Bile edhe cigaren e kishte dendësuar.

Ndërkohë Mato Gruda hyri në plevicë. Vende-vende trualli ishte lagur ngaqë çatia prej kashte pikonte. Një pikë bile kishte rënë mbi topin e mbuluar. «Po të pikojë gjithnjë, do të ma ndryshkë. Sa të pushojë shiu, do të hip në çati e do ta zë atë pikë. Tfu, dreqi!» — tha Mato Gruda.

Ai ia hoqi kashtën nga tyta dhe qëndroi i heshtur para saj. Nga jashtë vinte zhurma e shiut. Mato Gruda u mbështet në hekurin e murmë, siç mbështetej ndonjëherë në qafën e mushkës.

— Do të flesh edhe pak, — i tha tytës. — Pastaj do të zgjohesh dhe do të kollitesh nja dy-tri herë. Akoma nuk e di ti fatin tim të zi. As atë natë të llahtarshme nuk e di, se ende nuk ishe gatuar... Shtëpia jonë atë natë flinte. Unë me gjyshen e me hallë Esmanë kishim shkuar mysafirë te dajallarët. Kam qenë i vogël fare, por të gjitha këto m'i kanë treguar. Fizët zbritën nëpër korije të ngarkuar me shakuj të mbushur plot. E ç'kishte në ata shakuj? Ki-

shte vajguri. Erdhën vjedhurazi-vjedhurazi dhe, kur të gjithë flinin, i hodhën shakujt me vajguri në bodrumet e shtëpisë. Pastaj... ç'të tregoj... Pastaj... ndezën pishën dhe e flakën në bodrum... Shtëpia humbi në mes të flakës. Mes kësaj lemerie vdiq babai im, Ziguri — djali im i madh mban emrin e plakut, rahmet pastë; vdiq Sadiku — djali im i vogël mban emrin e xhaxhait, rahmet pastë; vdiq Xhemilja, nëna ime, rahmet pastë; vdiq Zeneli, vëllai im, rahmet pastë; vdiq motra ime, Ganimeti, rahmet pastë!... Edhe unë do të digjesh, edhe hallë Esmaja do të digjej, por nuk u ndodhëm në shtëpi. Kjo që tregova nuk është përrallë. Dajallarët e mi vranë nja dy nga Fizët, por Fizët i shuan edhe dajallarët, se kanë qenë shumë të djallëzuar dhe shumë finokë. Pleqtë e fshatit e panë që zjarri u zgjerua pa masë, e pleqësuan punën dhe e shuan flakën. Fizët donin të më vritnin edhe mua që të vogël që të mos u nxirrja telashe kur të rritesha, por nuk më vranë.

Gryka e topit, e zgjatur nëpër kashtë, dukej sikur rrinte e dëgjonte. Plevica ishte në gjysmerrësirë dhe rreth mureve të thurura me gardh bridhte era.

— Kanë ndodhur shumë gjëra, o babaxhan, para se të vije ti, po... — Mato Gruda nuk e mbaroi fjalën, se krisi dera e plevicës. Ai ktheu kokën dhe pa Zarën që qëndronte më këmbë me flokë të lagur.

— Mato, Mato! Ti llafosesh me... atë!

— Unë llafosem? Mos të bëjnë veshët?

— Ti ke një sahat që llafosesh! Unë në fillim kujtova se i flisje Muratit, po i folke topit... Dhe thua llafe të llahtarshme... Gjëmë e madhe do të na gjejë, Mato! Pupu, djemtë e mi! Po na shuan shtëpinë, Mato!

Ajo i ra në gjoks burrit gati duke qarë. Në tytën e topit ra një pikë nga çatia dhe hekuri tingëlloi. Burri nuk fliste.

— Mato, pse s'flet? Ti vetëm me topin flet! — thirri Zara.

Atëherë ajo u shkëput nga gjoksi i burrit dhe iu lëshua grykës së topit. I mbylli grushtet dhe filloi t'i binte me sa fuqi që kishte pa ndier dhembje në duar. Mato Gru-

da dëgjonte tingullin e mbytur të hekurit të përzier me fjalët e Zarës:

— Qofsh mallëkuar, qofsh mallëkuar!

Më në fund e lodhur ra në kashtë nën grykën e topit dhe Mato Gruda ndjeu ngashërimin e papërmbajtur të saj.

— Ti po luan mendsh, Zarë! Ngrehu!

— Lërmë! Ti ke shkalluar! Ti do t'u bësh varrin Zigurit e Sadikut. Të gjithëve do të na bësh varrin! Lërmë!
— ajo ia shtyu me forcë dorën burrit.

Mato Gruda i hutuar mori ca kashtë dhe ia vuri për-sipër tytës. Ai në këto çaste nuk donte ta shihte atë grykë të hekurit.

Zara u ngrit ngadalë, shkundi nga fustani kashtën dhe me kokën lart doli nga plevica pa vështruar të shoqin.

Me të ikur gruaja, burri u ul në një kosh me kashtë dhe vuri të dyja duart në kokë. Zara atë e trembi. Asaj nga mërzia mund t'i shfaqej ndonjë sëmundje e keqe. Ka ndodhur që gratë nga merakuri edhe kanë luajtur nga mendtë.

Kur u ngrit, shiu kishte pushuar, po toka ishte tërë ujë dhe oborri vazhdonte t'i ngjante një pellgu. Mato Gruda mori në qilar një bel dhe shkoi të hapte grykat e vijave për të kulluar uji. Me bel në dorë ia filloi punës dhe gjithçka të ligë harroi. Frynte një erë e ftohtë, po ai nuk e ndiente, se e kishte nxehur puna. Pas pak nga grykat e vijave të oborrit filloi të shushurinte uji dhe Mato Grudës iu kujtua koha e vaditjes në verë, kur mbusheshin brazdat dhe shushurinte uji i vakët. Ai e ndjeu se e kishte marrë malli për arat e për verën e ngrohtë. «Punon, punon dhe rri pastaj nën hije të ndonjë kumbulle dhe çdo gjë të duket e bukur dhe e mirë» — tha Mato Gruda me vete.

Pasi hapi nja dy vija, ai doli para portës. Vuri duart në ijat dhe qëndroi për një çast duke vështruar rrugën e lagur. Ndërkohë vuri re Aliun tek kalonte me duar në xhepa. Aliu, i gjatë e me pak kurriz, ecte rrëzë hendekut me çibuk në buzë, duke u lëkundur në këmbët e holla. Mato Gruda nuk e kishte takuar pas vrasjes së të vëllait.

— Si u ngryse, Ali? — pyeti ai.

— Të mos ankohe mi! — tha Aliu.

— Më ka ardhur shumë keq për gjëmën që ju ndodhi, Ali, — tha Mato Gruda.

— Njeriu i heq edhe të këqijat, — tha Aliu i menduar. — Por Kamberi la nëntë fëmijë të vegjël... Si do të rriten!

— Njeri i poshtër paska qenë ky Adnani, — tha Mato Gruda.

— Kamberi shkoi e vate, po kam frikë se do të shkojnë edhe të tjerë. Vëllezërit e mi janë egërsuar dhe duan të marrin hak.

Mato Gruda vështronte këpucët e veta. Atij nuk i pëlqyen fjalët e Aliut. Vetëm vëllezërit dashkan të marrkan hak? Po Aliu dashka të bëjë sehir? Ne për një nder jetojmë!

— Nuk dua, Mato, të vazhdojë sherri. Mirë e kishte Murat Shtaga atë ditë... Vëllezërit thonë se, sikur të kishin një top, do ta kishin bërë hi e pluhur shtëpinë e Pinxhove...

Me të dëgjuar fjalën «top», Mato Gruda u drodh. Si ishte e mundur që kjo fjalë të qëllonte papritur në shpirtin e tij? Ç'ishte kjo përputhje? Por në jetën e përditshme ndodh që të përputhen përfytyrimet e njërit me të tjetrit, megjithëse dy njerëz që bartin këto përfytyrime nuk kanë asnjë lidhje me shoku-shokun. Mato Gruda kishte vetë top, Aliu, pa ditur gjë, ia përmend atij këtë fjalë!...

— Top, xhanëm, s'ke ku të gjesh! — tha Mato Gruda, sikur kërkohet prej tij një mohim i tillë.

— Fjala që vjen, — tha Aliu dhe heshti për një çast, pastaj shtoi: — Nuk është koha të hapim zjarre të liga në vatrat tona! Thonë se po vjen gjermani. Andej nga Korça ka ardhur.

Mato Grudës iu kujtuan fjalët e Muratit. Ato paskan hyrë edhe në mendjen e Aliut!...

— Unë Adnan Pinxhon e vritja... — tha Mato Gruda.

— Po të shkonte me gjermanët, edhe unë e vritja, — tha Aliu, duke psherëtirë dhe u largua në rrugën tërë baltë e pellgje.

Mato Gruda vazhdonte të qëndronte para portës i me-

nduar. Ky Murat Shtaga kudo qenka futur. Me mendje ai e shihte këtë njeri tek lëvizte nëpër fshat, tek shkante shtëpi më shtëpi, mes hasmëve të përjetshëm e mes njerëzve të zemëruar me njëri-tjetrin. Rrinte e pinte kafe, ndizte cigaren dhe fliste. Shkante edhe mes hasmëve të fisit të vet, hynte në oborr dhe qetë-qetë ulej në odë pranë zjarrit. Sikur të kishte me vete me qindra fuçi uji, besonte se do t'i shuante tërë zjarret e hakmarrjes. Por ai nuk e dinte se shoku i tij Mato Gruda fshihte në plevicë diçka të tmerrshme!

Mato Gruda qëndroi një copë herë më këmbë para portës, e përcolli gjatë me sy Aliun dhe u kthye përsëri në oborr për të hapur vijat e ujit.

Tek ishte kredhur në mendime, dëgjoji një zë:

— Kulloje gjolin, o Mato Gruda, kulloje; sikur do ta mbjellësh!...

Ishte Murati.

«Ç'do ky? Mos e ka nuhatur topin? Mos e ka pikasur i dërguari Xhabir?» — dyshoi Mato Gruda.

Murati qëndronte te porta.

— Hajde, Murat! — tha ai me bel në dorë.

— Erdha për një punë me axhele.

Mato Grudës i theri diçka në zemër! «Mos i ka shkarrë gjë gjuha Zarës?»

— Hair ishallah!

— Jemi mbledhur ca burra nga fshati dhe do të shkojmë t'i mbulojmë ata italianët e vrrarë. Çiliminjtë kanë gjetur një trup njeriu në përrua. I kanë marrë ujërat me vete. Po nuk i mbuluam, do të përhapet ndonjë sëmundje, — tha Murati.

Shokut i shkriu gjaku. Ja përse paska ardhur Murati! Ka të drejtë. Të vdekurit duhen mbuluar. Trupi që kanë parë çiliminjtë duhet të ketë qenë i italianit që ia mora plaçkat.

— Kur do të shkojmë?

— Që tani.

— Të pimë një kafe.

— Jo, jo, se vonohemi e në errësirë nuk i gje të vrrarët, — tha Murati.

Mato Gruda shkoi të mbathej e të vishej. Në shkallë doli Ziguri dhe iu lut të vente edhe ai me të. por i ati e kundërshtoi:

— Nuk është punë për ty!

— Kur e morëm topin nga korija, ti më the se unë jam burrë! — tha Ziguri.

— Shët! Gomar! — u nxeh i ati dhe shikoi vjedhura nga oborri. E kafshoi buzën dhe ia tundi me inat kokën të birit.

Pa i folur Zigurit, u drejtua nga porta. ku e priste Murati.

Të dy burrat u fshehën prapa plevicës.

KAPITULLI I SHTATË

Në mbrëmje, pasi pastruan korijen nga ushtarët e vrarë, Mato Gruda dhe Murati u kthyen në shtëpi. Zara ndezi në oxhak zjarrin, se ishte freskët, dhe vuri në vatër xhezven e kafesë. Ata pinin duhan e këmbenin rrallë e tek ndonjë fjalë.

— Unë kujtova se do të gjenim më shumë të vrarë,
— tha Murati.

— Po të mos ishin dorëzuar, do të ishin vrarë më tepër, — u përgjigj Mato Gruda.

— Ne u dolëm nga borxhi. U thirrëm të dorëzohe-
shin, por në fillim nuk deshën.

— Ajo i bëri që të lënë edhe ata pesë a gjashtë të vrarë, — tha Mato Gruda.

Ata pastaj heshtën. Në zjarr kërcitnin drutë dhe flaka lëpinte muret e kllanikut. Zara e shtiu në filxhanë kafënë dhe ua vuri përpara burrave. Vetë u ul në një postiqe, mori shtizat dhe filloi të thurte çorape. Jashtë lehnin qentë dhe dëgjoheshin zilet e dhive. Burrat pinin kafe.

— Armët e të dorëzuarve i nisëm që dje në shtabin e zonës. Shkoi edhe i dërguari Xhabir, — tha Murati.

— Kishte shumë armë!

— Kishte, — pohoi Murati. — Por një top, dreqi e merr vesh, se si u kishte humbur në korije. Sipas fjalëve të komandantit të tyre, duhet të ishin pesë topa. U gjen-
dën katër.

Mato Gruda u vrenjt. Gruaja uli sytë. Ajo e ndjeu

se po i dërsinin gishtërinjtë që shtrëngonin shtizat. I shoqi zgjati dorën në vatër dhe mori një thëngjill.

— Topi nuk është kobure që të humbë aq kollaj, — tha ai, duke ndezur cigaren me thëngjill.

— Ashtu mendoj edhe unë. Ndoshta ajo skuadra që nuk u dorëzua, e mori me vete për t'ua shpënë gjermanëve, — tha Murati. — Këtë mendim pati edhe i dërguari Xhabir.

— Ka të ngjarë!

Murati liroi rripin e revolverit dhe e shtyu me dorë këllëfin prej meshini. Tyta e revolverit zuri në postiqe. Arma ishte e njëllojtë me atë që Mato Gruda ia mori italianit të vrarë.

Ai u shtri pakëz, mbështeti faqen në pëllëmbë të dorës dhe psherëtiu. Kjo ishte psherëtima e një njeriu të lodhur e plot brenga.

— Eh, more Mato!

— Çfarë! — tha Mato Gruda.

— Punët venë keq në fshat, — tha Murati.

— Fshat i lig, — tha Mato Gruda. — I lig dhe i egër.

Murat Shtaga nuk u përgjigj.

— Fiset e fshatit tonë e kanë inat njëri-tjetrin. Ta hanë, nuk ngopen, — shtoi Mato Gruda.

— E, si thua ti, tërë jetën kështu do të mbetet ky fshat, i përçarë? — tha Murat Shtaga pa e hequr dorën nga faqja.

— Ma merr mendja...

Murat Shtaga bëri sikur nuk e dëgjoi përgjigjen e Mato Grudës. Ai rrinte shtrirë dhe shikonte zjarrin. «Vërtet, — mendoi ai — keq venë punët!»

Fshati Arun, që shtrihej në dy faqet e një kodre, një çerek ore larg xhadesë, përbëhej prej pesë fisesh: Fizët, Shtagët, Marukët, Pinxhot dhe Grudët.

Fizët ishin përhapur në dyzet shtëpi të fshatit Arun. Fjala e tyre gjithnjë ka qenë ndier, se kanë qenë edhe në gjendje të mirë ekonomike. Por dal-

ngadalë shumë toka të tyre i blenë Pinxhot, pasi ata grumbulluan para, duke bërë tregti, e duke punuar nëpër sharra e dërstila, ku thurej shajaku dhe velenxat. Disa nga Pinxhot bile ishin më pasanikë se i pari i Fizëve. Prandaj Adnan Pinxhoja shpesh bënte shaka me plakun Mere:

— Të rroftë dera e madhe ty! Derën tani e bën paraja, o gjyshi i madh! Ikën ato kohëra nga porta jote dhe hynë në timen... A do të shesësh ndonjë arë? I dëgjon si tringëllijnë të verdhat në xhepin tim? Dëgjoji, o gjysh i madh, dëgjoji.

— Malum! O hak, largoje Shimbër Shimbërllarin, jezitin dhe lugatin e verdhë! — thoshte plakun Mere, duke bërë magji.

— Edhe magjinë ta ble unë, — qeshte Adnan Pinxhoja.

Adnan Pinxhoja ishte njeri pa cipë, njeri me një sjellje të keqe, në të cilën bashkohej fodullëku me paturpësinë dhe cinizmin. Ai nuk i besonte asgjëje në botë përveç parasë, të cilën e nxirrte nga gjithçka: nga toka dhe uji, nga druri dhe guri, nga kripa dhe sheqeri, nga gozhda dhe gjilpëra. Në fshatin Arun, në lagjen ku kishte më shumë shtëpi, ai kishte hapur një dyqan dhe shiste çdo gjë për nevojtarët. Atyre që nuk kishin para, u merrte ose bereqet, ose mbante shënim në fletoret e trasha të tij dhe, kur vinte koha, ua merrte arën apo korijen. Në ato fletore ishte shënuar edhe ara e Murat Shtagës, të cilën më në fund e mori. Murat Shtaga mblodhi para dhe donte t'ia blinte përsëri, por ai i kërkoi dyfishin. Atëherë Murat Shtaga për inat i dha dyfishin dhe ia mori. Duke numëruar napolonat, Murat Shtaga i tha:

— Do të vijë koha që do të t'i marr të gjitha arat dhe dyqanet pa para, Adnan Pinxhua.

— Atë kohë unë e kam lidhur me zinxhir në malin e Kokallës dhe nuk ka për të ardhur kurrë,

— i tha Adnan Pinxhoja duke qeshur me buzët e tij të holla pa kripë, pa ngjyrë.

Murat Shtaga ia përplasi napolonin e fundit në tavolinë dhe tha:

— Unë po i pres zinxhirët në malin e Koka-llës, — dhe doli nga dyqani pa kthyer kokën.

— Hi-hi! — qeshi thatë Adnan Pinxhoja, duke futur paratë në sirtar dhe shtoi: — Të gjithë në këtë sirtar do të futeni, nuk keni nga të shkoni. Në këtë sirtar do të fut edhe plakun Mere me gjithë Fizët, edhe Nevzatin me gjithë Marukët, edhe Maton, të fundin e Grudëve. Ky sirtar ju pret, o të zes! Edhe gratë tuaja këtu do të futen.

Gratë! Ato ishin dobësia më e madhe e Adnan Pinxhos. Gruan e tij e mbajti vetëm një natë pas martesës dhe në mëngjes herët e përzuri nga shtëpia.

— Më doli krimbkë, si kokrra e arrës që e ka shpuar krimbi. Po krimbi s'duket në lëvozhgën e arrës. Hi-hi! Unë e çava dhe, hop, gjeta krimbin, — kishte thënë dhe kishte përpjekur buzët e holla të paturpshme.

Dhe nuk u martua. Por, kur venin gratë në çesmë për të mbushur ujë, ai u afrohej dhe bënte shaka pa kripë me to.

— Unë nuk kam grua! Jam vetëm! — u thoshte.

— Pse na i thua këto, — thoshin gratë.

— Jo po që t'jua kujtoj, — skërmiste dhëmbët Adnan Pinxhoja.

Ai donte ta shtinte në dorë edhe Shegën, stërmbesën e plakut Mere. Duke u martuar me të, ai ëndërronte të merrte edhe pjesën më të madhe të arave të Fizëve.

— Pastaj ajo është edhe e bukur! Hi-hi! Ja, këtu në sirtarin e parave të mia do të të fut edhe ty, moj Shegëz, stërmbesa më e bukur e plakut Mere, moj sulltanllokumkëzë e Stambollit! Hi-hi! — dhe fërkonte duart e djersira.

Të gjithë Pinxhot përbëheshin nga pesëmbëdhjetë shtëpi. Ata shkonin mirë me Fizët, por i madhi i Fizëve, plaku Mere, i kishte zili se po bëheshin më të fuqishëm se ai.

Më të varfrit ishin Shtagët dhe Marukët. Shtagët kishin tetëmbëdhjetë shtëpi dhe Marukët njëzet e pesë. Mes tyre ka pasur një hasmëri të lashtë, që nxirrte kokën herë pas here. Por hasmëria më e madhe në fshat ishte ajo e Fizëve dhe e Shtagëve. Murat Shtaga punoi me natë e me ditë për t'i dhënë fund kësaj hasmërie dhe për t'i hedhur Fizët dhe Marukët nga ana e tij. Si t'i hidhte nga ana e tij Marukët, të punonte edhe me Pinxhot, veçanërisht me ata më të varfrit dhe më hallexhanët, siç thoshte edhe vetë. Mirëpo kohët e fundit edhe mes Pinxhove dhe Marukëve u ndez një hasmëri e egër. Pinxhot, si më të fortë, gjithnjë mundoheshin t'ua rrëmbenin sinorët dhe i ngushtonin. Por Marukët ishin edhe të ndershëm, edhe trima. Këta të fundit nuk donin të hapnin një sherr të madh, se atëherë do t'i sillnin dëm Lëvizjes Nacionalçlirimtare, prandaj ruheshin nga hasmëritë. A, kur Pinxhot ua bënë borxh dhe ua sillnin në majë të hundës, e humbisnin durimin.

Sa për fisin e Grudëve, as mund të flitej. Nga Grudët kishte mbetur vetëm një shtëpi, ajo e Matos. Po të mos ishin vrarë me Fizët, tani do të numëroheshin mbi pesëmbëdhjetë shtëpi. Prandaj Mato Gruda nuk fliste me Fizët. Ai e ndiente veten më të vetmuar në Arun dhe kjo për fajin e Fizëve. Edhe tokat e Grudëve të vrarë tanimë u kishin kaluar Fizëve.

Mato Gruda shkonte mirë me Shtagët dhe Marukët, se të parët e tij kishin bërë ilakara me ta. Edhe me Pinxhot nuk shkonte keq, por nuk i kishte aq të afërt, se i quante njerëz pa nder e pa besë. «Të vrasin natën e të qajnë ditën» — thoshte ai kur vinte fjala për Pinxhot.

Kështu, fshati Arun, i përbërë nga pesë fise

dhe nga nëntëdhjetë e nëntë shtëpi, jetonte me plot trazira në këmbë të malit Kokallë e në kodrat mbi lumin Krak.

Nëse Shtagët ishin të lidhur me Lëvizjen Nacionalçlirimtare, Fizët, si hasmë të tyre, duhej të bënin diçka tjetër, të hidheshin nga ana e Tosun Baçit, një komandanti ballist. Por, në qoftë se Fizët do të hidheshin me Tosun Baçin, atëherë edhe Pinxhot, me siguri, do të vinin pas tyre. Pinxhot, bile, i kishin thënë Muratit:

— Ne presim se ç'do të bëjë plaku Mere. Nga të shkojë plaku Mere, do të shkojmë edhe ne.

Më i rrezikshmi nga Pinxhot ishte Adnan Pinxhoja, i cili shpesh e kishte pritur në shtëpinë e vet Tosun Baçin dhe kishte pirë e kënduar me të. Por edhe Tosunin nuk i kishte dhënë fjalën për t'i rënë pas, se ende nuk ishte i bindur plotësisht.

Murat Shtaga nuk i humbte shpresat. Ai e dinte që edhe brenda për brenda një fisi kishte marrëveshje. Një palë mund ta simpatizonin Tosun Baçin, por një palë mund ta simpatizonin edhe Muratin. Kështu ndodhi me Marukët. Nevzati u bë me Muratin, megjithëse Marukët e tjerë e shanë dhe i thanë se shtëpia e Murat Shtagës ishte në hasmëri me shtëpinë e tyre dhe se Nevzati i turpëroi, duke u bërë shok i hasmit.

Murati qëndronte shtrirë me faqe të mbështetur në pëllëmbë të dorës dhe mendonte.

Zjarri digjej dhe Mato Gruda heshtte.

— Keq! — tha Murati, sikur të zgjohej nga gjumi.

— Hë, keq! — tha Mato Gruda.

Murat Shtaga lëvizi nga vendi.

— Dhe ne bëjmë sehir! Lufta ka përfshirë tërë vendin, ne dergjemi në kulla dhe mendja na punon për hasmëri, si e si t'i zëmë pritë njëri-tjetrit... — tha ai.

Mato Gruda uli sytë përdhe.

— Po s'u qëruan hesapet me hasmët, s'kemi prokopi, — tha Mato Gruda.

— Si me hasmët?...

— Të marrim njëherë hak për nderin e vatrave tona, pastaj të luftojmë për të mirën e vendit.

Murat Shtaga qeshi hidhur. Zara e vështroi dhe u skuq. Asaj iu kujtua topi i fshehur në plevicë, topi me tytë të mbuluar me kashtë. Topi rrinte atje i ngrehur për punë të liga, kurse Murati mundahej të shuante zjarrin e ligësive. Nuk e dinte Murati se një thëngjill i madh kishte rënë në kashtë dhe nga çasti në çast priste të shndërrohej në flakë. Edhe kullat e tjera nuk e dinin këtë thëngjill...

— Të marrim hak? — tha Murat Shtaga. — Hak? U lodhëm, Mato, nga këto plagë. Brenda pesëdhjetë vjetve janë vrarë me hasmëri në fshatin tonë 200 njerëz. Akoma po vritemi. Adnan Pinxhua vrau të vëllanë e Ali Marukës. Me të huajt vritemi, me tanët vritemi... Hak! Një hak duhet të marrim, hak ndaj armikut. Nuk dëgjoni? Në djall të veni! Nxirrni sytë me shoku-shokun... Njerëz të mallëkuar... Fshat i mallëkuar, — thirri Murat Shtaga papritur dhe u ngrit më këmbë me revolver të varur në rripin e çliruar.

Mato Gruda dhe Zara hapën sytë. Ata nuk e kishin parë Muratin në një gjendje të tillë dëshpërimi dhe zemërimi.

— Dale, Murat! — tha Mato Gruda, duke u ngritur.

Murat Shtaga i zbetë qëndronte në mes të odës në një pozë të çuditshme. Mjekra e tij e parruar gati i kishte rënë në gjoks, duart vareshin paralel në këllqet e thata të tij. Ndoshta ky shpërthim dëshpërimi vinte si përfundim i mundimit të tij shtëpi më shtëpi për t'i bindur njerëzit e për t'i kthyer në udhë të drejtë.

Ai për një çast e mblodhi veten, hodhi një vështrim nga Matoja e Zara dhe u ul përsëri. Fytyrën e tij tani ia mbuloi një ngjyrë e kuqe. Atij i erdhi turp nga vetja.

— Jo! — tha ai. — Ne nuk do të lejojmë që ju të nxirrni sytë me njëri-tjetrin!

Pas këtyre fjalëve ra heshtja në odën e zhytur në murgëtirën e mbrëmjes. U krijua një gjendje e vështirë për të ngarë bisedën.

Ata ndenjën gjatë pa folur. Në vatër ndriste zjarri

dhe kërcitnin drutë e ahut si dyfekë të largët, të vetmuar. Murat Shtagës i shkuan mendtë në male. Ai do të donte të ishte më mirë në mes të partizanëve, sesa në fshatrat me këtë punë të vështirë të «njeriut të terrenit», të njeriut të agjitacionit. Në mal ke armikun dhe ndeshesh me të ballë për ballë. Po në terren? Ndeshu, po të duash! I mbushet mendja Matos? I mbushet mendja Adnanit? I mbushet mendja plakut Mere? Qarkori pastaj të thotë: «Shok, s'ke ditur të punosh!»

Në këtë kohë Murat Shtagën e zgjoi zëri i Mato Grudës:

— Këta Fizët nga Tosuni anojnë?

Zara i la shtizat dhe mbajti vesn. Ajo e dinte se ç'përgjigje do të dëshironte të merrte Mato Gruda. I shoqi i saj donte që Fizët të venin me Ballin dhe të ngatërroheshin me ata të Tosun Baçit. Domosdo, inati i tij atëherë do të shtoej...

Murati ngriti kokën e tij të madhe dhe shtrëngoi vetullat e trasha me pëllëmbë:

— Fizët, the? Janë njerëz të mbyllur, ku ta dish?

Mato Gruda iu përgjigj me një ton qortues:

— Ti ke hyrje e dalje me ta, megjithëse edhe shtëpia juaj ka pasur hasmëri.

— Ç'hyrje e dalje? Vete me punë... Po dëgjo vëllanë ti, s'e besoj që Fizët të shkojnë me Tosun Baçin. Ç'është e vërteta, plaku Mere ka miqësi me Tosunin.

— E sheh? Qenka punë e mbaruar! — tha Mato Gruda dhe i ndritën sytë.

— Fizët nuk do të shkojnë pas Meres. Një plak matuf, i sëmurë.

— Plak matuf the? Ehé! I sëmurë? Nuk vdes ai...

Murati e vështroi shokun e tij si për t'ia kuptuar mendimet.

Duke luajtur me tytën e revolverit, tha:

— Ti ke qejf që Fizët të shkojnë me Ballin? Ashtu, Mato?

Zara u ngrit dhe ndezi kandilin, se në odë kishte filluar errësira. Dy burrat i prenë fjalët dhe shikonin zjarrin në vatër. Murati ndjeu një keqardhje të madhe për sho-

kun e tij. «Sikur Mato Gruda — mendoj ai — të ishte ndo-
një komandant partizan, do të përpiqej që gjithë hasmët e
vjetër të tij t'i mërzieste dhe t'i bënte me zor armiq. Ka
njerëz që për hir të tekave të tyre, t'u sjellin dëm edhe
gjërave më të shenjta. Këtë Mato Gruda nuk e kupton
dhe bile është shumë vështirë ta kuptojë...»

Mato Gruda u përgjigj me vonesë:

— Për mua Fizët janë të poshtër. Ç'të duan le të bëj-
në... dhe dëgjo, Murat, — ai u nxeh, — në qoftë se ju i
pranoni në mal, nuk qenkeni të drejtë...

Murati buzëqeshi me zor:

— Dhe ç'do të bësh ti atëherë?...

— Unë... unë do të... Ja ku ta them që ta dish... —
dhe ai tha ca fjalë pa kuptim.

Mato Grudës i dolën në ballë bula djerse. Këtë djersë
ai e ndjeu edhe në kofshë. Gishtërinjtë që mbanin ciga-
ren i dridheshin. Zarës nuk i pëlqyen fjalët e të shoqit dhe
i vari vetullat mbi çorapen që thurte. Nuk do të ishte punë
e nderuar, sikur Mato Gruda të ndahej nga shoqëria.

Murati shtrëngoi rripin e revolverit dhe u ngrit.

— Eh, Mato! — tha ai përsëri.

— Rri, Murat, pse ngrihesh? — tha Zara.

— Kam punë! Falemnderit! — pastaj iu kthye Matos:
— Shiko, na kanë ardhur nga qyteti nja dy dengje me
plaçka për partizanët. A ke kohë t'ua shpiesh në mal
partizanëve? Merre edhe mushkën time dhe nis.

Mato Gruda e vështroi me vetulla të vrenjtura. «Ky
Murat Shtaga dalngadalë edhe mua po më bën si veten
e vet, «njeri të terrenit» — mendoj ai.

— Mirë është të shkosh që nesër.

— Në shtëpinë tënde janë plaçkat?

— Në shtëpinë time, — tha Murati. — Merrja nënës,
se unë nuk do të jem. Edhe shiko, për nja dy ditë të vjen
edhe ai italian. Vetëm hap sytë nga gjermanët...

— Hiç merak të mos kesh!

Zarës i rrahu zemra:

— Italian?

— Italian. Do ta mbani në shtëpi t'ju ndihmojë! Të
tregon Matua. Natën e mirë!

Burrë e grua e përcollën Muratin gjer te porta.

Sa iku ai, Zara e pikëlluar u mbyll në odë. Nuk mjaftonte vetëm topi, po na tani edhe një italian. Cilin të ruash më parë nga gjermanët, topin apo italianin? Ç'është ky mallëkim për këtë shtëpi? Mato Gruda po luante mendsh!

Në hajat u dëgjua kolla e të shoqit. Gruaja mbuloi fytyrën me duar dhe u shtri në postiqe.

— U lodhe, Zarë? — pyeti ai.

— Ti po më ha të gjallë!

— Unë?

— Po ma solle italianin, do të marr një dru, do ta zhdëp mirë e mirë dhe do ta përze! — iu lëshua ajo burrit.

— Ai do të na ndihmojë në punë dhe do ta kemi si hyzmeqar. Kur të mbarojë lufta, do ta përcjellim në Itali.

— Kur të mbarojë lufta, mbarojmë edhe ne. — tha Zara.

— Gjepura!

— Pse nuk del si shokët partizan, po merresh me topa e me ca italianë të ngordhur? Turp të kesh! — Zara i ishte afruar fare të shoqit dhe qëndronte ballë për ballë tij me sy të kërcyer.

Mato Gruda për pak sa ngriti dorën ta qëllonte, por e fshehu prapa kurrizit dhe shkoi te dritarja.

Zara vendosi ta prekte Maton në një pikë akoma më delikate. Kjo do të ishte karta e fundit:

— Ti do ta sjellësh italianin në shtëpi? Po ti vetë më ke thënë që ata janë pushta...

Mato Grudës i hipi gjaku në kokë dhe i gumëzhinë veshët. Dhe, duke dalë, shau:

— E ligë!

Gruaja vuri duart në faqe. Fytyra i përvëlonte.

KAPITULLI I TETË

Të gjithë në shtëpi pritnin italianin. Zara, hallë Esmaja, të dy djemtë ishin tërë kureshtje se çfarë njeriu do të ishte ky ushtar i mbetur. Hallë Esmaja trembej më shumë se Zara. Në përgjithësi ajo për ushtarët ndiente një farë mëshire, por kjo mëshirë mbytej nga frika. Po të mos kishte në shtëpi ndonjë grua të re a ndonjë vajzë, Esmaja nuk kishte përse të trembej, se vetë ishte plakë. «Ushtari, — mendonte ajo — ngaqë ka qëndruar shumë larg vajzave e grave, në kazerma e në çadra, me të parë ndonjë femër, tërbohohet. Hajde de, të jetë ndonjë ushtar nga të vendit, po ky është edhe jabanxhi!»

Hallë Esmaja pinte duhan në postiqe dhe mendja i shkonte në të liga. Ndërsa Zara më tepër kishte frikën e gjermanëve. Sikur ata ta pikasnin italianin, do ta bënë shkrumb shtëpinë. Pastaj edhe ai i mallëkuar atje në plevicë!...

Mato Gruda, që porsa ishte kthyer nga partizanët, gdhendte një bisht për sqeparin në qoshe të odës dhe herë pas here shikonte hallën dhe të shoqen. Të tjera gjëra mendonte ai për italianin. Ai babaxhani atje në plevicë i fshehur në kashtë, diçka kërkonte nga italianit!

— Për atë dobiçin e ndreq sqeparin? — pyeti halla, duke prishur qetësinë e odës.

Mato Gruda u përgjigj pa ngritur kokën:

— Po i vë bisht të ri, se mund t'i duhet italianit.

— Do të na vërë edhe neve ndonjë bisht ky italiani! —
tha halla.

Mato Gruda nuk arriti dot ta kapte menjëherë fjalën e hallës. Por, si e mori vesh, u nxeh.

— Ama edhe ju ç'dërdëllitni kot!... — tha ai dhe hoqi një bluashkë nga prehri. Zara bënte sikur nuk dëgjonte.

— Dhëntë zoti të mos jetë dobiç! — tha halla. Fytyrën e saj e mbuloi tymi i cigares dhe bëri me dorë si për ta larguar.

Mato Gruda nuk u përgjigj.

— Po t'i zërë dora, të na bëjë, dobarem, një portë të re, se na është vjetëruar, — tha Zara.

— Italianëve, ç'u sheh syri, u bën dora... — tha Mato Gruda.

— Të më bëjë edhe mua një qerrkë me rrotka, — u hodh Sadiku dhe sytë i xixëlluan. — Do të më bëjë, baba?

Ziguri qeshi:

— Dhe një dyfek prej druri me tytë prej duduku të çadrave të ushtarëve.

— Mirë, baba? — pyeti përsëri Sadiku.

— Do të të bëjë, biri i babait, do të të bëjë! — tha Mato Gruda, duke goditur me sëpatë në bisht të sqeparit.

— Ty, hallë, do të të bëjë një dollap për të vënë bukën! — tha Ziguri.

— Fhé! — bëri halla. — Të ha bukë pastaj me duart e kaurit! Fhé!

Në odë krisi një e qeshur e madhe. Qeshi edhe Mato Gruda dhe tundi kokën.

Pas së qeshurës trokiti porta e oborrit. Të dyja gratë dhe djemtë vrapuan në dritare. Mato Gruda u ngrit me përtrim.

— Erdhi! — thirri Zara.

— Cili është, moj? — pyeti halla.

— Ai i gjati — tha Ziguri.

— Alamet llozi! — tha halla. — Dhëntë zoti të mos jetë dobiç!

Mato Gruda hapi derën dhe doli.

Te porta qëndronte Nevzati me një djalë të gjatë me një xhakëtë ushtarake, pa kapelë. Mato Gruda i hodhi një

vështrim nga koka gjer te këmbët dhe iu kthye Nevzatit:

— Urdhëroni brenda!

— Erdha vetëm për të sjellë këtë. — Ai bëri me kokë nga italiani. — E quajnë Augusto dhe di pak shqip. Rrobat do t'ia ndërrosh, — tha e iu drejtua italianit: — Ky është Mato Gruda. Në shtëpinë e këtij do të jetosh.

— Bukur, bukur! — qeshi Augustoja dhe ia zgjati dorën Mato Grudës. E qeshura e tij ishte e hapur dhe dukej sikur ia mbulonte gjithë fytyrën. Flokët i kishte gësh-tenjë dhe fare të drejtë. Bishtrinjtë e vetullave i kishte të hollë, si të vajzave dhe nuk i vareshin mbi sy si të bash-këfshatarëve të Mato Grudës. Që me vështrimin e parë Mato Gruda e vuri re se Augustoja ishte një djalë i pa-shëm, dhe veç asaj iu duk i urtë dhe i sjellshëm.

— Unë nuk do të të thërres Augusto, por Agush, — i tha Mato Gruda.

Italiani qeshi:

— Bukur. Jo Augusto! Agush mirë!

— Ja, kjo s'më kishte vajtur në mend! — qeshi Nev-zati.

— Mirë mendje! — tha italiani.

Mato Gruda u kthye prapë nga Nevzati:

— Unë të dija në mal...

— Sot do të shkoj. U mora me italianët. Kështu. Mato? Ngjatjeta, tani! — i zuri për dore të dy dhe u largua. Mato Gruda e ndoqi me sy. «Çuditë, — mendoi ai — ky me Muratin kanë qenë në hasmëri. Pleqtë e tyre janë vrarë e prerë. Të gjithë kanë vdekur nga plumbi. Asnjë s'ka vdekur nga sëmundjet. Çuditë me këta njerëz...»

Mato Gruda u kujtua që pranë kishte italianin. E vësh-troi njëherë dhe ia vuri krahun.

— Shok partizan? — bëri Augustoja me vështrim nga Nevzati që po largohej.

— Partizan! — psherëtiu Mato Gruda.

Ata iu drejtuan shkallëve të shtëpisë. Mato Gruda në fillim mendoi ta shpinte italianin në hashef, por i erdhi turp. «Ky është njeri, si gjithë të tjerët» — mendoi Mato Gruda. Prandaj vendosi ta shpinte në odë.

Ata ngjithnin shkallët të heshtur, meqë nuk kishin ç'të flitnin.

Në odë ishin vetëm halla dhe dy djemtë. Zara kishte dalë. Italiani qëndroi te pragu i derës i druajtur, po i qetë.

— Kjo është halla ime dhe këta janë djemtë, — tha Mato Gruda.

Augustoja vuri buzën në gaz:

— Mirëmbrema!

— Ulu, djalë, ulu! — tha halla.

Ai u ul në nim në posten e madhe karshi hallës. Mysafiri vërtiti sytë në muret e odës, shikoi raftet, tavanin dhe kërcurin bashkë me bishtin e sqeparit. Halla e pa me bisht të syrit.

Mato Gruda nxori kutinë dhe ia zgjati. Italiani e hapi ngadalë dhe filloi të dridhte cigare.

— Di? — pyeti Mato Gruda.

— Mësuar!... — tha Augustoja.

— Na të kemi, djalo? — pyeti halla.

Augustoja vështroi Mato Grudën, si një njeri që kërkon ndihmë.

— Thotë se nga ç'vend je, — shpjegoi Mato Gruda.

— A, bukur! Palermo, Palermo!

— Aha, qenka e zorçme! — tha halla.

Ziguri ia dha gazit.

— Po emrin si ta thonë? — pyeti halla.

— Agush, emri, — u përgjigj ai.

Halla lëvizi nga vendi dhe ktheu gjithë trupin nga i huaji. Fytyra e saj tregonte se kjo përgjigje e kishte çuditur.

— Agush? Muhamedan qenke, zotrote? — tha plaka.

Italiani qeshi me gjithë shpirt:

— Unë, jo. Unë Augusto, unë shkurt Agush, — tha ai pa e përmbajtur të qeshurën.

Halla tundi kokën e murmuriti me veten e saj:

— U, më març pleshtat, thashë se mos je bërë edhe ti synet!

Këto fjalë i kuptuan vetëm Mato Gruda me djemtë. Ziguri me Sadikun gajasën së qeshuri, duke mbuluar me duar dhëmbët e tyre. Por Mato Gruda nuk qeshi; bile i

erdhi inat me hallën që e zgjidhi gjuhën më tepër sesa duhej përpara të huajit. Italiani shikonte herë muret e herë njerëzit pa kuptuar asgjë. Mato Gruda vrenjti vetullat dhe u tha djemve të dilnin jashtë. Ziguri e Sadiku, me duar para dhëmbëve, duke u munduar të mbanin të qeshurën, dolën nga dera. Pastaj Mato Gruda ia ndezi të huajit cigaren dhe i dha shenjë me kokë hallës t'u bënte nga një kafe. Halla u ngrit ngadalë, si re e zezë, duke hequr zvarrë nëpër poste çitjanet e gjera, dhe mori në dollap xhezven dhe filxhanët. Kur u ul në vatër, ktheu kokën nga italianin dhe pyeti:

— Si e pi, zotrote, të ëmbël, apo të hidhur?

Augustoja përsëri nuk e kuptoi dhe iu drejtua Mato Grudës.

— Thotë, me shumë sheqer, apo me pak sheqer, — shpjegoi ai.

— Sheqer shumë, — tha italianin.

— Më rrofsh, të keqen halla! E gjete kohën kur ta pish me shumë sheqer!

Mato Grudës i erdhi për të qeshur, por u përmbajt, se nuk donte ta fyente italianin.

— Ke nënë?

— Nëna kam! — u përgjigj Augustoja pa ndihmën e Mato Grudës.

— E zeza! — psherëtiu halla.

— Plaka, sa ti, — tha italianin.

— Po baba?

— Baba vrarë bomba! — tha i huaji.

— Vriten, të keqen halla, vriten njerëzit...

Ndërkohë hyri Zara me një çemberkë në kokë. Ia dha dorën italianit dhe u ul në vatër pranë hallës. Augustoja e vështroi Zarën dhe aty për aty i largoi sytë. Mato Gruda me këtë gjest kuptoi se italianin qenkësh njeri i sjellshëm e që paskësh mësuar ca nga zakonet e fshatrave. Gratë nuk duhet t'i vësh re gjatë, nuk duhet t'i vështrosh në beben e syrit; dhe ai tha me vete se i huaji do të ishte nga ndonjë derë e mirë dhe fisnike...

— Tani, Agush, do të vishesh me rrobat tona dhe unë do të të gjej një qeleshe që ta vësh në kokë. Ne do të

punojmë bashkë dhe të dy do të bëjmë shumë gjëra të mira. Ma merr mendja që ti, Agush, je njeri i ndershëm; edhe unë i dua njerëzit e ndershëm.

— Faleminderës! — tha italiani. — Agush punon, Agush shumë punon...

Zara mbushi filxhanët dhe ua zgjati burrave. Edhe hallë Esmaja mori një filxhan për vete.

— Për të mira, vajç shëndoshë në shtëpi! — tha ajo.

— Faleminderës! — bëri me kokë i huaji.

— Mirë se ardhe, Agush! — tha Mato Gruda.

Zara shkoi përsëri pranë hallës.

— Pse, Agush e quajnë? — pyeti ajo ngadalë.

— Hë de! Gusho e thënkkan! Paska edhe talianë muhamedanë! — u përgjigj halla me buzë në gaz.

Zara qeshi vjedhurazi në vatër dhe e pa me bisht të syrit italianin. Në qafë të tij ajo vuri re një nishan të zi sa një kokërr meli. Italianit, tek pinte kafe, Zara ia vuri re buzët që i kishte të trasha dhe të bukura. Ajo i tha pastaj ngadalë hallës se Agushi qenkësh alamet djali dhe vërtet u dukka njeri i mirë.

— Vetëm mos na dalë kalli pa bukë, se kështu të merr më qafë, — tha halla.

— Ti thua se mos na dalë dembel? — pyeti Zara me buzë afër veshit të hallës.

Halla pastaj tha ca fjalë për të qeshur dhe Zara qeshi ngadalë pranë zjarrit.

Mato Gruda mezi i shkoqiste fjalët e grave, ndërsa Augustoja e merrte me mend se ato flitnin për të. Ai e piu kafënë dhe e vuri në tabaka, duke bërë një falënderim me kokë.

Hallë Esmaja e mori filxhanin e italianit dhe e përmbysi. Augustoja e ndiqte me sy.

— Të të hedhë halla një fall? — tha ajo.

— Fal? Ha-ha! Bukur, fal! — dhe italianin përplasi shuplakat.

Mato Gruda ishte bërë dimër në fytyrë. Ama edhe kjo plaka po luan mendsh!

Piaka, si e la pak kohë filxhanin të përmbysur, e mori përsëri dhe e afroi në fytyrë.

— Një rrugë e gjatë. Pupu, ç'ura të prishura! Një i keq me këmbë të gjata pret në çdo urë! Bah! Po kjo këtu? Ç'janë këta meitë, more djalë? Allah, allah! A, e sheh? Ja, këtu të presin. E sheh këtë qiell të hapur? Medet! Prapë i nxirë! Ja, këtu të pret një çupë!... — tha halla me sy në filxhan.

— Çupë hiç! — qeshi italiani.

— Hajde, hajde, se do ta gjesh, — tha halla.

— Nëna mirë, — tha ai.

Mato Grudës nuk i durohej. Ai i bëri me kokë hallës që të pushonte. Halla e kuptoi.

Pas pak, Mato Gruda u ngrit dhe i tha italianit që të dilnin bashkë.

Kur dolën, Zara i tha hallës:

— Matua do ta njohë Agushin me shtëpinë e pasurinë! — dhe qeshi si vajzë.

KAPITULLI I NËNTË

Duke folur e duke bërë me dorë, ata kaluan nëpër oborr dhe hynë në plevicë. Mato Gruda mbështeti shpatullat në mur, ndërsa Augustoja u ul në kashtë i lodhur. Në përgjithësi ai lodhej shpejt dhe çdo ditë e më tepër dukej i vrarë dhe i dërrmuar. Gjendjen e italianit Mato Gruda, me aq sa ia priste mendja, e shpjegonte me lodhjen e përgjithshme të Italisë nëpër luftëra. «Mbetën marritë udhëve në dhera të thara nga vapa e të lagura nga shiu» — mendoi ai duke vështruar italianin që rrinte gjysmë i shtrirë në kashtën e plevicës.

Pastaj Mato Gruda iu afrua topit të mbuluar, zgjati gishtin dhe i tha Augustos:

— Këtu, Agush, kam një plaçkë të fshehur!

Augustoja lëvizi nga vendi dhe hodhi sytë nga togu në kashtës.

— Nuk ia kam zbuluar njeriu. Ty po ta zbuloj.

Mato Gruda në fillim hoqi pak kashtë. Italiani ndoqi me kureshtje lëvizjen e dorës së të zotit të shtëpisë. I zoti hoqi edhe pak... I huaji vuri re se diçka nxii nën kashtë. Nga kureshtja u ngrit dhe i vajti pranë fshatarit. Mato Gruda ktheu gjysmën e fytyrës nga italianin, i bëri një shenjë duke mbyllur syrin e djathtë dhe shtyu me pëllëmbë gjithë kashtën që mbulonte tytën e topit. Ushtarit i kërcyen sytë nga orbita.

— Top! — tha ai shqip dhe pastaj foli ca fjalë të tjera italisht, të cilat Mato Gruda nuk i mori vesh. Por ai

e kuptoi që italiani u tremb, se vetëm kur trembej dhe habitej, fliste në gjuhën e nënës së tij.

Mato Gruda mbështeti bërrylin në tytën e zbuluar dhe priti se ç'do të thoshte më tej i huaji. I huaji kishte zënë faqen me dorë dhe qëndronte më këmbë pa thënë asgjë.

— Mirë the, top! — tha më në fund Mato Gruda.

Ai e hoqi bërrylin nga tyta dhe qetë-qetë u drejtua nga togu tjetër i kashtës në murin përballë. Augustoja e ndiqte me vështrimin e tij pa lëvizur nga vendi. Fshatari u përkul dhe futi duart në kashtë. Italianit nuk i durua. Ngadalë shkoi pranë të zotit. Nga togu i kashtës doli një arkë e murme. Mato Gruda hapi kapakun.

— Predha! — tha Augustoja gati duke u dredhur.

Mato Gruda e vështroi me përbuzje ushtarin. Ç'kishte këtu për t'u trembur? Gjylet nuk janë bomba me sahat, që mund të pëlcastin nga çasti në çast.

— Sa vjet ke bërë në ushtri? — pyeti Mato Gruda, se një pyetje të tillë kishte harruar t'ia bënte.

— Katër! — tha italiani.

Mato Gruda numëroi me gisht ca data dhe doli se Augustoja ishte marrë në ushtri që në 1939. «S'dihet, mund të ketë qenë edhe në 7 prill këtej» — tha ai me vete, por nuk e pyeti.

— Pse habitesh? Me këto gjëra je marrë katër vjet me radhë, — tha fshatari.

Augustoja vuri në gojë një kërcell të thatë kashte dhe filloi ta përtypte. Me kërcell në cepin e buzëve tha:

— Mërzitur top. Top jo, predhë jo. Lopatë, puna...

— Jo, more! E bërë tënden ti dhe, demek, «top jo, predhë jo!» — përqeshi Mato Gruda.

Ushtari u skuq si vajzë dhe nuk iu përgjigj të zotit të shtëpisë. Vetëm pas nja dy minutash heshtjeje, ai pyeti, duke bërë me kokë nga topi:

— Topi partizan shpje?...

— Atë e di unë! — ia preu Mato Gruda.

Ai e la arkën dhe iu afrua përsëri topit. I doli nga pas dhe filloi t'ia hiqte kashtën. Dalngadalë u zbuluan rrotat dhe më në fund shtrati. Mandej mori në qoshe të ple-

vicës një fshesë për t'ia fshirë bykun dhe fijet e imta të kashtës. Mato Gruda e mbështeste ngadalë fshesën në hekur sikur të kishte frikë se mos e gërvishte. Pastaj qëndroi përpara tytës, u ul pakëz dhe e fryu në grykë. Pluhuri i ra në fytyrë dhe ai teshtiu.

— Grykë fut pece vaj! — tha italiani, duke vërtitur dorën, sikur ta kishte brenda në grykë të topit.

— Ajo dihet, — tha Mato Gruda i menduar. — Si pushka... Po kjo grykë do shumë vaj.

Augustoja qeshi:

— Grykë vogël. Tjetër gryka topi shumë madhe. Top vogël.

— I vogël, po punën e bën! — tha Mato Gruda duke trokitur gishtat në tytën e topit të tij. Ai u vrenjt, se nuk i pëlqeu mendimi i italianit, pasi iu duk sikur ia zvogëloi kastile topin e vet.

Si e mbaroi së pastruari, shkundi pluhurin nga duart dhe u ul në një trung të thatë, që e kishte sjellë nga korija për ta bërë koritë. U ul edhe Augustoja në krah të tij. Mato Gruda hapi kutinë e duhanit dhe ia dha ushtarit:

— Të pimë nga një cigare.

— Ka Mato duhan butë? Duhan Mato fortë, — tha italiani, duke dredhur cigaren.

— Do të gjejmë!

— Bukur!

Përballë tyre qëndronte topi i zbuluar. Në gjysmëmuqëtitirë e plevicës ai i dukej Mato Grudës më i madh, më i rëndë. «Nga e nxori ky italianka që ky top na qenka i vogël?» — mendoi Mato Gruda.

— Lloj-lloj topash ka përdorur kjo qerrata luftë! — tha ai duke pështyrë copën e letrës së cigares.

Italiani thithi cigaren.

— Topi ka tip: malor, fusha, kondratank, zenit, vaporësh, bregdet, aero; shumë ka. Ky top mal, — tha ush-tari me sy nga topi. — Mushka merr shpinë, ik top fiu!... — fërshëlleu ai.

Mato Gruda largoi me opingë një shkarpë të thatë.

— Topçi ke qenë?

— A?

— Artilier ke qenë, them?

— Unë artilier. Bumb shenjë! — tha italiani dhe bëri sikur hodhi një gjyle.

Augustoja ngriti lart kokën dhe lëshoi nga goja rruaza tymi nga cigarja. Në një tra të plevicës ai vuri re një kosë. Bishti i saj varej gjer poshtë nën tra.

— Kosa! — tha ai.

— E? — pyeti Mato Gruda, që e kishte mendjen gjetkë.

— Kosa zhë-zhë bari! — tha Augustoja dhe imitoi kosarët që kositin livadhet.

«Ku e ka mendjen ky karafil!» — tha me vete Mato Gruda, duke i hedhur një vështrim kosës në tra të plevicës.

Duke ndenjtur në trung, italianit iu mpinë këmbët dhe u ngrit. Ai filloi të ecte në truallin e plevicës me duar prapa shpine. Vinte gjer te muri tjetër e kthehej përsëri. Mato Gruda e shikonte e pinte duhan. Tani nuk këmbenin më ndonjë fjalë, po secili mendonte më vete. Augustoja nuk kishte dëgjuar ndonjëherë që një fshatar të fshihete në shtëpi një armë të rëndë artilerie. Një kobure a një pushkë dhe fundja një mitroloz njeriu mund ta fshehë dhe ta mbajë jashtë ligjit, por një top... Ushtari mendoi se kjo që po i ndodhte atij në plevicën e këtij fshatari, mund t'u ketë ndodhur edhe shokëve të tij që ishin shpërndarë nëpër fshatra. Atij diçka iu kujtua dhe qëndroi për një çast në mes të truallit. Pastaj u drejtua nga topi dhe u ul më gjunjë nga pjesa e prapme e tij. Diçka fshiu me dorë dhe lexoi me zë: «Vermaht, Haufman, 59001».

Mato Gruda e dëgjoi dhe e kuptoi se këto fjalë kishin të bënin me topin.

— Ç'këndon ashtu? — pyeti ai.

— Marka e shifër topi. Fabrika.

— Ku është kjo fabrikë? — pyeti Mato Gruda.

— Gjermani. Nga kjo topi kemi në ushtri, — tha italian.

— Ushtri mavria. Kemi pasur, thuaj, — u vrenjt Mato Gruda.

Ushtari i ra me pëllëmbë rrotës:

— Topa mirë. Fort. Haufman.

— Ç'është ky Hafman? — pyeti Mato Gruda.

— Konstruktör. Bën topi, — tha Augustoja.

— Hafman, demek, — tha Mato Gruda i menduar.

Italiani u drejtua nga dera e plevicës. Jashtë dukej një copë qiell. Në majë të Kokallës qëndronte një re e bardhë, si bohçe me lesh të larë. Poshtë Kokallës, atje në grykë të përroit, dukej shtëpia e Fizëve.

— Gjer ku ha ky top? — pyeti Mato Gruda prapa shpinës së italianit.

— Nuk kupton! — tha italiani.

Mato Gruda u bë nervoz dhe e shau me vete italianin që nuk i kishte mësuar edhe fjalët më të thjeshta.

— Gjer më sa metra shkon predha e këtij topi? — tha ai.

— A, distanca. Shkon gjashtë kilometra, më shumë. Atje Kokallë, — dhe bëri me dorë nga mali.

— E ngrënka nga këtej, — tha Mato Gruda.

Në këtë kohë nëpër derë të plevicës, hyri Ziguri.

Mato Gruda në fillim nuk e pa të birin, se nuk e kishte fytyrën nga dera. Por ai ndjeu dritën të futej në plevicë dhe ktheu kokën. Në prag të derës qëndronte Ziguri, i hollë, i rrethuar nga drita e oborrit.

— Ç'do! — tha i ati pa u ngritur nga trangu i thatë, me cigare në dorë.

— Sefer Maruka, i vëllai i Aliut dhe i kushëriri i Nevzatit, vrau Syrjanë, të vëllanë e Adnan Pinxhos, — tha Ziguri me një zë të dredhur.

Mato Gruda u ngrit nga kërcuri i zhytur në gjysm-errësirën e plevicës. Fjalët e të birit e trembën... Syrjanë!... Po Syrjai ishte i vogël, dy vjet më i madh nga Ziguri! Mato Gruda u hutua. Ai mendoi për të birin.

— Ku e vrau? — pyeti Mato Gruda.

— Para derës së dyqanit. Syrjai kishte shkuar të takonte në dyqan Adnanin. Seferi e priste në qoshe të dyqanit. Ai doli dhe, sa kapërceu pragun, i ra me kobure. Ra mbi kripën që kishte marrë për ta shpënë në shtëpi. E mbante në dorë tasin me kripë... — tha Ziguri.

Mato Grudës iu drodhën buzët. Ai në vend të Syrjait shikonte të birin. Edhe ai pothuajse sa Ziguri ishte. Ra mbi tasin me kripë!... Mato Gruda e harroi edhe topin, edhe italianin.

— Shko, bir! — tha ai dhe mbeti përsëri vetëm bashkë me errësirën e plevicës.

«... Eh, ore të bekuar, me kripë në dorë të vritet njeriu?!» — mendoj Mato Gruda, duke pirë duhan të fortë.

KAPITULLI I DHJETË

Derën e plevicës ata e mbyllnin me lloz dhe çdo ditë fillonin mësimin e artilerisë. Italiani me durimin e një profesionisti, së pari i shpjegoi Mato Grudës pjesët që përbënin topin: tytën, shtratin, rrotat, mekanizmin e shkrepjes, mekanizmin e shënimit, pastaj hyri edhe në hollësira të tjera. Ai i tha Mato Grudës se presioni i gazeve në topa ishte, në përgjithësi, nga 2500 kilogramë për centimetër katror gjer më 3500. Mato Gruda këtë nuk arrinte dot ta kuptonte me fjalët e thata të italianit, se ishte një gjë që nuk dukej me sy. Tytën, shtratin, rrotat, mekanizmin e shkrepjes ai i prekte dhe i shihte. Po ky presioni ç'do të ishte vallë? Atëherë italiani sprapsi shulin e topit, vuri një gjyle dhe i tha Mato Grudës se, kur gjilpëra godet kapsollën, bërthama e gjyles largohet nga gëzhoja dhe në çast krijohen gaze me një shtypje të fuqishme. Sa më e fuqishme të jetë kjo shtypje, aq më larg shkon predha. Mato Grudës iu duk sikur e kuptoi, por italiani e pa drejt e në sy dhe e ndjeu se nxënësi asgjë nuk kishte marrë vesh. Augustoja tha ca fjalë italisht, vari duart poshtë dhe bëri:

— Uf!

Mato Gruda u skuq dhe ngadalë, sikur të fliste me veten e tij, tha:

— Ka ca gjëra që njeriu i gjorë nuk i merr vesh menjëherë!...

— Pimë cigare, — tha italiani dhe ata u ulën në trungun karshi topit.

Ndezën cigare dhe ranë në mendime. Italianin e habiste durimi i këtij njeriu për të mësuar gjithçka që kishte të bënte me topin. Në skuadrën e tij ai nuk kishte njohur ndonjë ushtar kaq të etur në mësimin e artilerisë. Mato Grudës nga ana e tij, italiani nuk i dukej si një artilier i thjeshtë, por si një njeri që e kishte shpikur vetë topin.

— Hë, personi!... — tha Mato Gruda.

— Presioni, shtypja! — e ndreqi italiani dhe shtrëngo-i pëllëmbët për të treguar shtypjen. Në çast atij diçka i ra në mend. U ngrit, hapi derën e plevicës dhe doli. Mato Gruda e vështroi pa lëvizur nga vendi. Pas pak italiani u kthye me një gur të vogël dhe me një shkop në dorë. E vuri gurin në trungun e thatë dhe i ra me shkop, sikur të luante bilardo. Pastaj u ul, e mori dhe e vuri përsëri në trung. Mato Gruda shikonte e s'fliste.

— Shiko, Mato! — tha italiani me shkop në dorë. — E madhe pesha që shtyn shkopin, larg ik guri; e vogël pesha, jo larg ik guri. Prova...

Ai ia dha shkopin Mato Grudës dhe i tha t'i binte gurit me forcë. Mato Gruda e shtyu shkopin dhe guri fluturoi. Augustoja vrapoi pas gurit. E vuri përsëri në trung.

— Shty pak, — tha ai.

Mato Gruda e shtyu pak shkopin. Guri ra në këmbë të italianit.

— Kështu edhe presioni i gazit. Shumë forcë gaz, shumë larg predhë...

Mato Grudës i ndritën sytë. E ndjeu se diçka të re po mësonte. Menjëherë u ngrit dhe filloi të kërkonte në truallin e plevicës, sikur të kishte humbur ndonjë send të vogël, të padukshëm. U ul në prag të derës dhe diçka mori. Erdhi pranë italianit dhe i tha:

— E sheh këtë bërthamë kumbulle?

— E sheh, — tha italiani.

Nxënësi e fshiu për mëngë dhe e futi në gojë. I fryu buzët si tullumbace, lëshoi një krismë jo aq të këndshme dhe fara fluturoi nga goja, kapërceu trarin dhe ra në qoshe të plevicës.

— Ky është presioni i madh! — tha Mato Gruda duke qeshur.

— Bravo! — thirri italiani dhe, duke luajtur valle, përplasi shuplakat.

Mato Gruda e mori farën dhe e futi përsëri në gojë. Këtë radhë i fryu pak buzët. Pas asaj krisme jo të këndshme, fara doli nga goja dhe ra para këmbëve të italianit.

— Ky është presion i vogël, — tha ai.

— Zhenial Mato, zhenial Mato! — thirri italiani dhe e përqafoi nxënësin. — Njeri i madh Mato. — tha ai pas pak.

— Atë e di unë! — tha Mato Gruda dhe ngrysi vetullat.

Po gjëja më e vështirë në mësimet e mëvonshme ishte gradimi i topit për të qëlluar në shenjë. Fundja presioni i gazrave ishte një njohuri që i hynte në punë vetëm një artilieri specialist. Gradimi ishte më i domosdoshmi se gjithçka. Duhet të përcaktoje largësinë e objektit, duhet të dije të matje këndin e qitjes... Po Mato Gruda këto gjëra kurrë nuk i kishte dëgjuar. Mund të mbyllte syrin e majtë e mund të shtinte me tërë pushkët e botës që kur ishin shpikur e gjer më sot, por topi kishte të tjera marifete.

— Me sy jo, Mato! Këndi i qitjes rëndësi... — tha italiani.

Ballin e Augustos e mbuloi djersa. Ai lëvizte një dorëzë dhe gryka e topit ulej dhe ngrihej ngadalë. I tregonte Mato Grudës se ç'rëndësi kishte këndi i qitjes.

— Nuk bëjmë dot manovra. Shohin topi njerëzit. Bëjmë manovra, mirë mësohet këndi. Praktika, — tha italianin.

— Ajo dihet! Po të bëjmë manovra, na e pikasin topin, — tha Mato Gruda i ngrysur.

Pastaj Augustoja e mësoi edhe se si ta përforconte topin edhe se si ta zbërthente...

— Kur qëllon, Mato, mos rri prapa topi. Vret gazi! — tha ai.

— Unë nuk jam tutkun sa këtë gjë kaq të thjeshtë të mos e di! — tha Mato Gruda i fyer.

— Pa fjalë! — thirri papritur italianin, si një rreshter

para skuadrës së baterisë. Fytyra e tij u shtrembërua dhe sytë i kërcyen.

— Pa fjalë! Objekti — kodra! Distanca — pesë. Këndi — 30. Zjarr!

Mato Gruda hapi sytë. Kjo ishte e papritur për të.

— Agush, shkallëve? — tha Mato Gruda.

Augustoja fshiu djersët me mëngë, e vështroi Mato Grudën dhe shkoi u shtri në kashtë. Zuri fytyrën me dorë dhe psherëtiu. Mato Gruda me gjakftohtësi dhe i qetë zgjati dorën në levën e përcaktimit të këndit të qitjes dhe e vërtiti nja dy herë. Tyta u ngrit. Pastaj e vërtiti nga ana e kundërt dhe ajo u ul. Italiani i hoqi duart nga fytyra dhe e vështroi Mato Grudën.

«Ç'do të bëjë ky njeri me këtë top, vallë? Në plevicën e një fshati gjysmë të shkretë unë përgatit një artilier! Ç'dreq është kjo punë! E vërtetë është apo ëndërr?» — mendoi italiani i shtrirë në kashtë.

Mato Gruda e pa që italiani u lodh dhe filloi të engle-disej vetë me topin.

— Me hamendje topi nuk mësohet! — psherëtiu Mato Gruda.

— Praktikë nuk vëmë. Dëgjon njerëzi, — tha italiani, i trembur, se kujtoi se mos i shkrepëj Mato Grudës të provonte të qëllonte.

— Ta zëmë, — tha Mato Gruda, — për ta goditur atë shtëpinë atje në grykë të përroit, sa gradë duhet ta shpiem këndin?

Italiani u ngrit. Hapi derën e plevicës dhe vështroi nga mali i Kokallës. Shtëpia e Fizëve zbardhte në këmbë të malit. Padashur ai u drodh. Njëherë bateria e tyre kishte qëlluar një shtëpi të tillë në një fshat. Atij i doli para syve flaka që kishte mbuluar çatinë dhe tymi që ishte ngritur kodrave.

Augustoja mbylli derën dhe u kthye nga Mato Gruda.

— Shtëpia, për shembull, 30 gradë... — tha ai.

Mato Gruda e vërtiti levën dhe uli kokën për të parë këndin.

— Këtu? — pyeti ai.

Italiani, pa iu afruar topit, sipas pozicionit të tytës, e kuptoi se këndi duhej të ishte 30 gradë.

— Atje! — tha Augustoja.

— Ç'llomotit kot, more dembel! Ku e sheh ti që andej? — u nxeh Mato Gruda.

— Atje. Kupton unë. Top me sy gradoj. Shumë vjet di top, — tha italiani.

Megjithatë ai shkoi pranë Mato Grudës. I bëri edhe nja dy-tri vërejtje të lehta dhe i ra me dorë në shpatull:

— Mëson topi. Ka qëllim madh. Mato Gruda bëhet hero nacional! Napoleon Bonaparte — artilier. Me top godit Tulon... Mato — Napoleon Bonaparte...

Mato Gruda e vështroi zymtë.

— Atë e di unë! — tha ai.

Augustoja prapë në të tijën:

— Ti, Mato, do godit objekt me rëndësi madhe. Shtab armik godit.

Mato Gruda prapë u vrenjt dhe lëvizi shpatullën për të hequr dorën e italianit.

— Atë e di unë! — përsëriti ai, duke marrë një pamje të madhërishe. Italiani hapi sytë, sikur ta shikonte për herë të parë. «Njerëzit gjenialë — mendoj ai — në fillim kështu e nisnin karrierën. Veprimet e tyre të fillimit të duken të çuditshme, se janë mënjanimet nga e zakonshmja!.. Ai vuri buzën në gaz.

— Pse qesh, Agush? — pyeti Mato Gruda.

— Mato strateg... — tha Augustoja.

Mato Gruda nuk u përgjigj, por u shtri në kashtë bashkë me italianin.

— Mësimi shkon mirë sot, — tha Augustoja.

— U lodhe, Agush?

— Pak!

— Kur është shpikur topi? — pyeti papritur Mato Gruda siç ishte shtrirë në kashtë.

— Kohë shumë, — tha Augustoja.

I shtrirë në kashtën e plevicës së Mato Grudës, italiani filloi një histori të gjatë për armët e rënda. Ai tha se topi me grykë të lëmuar, pa vjaska, filloi të përdorej në shekullin e katërmbëdhjetë. Ky ishte një top me grykë

hekuri. Në shekullin e gjashtëmbëdhjetë gryka e topit u derdh për herë të parë në gizë. Tre shekuj me radhë topa të tillë u përdorën në sulme për të shkatërruar mure qytelesh e kalash.

— Po atëherë më shumë dëm se topi bënte shpata. Shpata, Mato, vriste shumë. Tani topi vret shumë. Topi bën lumë gjaku, — tha italiani.

— Kërdinë bën mavria! — tha Mato Gruda.

Augustoja pastaj u hodh në shekullin e nëntëmbëdhjetë dhe tha se në atë kohë gryka e topit u bë me vjaska. Kjo bënte që predha të merrte shpejtësi dhe të hidhej në largësi të madhe. Kështu, zjarri u bë më i fuqishëm e më shkatërrues.

— Mjet fuqishëm, zhdukje armik në tokë, det, ajër. Në sulm hap rrugë ushtrisë, në mbrojtje pret rrugë armik, — tha italiani. — Konditat e efektivitetit zjarrit: forca, manovra, koncentrimi. Sipas lloji arme kemi zjarr aviacioni, kundëraero; kemi zjarr armë lehta, zjarr minahedhës, zjarr artileri detare. Sipas drejtimi qitje kemi zjarr: front, krah, kryqëzuar, tërthortë. Sipas karakteri të presioni në armiku kemi: nënshtrimi, paralizimi, shkatërrimi, ndalimi. Sipas mënyrës zjarri artileri kemi: përqëndrimi, masivi, valë zjarri. Artileria jep zjarr: të vetmuar, batare, metodik... Shumë zjarri, Mato, shumë zjarri! — tundi kokën italian.

Mato Gruda i shtrirë dëgjonte. Jashtë plevicës frynte era e vjeshtës së tretë. Futej në vrimat e mureve me gardh dhe ngrinte herë pas here bykun e kashtës.

Tek rrinin, trokiti dera dhe u dëgjua zëri i Zigurit.

— Baba, do të hani bukë? — thirri ai.

— Na e sill këtu në plevicë, — u përgjigj i ati.

U ngritën dhe shkundën nga rrobat kashtën. Të dy kishin uri. Veç kësaj italianit i hapej goja dhe kishte gjumë. Që kur kishte ardhur nga ushtria në shtëpinë e Mato Grudës, ai nuk ngopej dot me gjumë. Flinte sikur të pinte opium tri herë në ditë. «Është rraskapitur mavria» — mendonte Mato Gruda.

Ziguri solli tepsinë me bukë dhe sahanin e madh me fasule. E vuri mbi trungun e thatë dhe u mat të dilte.

— Sille edhe legenin të lajmë duart, — tha Mato Gruda.

— Lajmë në pus, — tha Augustoja.

— Jo, Agush, këtu, se jemi të lodhur.

Nga sahani dilte avull dhe përhapej era e shijshme e fasuleve.

— Fasol mirë, — tha italiani.

— Mish i fukarait. Ju në Itali keni më shumë makarona, — tha Mato Gruda.

— Oh, makarona! Ka edhe shumë fasol Italia, — tha italiani.

— Këto të shkreta në çdo vend të botës i hanë, — tha Mato Gruda.

Ziguri ua vuri përpara legenin dhe ata i lanë duart.

— Italia ka legenë? — pyeti Mato Gruda.

— Legeni shumë Italia fshatare, — tha Augustoja, duke i fshirë duart me peshqir.

— I përhapur është edhe ky mavri, — tha Mato Gruda për legenin. Ai pastaj iu kthye të birit: — Edhe pak gjizë dhe nja dy qepë.

Djali doli. Augustos nuk i pritej. Shikonte sahanin që avullonte dhe i lëshonte goja lëng. Ndërsa Mato Gruda priste më këmbë gjersa të kthehej i biri.

— Hamë, Mato? — tha Augustoja.

— Prit, Agush!

Në derë hyri Ziguri me një shishe në dorë e me një kupë druri me gjizë. Mbi gjizë kishte vënë qepët. Italiani e vështroi shishen e rakisë dhe buzëqeshi.

«I pihet karafilit» — mendoi Mato Gruda.

Ai e vuri shishen në tepsi dhe kupën me gjizë në trung. Mbushi filxhanët dhe tha:

— Gëzuar, Agush!

— Gëzuar! — tha Augustoja.

Ishte hera e parë që Mato Gruda i nxirrte raki ushtarit, se nuk e dinte si i kishte huqet në pije. «Na pihet dhe na bën ndonjë marrëzi. Kam parë unë ushtarë të dehur, kam parë» — mendonte ai me vete.

— E pi rakinë ti, Agush? — pyeti Mato Gruda.

— Pak, Mato, pak. Verë shumë. Itali verë, — tha ita-
liani.

— Në kohën e stërgjyshërve edhe ne pinim shumë
verë. Pastaj shumë vonë doli rakia, — tha Mato Gruda një
mendim që e kishte dëgjuar nga Murati.

— Shumë drejt, — pohoi Augustoja.

— Nuk të pyeta, Agush, cilët kanë qenë topçinjtë më
të mëdhenj? — tha Mato Gruda.

— E?

— Shpikësit them.

Italiani u mendua, duke lëvizur filxhanin nga vendi.

— Leonardo da Vinçi ka projektuar top, — tha ai.

— Kur?

— Gati pesëqind vjet më parë, — tha italiani.

— E, ç'ishte ky?

— Piktur.

— Aha, qenka i zoti, — tha Mato Gruda i menduar.

— Mjeshtri Zhan Zhil de Makon më 1443 bëri një top
që zbërthehej. Atëherë nuk zbërtheheshin top, Mato. Zhan
Zhil de Makon zbërtheu.

— Breh! — bëri Mato Gruda.

— Mjeshtra shumë mëdha topi janë Valier e Griboval.
Francezë janë. Më 1700 projektuan topa.

— Të zgjuar janë ata qerratenj topçinj francezë, —
tha Mato Gruda, duke mbështetur mjekrën në pëllëmbë
të dorës.

— Frederik dytë i Prusisë më 1758 bëri artilerinë e
parë me kuaj. Tërheq kali topi, — tha italiani.

— Ç'ishte ky Frederiku?

— Mbret.

— Atëherë ia kanë bërë të tjerët, — tha Mato Gruda.

— Zgjuar, Mato! — tha italiani dhe qeshi.

— Tjetër?

— Më 1703 u ndërtua në Torino topi fushor me ngar-
kesë të pasme. Ndërtoi Trivulçio, që ish në shërbim të
Vitorio Amadeo dytë. Pastaj më 1745, dyqind vjet më pa-
rë, Federiko Prokari, Xhulio Xhentileski, Valentino Gua
e Marcio Purçela bënë një top që transportohej në male.

Si ky, Mato, por më vulgar, — tha italianin, duke treguar me kokë topin në plevicë.

Mato Gruda buzëqeshte dhe e shikonte italianin me një farë admirimi. Çuditëj se si ky topçi rob dinte kaq gjëra për topin. «E po, atë punë ka pasur» — mendoi ai.

— Xhovani Kavoli vuri në përdorim gjylen e parë të zgjatur, si me fletë. Teknik i madh. Më 1846 e shpiku.

— Ç'ishte ky?

— Gjeneral! — tha italianin.

— Qenka gjeneral me mend, — tha Mato Gruda.

— Anglezi Nordenfeld ndërtoi top-mitraloz me katër gryka, kalibri 25 milimetër.

— Kur?

— Më 1877, — u përgjigj Augustoja. — Në atë kohë edhe konstruktori Hotkis bëri top-revolver me pesë gryka, kalibri 37-45 milimetra...

Italiani e ngriti filxhanin dhe e ngjeu kafshoren me gjizë.

— Iku përpara topi. Tani ka shumë shpikës. Të parët e kanë pasur vështirë, — tha ai.

— S'do mend të parët, — tha Mato Gruda, duke e hequr dorën nga mjekra.

Koha kalonte dhe ata pinin. Po rakia e goditi në kokë Auguston. Atij iu skuqën faqet dhe gjuha iu trash. E lëvizte supin e mëngjër dhe buzëqeshte.

— Që kur s'ke pirë? — e pyeti Mato Gruda.

— Katër muaj.

— Ha gjizë. Gjiza të bën esëll, — tha Mato Gruda.

Italiani e ktheu gjithë trupin e tij nga Mato Gruda dhe filloi të fliste ngadalë:

— Mato njeri mirë. Mban Mato në shtëpi. Unë nuk bëra krime. Unë ordiner, thjesht njeri. Shtëpi dua. Nëna pret mua. Shpëton mua Mato, — dhe italianin filloi të qante. Trupi i tkurrej dhe i lëshohej sikur ta kishte zënë lemza. Mato Gruda nuk i kishte qejf burrat që qajnë. Por ai nuk e përbuzi italianin, veçse e vështroi me keqardhje. «Ky fatzi edhe mund të qajë, — tha me vete Mato Gruda — ky fatzi rri në plevicën time, në vend që të rrinte në shtëpinë e tij.»

Mato Gruda i ra me dorë në sup për ta qetësuar:

— Pusho, Agush!... Unë të mbaj se ti nuk ke bërë faje. Edhe në ke bërë ca faje, ma ha mendja që do t'i lash.

Italiani u qetësua. Mato Grudës tani nuk i pihej as raki, nuk i hahej as meze. Topi qëndronte përballë tyre me tytë të ngritur lart. Augustoja e vështroi topin dhe i menduâr tha:

— Edhe unë ardhja me topi nga Italia në plevica Mato. Tetë milionë ushtarë Italia. Unë një ushtarë në plevicë Mato, — dhe ai qeshi po me aq ndjeshmëri, me të cilën kishte qarë.

— Kështu thotë edhe Murati: tetë milionë ka pasur. Ushtri e ligë! — tha Mato Gruda.

Augustoja i tha Mato Grudës se, po të kishte ardhur në Itali, kështu do ta kishte pritur e do ta kishte shpëtuar.

— Ti nuk mund të më pritje kështu, se unë nuk do të vija si ti...

Augustoja hapi sytë dhe pyeti:

— Pse?

— Se unë nuk do të vija me pushkë! — u përgjigj Mato Gruda.

Italiani heshti për një çast, pastaj tha:

— Ti, Mato, inteligent. Ti, Mato, bëhesh hero nacional! — dhe qeshi me zë të lartë.

Mato Gruda e vështroi, po nuk foli.

Tek bisedonin, në plevicë hyri Zara. E gjatë, e pashme, me kokën lart, ajo iu afrua tringut të thatë, ku pinin i shoqi dhe italianin. Augustoja, me ta parë, u gjallërua në fytyrë dhe u përpoq të mos e tregonte veten të pirë.

— Ka ardhur e ëma e Muratit, kërkon të të takojë, — tha Zara.

Ajo mori tasin e zbrazur të fasuleve dhe doli. Augustoja e ndoqi me një vështrim dhe psherëtiu:

— Mato grua bukur. Augusto s'ka vajzë, Augusto s'ka grua... — tha ai.

Mato Gruda këtë radhë i hodhi një vështrim përbuzës. «Dashke edhe grua!» — mendoi ai.

— Unë motër grua Mato, — tha italianin.

I zoti i shtëpisë rrinte i ngrysur. Piu edhe një gotë dhe

i tha italianit se duhej të ngrihej, pasi i kishte ardhur nëna
e shokut të tij.

— Ti, Agush, mbuloje topin me kashtë dhe shko fli
që të çlodhesh!

— Mato komandant mirë! — tha italiani.

KAPITULLI I NJËMBËDHJETË

Mato Gruda hapi ngadalë derën e odës. E ëma e Murat Shtagës rrinte pranë vatrës me hallë Esmanë, ndërsa Zara merrej me punët e shtëpisë. Të dyja plakat bisedonin dhe tundnin kryet. Flaka e zjarrit ua ndriste gjysmën e fytyrës së rrudhur dhe dukej sikur i shpinte në lashtësi, i bënte më të vjetra.

— Njatjeta, nëna e Muratit! — tha Mato Gruda dhe, duke e zënë për dore, u ul pranë saj.

— Si je, o bir? Fëmijët, gruan... Shyqyr, — tha nëna e Muratit. — Që atë ditë që erdhe e more ato plaçkat për partizanët, nuk të kam parë. Po mirë qenke...

— Mirë. Murati si është?

— Murati? Ja me atë të shkretë punë të malit. Njëherë në një shtëpi, njëherë në një fshat. Nuk di ç'të them se ç'bën. Më është dobësuar djali. Ah, kjo e shkretë pulitikë! Nuk e marrin vesh të gjithë dhe Muratin e ha merakun, se s'i bind dot, moj Esma! Është i madh në pulitikë Murati! Kur të ikë dushmani, do bëhet akoma më i madh... Më është dobësuar, ia marçta të keqen. Ishte te Fizët. Rrahu t'ua mbushë mendjen të dalin në mal, nuk i la plaku Mere. Pas Muratit shkova edhe unë dhe i thashë plakut Mere: «Po ti, o matuf, pse nuk i lë djemtë të dalin në mal? Po ti, o matuf, pse ma mundon djalin? E shiko, o matuf, se, po u bëre me Tosun Baçin, do të vij e të ta djeg shtëpinë ja me këtë dorë!...» Kështu i thashë. Ai më vështroi me sy si të xhindit e tha: «Largoje, o allah, shejta-

nin!» Po unë i thashë: «Je shejtan vetë, se unë nuk jam shejtan, po jam nëna e partizanit që merret me pulitikë dhe ti më març pleshtat.»

Mato Gruda e vështroi nënën e Muratit me habi. Atij nuk ia merrte mendja që kjo grua e lashtë, e imtë, e dobët të bëhej një ndihmëse kaq e madhe e të birit e të merrej bile edhe me politikë. Ai e krahasoi atë me hallë Esmanë. Hallë Esmaja nuk i dinte këto gjëra. Ajo e kishte mendjen te hakmarrja ndaj Fizëve. Shpesh i thoshte Matos: «Djalë, tani duhen përvëlur Fizët, siç na kanë përvëlur!» Ndoshta edhe hallë Esmaja, po të mos e kish mendjen te hakmarrja, mund të bëhej si nëna e Muratit.

— Ndenja, ndenja në shtëpinë e Fizëve nja tre sahat. Vërtet plaku Mere nuk donte të dëgjonte për partizanët, po stërnipërit e tij, siç ma merr mendja mua, kanë qejf të dalin në mal. Ke parë ti, Esma? — Ajo u kthye nga halla. — Edhe Shega ka qejf të dalë partizane. Shega, moj, e motra e Fahremudinaliut! Ajo më tha në vesh: «Hallë, unë do shkoj me Muratin!» Ke parë ti?

Hallë Esmaja buzëqeshi. Mato Gruda rrudhi vetullat.

— Moj Nalo!... Nuk më duket shenjë e mirë... — tha hallë Esmaja

— Pse?

— Shega është goxha pelë.

— E?

— Mos ia ka prishur mendjen Muratit?

— T'u thaftë gjuha që në rrëzë! — tha nëna e Muratit.

— Ndodhin gjëra, ndodhin, — tha Esmaja.

Këtu u hodh Zara:

— Ç'janë këto! Murati është i martuar dhe ka një tufë fëmijë!

Hallë Esmaja përsëri vuri buzën në gaz.

— Ne i kemi qejf më shumë kulaçet e ngrohta, se sa misërniket e ftohta, — tha ajo.

Mato Gruda ndezi cigaren me një thëngjill në vatër. Atij nuk i pëlqyen fjalët e hallë Esmasë.

— Hajvanllëqe! — tha ai. — Nuk duhet t'i marrim njerëzit nëpër gojë. Nuk ka kohë Murati të merret me gjëra të tilla.

— Ah, more djalë, femra të bën të merresh me gjëra të tilla edhe sikur të të kenë shpënë pranë një kazani me zift të valuar dhe ta dish që pas një ore do të të hedhin brenda... Femra, more djalë, femra! Shega është e bukur. Ajo s'e ka mendjen te partizanët, po te... — hallë Esmaja tha një fjalë të ligë dhe të gjithëve nuk u erdhi mirë.

— Të dija grua me mend, po qenke më e ligë se plaku Mere, — tha nëna e Muratit.

— Më març pleshtat ti dhe plaku Mere! — thirri hallë Esmaja.

Nëna e Muratit u ngrit e dëshpëruar. Mato Gruda ia hodhi dorën në sup dhe iu lut të ulej dhe të mos i merrte për të keq fjalët e hallës. Por ajo ishte grua me karakter të fortë:

— Po dal, djalë! Më mirë thirreni të vijë për darkë Tosun Baçi. Ai erdhi me njëzet shpirt në shtëpinë e plakut Mere. Sa po ikja unë, ai erdhi. Shko, Esmaja, thirre për darkë, se edhe ai gjuhën e ka si tënden...

Tani Mato Gruda e harroi zënkën e plakave. Tosun Baçi paska ardhur te plaku Mere! Qenka punë e mbaruar! Fizët qenkan hedhur nga ana e ballistëve. Dhe atij i shkoi mendja te topi...

— Tosun Baçi the? Prit, nëna e Muratit, prit! Tosun Baçi te Fizët? — pyeti Mato Gruda.

— Po, bir, Tosun Baçi, — tha nëna e Muratit dhe në zërin e saj ndihej një vuajtje e thellë.

Ajo mori shkopin që e kishte lënë në qoshe të odës dhe u mat të dilte. Zara i doli përpara.

— Rri, nëna e Muratit, për darkë!

— Faleminderit, bijë! Po shkoj t'i dërgoj haber Muratit që të fshihet, se mos e kapin horrat e Tosun Baçit.

E përcollën gjer te porta e oborrit dhe u kthyen përsëri në odë. Mato Gruda rrinte i ngrysur. Atij i vinte inat me hallë Esmanë. Ç'iu shkrep asaj të fyente nënën e Muratit?

— Po ti ç'pate? — tha ai.

— Hë, na bëka për vete edhe femrat e Fizëve! Në vend që të marrë hakun, që e ka lënë pa e larë për turp të botës, hyka dhe dalka te Fizët dhe zbardhka dhëmbët

me Shegën! Pika burrit! Merret me gratë! Hë, Shega na dalka partizane! Pika, pika!

— Ty s'të duhet gjë! — tha Mato Gruda.

— A ç'më çan kokën! Mos je edhe ti më i mirë se Murati. Ty ta përvëluan shtëpinë Fizët dhe s'je akoma i zoti të zbrazësh një kobure kundër tyre! Mbeti haku pa marrë. Pika, pika! Burra që rrinë në çitjanet e grave. Të shkojnë Fizët njëzet herë te porta dhe ti i vështron si gallof. Pse nuk shkon t'ua ndezësh edhe cigaren! Mos do t'i thërresësh në gosti? Pika, pika! As gjyshit s'i ke ngjarë, as tët ati s'i ke ngjarë. Ja si më thërret gjaku i tyre! Ja si më gjëmojnë veshët. Edhe hiri i tyre më thërret... Rri tif Nesër të vijnë Fizët e të vrasin edhe tët bir! Dhe ti prapë do hapësh gojën si gallof. Dhe prapë Fizët do të kalojnë te porta jote. Pika, pika! — Hallë Esmaja hapi krahët dhe përpoqi shuplakat, si në çastet e një gjëme të madhe.

— Hallë Esmaja! — thirri Zara. — Mos ia ndill të keken Zigurit, djalit tim!

Hallë Esmaja, pa folur, me leshra të lëshuara, u ngrit dhe iku nga oda, duke i lënë vetëm Maton dhe Zarën. Ajo la në odë edhe një trishtim të madh. La në odë jehonën e zërit të stërgjyshërve, jehonën e gjakut... Mato Grudës iu duk sikur kjo jehonë spërkati me gjak tytën e topit të fshehur në plevicë.

— Hë, — tha Mato Gruda, — hallë Esmaja nuk e di.

— Çfarë s'di! — tha Zara.

— Topin, — tha Mato Gruda ngadalë.

Zara u zbeh. Ajo e ndjeu se jehona e zërit të stërgjyshërve e dehu Mato Grudën dhe u drodh, se e dinte se çfarë hekuri fshihej në kashtën e plevicës. Po të ndodhte ndonjë gjë, do të ishte marrëzia më e kobshme dhe për këtë do të ishte edhe ajo vetë fajtores. Pse? Ç'mund të bënte? Po, mund të bënte diçka. Të vinte e t'i thoshte Muratit. T'ia tregonte topin. Ta mernte topin Murati e ta shpinte te partizanët. Por ajo pastaj duhej të ikte nga shtëpia, se Mato Gruda do ta vriste. Ku të shkonte? Vetëm një rrugë kishte. Të vinte me partizanët. Po fëmijët?...

Që kur kishte ardhur topi në shtëpi, ajo e kishte humbur qetësinë. Ajo tирte në mendje lloj-lloj mendimesh.

Nuk dinte se ç'të bënte për ta larguar atë tog hekurash nga shtëpia. Togu i hekurave flinte nën kashtë, Zara flinte nën jorgan e shqetësuar me ëndrra të turbullta.

— Po, topin! — tha Mato Gruda.

Ajo heshti. Pastaj diçka shkrepiti në sytë e saj.

— Mato! — tha ajo dhe iu afrua të shoqit, si atëherë kur ishte me barrë, si atëherë kur priste të lindte Zigurin. Mato Gruda u tremb, se kujtoi se mos Zara kishte mbetur përsëri shtatzënë. Ç'të bënte pastaj? Ku mbaheshin dot tri fëmijë? Ai nuk donte të kishte edhe kalamanj të tjerë, se nuk mund t'i ushqente. Në të vërtetë atij ia kishte ënda të kishte edhe një çupë, por e shkreta varfëri...

— Mato! — përsëriti Zara dhe u afrua më shumë.

— Çfarë? — tha ai.

— Pse nuk bëjmë edhe një çupë? Ne vetëm dy djem kemi, — tha ajo dhe u skuq si vajzë.

Mato Gruda rrudhi vetullat. Ç'thoshte kështu Zara? Në këtë kohë turbullirash paska dëshirë të lindë fëmijë? Ta lëshojmë fëmijën në valë të turbullta? Të qajë fëmija dhe zëri i saj të futet në grykën e topit?

— Ç't'u shkrep?

— U mërzita, Mato, dua të përkëdhel një të vogël, ta marr në krahë, t'i jap sisë, ta tund në djep, ta mësoj të të thotë «baba»...

— Ke djemtë, — tha ai.

— Djemtë u rritën, ata s'mblidhen në shtëpi, — tha Zara.

— Nuk është koha për fëmijë. Turbullirë e madhe...

Zara ia hodhi duart në qafë Matos dhe ai u zbut. U zbut Mato Gruda si qengj dhe ngrohësia e mbuloi tërë trupin e tij.

— Mato... — pëshpëriti Zara, — e zëmë që sot, çupën, që tani e zëmë...

Mato Gruda u zgjua

— Jo! Është turbullirë... — tha ai ngadalë si njeri me mendime të thella, mendime të grumbulluara nëpër vuajtje të mëdha.

Atëherë Zara u shkëput nga ai. Uli sytë në dysheme dhe e pikëlluar tha:

— Ty t'i ka marrë mendtë ai. Edhe fëmijët i ke harruar, edhe fëmijë s'ke qejf të bësh. Të ka turbulluar ai...

— Kush?

— Ai, — tha Zara.

— Gjepura! — tha Mato Gruda, kur e kuptoi përse bënte fjalë e shoqja.

— Edhe tani tek ai e ke mendjen. Ti shkon gjithnjë në plevicë dhe e zbulon. E zbulon. Ia sheh tytën e kënaqesh...

Mato Gruda e vështroi me vetulla të ngrysura dhe nuk i dha përgjigje. U ul në nim dhe nxori kutinë e duhanit.

Zara i vajti përsëri pranë dhe u ul në krah të tij. Ajo vështronte gishtërinjtë e trashë të burrit që dridhnin cigaren, gishtërinj të verdhë nga nikotina. Në odë dëgjohej vetëm zjarri.

— Ku janë djemtë? — pyeti Matoja.

— Lozin me italianin.

— Lozin! Ai është i pirë.

— Po i bën një qerkë Sadikut. Edhe ai kalon kohën... Pija i ka dalë, siç duket.

— Kalon kohën... — tha Mato Gruda.

— Ty ta mësoi atë?

— Kalon kohën... — përsëriti Mato Gruda.

— Të vij edhe unë të mësoj?... — tha Zara.

Mato Grudës i mbeti cigarja pa u dredhur. Ai ktheu kokën me habi nga Zara.

— C'të të mësojë?

— Topin! — tha ajo.

— Ama llaf!

— Ta di edhe unë...

— Pse?

— Ndodh ndonjë gjë... — tha Zara e menduar.

— Ti atë nuk e do!...

— Mato, i mbrejmë qetë si atë natë dhe e nxjerrim nga plevica? Natën asnjeri s'na sheh... E? — tha Zara papritur.

— Pastaj?

— T'ua shpiem partizanëve. Ata do të gëzohen!

— Kam punë me të. Më vonë do t'ua shpiem. Më vonë edhe unë mund të shkoj bashkë me të. Tani as nuk ua shpie, as nuk shkoj. Kam ca punë. Nuk zgjat shumë. Pastaj e bëjmë atë që thua ti... Doemos ashtu do ta bëjmë... Këtu jemi. Hëpërhë na duhet, — tha Mato Gruda dhe u ul në vatër të ndizte cigaren. Si e ndezi, qëndroi në mes të odës, duke vështruar gruan. — Pastaj, Zarë, bëjmë edhe një çupë. Tani nuk e bëjmë.

Zara psherëtiu.

— Nëna e Muratit tha se te Fizët ka ardhur Tosun Baçi.

— Ë, — bëri gruaja.

— Do kenë gosti. Plaku Mere ka gosti. Do pijë Tosun Baçi. Vanë Fizët. U bënë ballistë. Ia hëngra t'ëmën... — tha Mato Gruda.

— Ti kujton se shkoi për darkë Tosun Baçi dhe mbaroi puna, u bënë ballistë?

— Ashtu duket! — tha Mato Gruda dhe buzëqeshi.

Buzëqeshja e tij Zarës nuk i pëlqeu. Diçka fshihte kjo buzëqeshje.

— Tosun Baçi mund të vijë edhe te ne, po kjo s'do të thotë se ne do bëhemi ballistë, — tha ajo.

— Ashtu fillon, — tha Mato Gruda dhe u drejtua nga dera. Zara u ngrit.

— Ku shkon? — pyeti ajo.

— Do dalim me Agushin të bëjmë hendek në ara. Hendekët i kemi për faqe të zezë. Arat janë bërë pëllgje-pëllgje, se s'kullon uji.

— Mirë që u kujtove, — tha Zara. — Unë mendova se ti i harrove arat... .

Mato Gruda e vështroi vëngër të shoqen dhe doli nga oda.

KAPITULLI I DYMBËDHJETË

Para se të shkonin në arë për të bërë hendek, ata u kthyen në dyqanin e Adnan Pinxhos. Mato Gruda donte të blinte një kilogram sheqer për kafe, pasi kishte kohë që mungonte. Hallë Esmaja harxhonte shumë kafe. Me gjithëse e pinte të hidhur, prapëseprapë sheqeri shkante.

Të dy me Auguston ata hynë në dyqanin e Adnan Pinxhos me bela në krahë. I zoti i dyqanit i ftoi të uleshin dhe i pyeti nëse donin ndonjë kafe.

Mato Grudës iu kujtua djali i vogël që u vra me kripë në dorë para derës së atij dyqani dhe u pikëllua.

Por ai nuk pranoi të ulej e të pinte kafe. Ai e quante Adnanin shkaktarin e vrasjes edhe së të vëllait, edhe të të vëllait të Aliut. Adnani për Maton ishte një nga njerëzit më të padëshiruar të fshatit Arun.

Adnan Pinxhoja e vështroi shtrembër:

— Ti, Mato, nuk vjen kurrë në dyqanin tim, sikur të isha Mere Fizi.

— Vij kur kam nevojë, — tha ftohtë Mato Gruda.

— Sot paske ardhur me një sejmen pas. Edhe me ç'sejmen sel... Me sejmen italian... Ç'them edhe unë! Ky nuk është sejmen, po dylber. Hi-hi! — bëri Adnan Pinxhoja.

Mato Gruda e vështroj nën vetulla me rreptësi të tillë, saqë Adnan Pinxhoja u drodh. Ai i uli sytë, po Mato Gruda vazhdonte ta vështronte po me atë rreptësi në heshtje. Më e tmerrshme ishte heshtja.

— Një pako sheqer doni, apo më tepër. S'ka gjë, po të mos keni para, m'i jepni më vonë, — murmuriti Adnan Pinxhoja, duke lëvizur duart pa asnjë qëllim.

Mato Gruda e vështronte i zymtë, i egër, i tmerrshëm, gjithnjë në heshtje. Në xhepin e tij lëvizte tyta e revolverit. Adnan Pinxhoja e ndjeu atë lëvizje. Gishti nuk mund të ishte aq i gjatë e aq i trashë. Në xhep fshihej një revolver!

— Ne, Mato, kemi shkuar mirë bashkë, — belbëzoi Adnan Pinxhoja qull në djersë.

Në dyqan nuk kishte hyrë asnjëri përveç Matos dhe Augustos. Adnan Pinxhoja dridhej dhe shikonte derën. Matos, këtij njeriu pa fjalë, ai i trembej. E trembte edhe ndershmëria e tij. I ndershmi i zemëruar është nga më të tmerrshmit. Ç'iu desh që ta ngacmonte?!

Mato Gruda i hodhi sytë mbi raft, ku Adnan Pinxhoja kishte radhitur shishet e vajit, njëra pas tjetrës. Nxori revolverin, e vështroi Adnanin që po lebetitej dhe shënoi në shishen e parë. Revolveri krisi dhe copërat e shishes bashkë me vajin ranë në truall. Augustoja e hoqi për xhakete të zotin, por ai e shtyu me bërryl. Mato Gruda e futi revolverin në xhep. Nxori paratë dhe i vuri në banak.

— Sheqerin! — thirri ai.

Adnan Pinxhoja zgjati ngadalë kokën nga ishte fshehur, mori sheqerin dhe ia dha duke u dredhur.

— E pe atë shishen? E pe vajin që u derdh? Unë di të thyej edhe shishe të tjera një metër e shtatëdhjetë të gjata dhe të derdh vaj të kuq! — tha Mato Gruda.

Mori sheqerin dhe doli bashkë me italianin e zverdhur si meit.

— Mato njeri madh. — tha Augustoja.

— Atë e di unë, — tha Mato Gruda.

Mato Gruda qëllonte për herën e parë me revolverin që ia kishte marrë italianit të vrarë në koriye. Duke ecur, ai e harroi Adnan Pinxhon dhe filloi të mendonte për revolverin. «Qëlluaka mirë e shkreta» — tha ai me vete.

— Unë tremba — tha Augustoja.

— Ç'ka këtu për t'u trembur? — ia preu Mato Gruda.

— Vret dyqanxhi, — tha Augustoja.

— Pis millet! — shtrëngoi dhëmbët Mato Gruda.

— A? — bëri italiani që nuk e kuptoi shprehjen.

— Është njeri i poshtër dhe i poshtri është frikacak, se e do shumë veten e vet, — tha Mato Gruda.

— Flet mirë, Mato, — tha Augustoja i menduar dhe ndjeu në veten e tij një krenari që ecte bashkë me një njeri të tillë, si Mato Gruda. Ai, duke ecur, herë pas here ia hidhte tinëz sytë dhe e vështronte me admirim, si ndo një perëndi. Tani edhe vetja i dukej më e sigurt.

Duke ecur, Mato Gruda u mundua ta harronte këtë ngjarje. Kur e pa nga larg të birin, Zigurin, gjithë ajo potere humbi në mjegull.

— Na sheqerin dhe shpjere në shtëpi! — i thirri ai të birit.

Ziguri e mori qesen e vogël në dorë dhe u kthye në shtegun që të çonte drejt e në shtëpi. Mato Gruda e vësh-troi për një çast e tha:

— Po rritet!

Ata zbritën tatëpjetë kodrës me bela në supe. Mato Gruda shkante përpara, Augustoja vinte pas. Era ua merr-te cepat e xhaketave prej shajaku dhe balta u ngjitej pas këpuce. Tyta e revolverit të vogël në brez të Mato Grudës herë shfaqej e herë fshihej. Lumi Krak shtynte ujë të turbullt e oshëtinte tatëpjetë luginës së ngushtë. Nga larg dukej tymi i oxhakut të shtëpive të Fizëve. Era e tymit përzihej me erën e lagështirës së tokës.

Kur iu afruan arës që shtrihej këtej bregut të lumit, ata ndalën. Një cipë e hollë mjegulle e tymi hapej mbi luginë, por kjo cipë ishte e tejdukshme, e kaltër. Nëpër këtë cipë dukeshin pellgjet e arës së Mato Grudës. Arën e kishte mbjellë me grurë. Bima e imtë vende-vende du-kej e verdhë nga lagështira dhe Matos i erdhi keq. Ai u ul dhe këputi një llastar të vogël gruri. E afrohi pranë syve, e vështrroi, e vërtiti në dorë e tha ngadalë:

— Je dobësuar pak, or i uruar. E kam fajin unë që të kam lënë në mes të ujit, që s't'i kam thëlluar hendeqet, që të kam harruar. Po unë do ta thaj ujin e t'i do ngrohesh e do ngresh kryet e do hazdisesh. O kolopuçi i xhaxhait

— i tha ai kërcellit që mbante në duar dhe pastaj e futi në gojë dhe e përtypi. Kërçelli kishte erë të mirë dhe Mato Gruda buzëqeshi.

Italiani në fillim kujtoi se Mato Gruda fliste me vete. Kur e kuptoi se ai fliste me kërcëllin e grurit, qeshi dhe tundi kokën. «Matua flet edhe me grurin» — mendoi ai, duke e shikuar me një admirim të madh të zotin.

Mato Gruda u drejtua në fund të arës, andej nga pje-rësia e saj. Italiani vazhdonte të qëndronte. I zoti ktheu kokën pas:

— Agush, në fillim do të hapim këtë hendek, pastaj do bëjmë ca vija që të kullojë ujët.

Augustoja i ra përmes arës, për të prerë shkurt. Kë-pucët e tij futëshin thellë në baltë.

— Agush, bjeri nga ledhi, se më dreqose grurin! — thirri Mato Gruda.

— A?

— Më prishe grurin, të them. Një byrek e hëngre që tani, pa ardhur vera.

— A? — pyeti Augustoja.

— Tutkun! Kalo nga ledhi. E shkele me këmbë gru-rin! — thirri Mato Gruda dhe bëri me dorë.

Augustoja e kuptoi dhe kaloi nga ledhi. Atij iu kuj-tua koha e ushtrisë. Një batalion i tërë kalonte nëpër gru-rin e sapombirë dhe gjithçka shkatërrohej. Edhe këpucët e tij e fundosnin grurin. Askush nuk mendonte se, për të mbirë gruri, kishte rrjedhur shumë djersë. Atij i kujtohe-shin edhe fshatarët që vështronin të vrenjtur në ledh të arës. «Po ai fshatari që u vra në ledhin e arës, se i pati dalë përpara komandantit të batalionit dhe ishte sharë me të? Ai u shtri pranë kërcëjve të posambirë të grurit dhe gjaku rrodhi në ledh... Batalioni u largua duke lënë pas grurin e shtrirë e të gërryer nga këpucët me gozhdë dhe të zotin e grurit të shpuar me plumb në gjoks. Dy vrasje: fshatari dhe gruri» — mendoi Augustoja.

— Atje filloje ti, këtu unë, — tha Mato Gruda, duke zhveshur xhakëtën prej shajaku.

Italiani e hoqi belin nga supi dhe e nguli në tokë. E la ashtu të ngulur dhe ndoqi me sy Mato Grudën.

Mato Gruda rëndoi me këmbë në veshin e belit, pastaj e ngriti, duke prerë një thelë toke të njomë. Thelën e tokës e nxori në krahun e djathtë dhe e lëshoi në anë të arës. Augustoja priste më këmbë.

— Pse nuk fillon? Nuk di të bësh hendek? Afrohu dhe vështromë mua, — tha Mato Gruda dhe përsëri nguli belin.

— Nuk di të bëj hendek, — tha italiani.

— Llogore a ke bërë?

— Po!

— S'ditke të bësh hendek! Hendeku është llogore! — tha Mato Gruda. — Ju s'latë kodër pa e mbushur me llogore.

— Po, llogore, hendek, një! — tha italiani.

— Një s'janë, xhanëm! Hendeku për të kulluar uji, llogorja për të futur kokën. Një s'janë, xhanëm, po e njëjta punë... — tha Mato Gruda.

Augustoja filloi të hapte hendek. Katër-pesë belat e parë ai mezi i nxirrte, pastaj dalngadalë u mësua, veçse thelat e tokës i priste shumë të trasha dhe hendeku nuk bëhej i bukur. Mato Gruda kishte qejf që hendeku të bëhej si kurriz peshku dhe mbi atë kurriz peshku pastaj të ngulte gjemba, që të mos futeshin dot bagëtitë.

— Agush, mos i pre thelat të trasha.

— Mirë, — tha Augustoja.

— Ka në Itali hendekë?

— Ka, — tha Augustoja.

— Kështu siç i bëj unë, i bëjnë?

— Kështu!

— Le që i prishën ushtritë hendekët e arat e grunjrart e... — tha Mato Gruda.

— Në Itali nuk u prishën, — tha Augustoja.

— A, nuk i prishte? Po ushtria juaj i prishi arat e hendekët tanë...

Augustoja nuk foli. Mato Gruda kishte të drejtë.

Belat gërvishnin në tokë. Në këmbët e tyre grumbu-llohej ujë i turbullt.

— Si llogore, — tha Augustoja.

Mato Grudës iu kujtua ajo llogorja, ku gjeti gjylet

dhe topin. Iu kujtua edhe ushtari i vrarë që ia mori revolucionin dhe rrobat.

— Shumë nga ju mbetën në llogore, — tha Mato Gruda.

— Shumë, — tha Augustoja.

Në këtë kohë u dëgjua një krismë pushke e mbytur. Vinte nga shtëpia e Fizëve. Augustoja ngriti kokën i shqetësuar. Mato Gruda e kuptoi. Tosun Baçi ndoshta e kishte filluar që herët rakinë. Do të ishte bërë më qejf dhe do të kishte dalë në oborr për të shtënë në shenjë. Ai kështu bënte gjithnjë. Po Mato Gruda nuk donte t'i tregonte Augustos për ardhjen e Tosun Baçit, se nuk kishte dëshirë ta trembte.

— A? — pyeti Augustoja.

— Vrasin ndonjë sorrë Fizët, — i tha Mato Gruda Augustos.

Pastaj Mato Grudës i shkoi mendja te Murat Shtaga. «A e kanë lajmëruar për ardhjen e Tosun Baçit? Me sa duket Tosun Baçi nesër do të mbledhë fshatin për të bërë me vete shokë» — mendoi Mato Gruda.

— Këta Fizët janë të poshtër, — tha me zë të lartë Mato Gruda.

— Si? — pyeti Augustoja.

— Hiç! — tha Mato Gruda, se nuk donte të merrte vesh një i huaj për mosmarrëveshjet e tij me të tjerët. Hesapet e shtëpisë nuk nxirren në pazar.

— Ka ballistë në Itali? — pyeti Mato Gruda papritur.

— Ballistë?

— Ballistë!

— Nuk e di. Sa isha unë, nuk kish, — tha italianin.

— Hë, nuk kish! — përqeshi Mato Gruda. — Po ju me Duçen ç'ishit, nuk ishit ballistë? Nuk kish! Kur ishe ti në Itali, të gjithë ballistë ishin. Unë them tani, unë them sot.

Dy veta hapnin një hendek në një rrip toke buzë një lumi, dy veta dikur krejt të panjohur, dy veta nga dhera të ndryshme. E para syve të tyre gjelbëronte një grurë i sapombirë, që nuk e dinin se kur do të piquej, që nuk e dinin nëse do ta korrnin ata vetë, apo do ta korrte ndonjë tjetër. Mbi gjelbërimin e zbetë të këtij gruri sa vinte dhe

aq më e trashë bëhej cipa e mjegullës dhe e tymit, se dita po mbaronte...

Cipën e mjegullës dhe të tymit përsëri e grisi një krismë pushke. Krisma mezi dëgjohej, se nuk e linte oshëtimin e lumit Krak.

— Prapë! — tha italiani.

— Vrasin sorra, — tha Mato Gruda.

Po ç'është e vërteta, ai mendoi për Tosun Baçin. Bëj qejf, o Tosun Baçi, me Fizët, bëj! Meqë zbraz pushkë, patjetër ti bën qejf. Mirë, kthejua mendjen Fizëve.

— Ka shumë njerëz ajo shtëpi? — pyeti italianin, duke shikuar nga shtëpia e Fizëve i mbështetur në bel.

— Një batalion! — tha Mato Gruda.

— Të mirë?

— Çdo shtëpi ka të mirë, ka edhe të këqij, — tha Mato Gruda, pa e ndërprerë punën.

Në këtë kohë, nga kodra karshi, nën shtëpitë e Fizëve, ata vunë re një njeri duke vrapuar. Augustoja u shqetësua.

— Shenjë keqe, — tha ai.

Mato Gruda u mbështet në bel e ndenji një copë herë i përkulur me vështrim nga njeriu që vraponte. Njeriu vinte prej Fizëve. Me siguri në shtëpinë e tyre duhej të kishte ndodhur diçka. «Mos janë zënë me Tosun Baçin?» — mendoi ai.

— Grua... Është grua, — tha italianin.

Mato Gruda vuri dorën përpara ballit.

— Vërtet grua, — tha ai.

— Vrasin grua? — pyeti Augustoja me një zë të trembur.

Mato Gruda u ngrys:

— Pse ta vrasin? Ne nuk i vrasim gratë.

— Xhelozia vret gra, — tha Augustoja.

— Ama të folur! Në kohë të tilla s'punon xhelozia, — tha Mato Gruda.

— Italianët vrasin gra; kanë xhelozia; vrasin gra, — tha Augustoja.

Mato Gruda, pa kthyer kokën nga Augustoja, tha:

— S'ma merr mendja të kenë aq xheloz. Po të kishin aq xheloz, do të vriteshin të gjithë. Italianët me të gjitha gratë shkojnë...

Augustoja qeshi:

— Jo, Mato!

— Ato mos m'i thuaj mua. E di unë atë... — tha Mato Gruda. — Po të kishit xheloz, nuk do t'i linit gratë vetëm dhe të bridhnit nëpër botë me nga një pushkë në dorë: Ju keni pasur xheloz për të zaptuar vende!

— Mato i zgjuar, — tha italiiani.

— Atë e di unë, — tha Mato Gruda.

Gruaja u fsheh në dushqe, pastaj u shfaq poshtë përroit dhe erdhi pranë arës. Mato Gruda e njohu. Ishte Shega. Ajo vraponte drejt tyre. Augustoja kapuliti sytë në heshtje. Ajo qëndroi afër një shelgu të ventuar në breg të lumit Krak dhe thirri:

— Mato! Mato!

Mato Gruda, pa u përgjigjur, e la belin dhe shkoi pranë saj.

Shega ishte skuqur dhe sumbullat e djersës i ishin mbledhur në fund të mjekrës së saj të vogël. Merrte frymë me zor dhe kraharori i saj ulej e ngrihej nën jelekun e shtrënguar.

— Mato! — tha ajo.

— Hë!

— Mato! Tosun Baçi do të djegë nesër shtëpinë e Muratit. Ai po e kërkon Muratin... I duhet thënë të ikë Murati. Edhe plaçkat t'i heqin nga shtëpia. Tosun Baçi bëri bé dhe tha se do ta përvëlonte si miun Murat Shtagën. Mos e ke parë ku është Murati? Unë po shkoj t'u ndihmoj të heqin plaçkat, pa ardhur ballistët, — tha ajo, duke marrë frymë me zor.

Mato Gruda kurrë nuk kishte folur me njerëzit e shtëpisë së Fizëve. Shega ishte e para që prishi këtë heshtje. Ai heshte para saj i ngrysur me vetulla të rrudhura mbi sytë e tij të thellë. Në kohë të tjera ai kurrë nuk do t'i kishte dalë asaj përpara, sikur ta shihte edhe në buzë të varrit.

— Mato, edhe ti duhet ta kërkosh Muratin, — tha ajo duke hedhur një hap drejt tij.

— Atë e di unë, — tha Mato Gruda i vrenjtur, se nuk i erdhi mirë që ajo e mësonte si të vepronte me shokun e tij.

— Si të duash, po unë them ta kërkosh, — tha Shega dhe nisi përsëri vrapin.

Mato Gruda me hapa të rëndë u kthye tek Augustoja. Italiani kishte vënë duart në mes dhe vështronte Shegën që ecte me vrap në ledhin e arës. Asaj i ngrihej fustani gjer në pulpat e bëshme e të kuqërreme nga tendosja e muskujve. Nga vrapimi u pengua në një plis të madh dhe ra. Atëherë fustani i gjerë ia zbuloi këmbët dhe iu mbështoll në kokë. Augustoja vështronte. Mato Gruda shfryu:

— Hendekun, Agush, hendekun! — dhe tregoi me kokë belin që italianin e kishte përpara. Mato Gruda nuk donte që i huaji të ndiqte me sy femrat.

— Vajzë mirë, — tha italianin.

— Hë! — bëri Mato Gruda i zemëruar me fjalët e italianit.

Augustoja e futi belin në tokë, po fytyrën vazhdoi ta mbante nga Shega.

— Hendekun! — shfryu përsëri Mato Gruda.

Në këtë kohë në kodrën karshi, nën shtëpitë e Mato Grudës, po zbriste një njeri tjetër. Mato Gruda e vështrroi dhe e njohu Adnan Pinxhon.

Adnan Pinxhoja u hodh në shteg dhe ia preu udhën Shegës. Shega ndali dhe mekanikisht vuri duart përpara gjoksit. Mato Gruda dhe italianin lanë belat. Shfaqja e këtij njeriu atyre u erdhi e papritur. Ata vështruan njëri-tjetrin pa kuptim. Adnan Pinxhoja iu afrua Shegës dhe e zuri për mënge. Ajo u praps dhe u përkul nga pas. Mato Grudës iu kthye inati që kishte grumbulluar në dyqan.

— Më liro udhën! — thirri ajo.

Adnan Pinxhoja hodhi edhe një hap para saj.

— Ti me mua s'do të vish. Ti ke qejf atë pushtin,

atë, tfu! Atë korbin... Atë Muron! — tha ai dhe e zuri për krahu.

Shega e tërhoqi me forcë krahun dhe në dorë të Adnan Pinxhos mbeti mënga e fustanit të saj. Ai iu hodh përsëri.

— Ti do bëhesh gruaja ime. Murat Shtaga do të të marrë kur ti të kesh fjetur nën një çati me mua.

Shegë Fizi thirri me të madhe. Oshëtimën e zërit të saj e mori me vete gryka e lumit Krak. Adnan Pinxhoja e pushtoi atë me të dy krahët e tij të fuqishëm. O nga dashuria, o nga epshi, ai nuk donte të dinte se atje poshtë buzë lumit Krak ishin dy njerëz: Mato Gruda dhe Augustoja, që e shikonin dhe e dëgjonin. Mato Gruda instinktivisht vuri dorën në revolver dhe u hodh matanë hendekut. Pas tij shkoi edhe Augustoja, duke marrë me vete edhe belin tërë baltë.

Adnan Pinxhoja mundahej ta vinte poshtë Shegën në shtegun me driza.

— Adnan Pinxhua! — thirri Mato Gruda me një zë të egër.

Adnan Pinxhoja e la Shegën dhe u spraps, duke u hedhur matanë shtegut të ngushtë. Ai qëndronte i zbetë. Duart i dridheshin dhe mjekra i kishte shkuar mënjanë. Ajo u ngrit, e shkundi fustanin e ndotur me baltë e fletë drizash të thata dhe, pa thënë asnjë fjalë, mori vrapin përpjetë kodrës.

— Ç'ke me atë vajzë! — tha Mato Gruda me një qetësi të shtirë.

— Atë e dua, — tha Adnan Pinxhoja. — Dhe ju mos futni hundët.

— Horr! — shfryu Mato Gruda.

— Unë të!... — mbylli grushtin Adnan Pinxhoja dhe iu afrua Matos.

Augustoja ngriti belin për t'i dhënë të kuptonte Adnanit se kishte të bënte edhe me një njeri tjetër. Adnani i verdhë dyllë qëndronte në shteg me grushte të mbyllura.

— Që kur u bërë mik i Fizëve? — u mundua të buzëqeshte hidhur Adnan Pinxhoja.

— Jo, more, dashke që unë të bëja sehir kur ti të

shqeyeje një femër... Hajde, mbushu! — tha Mato Gruda.
Adnan Pinxhoja u ul dhe rrëmbeu një gur të madh në dorë.

Mato Gruda vuri dorën në brez dhe hoqi revolverin.

— Hidhe gurin dhe mos më dil më përpara... — tha ai dhe i bëri me kokë italianit të largohej.

Adnan Pinxhos i shpëtoi guri nga dora. Mato Gruda futi revolverin në brez, i bëri shenjë italianit dhe u largua... Adnan Pinxhoja mbeti vetëm.

Ata u drejtuan përsëri në arë. Adnan Pinxhoja qëndroi një copë herë dhe mori ngadalë përpjetë shtegut.

— Xhelozia? — pyeti Augustoja.

— Ç'më çan kokën me gjithë xhelozia! — shfryu Mato Gruda.

Augustoja heshti.

Si mbaruan një copë të hendekut, u hodhën në arë dhe filluan të hapnin vijat kulluese. Në luginë po binte mbrëmja. Më nuk dukej tymi i oxhakut të Fizëve. Në dritare ndriste kandili i plakut Mere dhe në odat e tjera kishte dritë. Augustoja, duke hapur vijën diçka murmuriste:

— Adnan Pinxhoja i keq? — pyeti ai.

— Meqë donte t'i bënte keq një femre, duhet të jetë i keq, — tha Mato Gruda.

— E do femrën, — tha Augustoja.

— E pastaj?

— Puth! — tha Augustoja.

— Tfu! — pështyu Mato Gruda. — Me zor nuk shtrihet femra në udhë. Në Itali i shtrijnë me zor femrat? Le që dihet, i shtrijnë, — u përgjigj vetë ai.

— Ushtarët i shtrijnë, — tha italianin.

— Tani shtrihen ushtarët... — tha Mato Gruda.

— A? — pyeti Augustoja.

— Tani u shtrinë ushtarët tuaj, si femrat u shtrinë, — tha Mato Gruda.

Augustoja nuk foli.

Dy pëllgje të mëdha filluan të shtronin. Ujë të vrapon-

te në vijat dhe binte në hendek. Gruri i mbuluar gjer atëherë me ujë filloi të zbulonte majat e zverdhura.

— Të lirova nga pellgu, o kolopuçi i xhaxhait! Sa je munduar nën ujë, sa je munduar! — i tha Mato Gruda grurit.

Italiani vështronte.

— Fole grurit, Mato? — tha ai.

— Atë e di unë! — tha Mato Gruda. — Tani vrap të gjejmë Murat Shtagën.

KAPITULLI I TREMBËDHJETË

Mato Gruda u qetësua. Asgjë nuk ndodhi në fshat. Tosun Baçi nuk e dogji shtëpinë e Murat Shtagës. Këtë nuk e bëri ndoshta nga frika se mos i keqësonte marrëdhëniet me fshatin Arun dhe mos shtonte kundërshtarët e vet. Për çudi të të gjithëve, ai, dy ditë që ndenji në fshat, nuk doli nga shtëpia e Fizëve. Hëngri e piu, thirri disa nga pleqtë e Fizëve, kuvendoi me ta dhe krisi e iku. Se ç'u kuvendua nuk e mori vesh njeri. Por, sipas fjalëve, plaku Mere kishte mbajtur paanësinë: as me Tosun Baçin, as me Murat Shtagën. Të shohim më vonë! I ati i Adnanit, Abdurahim Pinxhoja, ishte munduar t'ia bënte qejfin dhe i kishte premtuar se pak më vonë njërin nga djemtë e tij mund ta dërgonte me Tosun Baçin dhe këtë e bënte, sipas fjalëve të njerëzve, vetëm për hir të miqësisë së tyre të vjetër.

Ngjarjet kishin ardhur gjer në pikën më të vdekur: o këtej, o andej. Patjetër, nuk do të vononte shumë, kur ato të merrnin një rrugë të qartë. Vështirësia ishte vetëm në dy fiset e mëdha: në Fizët dhe Pinxhot, veçanërisht në të parët. Përsa u përket Pinxhove, udha e tyre dalngadalë po qartësohej. Ata, siç dukej, po merrnin anën e Tosun Baçit. Aq më tepër kur edhe Marukët kishin filluar grindjet me Pinxhot për arsye të vrasjes së vëllait të Aliut.

Mato Gruda lutej në vetvete, që edhe Fizët të merrnin anën e Tosun Baçit. Dhe ç'është e vërteta, nuk i erdhi mirë, kur dëgjoji se plaku Mere ende nuk kishte rënë në ujdi me Tosun Baçin. Ndërsa Murat Shtagës i lindi një

shkëndijë shprese. Pas ikjes së Tosun Baçit, ai erdhi menjëherë në fshat. Qarkori u kishte dhënë urdhër të prerë atij dhe shokëve që fshatin nuk duhej ta linin të rrëkëllehej pas Tosun Baçit. Ishte i vetmi fshat në krahinë, që nxirrte kaq vështirësi e që kishte kaq rezistencë. Kjo gjendje rëndonte në fatin e Murat Shtagës si komunist. Domethënë, puna e tij ishte e dobët. Prandaj qarkori kishte vendosur që më vonë të niste në fshatin Arun edhe të dërguarin Xhabir.

Murat Shtaga, me të ardhur në fshat, shkoi në shtëpinë e Fizëve. Mato Gruda këtë nuk e dinte. E mori vesh më vonë, pas disa ngjarjeve të çuditshme dhe tepër të trishtuara.

Murat Shtaga vetëm me një revolver në brez e me një krehër fishekësh, i lodhur nga udha dhe i uritur, trokiti në portën e Fizëve dhe hyri brenda, si të ishte një mik i zakonshëm i asaj shtëpie.

Në odën e Fizëve ishin mbledhur të gjithë. Plaku Mere rrinte pranë dritares. Hiqte tespihet e lëvizte buzët. Katër pleq të tjerë, nipërit e tij, rrinin në rrethin e parë pas vatrës. Dhjetë stërnipërit e tij rrinin në rrethin e dytë, sipas moshave. Në mur vareshin pesëmbëdhjetë pushkë. Njëra nga ato ishte më e lashta, e kohës së Turqisë. Ishte pushka e plakut Mere. Kur hyri Murat Shtaga, të gjithë u ngritën më këmbë, përveç plakut Mere. I lëshuan bashin e vendit, pas plakut Mere, dhe përsëri u ulën në postiqet me lesh të gjatë një pëllëmbë. Pas fjalëve të zakonshme, e pas përsëritjeve të zakonshme, plaku Mere, duke numëruar kokrrat e tespiheve, tha:

— Sën nëllug këlltin bizin-te?

Murat Shtaga mbloodhi supet dhe, duke buzëqeshur, vështroi njerëzit e tjerë. Ç'ishin këto fjalë që nuk i kuptonte? Ai e dinte që plaku Mere e fliste turqishten, por s'ia merrte mendja ta dëgjonte këtë gjuhë në këtë odë. Murat Shtaga kujtoi se plaku Mere kishte lajthitur dhe ra në një gjendje të vështirë.

— Ç'thua, gjysh i madh? — tha Murati.

— Me çfarë na erdhe, pyes, — tha plaku Mere, — ç'na solle, o djali i Zenunit dhe nipi i Zija Haxhibektashit? — shtoi ai.

— Erdha njëherë, gjyshi i madh! — tha Murat Shtaga, duke u munduar të buzëqeshte.

— Ëndrra më lajmëroi se ti nuk vjen për të mirë! — tha plaku Mere.

Në odë të gjithë heshtën. Stërnipërit filluan të vështronin njëri-tjetrin. Katër pleqtë e tjerë ulën sytë në poste, duke trazuar leshin me çibukët me bishta të gjatë.

— Vij për të mirë, — tha Murat Shtaga.

— Tri herë ke ardhur për të keq; kjo është hera e katërt, — tha plaku Mere.

Stërnipërit shikonin Murat Shtagën. Plakut Mere i shkau nga supet setra. Atëherë u ngrit stërnipi i parë Fahremudinaliu, ia ngriti dhe ia vuri përsëri në krahë. Plaku Mere nuk i lëvizi supet. Stërnipërit heshtnin. Gjithë oda heshtte.

— Mora vesh se paska qenë në këtë odë Tosun Baçi, — tha Murat Shtaga pas një heshtjeje.

— Pushko e trimit dhe sofrë e mikut nuk kthehen! — tha plaku Mere.

— Ai nuk është as mik, as trim! — tha Murat Shtaga.

— Trim nuk e di, po mik është, se kapërceu këtë prag! — tha plaku Mere.

— Ai nuk e kapërcen këtë prag si mik, po si tradhtar. Kur ka dashur të kapërcejë pragje të tjera, ia kanë vënë hurin... Ai është me ata që djegin pragjet e popullit. Dhe është gënjeshtar, — tha Murat Shtaga.

Njëri nga katër pleqtë u ngrit dhe mori në kamare xhezven e kafesë dhe dy filxhanë, njërin për Murat Shtagën, tjetrin për plakun Mere. Ai e mbushi me ujë dhe e vuri në zjarr.

— Gjysh i madh, — tha Murat Shtaga, — ka ardhur koha që stërnipërit e tu të zgjedhin

udhën. Djemtë e popullit ka kohë që e kanë zgjedhur udhën. . .

Plaku Mere vuri dorën në shpatull, pastaj në zemër dhe tha:

— Kariçin-te ig kirdi, konull için-te oot kirdi!

— Përsëri s'të mora vesh, — tha Murat Shtaga.

— Them që në shpatull më hyri sëmundja, në zemër më hyri zjarri! — tha plaku Mere.

Njerëzit heshtnin. Plaku Mere foli përsëri:

— Kokrrat e tespiheve gjithnjë rrinë bashkë, se i mban peri, — dhe i vari tespihet në gishtin e madh.

— Gjysh i madh, — u ngrit e tha stërnipi i dhjetë, Veseli, — në perin e vjetëruar tespihet mezi rrinë bashkë, mezi mbahen.

Plakut Mere i shkau përsëri setra nga krahët. U ngrit stërnipi i dytë dhe ia vuri në supe.

Plaku Mere zuri me gisht një kokërr tespihe dhe e ndau nga të tjerat. Vështroi mbi dollapin e melhemrave dhe diçka kërkoi me sy. Stërnipi i tretë u ngrit, mori mbi dollap gërshërën dhe ia dha. Plaku Mere futi gishtin e madh në dorezë të gërshërës, pastaj futi dhe dy të tjerët dhe preu fillin e tespiheve. Kokrrën që mbante në gisht e mori dhe e hodhi në truall. Dhe pas kësaj i ndali sytë te stërnipi i dhjetë, Veseli. Të nëntë stërnipërit e kuptuan: Veseli u nda nga ata.

Stërnipi i tretë, Baftjari, e vështroi Murat Shtagën dhe ia mbylli syrin. Plaku Mere e vuri re dhe hoqi nga filli i tespiheve edhe një kokërr. Kokrrën e hodhi në truall pas së parës: Iku dhe Baftjari. Baftjarin plaku Mere e kuptoi që mbante anën e Muratit, e kuptoi vetëm me një vështrim, me një shenjë syri.

Plaku që vuri xhezven në zjarr, e derdhi kafënë në dy filchanët. Filchanin e parë ia vuri përpara plakut Mere, të dytin Muratit.

Të tjerët kishin ulur kokat e shikonin postet.

Plaku Mere zgjati dorën dhe mori në vatër një thëngjill për të ndezur çibukun. Thëngjilli i shpëtoi dhe i ra në poste. U ngrit stërnipi i katërt, kapi thëngjillin dhe ia vuri në çibuk.

— Ne nuk mund të shkojmë me Tosun Baçin për hir të miqësisë suaj të vjetër, gjysh i madh! Tosun Baçi është tradhtar... — tha stërnipi i nëntë, Abazi.

Plaku Mere tërhoqi edhe një kokërr dhe e hodhi në truall pranë dy të parave. U nda edhe Abazi.

Plakut Mere përsëri i shkau setra. U ngrit stërnipi i pestë dhe ia vuri në supe.

— Po nuk luftuam për lirinë e vendit, ne do t'ia hamë kokën njëri-tjetrit, — tha Murat Shtaga. — Shtëpia juaj është e madhe dhe i shkon fjala në fshat. Po të hidheni ju me luftën, do të hidhet gjithë fshati. Tosun Baçi, ai mikun yt, gjysh i madh, është vrasës dhe kërkon të ndezë përsëri sherrin e hakmarrjeve të vjetra.

— Qepaze është, — ngrihet e thotë stërnipi i tetë, Rahmiu.

Plaku Mere u ngrit pa e pirë kafënë, e lidhi fillin e kokrrave që kishin mbetur, vuri duart mbi kandil me tespiket e varura në gishtin e madh e tha:

— Muhameti surullah! Na e nxirr shejtan shejtanllarin nga barku!

U ul. Kapi me duar kutinë e duhanit dhe u mundua ta hapte. U ngrit stërnipi i gjashtë dhe ia hapi. E mbushi çibukun dhe hapi gojën sikur t'i flihej. Psherëtiu me gojë të hapur:

— Hak i madh! Ç'sahat e ç'dekika po sjell! Kurdisë, o hak i madh sahatin, kurdisë! Ti e kurdis, po as vetë s'e di se ç'dekika e ç'vaki sjell. Hak! — dhe zgjati dorën në qafë për të marrë peshqirin, po nuk e kishte.

Stërnipi i shtatë u ngrit dhe ia dha peshqirin.

Plaku Mere fshiu buzët dhe mustaqet e bardha.
Iu drejtua Muratit:

— Ti, i biri i Zenunit dhe nipi i Zija Haxhibektashit, dëgjo këtu, dëgjo këtu dhe vër gishtin në kokë: Shejtan Mulahim Shimbër Jeziti ka hyrë në barkun dhe në kokën e insanit dhe e ka trazuar vuxhutin e insanit me baltën e me llucën e me rërën e me bykun e me plehun dhe ka prishur birinçhinë e insanit...

Pastaj iu kthye stërnipit të dhjetë dhe i tha:

— O Vesel, nipi i Selmanit. Unë Selmanit ia kam mbyllur plagën me melhemin që kam bërë me dhjain e rosës e me fletën e luleshtrydhes e me mjaltin e bletës e me çallmën e lulëkuqes e me lëngun e zi të kafesë... Dhe Selmanin e vrau Ziguri, i kunati i babait të Muratit. Dhe ti, Vesel, nipi i Selmanit dhe i biri i Bakirit, dije, babanë tënd e vrau vetë babai i Muratit. Dhe ti, Vesel, nipi i Selmanit, që shkon me Muratin, je një mizë kali në konakun tonë. Dhe shko ti me Muratin!

Plaku Mere thithi çibukun dhe iu drodh dora. Mandej u ngrit më këmbë. Shkoi në dollapin e melhemrave, e hapi dhe nxori një shkop të mbushur me vija të holla të bëra me thikë. E mbylli dollapin dhe u ul përsëri. E tundi shkopin dhe iu drejtua stërnipit të nëntë:

— O Abaz, nipi i Durgutit dhe i biri i Zyrapit. Në këtë shkop është kjo vijë e vogël dhe kjo vijë tjetër e vogël, — dhe vuri thoin në vijat e bëra me thikë. — Vijën e parë e kam bërë kur u vra Durguti; vijën e dytë, kur u vra Zyrapit. Durgutin e vrau Hyseni, i ati i Zigurit; Ziguri ishte i kunati i Zenunit, babait të Muratit. Zyrapin e vrau probatini i Zenunit. Në këtë shkop kam bërë tridhjetë vija, që janë tridhjetë varre. Dhe nuk dua të bëj edhe vija të tjera. Po shkopi më thotë se do të bëhen edhe katër vija të tjera, që do jenë katër varre. Ju të katër: ti, Vesel, ti, Abaz, ti, Rahmit, ti, Bahtjar, doni të shkoni me

Muratin? Murati ju ndau si katër qengja nga kopeja dhe po ju shpie në mal që t'ju hajë ujku. Me dorën e tij ai s'ju vret dot, po ju vret me dorën e jezitëve të tjerë. Ju vret dhe unë bëj në shkop katër vija. Bëhen në shkop tridhjetë e katër vija...

Stërnipi i dhjetë, Veseli, ngriti kokën dhe vështroi të nëntë stërnipërit e tjerë dhe ndali sytë te plaku Mere:

— Ne do të ikim me Muratin që ti të mos shkruash vija të tjera në atë shkop, do të ikim me Muratin që të mos hapen gropa në varreza. Edhe në u hapshin, ato nuk do të jenë si tridhjetë gropa që ke shënuar në shkop, o gjysh i madh! Edhe në u hapshin, në to do të prehen katër therorë për liri...

Në odë dëgjohej vetëm fryma e njerëzve, se u bë një heshtje e madhe. Në mes të kësaj qetësie u ngrit stërnipi i parë, Fahremudinaliu, e tha:

— Ti, Vesel, biri i Bakirit dhe nipi i Selmanit, je më i vogli i konakut. Gjyshi i madh nuk ta tha, po unë po ta them. Dy herë fole përpara të mëdhenjve të oxhakut. Flasin më parë këta katër pleq, flas pastaj unë. Ti flet i pesëmbëdhjeti. E përpara këtyre katër pleqve dhe meje flet gjyshi i madh! Dhe ti je mizë kali. — Fahremudinaliu heshti. Plaku Mere ngriti dorën dhe kroi vetullat e bardha si kërpudha dhe hapi gojën si për gjumë.

— O hak i madh, s'dimë pse u katandis kësh-tu oxhaku ynë! S'dimë pse na humbi sajdia dhe itibari! O hak i madh, bëje tërbije shejtan Mula-him Shimbër Jezitin dhe nxirre nga oxhaku ynë, që i vogli të ketë sajdi e itibar për të madhin dhe lëre të madhin ta bëjë terbije të voglin... O hak i madh!

Këtu u ngrit Murati e tha:

— Sajdi e itibar për të mëdhenjtë ne kemi, o plaku Mere. Po nuk kemi sajdi e itibar për ata të mëdhenj që na thonë të shkojmë të mbytemi në

lumë. Ne kemi sajdi e itibar për ata të mëdhenj që na thonë: Shkoni, djem e luftoni për vendin.

Fjalën ia preu Fahremudinaliu:

— Ti na thua që të kemi sajdi e itibar vetëm për ty?

Murati ia preu:

— Pse çuditësh, o Fahremudinali? Për mua dhe për ata që luftojnë.

Të katër stërnipërit tundën kryet:

— Mirë e ka Murati!

Katër pleqtë e tjerë nuk flitnin. Ata duke-shin sikur flinin, duke ndenjtur në postet e mëdha. Stërnipërit e plakut Mere ishin në lëvizje. Ata zhurmonin ngadalë në mes tyre. Shtëpia e madhe e fisit të Fizëve po tronditej nga brenda. Me dhjetëra vjet, a ndoshta me qindra, ajo ecte sipas rregullit stërgjyshor, tani çdo gjë po shturej. Murat Shtaga vuri në buzë filxhanin me kafe tanimë të ftohur.

— O hak i madh! — tha plaku Mere. — Të vjen një njeri në shtëpi dhe të shtur... Tri herë ke ardhur, Murat Shtaga, biri i Zenunit dhe nipi i Zija Haxhibektashit! Ti fillove t'ua prishësh mendjen stërnipërvet të mi që me ardhjen e parë. Ti i ndoqe ata arë më arë e ledh më ledh dhe derdhe tek ata shafra në tënde. Shafraja i zuri stërnipërit e mi. Të katërtën herë, sonte, shafraja jote bëri të sajën. Shafraja jote e drodhi shtëpinë time. I drodhi trarët, e drodhi dyshemenë, i drodhi trupat e njerëzve. Të gjitha u drodhën. Po shafraja jote mua nuk më dredh... Dëgjon, apo jo, o i biri i Zenunit dhe i nipi i Zija Haxhibektashit?

Murat Shtaga rrinte në vatër i ngrysur. Ai ngriti kokën e rëndë dhe vështroi nga djemtë:

— Nuk është shafraja ime. Është era e lirisë që na dehu të gjithë dhe dehu edhe këta djem. Ajo nuk do të lërë njeri të ndershëm pa dehur. Ajo do të dehë ndoshta edhe këta katër pleq, që

janë nipërit e tu. — Murat Shtaga vështroi të katër pleqtë e heshtur.

Në fytyrat e nëntë stërnipërve rrodhi një buzëgëshje e paparë gjer atëherë. Vetëm stërnipi i parë, Fahremudinaliu, rrinte i vrenjtur, i zhytur në mendimet e veta. Siç dukej ai përgatitej të zinte vendin e plakut Mere në atë shtëpi, përgatitej të merrte në duar fuqinë. Por pushteti i tij i ardhshëm po vinte në një kohë të vështirë, në një kohë kur gjithë pushtetet e vjetra po shkallmoheshin...

Murat Shtaga u ngrit. Të gjithë lëvizën nga vendi, përveç plakut Mere. Ai ua dha dorën me radhë dhe doli i lodhur, por me një gëzim të patreguar në shpirt.

Ndërkohë ai ndjeu zërin e plakut Mere dhe u kthye përsëri në odë. Fytyra e tij u ndrit nga një rreze shprese. Ndoshta plaku Mere kishte ndërruar mendimin e tij të vjetër!

— Dëgjo, o i biri i Zenunit dhe i nipi i Zija Haxhibektashit. Dëgjo, se dua të të sjell në hatërca gjëra të zëmanit që ti i ke harruar. Atë vit që vdiqa unë dhe që më shpunë në varreza me tabut, yt atë, Zenuni, i biri i Zija Haxhibektashit, nuk erdhi të ngushëllonte shtëpinë. Unë u ngjalla përsëri dhe më shpuri në shtëpi xherah Xheladin Durballia, rahmet pastë! Yt atë nuk erdhi në varrimin tim, se nuk më donte. Dhe unë nuk ju dua. Yt atë ngriti edhe një këngë, kur u ngjalla. Kënga më shante edhe mua, edhe xherah Xheladin Durballinë. Kënga thotë:

Xheladin xherahu,
më t'u thaftë dora,
s'e le plakun Mere
ta hante dëbora!

Murat Shtaga mezi e solli në mend ngjarjen e atij dimri. Por ai e kuptoi që plaku Mere mban-te një inat të vjetër për të atin e për shtëpinë e tij.

— Bëj si të duash, o gjysh i madh! Por ti do të mbetesh vetëm, — tha ai dhe doli.

Stërnipërit e përcollën gjer te porta dhe ai mori tatëpjetë kodrën. Te lisi i madh, gjysmë i djegur nga rrufeja, atij i doli përpara Shega me dy stomna me ujë. Ajo u skuq. Murat Shtaga e zuri për dore.

— Më tha nëna që e kishe lajmëruar. Falemnderit, Shegë! — tha Murat Shtaga.

— Sa frikë pata për ty! — tha ajo.

— Kohëra të vështira, — tha Murati.

— Unë doja të hyja në odë, kur flisje ti, po kisha frikë nga gjyshi i madh dhe Fahremudinaliu, — tha Shega.

— S'ka gjë, Shegë, do të na dalë frika! — tha ai.

— Ti, Murat, duket se mua nuk më përfill, — tha ajo dhe u skuq më tepër.

Për Murat Shtagën këto fjalë ishin të papritura. Ç'thoshte Shega? Si fliste ajo me këtë gjuhë me një burrë të martuar?

— Si s'të përfill? — pyeti ai.

— S'më përfill! — tha ajo dhe u mat të ikte, duke shtrënguar stomnat.

— Unë për të gjithë kam respekt, — tha Murat Shtaga i menduar.

— Mirë, mirë! — tha Shega ngadalë duke u larguar.

Murat Shtaga i hodhi një vështrim të shkurtër, i ra një guri me këmbë dhe filloi të ecte në shtegun me driza.

Atij i hahej bukë. Kafaja që piu te Fizët sikur ia prishi më tepër stomakun. Zorrët i kërcitnin. Por ai duhej të vente edhe në shtëpinë e Pinxhove. Nuk mund të lejonte Murat Shtaga që gjithë Pinxhot të shkonin me Tosun Baçin. Atëherë do të ishte humbje për fshatin dhe për atë vetë. Por puna me Pinxhot tani ishte vështirësuar më shumë se me Fizët. Abdurahim Pinxhoja ia kishte

dhënë fjalën Tosun Baçit, kurse plaku Mere ende ia kishte lënë përgjysmë. Pastaj, vërtet Pinxhot kishin në fshat influencë më të paktë se Fizët, por ata kishin vënë pasuri më të madhe, kishin blerë ara e mulli dhe po bëheshin të fuqishëm. Ata po krijonin një bazë të mirë ekonomike, gjë që vetvetiu sillte pavarësinë e tyre në fshat dhe rriste influencën te njerëzit e lëkundur. Doemos, prirja e tyre do të ishte drejt Tosun Baçit. Megjithatë Murat Shtaga nuk i humbiste shpresat. Ai shkante drejt tyre me forcën e logjikës dhe të bindjes politike, duke mbajtur në brez një revolver të vogël.

Murat Shtaga zbriste tatëpjetë kodrës, duke shkarë nëpër baltën e shtegut, gërmuar nga këmbët e mushkave dhe të njerëzve. Frynte një erë e lagët dhe e ftohtë.

Të gjitha këto peripeci të Murat Shtagës nuk i dinte Mato Gruda. Me mendimin e tij të marrë, ai nuk e dinte që prishte natën atë që ndërtonte ditën Murat Shtaga. Dhe me këtë pritëshin turbullira të tjera në fshatin Arun. Topi heshtte në plevicë...

Tek mendonte këto ngjarje, të ngarkuara me hallet dhe trazirat e fshatit dhe të Murat Shtagës, Mato Gruda kishte harruar për punët e shtëpisë së vet, për dimrin që po vinte e për lopën barrsë në qilar. Medoemos duhej bërë diçka për Larën. Ajo së shpejti do t'i pillte një viç të bukur. Po të dilte mashkull, aq më mirë, se do ta rriste e do ta bënte një ka të madh si Kazilin. Dhe kështu, Mato Gruda e ndau lopën nga ahuri i qeve dhe e shpuri në një plevicë në një qoshe larg topit. Tanimë nuk mund ta linte në ahur, pasi Lara ishte në muajin e fundit të barrës dhe pritej nga dita në ditë të pillte. Në atë qoshe ia zuri gjithë vrimat gardhit të plevicës që të mos i frynte erë dhe të mos i vinte lagështira nga jashtë. Lopa, që ishte mësuar të jetonte bashkë me kaun dhe mushkën, e ndiente veten të vetmuar dhe herë pas here pëlliste me një zë të trashë e të zgjatur. I zoti e dëgjonte

dhe i vinte keq. Por e ngushëllonte, duke i thënë se nuk do të rrinte edhe shumë e vetmuar. Së shpejti do të bëhej vetë e dytë.

Kur Mato Gruda zbulonte grykën e topit, Lara shikonte dhe tundte brirët e gjatë. Bile tërhiqte litarin dhe i binte me këmbë truallit. Atëherë Mato Gruda kishte frikë se mos Lara trembej nga topi dhe dështonte. Kjo do të ishte një gjëmë e madhe për shtëpinë, se do të thaheshin lugët për një pikë qumësht. Prandaj ai donte që Lara të mësohej sa më shpejt me topin dhe t'i dukej si një gjë e zakonshme, si kau dhe si mushka. «Çudi, — thoshte ai — kau nuk u tremb aspak nga topi. Kjo Lara është shumë delikate, si të ishte ndonjë bijë pasaniku!»

Që t'ia hiqte frikën, e merrte për kapistalli dhe e shpinte pranë topit. Ajo prapëj me mundim dhe Mato Grudës gati sa nuk i futej litari në mishrat e dorës.

— Budallaqe! Ai nuk të ha, se nuk është ndonjë gjë e gjallë. Ti duhet të jesh trime dhe të mos e kesh zemrën sa të pulës. Ja, këndesi, që është sa një plesht, hipën në majë të tytës dhe as tër nuk i bën veshi! — i thoshte Mato Gruda dhe ia lëmonte kurrizin me pëllëmbë.

Lopa e shikonte Mato Grudën kur e mbulonte tytën e topit me kashtë dhe qetësohej. Ndoshta i dukej sikur i zoti i jepte të hante kashtë edhe asaj qenieje të çuditshme, siç i jepte jonxhë edhe Larës. Duke ndjekur ditë për ditë punën e të zotit me topin, ajo u mësua dhe i doli frika. Pastaj ajo tytë e murme, që dilte herë pas here nga kashta, asaj iu bë e zakonshme si kau e si mushka. Erdhi një ditë që, kur Mato Gruda i hidhte asaj jonxhë dhe nuk e zbulonte tytën e topit, Lara sikur zemërohej dhe pëlliste ngadalë me zë të ulët. I zoti e kuptonte dhe nënqeshte, se i vinte mirë që lopa ishte pajtuar me rivalin e saj.

— Ke për ta parë, ti, Larë, se ç'do të punojë ky babaxhan! — i tha një ditë Larës Mato Gruda, duke zbuluar tytën e murme.

Por ai nuk e kishte vënë re Auguston që kishte hyrë në plevicë.

— Mato, llafos lopa? — tha Augustoja.
— Atë e di unë! — tha Mato Gruda.
— Viç mirë bën Lara, — tha italiani, duke iu afruar
lopës me një buzëqeshje fëmijnore në fytyrë.

Ai pastaj i ra ngadalë me dorë në kurriz, e kapi për
briri, për hunde, për lafshe...

— Keni lopë si këto në Itali? — tha Mato Gruda.

— Ka kuqe, zeza, lara, — tha italiani.

— Japin shumë qumësht? — pyeti Mato Gruda.

— Shumë, pak, mesme, — tha italiani.

— I mbani në plevicë bashkë me topin? — tha Mato
Gruda.

Italiani e vështroi në fillim me habi; pastaj u men-
dua, sikur të ishte para një provimi të vështirë.

— Mato njeri madh! — tha italiani me seriozitet.

— Atë e di unë! — tha Mato Gruda dhe filloi ta mbu-
lonte përsëri tytën e topit.

Ata u ulën në kashtë pranë topit. Në heshtje dë-
gjonin Larën që përtypte jonxhë të thatë. Era e jonxhës
përhapej në plevicë dhe të sillte në mend livadhet e ko-
situra në verë.

— Di ndonjë këngë ti, Agush? — pyeti Mato Gruda,
duke thyer heshtjen.

— Di këngë populli, — tha Augustoja. — Di, Mato?

— Di! — u përgjigj Mato Gruda.

Italiani mori lehtë-lehtë një këngë në gjuhën e tij.
Mato Gruda dëgjonte, duke mbajtur në buzë një fije
kashte. Lara pushoi së përtypuri jonxhë dhe ngriti ve-
shët. Kur mbaroi kënga, Mato Gruda mbështeti faqen
në pëllëmbë dhe murmuriti:

— Mirë kënduake. Si janë këto të shkreta këngë!
Edhe gjuhë mos dish, i merr vesh. Ja, ti këndove për një
vajzë e për një lumë e për një lopë që pi ujë...

Augustoja u hodh përpjetë, sikur të kishte luajtur
mendsh. Pastaj filloi të kërcente dhe të përplaste shu-
plakat si fëmijë.

— Mato njeri shumë madh! Mato kolos! Gjeti Mato fjalë kënge. Mama mia! Kolos!

Mato Gruda e shikonte dhe habitej se ç'kishte ndonjë gjë për të bërë gjithë këtë bujë. Këta italianët janë si të lajthitur!

— Mato kolos! — përsëriti italiani, i skuqur në fytyrë.

— E, more, me gjithë këtë kolos! — bëri me dorë Mato Gruda dhe Augustoja e kuptoi se nuk duhej folur më shumë.

KAPITULLI I KATËRMBËDHJETË

Mato Gruda me kandil të shuar në dorë qëndroi para derës së plevicës. Hëna rrinte në majë të Kokallës dhe gjithë rrëza e malit ndriste me një dritë të zbetë. Kjo dritë e zbetë binte edhe në muret e bardha të shtëpisë së Fizëve në këmbë të Kokallës. «Fizët flenë» — mendoi Mato Gruda duke hedhur vështrimin e tij nga gryka e përroit. Mezi dallohej drita e venitur e dritares së tyre të vogël. «Nuk e shuan kandilin plaku Mere» — mendoi Mato Gruda.

Ai hyri në plevicë. Topin e kishte lënë zbuluar. Edhe tyta kishte mbetur e ngritur, siç e kishte harruar italiani. E ndezi kandilin dhe e vuri në rrotën e topit. Pastaj, si gjithnjë, u ul në trungun e thatë dhe drodhi një cigare. Nëpër derën e hapur të plevicës dukeshin këmbët e Kokallës dhe dritarja e Fizëve.

— *Haufman, — i tha topit Mato Gruda, — e shikon atë dritë të vogël? Plaku Mere dergjet, po s'jep shpirt... Ka kohë që nuk ka dalë nga shtëpia. Thonë se do të vdesë... Plaku Mere! — pshe-rëtiu Mato Gruda. — Atëherë, pas vrasjes së Sulës, vëllait të babait, fisi ynë vrau një nga Fizët dhe sherri u mbyll. Përveç Sulës, babai kish edhe katër vëllezër: Sadikun, Xhemalin, Servetin dhe Jusufin. Kish edhe dy motra, Esmanë, që jeton, dhe tjetrën që ka vdekur. Babai im ishte më i madhi.*

Hakmarrja vërtet ishte mbyllur, por përsëri të dy shtëpitë zienin përbrenda dhe pritnin rastin për ta ndezur sherrin. Në fillim shërri u ndez për punë të një are. Babai i gjeti në grurë qetë e Selmanit, stërnipit të plakut Mere. E zuri loparin, një djalë të Fizëve, e rrahu dhe i përzuri qetë tutje nga korija. Selmani me nja tri-katër veta erdhi të lëronte. Kur pyeti se ku ishin qetë, djali i tha që i kishte përzënë Ziguri. Atëherë Selmani shkoi në korije, mori vetëm njërin nga qetë dhe bashkë me Fizët e tjerë iu lëshuan babait:

— Tët vëlla ta kopanisa, por ty do të të mbrej në zgjedhë në vend të kaut që ma përzure.

Selmani dhe Fizët e tjerë e kapën babanë, e shpunë te zgjedha dhe e mbënë tok me kaun. Këtë e bënë për ta turpëruar babanë, rahmet pastë.

Babai nga turpi nuk dilte dot në fshat. Njerëzit thoshin se Ziguri lëroi bashkë me kaun e plakut Mere një dynym arë; ca thoshin një hektar...

Im atë ishte shumë i ri dhe vëllezërit e tjerë i kishte të vegjël, prandaj nuk e ndezi sherrin me Fizët. Përbrenda ama bluante.

Pak kohë më vonë kësaj ngjarjeje, Fizët donin të ndërtonin një shtëpi tjetër, se ishin shtuar shumë. Shtëpinë donin ta ngrinin në kufi me trojet tona, se atje ishte një vend i mirë dhe kishte pranë ujë të pijshëm. Po, për ta ndërtuar, duhej të merrnin lejë nga babai. Babai nuk donte t'i kishte fqinjë, se i kujtohej i vëllai që ia kishin vrarë dhe turpi i zgjedhës në arë. Fizët nga ana e tyre luteshin dhe ngulnin këmbë. Atëherë babai i hipi mushkës dhe shkoi në Krajë për të takuar dervishin e për ta pyetur se si të bënte.

Dervishi i nxori kafe, e pyeti për punë të shtëpisë, kujtoi Sulën, që e donte shumë...

— Allah belaversën! — tha dervishi. — Sula ka qenë burrë i mirë. E vranë me të pabesë!

Dervishi përmbysi filchanin e kafesë, e la pak të përmbysur, e mori dhe e afroi pranë syve:

— E sheh këtë? — dhe tregoi me gisht në filxhan. — Shoh një shtëpi. Dale, dale? E sheh? Shoh edhe një xhenaze...

— E kujt është xhenazja? — pyeti babai.

— Dale, dale? Ja, kjo vija këtu thotë se xhenazja është e Fizëve. E sheh këtë? Plaku Mere heq tespiket. Ja, kjo e gjata këtu thotë për tespiket... — tha dervishi dhe e la filxhanin.

— Si të bëj, hejvallah, t'i lë të ndërtojnë shtëpi në kufi me trojet e mia? — pyeti babai.

Dervishi vuri gishtin në tëmth dhe e vërtiti si turjelë:

— Lëri t'i ndërtojnë shtëpitë. Muajin që të hyjnë brenda, shko me vëllezërit e rritur dhe vriti. Në gjyryllidi e sipër do të jenë, se hyjnë në shtëpi të reja. Vriti në gjyryllidi, — tha dervishi. — Këtë ta them, se plaku Mere futi stërnipërit të vrasin Sulën, mikun tim.

Babai, sa u kthye nga dervishi i Krajkës, u dërgoi haber Fizëve se kishte rënë në ujdi, për punë të shtëpisë.

Fizët pas ndonjë muaji mblodhën qereste dhe filluan t'i ngrinin shtëpitë. Tek vazhdonin punën ustallarët, Selmani u fejua me një vajzë të re nga fshati, me të motrën e Selvisë, gruas së Muke Marukës. Ai ishte gjashtëdhjetë e ca vjeç burrë dhe kishte qenë martuar tri herë. Të tria gratë i patën vdekur. Këtë radhë priste të martohej në shtëpitë e reja. Në fshat ishin hapur llafe se grave të tij u kishte bërë magji plaku Mere, prandaj vdisnin. Magjinë ua kishte bërë me tespiket, me flakën e kandilit dhe me melhemin që kishte në dollap dhe me një qime që kishte shkukur nën sqetullën e majtë. Kështu tregon hallë Esmaja. Po gjyshja tregonte se magjinë nuk ua kishte bërë plaku Mere, po dervishi i Krajkës, se nuk e donte.

Fizët kishin shumë ustallarë dhe i ngritën shpejt shtëpitë.

Me të hyrë në konakët e rinj, Selmani u mar-

tua. Plaku Mere me nipërit dhe stërnipërit e tjerë mbetën në shtëpitë e vjetra atje pranë.

Një ditë, pa u mbushur muaji, që kur Selmani kishte ndezur zjarr në shtëpitë e reja, futet brenda babai im, Ziguri, me Sadikun e me Xhemalin. E gjejnë Selmanin në odë duke grirë duhan me havan. Selmani e ndjeu se ardhja e tyre nuk ishte për të mirë, por nuk arriti të fuste dorën në brez e të nxirrte koburen. Babai, rahmet pastë, heq dhjetëshen e Sulos dhe ia numëron të dhjeta.

— E njeh ti, pis, këtë kobure? E Sulos është!
— tha babai.

Në këtë kohë gruaja e Selmanit lante këmishë në çeshtë. Kur dëgjoi krismat, i la këmishët dhe hyri e lebetitur brenda. Selmani ngriti kokën dhe, siç ishte i plagosur për vdekje, qëlloi me kobure. Atëherë babai shtiu edhe një herë, po gruaja hyri në mes të zjarrit dhe mori një plumb në gjoks. Ajo ra në dysHEME e gjakosur.

Që nga frëngjia e shtëpisë së vjetër, pas pak nxori kokën plaku Mere dhe, kur e pa Zigurin në oborr, thirri:

— O Zigur Gruda! Ç'janë ato pushkë?

— Kemi martuar Selmanin, o Mere Fizja! —
u përgjigj babai.

Plaku Mere e pa se nuk mund të dilte dot nga shtëpia dhe u fsheh prapa frëngjive. Nipërit e tjerë i kishte në arë dhe me bagëti.

Ziguri me të vëllezërit e zhveshën trupin e Selmanit dhe e nxorën lakuriq në oborr që të shihte plaku Mere e të dilte nga shtëpia e vjetër.

Babai e zhaxhallarët u fshehën pas avllive dhe pritnin. Në këtë çast që nga shtëpia e saj vrapoi Selvia, e motra e gruas së Selmanit. Në oborr, kur pa kufomën lakuriqe, thirri me të madhe dhe mbuloi sytë me duar.

Akoma më e llahtarshme ishte thirrja e saj, kur hyri në odë dhe pa të motrën të shtrirë në

pellgun e gjakut. Ajo u hodh mbi të dhe e mori në gjoks:

— Mihanë, motër, kush të vrau? — thirri Selvia e lebetitur.

— Zigur Gruda! — tha ajo dhe pas këtyre fjalëve vdiq.

Kështu Ziguri, babai im, e mori hakun e të vëllait, por i mbeti peronë në zemër vrasja e Mihanës së shkretë. Gruaja e zezë nuk kishte faj. Ky ishte një turp i madh për shtëpinë tonë.

Kuvendi i pleqve donte ta përzinte nga fshati babanë, se kishte vrarë një grua. Nuk kishte bërë kurrë vaki as në fshatin tonë, as ç'rrjedh ujët që nga rreza e Kokallës e gjer ku derdhet lumi Krak.

U bë mukajet dervishi i Krajkës, iu lut kuvendit të pleqve dhe mbetën në fshat edhe babai, edhe vëllezërit e tij. Sherri ama vazhdonte. Fizët vranë Xhemalin dhe do të vritnin edhe të tjerë, sikur të mos bëhej përsëri mukajet dervish Shemshedini i Krajkës, rahmet pastë, nazari. Dervishi shkoi te Fizët dhe u tha:

— Efendëm plaku Mere, turpi u bë, turpi të lahet! Zigur Gruda të paguajë për gruan dy herë më shumë sesa është blerë. Merhum Selmani e pati blerë shtatëdhjetë e tri napolona e gjysmë, Ziguri të paguajë një qind e dyzet e shtatë napolona...

— Ashtu qoftë, — tha plaka Mere. — Po që të lahet turpi e të mbyllet sherri, unë me nipërit e stërnipërit e mi duhet të shkojmë në shtëpinë e Zigurit e ta shkelim me këmbë truallin e t'i për-pjekim këmbët. Bashkë me ne duhet të vish edhe ti, dervish, ejvallah!...

— Vemë dhe e shkelim shejtanin që mos ketë më sherre, allah belaversën! — tha dervish Shemshedini i Krajkës.

Fizët me dervishin përpara erdhën dhe i shkelën të katër qoshet e truallit. Ata përpoqën këm-

bët në oda, sipas zakonit, dhe plaku Mere ngriti
tespihet lart e tha:

— I shkelur goftë shejtan Mulahimi dhe tur-
pi. Allah, allah, Muhameti surullah! Kabullosun!

I përpoqën edhe një herë këmbët dhe ikën.
Dervishi mbeti pas dhe i tha babait tim, Zigurit,
i ndristë shpirti:

— Truallin Fizët e shkelën. U shkelën të li-
gat që bëri shejtan Mulahimi po ti ki mendjen, se
plaku Mere nuk harron kollaj...

Kaloi një kohë dhe në fshat ngritën një kën-
gë. Gjyshja, rahmet pastë, thoshte se ajo nuk
ishte këngë, po duva e plakut Mere. Ajo, i ndristë
shpirti atje ku ka rënë, e këndonte kështu:

*Plaku Mere erdhi me dervishin
edhe pas u vinin dyzet nipër.*

*Obobo, Zigurit do t'ia prishin
dyskemetë e odave të miqve.*

Plaku Mere bën magji e thotë:

— *Zigur Gruda, mbeç me gisht në gojë,*

në qymes as gjeli mos këndoftë.

në shallë parmënda mos lëroftë...

Ti më vrave nipin tim Selmanë

dhe në oborr e nxore lakuriq,

ti me plumb qëlllove mbi Mihanë

ditën që shtëpia priste miq!..

Mato Gruda kishte humbur në këtë rrëfim të llahtar-
shëm. Vetëm kur era e shoi kandilin dhe në plevicë u
bë errësirë, ai erdhi në vete. Papritur e pushtoi një mër-
zi e pakuptueshme. «Kujt i flas kështu? Topit i flas? Mos
lojta mendsh?» mendoi ai dhe u ngrit nga trangu i thatë.

Ndezi kandilin dhe e vari në gozhdë në mur të ple-
vicës. Pastaj u përkuul mbi tabelën e numurave të topit
që ia kishte shpjeguar italianin.

— *Vermaht. Haufman, domethënë!* — *tha ai*
me vete. — Kështu, Haufman! Ndrin kandili i pla-

kut Mere dhe nuk i mbaron kurrë vajguri. Ka shumë vajgur plaku Mere. Të gjithë njerëzit, të gjithë konakët me vajgur m'i dogji. Nuk e harroi plaku Mere as Selmanin, as Mihanën, që vrau babai. Dërgoi në Dibër të Madhe njerëz dhe u tha:

— Dua të më blini një kade me vajgur, një kade të madhe. Të vini të kërkonit sheh Islam Arabanë dhe ai do t'ju shpjerë te Kramer Çifuti, që e ka dyqanin në të dalë të Dibrës së Madhe. Kramer Çifuti do t'ju mbushë një kade me vajgur dhe ju do ta sillni këtu. Allah! — u tha stërnipërve e nipërve plaku Mere.

Ata u nisën në Dibrën e Madhe e bënë pesë ditë e pesë net udhë. E kërkuan sheh Islam Arabanë dhe sheh Islam Arabaja i shpuri te Kramer Çifuti. I thanë kështu e kështu dhe ai u dha një kade me vajgur.

Pas dhjetë ditëve e dhjetë netve erdhën në fshat. Plaku Mere e mori vajgurin dhe e hodhi në pesë shakuajt. Kur i mbushi shakuajt, lau sytë me vajgur dhe bëri duva:

— Të digjet! Gjaku i Selmanit dhe gjaku i Mihanës kërkon që shtëpia e Zigurit të bëhet shkumb. Bismilah! Shejtan shejtanllari u largoftë e plastë!... — tha plaku Mere dhe nga fytyra i kullonte vajguri i Kramer Çifutit.

Nipërit e stërnipërit i morën natën të pesë shakuajt, zbritën natën tatëpjetë nëpër korije dhe ndodhi ajo që ndodhi. Në shtëpinë tonë të gjithë flinin. Siç thashë, vetëm unë, gjyshja dhe hallë Esmaja nuk ishim. Atë natë në shtëpinë tonë ishte edhe dervishi i Krajkës, si mysafir. Edhe ai flinte në odën e mysafirëve.

Nipërit dhe stërnipërit e plakut Mere e hodhën vajgurin fshehurazi në bodrumët e shtëpisë sonë dhe i vunë pishën.

Flakë të atillë nuk ka parë kurrë as maja e Kokullës, as lumi Krak.

Të gjithë ç'qenë brenda u dogjën. U dogj edhe dervishi i Krajkës, rahmet pastë, nazari...

Për dervishin ngritën një këngë që e di hallë
Esmaja fill e për pe:

— Lanet paç, or Mere Fizi! —
thirri Shemshedin dervishi,
thirri Shemshedin i Krajkës,
kur u ngrit në mes të flakës.

— Lanet paç, or Mere Fizi!
Në xhehenem të vajttë shpirti,
dhjamin xhindet ta kullofshin,
në kazan të përvëlofshin! —
thirri Shemshedin dervishi,
kur i merrte flakë mishi,

— Lanet paç, or Mere plaku.
t'u shkretoftë krejt oxhaku! —
thirri Ziguri i gjorë
dhe rrëmbeu djalin në dorë,
dhe rrëmbeu djalin që digjej
porsi zog që përpëlitej...

Mato Gruda doli nga ana e shtratit të topit i djer-sirë nga kujtimet e hidhura. U përkul dhe e kapi me duart e tij të forta pjesën e fundit të shtratit, pjesën që e pati lidhur në kulaçin e zgjedhës atë natë kur e mori nga koriya. E ktheu në drejtim të derës së plevicës dhe e tërhoqi. Topi mezi lëvizi. E tërhoqi edhe një herë me tërë fuqinë e tij dhe rrotat filluan të lëviznin. Ai nuk do ta kishte luajtur dot nga vendi, sikur të mos vinte pak i pjerrët trualli i plevicës.

I bërë qull në djersë, e shpuri gjer te dera. Pastaj e ktheu shtratin dhe ia drejtoi tytën nga Kokalla. Mori dy kërcunj dhe i vuri prapa rrotave, se topi, kur të qëllonte, mund të kthehej prapsh.

Mato Gruda e vështroi edhe një herë shtëpinë e Fizëve dhe e tereziti tytën e topit. Këndin e gradimit e la aq sa ç'i kishte thënë italianin.

Vrapoi në vendin ku ishin arkat e gjyleve dhe mori që andej njëren prej tyre.

Kur u sigurua se e kishte drejtuar tytën në objektiv, futi gjylen...

Me dorë në mekanizmin e shkrepjes, tha me zë të lartë:

— Plaku Mere Haufmani do të ta shuajë kandilin me atë presionin e tij. Dëgjoni, o Fizë! Edhe një dekit dhe fluturoni në atë botë, se shumë të liga i keni sjellë kësaj shtëpie! Dëgjoni, o Fizë! Për Sulon, rahmet pastë; për babanë tim, Zigurin, rahmet pastë; për xhaxhanë tim, Sadikun, rahmet pastë; për xhaxhanë tjetër, Xhemalin, rahmet pastë; për xhaxhanë tjetër, Servetin, rahmet pastë; për xhaxhanë tjetër, Jusufin, rahmet pastë; për nënën time, Xhemilen, rahmet pastë; për vëllanë tim, Zenelin, rahmet pastë; për motrën time, Ganimetin, rahmet pastë; për dervish Shemshedinin e Krajkës, rahmet pastë nazari!...

Mato Gruda tërhoqi litarin e mekanizmit të shkrepjes dhe plevica u tund dhe veshët iu zunë nga gjëmimi. Kurrë ndonjëherë nuk kishte dëgjuar një gjë të tillë. Pa vënë re se ku ra predha, futi edhe një gjyle tjetër dhe përsëri tërhoqi litarin. Ky gjëzim atij iu duk akoma më i llahhtarshëm.

— Hi, more, hi u bënë! — thirri ai kur dëgjoi plasjen e predhës diku andej nga shtëpia e Fizëve. Dhe, kur pa flakën, qeshi me të madhe dhe tundi dorën për të treguar se andej po bëhej kërdia... Vërtet, në grykë të përoit u ngrit një flakë e madhe...

— Ike, o plaku Mere, ike! Ike me gjithë tespihe e me gjithë kandil! — tha ai dhe tundi krahun. Pastaj futi duart në arkë dhe mori edhe një gjyle tjetër.

Në këtë kohë në plevicë vrapuan Zara me flokë të lëshuar, italiani në brekë e në këmishë, hallë Esmaja në xhyben e natës, Ziguri i zhveshur. Sadiku i zhveshur...

— Mato. Mato! — thirri Zara. — Pushoje topin, Mato!

— Stop zjarri! Mato, stop! — thirri italiani dyllë i verdhë.

— Ua! Po digjen Fizët! He, hé, hé! — thirri hallë Esmaja, kur pa flakën në grykë të përroit.

Mato Gruda qëndronte me gjyle në dorë krejt i hutuar.

Të gjithë iu lëshuan topit. Hallë Esmaja për çudi të tyre tha:

— Le ta zbrazë edhe këtëzë që ka në dorë! Zbraze, pëllumbi i hallës, zbraze!

Zara kapuliti sytë:

— Hallë Esmaja!

Italiani iu lëshua hallës:

— Teatro nuk është topi, hala Esmaja! — dhe e kapi shtratin e topit për ta tërhequr.

Zara e fëmijët filluan ta shtynin duke u dredhur. E shtyu edhe Mato Gruda. Vetëm hallë Esmaja rrinte në prag të derës dhe shikonte flakën që dilte nga oborri i Fizëve.

Kur e shpunë në vend, të gjithë mbushën krahët me kashtë dhe e mbuluan. Hallë Esmaja që nga pragu i derës tha:

— Ku paska qenë fshehur gjithë kjo xhephanë, more Matua i hallës? Mato, evlat, nga na ardhi ky top? Mato evlat!...

— Predhat! — thirri italiani dhe vrapoi e mori arkën dhe dy gëzhojat e gjyleve të zbrazura. Edhe ato i futi në kashtë.

Mato Gruda erdhi në vete e tha:

— Topi është i nxehtë. Mos marrë zjarr kashta e të digjet plevica.

— S'ka rrezik! — tha italiani i qetë. Pastaj shkoi pranë Mato Grudës. — Tyta të rrijë jashtë. Fshi me leckë, Mato. Nuk fshi, ndryshket. Kur qëllon topi, fshi gryka!

— Lëreni, le të ndryshket, Lëreni, Mato! — thirri Zara, kur italianin zbuloi grykën e topit.

— Lëre, Augusto! — thirri prapë ajo dhe e kapi për dore italianin.

Augustoja shikoi Mato Grudën.

— Ik, moj! — shfryu ai.

— U përcëlluan Fizët! — thirri hallë Esmaja në prag të derës së plevicës.

Mato Gruda mori leckën e madhe dhe bashkë me italianin filluan të fshihnin grykën e topit. Zara e fëmijët shikonin. Ajo habitej se si italianit dhe Mato Grudës u zinin duart punë, pas gjithë kësaj hataje. Italiani, duke e fshirë, i thoshte Mato Grudës:

— Nuk duhet praktika. Zbulon topi. Marrin Maton e mua në burg. Vrasin. Manovra natën nuk bën... Teoria mësojmë, pastaj praktika.

— Ama llaf! — tha Mato Gruda.

— Sa e vure këndin e gradimit? — pyeti Augustoja.

— 30 gradë! — tha Mato Gruda.

Italianit i ra lecka nga dora:

— Dogji shtëpia gryka përroi. Vret fëmija! Kur bën manovra artileria, lajmëron banorët të iki. Manovra bën në territori pa banorë. Mato shumë keq! — tha italianit.

Mato Grudës i ishin zënë veshët nga gjëmimi dhe mezi dëgjonte.

Qentë e fshatit lehnin dhe dëgjoheshin diku larg të thirrurur e grave e të fëmijëve.

— Prishmë menç fshatin! — tha Zara duke u dredhur si purtekë.

Vetëm hallë Esmaja ndiente një gëzim të çuditshëm, por e fshihte. Ajo iu afrua Mato Grudës dhe i ra me dorën e ligur në sup:

— Hajde, të keqen halla, se u lodhe. Lëre ta fshijë Agushi. Shkojmë e flemë... Plaku Mere vajti në xhehenem...

Në këtë kohë në plevicë u ndje një rënkim i zgjatur. Mato Grudën ky rënkim e solli në vete. Ai i la njerëzit e shtëpisë dhe vrapoi në fund të plevicës i shqetësuar. Pas tij vrapuan edhe të tjerët.

— Sillni kandilin. — thirri Mato Gruda.

Zara mori kandilin dhe e ngriti lart. Nën dritën e zbehtë, të gjithë vunë re Larën që ishte strukur në qoshe të plevicës. Lara dridhej e tëra nga frika e gjëmimit të topit.

— Pu-pu! Do të dështojë, Mato! — thiri Zara.

— T'u thaftë gjuha, moj nuse! Ç'llafos ashtu! Nga

dy të zbrazura na dështuaka! Na, të plaçin! — tha hallë Esmaja.

Mato Gruda i urdhëroi gratë të pushonin dhe filloi ta lëmonte Larën në kurriz me dorë. Edhe Augustoja bëri si i zoti i shtëpisë, duke murmuritur:

— Lara, Lara, mos u tremb. Topi vogël. . .

— E ç'i vogël, more Agush! Ai i bëri hi Fizët! — tha hallë Esmaja.

— Pa na lër, moj hallë, me këtë të shkretë top! — tha Zara.

— Lara u mësua me topin. Lara e dinte që ai do të gjëmonte, — tha Mato Gruda. — Tani do të flemë. . .

Pas pak dolën të gjithë nga plevica, duke e mbyllur derën me kyç. Në grykë të përroit dilte flakë.

— E sheh, Mato? I dogje! — tha italiani me fytyrë nga flaka.

Mato Gruda me fëmijët u ngjitën në odë. Italiani shkoi në qoshen e tij, në të ndarën e hajatit.

Ranë të flinin, po gjumi nuk i zuri. Mato Gruda dëgjonte në veshë gjëmime. Italiani habitej me këmbënguljen e të zotit.

— Mato i madh! — thoshte ai, duke u vërtitur në dyshek.

KAPITULLI I PESËMBËDHJETË

Sa nisi të zbardhëllonte, Mato Gruda doli në dritare, i bindur se në vend të shtëpive të Fizëve, do të shikonte gërmadhat e mureve dhe tymin e zjarrit të shuar. Por nga dritarja nuk dukej asgjë, se gryka e përroit ishte e mbuluar me një mjegull të dendur. Ai, ende pa u veshur, u ul në minder dhe vuri bërrylat në prag të dritares me vështrim nga shtëpia e Fizëve, duke pritur të largohej mjegulla. Gruaja dhe fëmijët flinin, ai vështronte si ndonjë zbulues.

Askujt nuk mund t'i shkonte në mend që Mato Gruda të bëhej vrasës. Ai fliste me gjithë qeniet e gjalla: me qenin e me lopën, me kaun e me mushkën, me barin e me lisat. . . Ai nuk mund të therte dot një qengj, se i vinte keq. Kur mbante Ziguri ndonjë manar dhe kur vinte koha për ta therur, Mato Gruda vante shpirtërisht. Një javë të tërë e vështronte manarin, tundte kokën me keqardhje dhe fliste me të si me një njeri, duke filozofuar për jetën e për vdekjen me gjuhën e vet. «Ti jeton, o manar, dhe nuk e di se ai që të hedh bar dhe të jep kripë dhe të shpie për ujë është xhelati yt! Ç'është kjo jeta, more, ç'është!»

Ky njeri me një shpirt kaq të dhemshur tani rrinte në dritare dhe shikonte nëse në një shtëpi tjetër kishte hyrë vdekja. Vdekjen asaj shtëpie ia kishte dërguar vetë, duke e futur në një gjyle topi! Si ishte e mundur?

Dalngadalë mjegulla filloi të ngjitej majave dhe gry-

ka e përroit nisi të zbulohet. Mes mbeturinave të togjeve të mjegullës së mbetur, Mato Gruda vuri re se shtëpia e Fizëve ende zbardhte dhe oxhaku si gjithnjë nxirrte tym. Flaka që panë natën pas plasjeve të gjyleve, dilte nga mullari. Predhat kishin rënë mbi të dhe ai kishte marrë zjarr.

Në fillim ai pati një gëzim të çastit: Shtëpia jetonte dhe njerëzit nuk ishin lënduar! «Në drejt të vejë edhe kjo punë! Më mirë që nuk qëllova në shenjë. Njeriu i zi përpiqet, lëron arat, mbjell farën, ndërton shtëpinë, bën fëmijë dhe pastaj të del një i krisur me një gjyle dhe të bën hi! Njeriu atëherë mbetet i shtrirë përgjithmonë me majat e këmbëve përperjetë. Po sa kanë ecur ato këmbë! Ec andej e ec këtej; ngjitu në mal e zbrit në fushë; futu në dëborë e ngulu në baltë; ftohu në akull e ngrohu në vatër: lodhu në rrugë e çlodhu në jatak!... I shkreti njeri! E gjen të keqen nga shembëllimi i tij, nga njeriu. Pse, xhanëm, të jetë kështu? Të ishte ndryshe, fare ndryshe.»

Pastaj Mato Grudën e pushtoi përsëri dëshpërimi tek vështronte mullarin që tymonte. «Si nuk e qëllova të paktën me një gjyle! Për dy-tri metra gjë më shpëtuan Fizët! Edhe vdekja duhet, se pastron njerëzit nga shpirtrat e këqija. Ajo nuk i lë të shtohen shumë e të mbulojnë shpirtrat e mira. Xhanëm vdekja e shpëton njeriun nga ca gjëra...»

Mato Gruda shau me vete italianin që i dha numrin 30. «Të kishte dhënë edhe një gjysmë gradë! Gomar është, jo topçi! Ngaqë i gradonin kështu topat, prandaj greku i vuri përpara si lopët. Ata qërratej grekë dinë të qëllojnë në me top!» — tha Mato Gruda me vete.

Ai ndjeu se dikush e hapi ngadalë derën. Ktheu kokën dhe pa hallën.

— Mato evlat! — tha ajo. — Xhephania nuk e paska goditur plakun Mere, po paska goditur mullarin.

— Atë po shoh edhe unë, — tha Mato Gruda.

— Po si s'ia terezite tamam, të keqen halla? — tha ajo e dëshpëruar.

— S'e gradova mirë!

— S'ka gjë, të keqen halla. Mos u ligsho. Sonte natën ia terezitim mirë. Do të vij edhe unë të të ndihmoj via terezitësh, — tha halla dhe ia lëmoi flokët të nipit.

Zara u hodh nga dysheku. Nëpër gjumë i kishte dëgjuar fjalët e hallës.

— Hallë Esma! Ç'është kështu?? Edhe ti po luan meng? — tha ajo dhe ia nguli e habitur sytë.

Halla nuk foli. Në këtë kohë filloi të buçiste çatia e shtëpisë. Ia dha një shi i madh. Koha erdhi e u nxi si pus. Gjithçka gjëmonte.

Hallë Esmaja lëshoi papritur një rënkim. Pas këtij rënkimi e kapi për supi Mato Grudën, sikur të mbahej për të mos rënë.

— Hallë! — tha Mato Gruda i trembur.

Hallë Esmaja në këtë kohë kishte rënë nën pragun e dritares pranë dyshekut të Zarës e të fëmijëve.

Mato Gruda dhe Zara u hodhën drejt saj.

— Hallë!

Po hallës i kishte rënë të fikët.

Zara mori një leckë, e lagu dhe ja vuri në ballë.

— Hidhi ujë, — tha Mato Gruda.

Zara mbushi tasin me ujë dhe ia hodhi në fytyrë. Hallë Esmaja hapi sytë dhe diçka foli si nëpër ëndërr:

— Tym i zi! Tym, tym! Hé, he! Ja si hidhen nëpër tym... Plakut Mere iu frynë sytë dhe po i pëlcasin... E patë si iu frynë. Dëgjoni si bëjnë: Puf! Puf! — tha nëpër ëndërr hallë Esmaja.

Zara u bë dyllë e verdhë nga fjalët e llahtarshme të hallë Esmasë.

— E vura re unë që dje. Nuk ishte mirë, — tha Zara ngadalë.

Ata e vunë hallë Esmanë në dyshek. Ajo tani filloi të vinte në vete.

— Ç'ke, hallë Esma? — tha Mato Gruda te koka e saj.

— Mato evlat, s'jam mirë. Ku di unë se si jam kështu! — tha ajo ngadalë.

Ajo pastaj u çua, iu afrua dritares, ngriti me m duarë të gishtërinjve perden dhe vuri ballin në xham. Jashtë oshë-tinte shiu nën qiellin e errësuar. Oborri e kopshti ishin mbuluar me ujë e baltë të verdhë. Halla psherëtiu:

— Pika, pika, ku do të futem!

Mato Gruda dhe Zara prenë frymën. Ziguri shikonte me indiferentizëm.

— Ç'thua, hallë? — tha Zara.

— Pika, ku do të futem, — përsëriti ajo.

— Ti je brenda në odë, — tha Mato Gruda.

— Jam brenda në odë, po varrin e kam jashtë. Do vdes, Mato, — tha halla.

Kjo fjalë u përhap në të katër qoshet e odës si diçka e kobshme dhe pastaj ra erë vdekje.

Mato Gruda uli kokën me vështrim nga postiqja pa lëvizur. Pastaj hapi derën dhe doli. Mendoi të shkonte të kërkonte ndonjë ilaç.

Te pusi gjeti italianin duke fërshëlyer melodinë e një kënge. Sa e pa Mato Grudën, thirri i gëzuar:

— Mato, shtëpia shpëtoi! Predha godit mullari. Manovra nuk bëri dëme mëdha! Një mullari bëri dëm...

Mato Gruda i hodhi një vështrim të zymtë, por nuk i foli. «Ku e ka mendjen ky karafil e ku e kam unë!» — tha ai me vete. Pastaj filloi të ecte nëpër oborr, si për t'i hapur punë vetes. Qëndroi në mes të oborrit dhe ktheu kokën nga avllia. Afër pjesës së murit që ishte rrëzuar, fëmijët kishin mbledhur një tog me gurë. Mato Gruda disa herë ishte matur ta ndreqte atë pjesë të rrëzuar, por e kishte lënë pas dore. Shirat e shpeshta po e rrëzonin gati gjysmën e murit. I zoti i shtëpisë vetëm tani u kujtua se ç'mund të bënin shirat.

— Agush! — thirri ai.

— Mato! — u përgjigj Augustoja.

— Mirë do të bësh, sikur ta ndreqësh! Gurët i ke këtu. Bëj ca baltë dhe filloja.

— Bukur, Mato, bukur. Bëj unë, — tha italianin me peshqir në qafë.

Për Mato Grudën të shtënat pa dobi të natës që kaloi ishin një humbje e madhe. Ato të shtëna pa bereqet Mato Grudën e çarmatosën plotësisht dhe e fundosën në një dëshpërim të rëndë. Në fillim ai këtë dëshpërim nuk e ndjeu, se qenia e tij ishte ende e mpirë nga narkoza e hakmarrjes. Njeriu, kur është i pirë, është grotesk e bujë-

madh, zhurmon dhe u lë udhën shumë pasioneve të shfrenuara. Por, kur i del pija në mëngjes, bie në një dëshpërim të thellë, se kujton natën e kaluar. Jo vetëm kaq. Në mëngjes e ndien veten pa asnjë energji, pa asnjë mendim, pa asnjë pasion. Atë e pushtojnë mërzia dhe indiferentizmi. Mato Gruda i shembëllente një njeriu që kishte pirë tërë natën dhe të nesërmen i kishte dalë rakia; veçse me një ndryshim: Mato Gruda kishte vetëm dëshpërimin e këtij njeriu, por jo indiferentizmin. Kjo gjendje e përgjithshme shpirtërore nuk kishte të bënte vetëm me frikën e tij, me parandjenjen se mos ia zbulonin topin e fshehur në plevicë. Ishte diçka tjetër, që nuk dinte ta shpjegonte. Ndoshta ishte ndjenja e njohjes së kotësisë së veprimeve të veta. Njohja e kësaj ndjenje në dukje ishte spontane, e pavetëdijshme. Ai me fjalë këtë gjë nuk do ta pranonte. Sikur t'i thoshte njeri se ishte e kotë të merrej me këtë top për synime hakmarrjeje, për synime të lashta, ai nuk do ta pranonte këtë pohim, përkundrazi veprimet e tij do t'i quante të drejta. Por thellë në vetëdijën e vet në të vërtetë kishte filluar njohja e kotësisë së këtyre veprimeve. Dhe kjo njohje u rrit pas disfatës. Rritja e saj erdhi me dëshpërimin e tij të plotë. I zhytur në këtë dëshpërim, në fillim ndjeu një urrejtje për topin dhe për italianin që ia mësoi ta mbushte e ta zbrazte. Po të kishte në ato çaste ndonjë furrë, do ta kishite hedhur brenda dhe do ta kishite shkrirë për t'ia ndërruar trajtën. Po italianin? Italianin do ta kishite vrarë... Por pastaj urrejtja kaloi nga topi në veten e vet. E urreu veten. Ndoshta, po të kishin goditur predhat në shtëpinë e Fizëve, nuk do të kishite vend për urrejtjen e vetvetes, as për urrejtjen e topit. Ai tani ishte në mes të një mjegulle. As Fizët nuk i goditi dot, as në mal me partizanët nuk shkoi. Kjo mesruge e torturonte.

I kredhur në këto mendime, ai e la italianin në oborr e shkoi në plevicë. Donte të rrinte vetëm në trungun e thatë. U ul dhe vuri duart në kokë. Bile i zuri edhe veshët që të mos dëgjonte asgjë. Prapa kurrizit të tij rrinte topi i mbuluar me kashtë. Plevica ishte në gjysmerrësirë. Tek rrinte në kërcu, një dritë e lehtë ia ngacmoi sytë.

U hap dera e plevicës. Pastaj drita përsëri u shua. Dera u mbyll. Mato Gruda përsëri u krodh në mendime. Në këtë çast ai ndjeu se dikush e preku me dorë, pastaj ndjeu emrin e vet.

— Mato!

Ishte Augustoja. Mato Gruda u ngrit dhe papritur, si i tërbuar iu hodh italianit, e kapi për shpatulla me forcë dhe filloi ta shkundte. Italiani, i tronditur, thirri me të madhe. Mato Gruda nuk dëgjonte. Ai vazhdonte ta shkundte italianin. Augustoja mundohej të shkëputej nga krahet e Mato Grudës. Të dy vërtiteshin nëpër truallin e plevicës së errët.

— Më lësho, Mato! Ç'ke, Mato!

Mato Gruda e shtyu dhe e hodhi në kashtë pranë topit të mbuluar. Italiani u tulat në kashtë, duke marrë frymë me zor. Në këto çaste do të dëshironte të mos bëhej i gjallë, ose të ishte një qenie e vogël, e padukshme. Nuk e kuptonte se ç'kishte ngjarë me Mato Grudën; ç'ishte kjo furi e papritur, pse ishte fyer nga Augustoja, çfarë i kishte bërë italianit këtij njeriu me top?

Mato Gruda qëndronte më këmbë para italianit të shtrirë, kokulur. Ai nuk fliste, veçse qëndronte. Këmbët e mëdha i kishte ngulur në kashtë. Në gjunjët e pantallonave të arnuara binte një rrip drite, që vinte nga e çara e derës së plevicës. Të dy nuk flitnin. Italiani vështroi kosën e varur në trarin e plevicës, kosën që mezi dallohej nga mugëtira dhe ballin e tij e mbuloi djersa e ftohtë. Edhe Mato Gruda ngriti kokën nga kosa. Atëherë italiani u tulat më tepër në kashtë. Pastaj u hoq zvarrë dhe u fsheh prapa topit. Mato Gruda nuk e ndoqi. Ai vazhdonte të qëndronte më këmbë i heshtur... Më në fund ai erdhi në vete.

— Agush — tha ai pa lëvizur nga vendi.

Augustoja heshte.

— Agush! — thirri Mato Gruda.

— Këtu! — tha Augustoja me zë të dredhur që nga prapa topit.

— Unë u nxeha, Agush! Më hipi në kokë gjaku dhe u nxeha. Po ne të dy edhe mund të ikim... Mund të shkoj-

më në mal me partizanët. Edhe topin mund t'ua shpiem. I mbrejme getë dhe ua shpiem. Nejse, e mendojmë, Agush!

Unë u nxeha, — tha Mato Gruda.

— Pse u nxehe, Mato? — pyeti Augustoja, duke dalë që prapa topit.

— M'u mblodhën shumë gjëra dhe u nxeha, — tha Mato Gruda dhe pas një heshtjeje shtoi: — Në Itali nxehen?

Augustoja, megjithëse para pak sekondave ishte në një gjendje të mjeruar, nuk u përmbajt dhe qeshi.

— Nxehen! — tha ai.

Kur ata të dy i kishin mbaruar fjalët dhe ishin pajtuar, në plevicë erdhi me vrap Ziguri me një letër në dorë. Letra ishte e lagur dhe e zhubrosur.

— E gjeta në korije. Nuk e di se kujt i ka rënë, — tha ai, duke ia dhënë të atit.

I ati bashkë me italianin shkuan të dera e plevicës për të parë. Letra ishte e shaptilografuar dhe vende-vende gërmat e fjalët ishin prishur. Mato Gruda e afroi pranë syve dhe filloi ta lexonte, por menjëherë i largoi sytë:

— Kjo është në gjuhën tënde, Agush, — tha ai.

Italiani ia mori letrën Matos dhe e afroi në fytyrë si një gjë të rrallë. Ai kishte kohë që nuk kishte lexuar asnjë gërmë në gjuhën e vet. Te dera e plevicës kumbuan fjalët e një gjuhe të huaj, të cilën Mato Gruda nuk e merrte vesh:

«Italianë që jeni në Shqipëri! Luftën e padrejtë që ju pati imponuar fashizmi, e keni humbur. Tani ju jepet ende mundësia t'i shërbeni Atdheut tuaj... Duhet të rrëmbeni armët kundër armikut Hitler... që t'i jepni Italisë pavarësinë dhe një regjim të vërtetë lirie, një demokraci të vërtetë popullore!

Bashkohuni me ne në luftë kundër Hitlerit për të goditur armikun e Atdheut tonë dhe të Atdheut tuaj, për të çelur rrugën e riatdhesimit. Ne do t'ju japim të gjitha ndihmat e nevojshme, por duhet të vepronim më me vendosmëri.»

Mato Gruda nga gjithë kjo kuptoi vetëm fjalën Hitler

134

dhe kroi kokën. «Demek, puna qenka me Hitlerin» — mendoi ai. Pastaj iu kthye italianit:

— Ç'thotë?

Augustoja filloi t'ia përkthente. Mato Gruda dëgjonte dhe bënte:

— Breh, breh!

Augustoja, si e mbaroi së përkthyeri, e vështroi Mato Grudën për të dalluar se ç'përshtypje i bënë ato fjalë të çuditshme.

— E kanë hedhur partizanët, — tha Augustoja pas një heshtjeje.

— Dihet që partizanët! — tha Mato Gruda.

Ata e lexuan përsëri letrën. Pastaj Augustoja filloi ta lexonte edhe një herë me zë. Mato Gruda dëgjonte i menduar. Janë të çuditshëm këta komunistët! Këta njerëz, si Murat Shtaga, edhe shejtanin mundohen ta bëjnë për vete. Le që Fizët i ftojnë të hidhen në male, po na tani, edhe italianët e mbetur! Ç'bëhet kështu, more, ç'bëhet!

— Mirë! — tha Augustoja, duke e palosur letrën.

— Çfarë? — pyeti Mato Gruda që nuk e kuptoi.

— Shkruan mirë.

— Ajo dihet! — bëri Mato Gruda, sikur kjo të ishte diçka e zakonshme, dhe ia mori letrën Augustos.

Augustos nuk i erdhi mirë që ia mori dhe ia zgjati dorën.

— Mato, letra ime... — tha ai.

Mato Gruda futi duart në xhepat e pantallonave, hapi këmbët dhe e vështroi italianin me kryelartësi:

— Pa dale, pa dale! Që kur kështu?

— Partizani dërgon mua, — tha Augustoja me djersë në ballë.

«E po kjo nuk hahet! U rrit kungulli dhe mori gardhin. Ç'kujton ky se një mal i tërë me partizanë do të merret me një italiankë të humbur në plevicën time?»

— Letra ime! — nguli këmbë Augustoja, si një fëmijë që merr guxim ngaqë ka një shok të rritur atje pranë.

— Nuk është jotja! Është për italianët e tjerë. Ti s'ke nevojë për letra, se partizanët e dinë që ti je tek unë.

Të stërvit unë për në mal. Dhe me mua mëson sa ç'nuk mund të mësoh nga një mijë letra të tilla, — dhe Mato Gruda e ngriti letrën lart mbi kokë.

Augustoja hapi sytë.

— Ç'më shikon! Shkoqitur po të flas. Ti je partizani im. Ne kemi top. Shtabi ynë është këtu në plevicë!... — Mato Gruda tregoi me kokë hapësirën e plevicës.

— Mato hero nacional! — tha italiani.

— Atë e di unë! — tha Mato Gruda.

Ziguri qeshi me çiltëri, qeshi me zë të lartë.

Pas kësaj ata dolën përsëri në oborr, duke ecur ngadalë, secili me mendimet e veta në kokë. Italiani shkoi të ndreqte murin e rrëzuar, ndërsa Mato Gruda qëndronte më këmbë e vështronte malin e Kokallës.

Në këtë kohë u hap kanati i portës dhe Mato Gruda me italianin shtangën. Në prag qëndronte një plak i gjatë me një fytyrë të hollë me një shkop në dorë. Ai shikonte nën vetullat e bardha, që i rrinin mbi sy si dy kërpudha. Flokët i kishte të bardhë dhe dukeshin sikur të gjitha qimet i ishin bashkuar dhe kishin formuar një si ai myshku i mureve të lagura, veçse ngjyra e tyre nuk ishte e gjelbër si e myshkut, por e bardhë. Bile këta flokë dukeshin sikur, po t'i prekje pakëz, do të binin përdhé si copëra dëbore.

— Plaku Mere! — tha Mato Gruda dhe u zverdh në fytyrë.

Plaku Mere hodhi edhe dy-tre hapa të tjerë dhe qëndroi në mes të oborrit, duke u mbajtur në shkopin e tij të lashtë. Ktheu kokën nga muret e shtëpisë dhe e ndali vështrimin në gardhin e plevicës, pa thënë asnjë fjalë. Futi duart në xhep dhe nxori tespihet. Pastaj e ngriti dorën dhe e drejtoi nga plevica. Mato Grudës i vajti dora në kobure. Gishti i tij preku tytën e saj të ftohtë. Por e hoqi menjëherë. «Sa para bën të vrasësh vetëm plakun Mere» — mendoi ai.

Italiani ia afroi Mato Grudës buzët në vesh dhe e pyeti:

— Kush është plakun?

— I zoti i asaj shtëpisë në grykë të përroit, — tha Mato Gruda ngadalë.

Augustoja u drodh.

— Shshitt, Agush! — bëri Mato Gruda.

Plaku Mere u kthye nga muret e avllisë dhe diçka murmuriti.

— Gjysh i madh, urdhëro brenda! — tha Mato Gruda me zor.

Plaku Mere e vështroi Mato Grudën dhe italianin. Sytë e tij të thellë mbetën të palëvizur në një pikë. Pas pesë minutave ai ktheu kokën prapë nga plevica. Qëndroi gjatë më këmbë dhe, kur po ikte, përpoqi shkopin në oborr e tha:

— Ollun madar këllin oz-te tutumysh sever ofull-yf kyz-yf yllaty of-yg kan-yf barça adyry adyn azhynka illty baryr.

Këto fjalë mbetën në oborr si mister. As Mato Gruda, as italiani nuk i kuptuan. Ata vetëm ndien zymtësinë e tyre. Edhe pa i kuptuar, u rrëqethën. Kuptimi i fjalëve të plakut Mere ishte: «Do të vijë puna e vdekjes dhe do ta ndajë prej njeriut gjithçka që është e dashur për atë dhe gjithçka që i përket atij — djali dhe vajza, babai dhe nëna — dhe do t'i shpjerë në botën tjetër.»

Plaku Mere e vështroi Mato Grudën dhe pastaj dalngadalë, duke u mbajtur në shkopin e lashtë, u drejtua në portë.

— Allah belaversën! — tha pa iu drejtuar njeriu dhe doli.

Mato Gruda me italianin mbetën të ngrirë.

— Gjyshi i madh zbuloi topin, — tha italiani.

— Ai është koskë e lëkurë. Si u ngrit? Sikur e solli shejtani, — tha Mato Gruda.

— Plaku ka shejtan, shejtan. Plaku ka shumë mend në kokë, — tha Augustoja.

— Xhind!

— Mato, topin ta heqim nga plevica, — tha italiani.

— Ku ta shpiem?

— Bëj unë një kolibe qeni. E futim në kolibe. E

mbuloj me dërrasa. Përpara rri qeni. Nuk dyshon njeri. Topi i vogël. Kolibe e vogël, — tha Augustoja.

Mato Grudës i pëlqeu mendimi i italianit. Plaku Mere mund të përhapte fjalë nëpër fshat dhe mund të bastise-shin plevica e shtëpia.

— Augush, atëherë lëre murin e avllisë dhe fillo shpejt koliben.

— Bukur, Mato. Sqepari, sharra, sëpata. Filloj unë puna, — tha Augustoja.

Të dy hynë në plevicë dhe filluan të kërkonin trarë dhe dërrasa. Diku në një qoshe Mato Gruda kishte grumbulluar ca qereste për shtëpinë dhe qilarin. Me to mund të ndërtohej një kolibe e mirë për topin dhe qenin. Pa folur, filluan t'i nxirrnin në oborr, pranë vendit ku do të ndërtonin koliben. Si i nxorën të gjithë trarët dhe dërrasat, Augustoja mori kazmën dhe lopatën dhe filloi të hapte gropat për shtyllat dhe themelet, ndërsa Mato Gruda përveshi mëngët dhe rrëmbeu sëpatën për të gdhendur trarët.

— Fshati dëgjoji shpërthimin, — tha Augustoja. — Trembur fshati.

— Kushedi ç'thonë! — tha Mato Gruda.

— Keq bëre, — tha Augustoja.

— Atë e di unë! — shfryu Mato Gruda.

Mato Gruda gdhendte me sëpatë dhe mendjen e kish-te te fshati. Sipas mendimit të tij, gjëmimi i topit në mes të natës do ta kishte tronditur fshatin dhe do të kishte filluar në çdo vatër komentimi i kësaj ngjarieje.

Atij nuk i rrihej pa dalë një herë nëpër fshat. Prandaj e la sëpatën, veshi xhaketën prej shajaku dhe i tha italianit të vazhdonte punën. Italiani e vështroi me frikë:

— Kujdes. Mato! Zbulon topi.

Mato Gruda tundi dorën në shenjë mospërfilljeje dhe doli nga porta.

Në rrugë, ende larg xhamisë, takoi dy ballistë. Njëri prej tyre ishte nga fshati i tij. Ata i thanë të shkonte te rrapi i madh, se do të mbante një kuvend Tosun Baçi. Mato Gruda mallëkoi veten që doli nga shtëpia, por tani ishte vonë.

— Për ç'punë? — pyeti ai ballistin.
 — Më ngjan se për punën e gjyleve që ranë në oborrin e Fizëve. A? Nuk i ke dëgjuar? — tha ballisti.
 — I dëgjova... — tha shkurt Mato Gruda.
 — Më ngjan se kanë qëlluar partizanët, — tha ballisti.
 — Ku ta dish se kush ka qëlluar.
 — Tosun Baçi thotë se partizanët, — tha ballisti.
 — S'ma merr mendja.
 — Gjithë fshati thotë se kanë qëlluar partizanët. Tosun Baçi është zemëruar. Ia hedh fajin Murat Shtagës, — tha ballisti.

— Njëri na tha se mund të kenë bombarduar aleatët. Po ne nuk dëgjuam asnjë aeroplan! Pastaj aeroplani i ka bombat të mëdha. Ato ishin gjyle, — tha ballisti tjetër.

— Xhanëm, aeroplani ka edhe bomba të vogla si gjyle, — tha ballisti nga fshati.

— Po zhurma e aeroplanit duhej të dëgjohej, — tha ballisti tjetër.

— Mund të ketë fluturuar shumë lart, — tha ballisti nga fshati.

— Duhet të jetë ashtu si thotë Tosun Baçi. Partizanët duhet të kenë qëlluar, — u mendua ballisti tjetër.

Mato Gruda i la ballistët dhe u drejtua te sheshi i xhamisë. Në shesh dukej një turmë e madhe. Ai ngadalë, duke e përzënë qenin që i kishte rënë pas, doli që sipër xhamisë dhe u fut në turmë.

Tosun Baçi, i imtë, me mustaqe të verdha e të rralla, qëndronte më këmbë te sheshi i xhamisë pranë një rrapi të madh. Rreth tij ishin mbledhur burrat e fshatit. Ata rrinin kokulur e mbanin sytë përdhe, duke trazuar me shkopinj dheun. Tosun Baçi fuste herë pas here dorën në xhëp, merrte që andej arra, i thyente dhe hante. Arrat kërcejnin në duart e tij të holla dhe ai e ndërpriste fjalën, sikur donte të mbante vesh këto krisma.

— Që thua ti, afa kujtonin se unë isha te plaku Mere. Që thua ti, qëlluan me top. Bashkë me mua do të shuanin një shtëpi të tërë. Që thua ti, e dinin që plaku Mere e Fizët nuk i duan komunistët. Me një gur donin të vritnin dy zogj: mua të më vritnin, Fizët t'i trembnin e t'i vritnin, që

t'i kishin duart të lira në fshat. Komunistët e dinë se Fizët kanë emër në fshat... Ja ç'janë komunistët, qëllonë shtëpitë e popullit me top, — tha Tosun Baçi dhe shtrëngoi me gishtërinj dy arra. Ai heshti dhe filloi të përtypte arrat. Burrat vazhdonin t'i mbanin sytë përdhe. Mato Gruda pikë e vrer rrinte nga fundi me hundë të futur në jakën e xhaketës prej shajaku dhe dëgjonte. Atij nuk i kishte shkuar në mend që faji t'u hidhej partizanëve. Për një çast mendoi për Murat Shtagën. Gjithë puna e Muratit për të bashkuar fshatin dhe për ta bindur atë në drejtësinë partizane, tani ishte rrëzuar. Ai i ndjeu djersët e ftohta që po i dilnin në trup.

— Që thua ti, — filloi përsëri Tosun Baçi, duke përtypur një thelb arre, — Murat Shtaga e pa që nuk ua dilte dot Fizëve me të urtë, e pa që nuk i bindte, dhe përdori topin. As kriminelët, që thua ti, nuk bëjnë një gjë të tillë... — Tosun Baçi prapë theu një arrë dhe prapë heshti. Pastaj, duke mbajtur në dorë arrën e thyer, u hodhi një vështrim burrave dhe i ndali sytë te Pertefi, i vëllai i Nevzat Marukës. — Po ne do ta shohim. Përpiqen dy arra: njëra thyhet, tjetra s'thyhet. Ata mundohen t'i ngulin krimb arrës sonë, që ta thyejnë kollaj. Që thua, ti, nuk u shkon. Unë nuk do t'i lë të qëllonë me top shtëpitë e popullit. Unë doja të digjja shtëpinë e Murat Shtagës. Po nuk e dogja, se më erdhi keq për nënën e Muratit e për gruan e Muratit. Po tashi do ta djeg, se edhe ata filluan të djegin. bile, jo të djegin, po të qëllonë me gjyle. E, ti Pertef. vëllai i partizanit, ç'thua?

Pertef Maruka, i mbështetur në shkopin prej thane, e vështroi me sytë e vegjël Tosun Baçin, tundi pastaj kokën me flokë të zinj, dhe tha ngadalë:

— Ne nuk e dimë se kush qëlloi në shtëpinë e Fizëve, zoti Tosun. Mejtimi im është se nuk kanë qëlluar partizanët. S'kanë pse të qëllonë... Me të djegur nuk i dilet. Ti djeg Murat Shtagën, ata vijnë dhe djegin miqtë e tu... Mejtimi im është se nuk bën të djegim. Partizanët nuk kanë qëlluar... — tha ai dhe heshti.

Pas këtyre fjalëve për një çast burrat e prenë frymën dhe nuk shikonin as Tosun Baçin, as Pertefin. Mato Gruda,

i zhytur në një dëshpërim të thellë, ishte zbehur dhe nuk i ngrinte sytë. E ndiente se topi i tij po merrte fshatin më qafë. Në ndërgjegjen e tij erdhi për një çast si vetëtimë një mendim: të ngrihej e të thoshte: «Qëllova unë! Dhe ti, Tosun Baçi, gënjen!» Por ky mendim shpejt u errësua. «Me Fizët unë nuk i kam qëruar hesapet!»

— Po ti, Fahremudinali, ç'thua? — pyeti qetë Tosun Baçi me dorë në xhepin e arrave.

Burrat ngritën fytyrat nga Fahremudinaliu.

— Para pak ditëve ka qenë në shtëpinë tonë Murat Shtaga. Gjyshi i madh dhe unë u zumë me të. Puna qëndronte këtu. Ai donte ta përçante shtëpinë tonë. Ne i kundërshtuam. Pas kësaj ngjarjeje shtëpia jonë u godit me top. Kam dyshim se kjo është punë e Murat Shtagës. Më thoni, kush mund të qëllonte? Jo po më thoni! — Fahremudinaliu heshti.

Tosun Baçi qeshi nën mustaqet e verdha e të rralla. Nga mesi i burrave u ngrit Adnan Pinxhoja:

— Mua sikur të më varin, nuk ma mbushin mendjen që s'kanë qëlluar partizanët. Murat Shtaga atë mbrëmje erdhi edhe në shtëpinë tonë. Sa u largua nga Fizët, erdhi te ne. Babai im e përzuri.

— I lumtë Abdurahimit, — tha Tosun Baçi.

— E pse e përzuri? Murat Shtaga shau zotin Tosun, e quajti të poshtër dhe na quajti edhe ne të poshtër që përzihemi me zotin Tosun... — vazhdoi Adnani.

Tosun Baçi tërhoqi cepin e mustaqeve dhe lëvizi nga vendi.

— Murat Shtaga, kur doli, tha i zemëruar se ne gjoja do të pendoheshim, por do të ishte vonë. Ai tha gjithashtu se partizanët nuk do të kishin mëshirë për tradhtarët. për ata që shkojnë me gjermanin dhe Tosun Baçin. Dhe Murat Shtaga e bëri të tijën, shkoi në mal. bisedoi me komunistët dhe qëlloi me top për të trembur fshatin...

Mato Grudës iu ngrit një lëmsh i hidhur në lukth të gjoksit. Gjuha e ligë e Adnan Pinxhos atë e turbulloi. «Si i lidhin gjërat, more, si i lidhin! E ku u vete mendja! Ç'bëjnë kështu njerëzit, more!» — mendoi ai.

Tosun Baçi mori një pamje të dëshpëruar. Ai nuk flis-

te. Edhe burrat nuk flitnin. Një pjesë e tyre mendonin se vërtet mund të kishin qëlluar partizanët. Ata nuk e donin Tosun Baçin, por nuk ishin dakord që partizanët të qëllonin papritur, në mes të natës, një shtëpi të vetmuar diku buzë përroit. Kjo cënonte drejtësinë partizane në sytë e këtyre burrave.

Në anë të turmës lëvizti njëri nga Fizët. Ai, i skuqur në fytyrë, me sy të vllazhdë, vështroi Tosun Baçin, pastaj Fahremudinaliun, të vëllanë, e tha:

— Vëllezër, unë e doja Murat Shtagën. U përgatita të dilja me të në mal, të dilja partizan... — Atij iu mor goja dhe vështroi njerëzit si për të kërkuar ndihmë. — Do të dilja, vëllezër. Por tani pas poshtërsisë së tyre me shtëpinë tonë, nuk dal. Nuk dal! U pendova, zoti Tosun. U pendova! Nuk e dëgjova gjyshin e madh... Ah, more!... — Baftjar Fizi uli kokën e filloi të qante. Tre-katër njerëz kafshuan buzët. Atyre nuk u erdhi mirë që një burrë të qante. Mato Gruda u ngrys. «Mirë bën që nuk del partizan — mendoj ai. — Ç'të të duan ty, qaraman, partizanët!» Dhe ai u nxehe me Murat Shtagën që ia kishte mbushur mendjen një qaramani të tillë.

Tosun Baçi zgjati gishtin e hollë nga Baftjari:

— E shihni, zotërinj, një njeri të ndershëm? Ai qan nga inati! Trimat vetëm nga inat qajnë. Ai u vra në shpirt. Ai mallëkoi veten që desh u hodh me partizanët, me vrasësit, me njerëzit pa fe, pa din, pa moral.

Rreth e përqark u bë një heshtje varri. Asnjëri nuk pëshpëriste, asnjëri nuk ngrinte kokën. Edhe ata që anonin nga ana e Tosun Baçit, kishin rënë në një mërzë e në një trishtim të madh, se mendonin për trazirat që do të ndodhnin në fshat këtej e tutje. Tosun Baçi do të digjte Murat Shtagën, Murati do të vinte dhe do të digjte ata që nuk i donte. Tani o duhej hedhur nga ana e Tosun Baçit dhe të mbroheshin shtëpitë e tyre, o nga ana e partizanëve për t'u bërë ballë ballistëve. Ata që anonin nga ana e partizanëve, shanin Murat Shtagën për këtë veprim të shpejtuar. Një pjesë e tyre mendonin se Murati mund të kishte qëlluar shtëpinë e Fizëve më kokë të vet. Do t'ua kishte mbushur mendjen partizanëve dhe ata do të ishin bindur.

«Partia në këtë punë nuk do të jetë pyetur dhe Murat Shtaga do ta paguajë rëndë» — mendonin ata në heshtje. Vetëm njëri që i dinte të gjitha qëndronte dhe heshte. Ato të shtëna vinin nga thellësia e shekujve dhe s'kishin të bënin fare me palët luftuese. Ato ishin diçka tjetër, diçka e vjetër, po që kjo e vjetër përziante dhe ngatërronte kohën. Kjo e vjetër shkonte në dobi të Tosun Baçit. Mato Gruda nuk mund të arsyetonte me këtë gjuhë, por ai e ndiente se dy të shtënat e tij po venin në dobi të Tosun Baçit dhe ai hante thonjtë në mes të turmës. Ai u mat të ngrihej e të ikte, të nxirrte topin nga plevica e të qëllonte përsëri Fizët. Atëherë njerëzit të vështronin njëri-tjetrin e të thoshin: «Ja cili qëlloi!» Dhe njerëzve do t'u kujtohej historia e shakujve me vajguri dhe historira të tjera. Aty për aty ai tha me vete: «Këtë do ta bëj. Do të më shihni...»

Në këtë çast nga burrat u ngrit Asllan Maruka, një nga pjesëtarët e fisit më të largët të Nevzat Marukës. Ai nxori nga brezi revolverin, e ngriti lart e tha:

— Unë me këtë kobure do dilja në mal me partizanët. Dhe iu betova Murat Shtagës me dorë në millin e kësaj kobureje. Unë nuk dal partizan. Unë me këtë kobure do shkoj me Tosun Baçin, ja, me atë burrë të ndershëm. Dhe ju them se, po nuk u lidh fshati ynë e fiset tona me Tosun Baçin, do të na marrë lumi. Do na përvëlojnë si minjtë komunistët. Unë e kam Nevzatin, kushëririn tim, në mal me partizanët. Unë do ta luftoj edhe kushëririn...

Gjithë turmën e përshkoi një dridhmë. Njerëzit filluan të zhurmonin, të tundnin kokat, të ulnin e të ngrinin këmbët.

— Edhe unë nuk shkoj, megjithëse kushëririn im i parë, Nevzati, është në mal. Unë do të vete në mal e do t'ia mbush mendjen edhe Nevzatis që të kthehet. Mirë thotë Asllani, — thirri Abedin Maruka, një burrë i gjatë me vetulla të thinjura e me një çibuk në dorë.

Në krah të tij rrinte Fetah Shtaga, një kushëri i dhjetë a i pesëmbëdhjetë i Muratit. Ai e zuri për krahu Asllan Marukën dhe papritur ia rrëmbeu koburen nga dora. Ia rrëmbeu dhe e hodhi me sa fuqi që kishte tutje. Koburja

fluturoi mbi degët e mëdha të rrapit dhe pastaj, duke bërë një gjysmëhark, ra mbi çati të xhamisë. Asllan Maruka në fillim u hutua, pastaj, i zbetë si qiri, iu lëshua Fetahut. Mato Gruda u hodh në mes të tyre për t'i ndarë. U hodhën edhe dy-tre burra të tjerë. Tosun Baçi, pa e prishur gjakun, qëndronte më këmbë dhe thyente arra.

— Maskarenj, — thirri Fetah Shtaga, — të gjithë ju që lllomotitët jeni maskarenj. Dhe tradharë jeni. Ku e dini ju se kanë qëlluar partizanët. Ua mbajtët kandilin a? Pse nuk mendoni që mund të ketë qëlluar edhe ky mustaqeverdhi që thyen arra dhe mbllaçitet si lavire para nesh? — dhe ai shtriu dorën drejt Tosun Baçit. — S'kanë nevojë partizanët të qëllojnë me top një palo plak që heq shpirt, një palo Mere Fizi. Partizanëve u duhen gjylet për gjermanët. S'kishte nevojë të përdornin topin për një të ngordhur. — Ai iu kthye Tosun Baçit. — Po ty, more mustaqemisër, pse nuk ta qëlluan partizanët shtëpinë me top? Ty ta dogjën. E morën për krahu zonjën tënde dhe tët atë, i shpunë në një shtëpi tjetër dhe ta vunë zjarrin, se ke bërë shumë poshtërsira. Por nuk t'i vranë fëmijët, — thirri Fetah Shtaga dhe nga zemërimi u drodh.

Tosun Baçi, duke përtypur një thelb arre, i bëri me kokë një ballisti që rrinte roje.

— Merreni atë dhe mbylleni në plevicën e Abdurahim Pinxhos. Fuqjani këmbët në rrip të dyfekut dhe guduliseni pak me thuprën e pushkës. Që thua ti!...

Ai theu edhe një arrë tjetër. Katër ballistë hynë në turmë dhe e zunë Fetah Shtagën për krahu. Fetah Shtaga, i qetë, i shtyu krahët e tyre, dhe u nis përpara. Njerëzit i liruan udhën. Ai ktheu njëherë kokën nga burrat, i vështroi me zemërim e tha:

— Tradhtarë!

Njerëzit në heshtje e ndoqën me sy. Pas Fetahut, duke përpjekur opingat, doli nga turma edhe Pertef Maruka. Pertefin e ndoqën edhe katër-pesë burra nga Marukët dhe Shtagët.

— U lodhët, djem? — pyeti i qetë Tosun Baçi.

— Më duket se mbaruam me kaq! — tha Pertef Maruka

— Edhe unë mbarova! — tha Tosun Baçi dhe iu drejtua burrave që mbetën. — Ai që do, të vijë me mua, unë këtu jam.

Mato Gruda vështroi njëherë përçark dhe, duke u lëkundur në këmbët e tij të gjata, u nis pas burrave që shkuan me Pertef Marukën.

Pas pak gjithë sheshi u zbraz. Tosun Baçi mori Adnan Pinxhon dhe disa nga Pinxhot e tjerë dhe u nis për në konak. Konaku i tij ishte shtëpia e Pinxhove.

Mato Gruda ecte ngadalë në rrugën me gurë të zinj të fshatit Arun. Pas i vente qeni, që e kishte pritur diku në një rrzë. Pertefi me burrat e tjerë ishin larg tij. Diku prapa kumbullave dukej Fetah Shtaga me katër trimat e Tosun Baçit.

Mato Gruda ndiente në shpirt një apati e një lodhje të rëndë. Atij përsëri iu kthye mërzia e mëparshme.

— Ah, o Balo, ç'na gjeti! — i tha ai qenit, që vinte pas.

KAPITULLI I GJASHTËMBËDHJETË

Ata e nxorën topin natën nga plevica. Kur po e nxirrnin nga dera, dëgjuan pëllitjen e lopës dhe trokitjen e këmbëve të saj. Mato Gruda qeshi:

— E ndien ti, Agush, se Lara është mësuar me topin dhe i vjen keq të ndahet prej tij?

— Çudi! I vjen keq. Rri vetëm! — tha Augustoja.

— I vjen keq se edhe ajo që është një kafshë pa tru, e kupton që topi e mbron nga gjërat e këqija, — tha Mato Gruda.

Augustos për pak sa i shpëtoi nga duart shtrati i topit. Ç'mendon ky Mato Gruda!

Italiani kishte ndërtuar me dërrasa një si hambar dhe i kishte bërë një çati të bukur. Përpara topit të mbuluar ai kishte lënë një vend për qenin. Duke e parë këtë kolibe, askujt nuk i shkante në mend për topin.

Mato Gruda, tek vështronte koliben, i tregoi italianit për Tosun Baçin dhe për fjalët që ishin përhapur në fshat, pas dy krismave të asaj nate.

— Njerëzit e ligj gjithë fajin ua kanë hedhur partizanëve, — tha ai.

Augustoja, duke kopsitur jakën e bluzës, tha i menduar:

— Historia njej shumë fakte të tilla, Mato. Më 27 shkurt 1933 Gering dogji Reinshtagun. Vetë e dogji dhe hodhin fajin komunistëve. Fajin ka komunisti e vret komunistë e arresto natën komunistë...

— Ç'është ky Geringu? — pyeti Mato Gruda.

— Gering mëkëmbësi Hitlerit, — tha italiani.

— A! — bëri Mato Gruda.

— Frikë, Mato! Vjen gjermani, vjen Balli, djegin baza partizane në fshat... Meqë qëlluan partizanët një shtëpi, edhe do të djegim, thonë, — shpjegoi italiani.

Mato Gruda, pa ia vënë veshin fjalës së italianit, pyeti:

— Ç'është ky Reshagu?

— Reinshtag, Mato, pallati i parlamentit gjerman, — tha italiani.

— A! — bëri Mato Gruda. — Ti, Agush, le ndonjë derë për ta nxjerrë topin?

Augustoja e vështroi me habi. «Prapë kërkon ta nxjerrë? Ç'ka ndër mend të bëjë?» — mendoi ai.

— Derë nuk lashë, — tha Augustoja.

— Nesër bëji një derë këtej nga ana e qenit. Do ta nxjerrim përsëri, kur t'i vijë koha... — tha Mato Gruda.

Italiani ra në mendime. «Mos vallë Mato Gruda ka informata për gjermanët? Ndoshta gjermanët do të ndërtojnë në malin e Kokallës ndonjë fortifikatë dhe Mato Gruda do ta qëllojë me top? Mato duhet të jetë njeri i madh» — tha me vete Augustoja.

Atij iu kujtua biseda e tyre në plevicë për traktin që kishin hedhur partizanët. Mato Gruda thotë se ne e kemi shtabin në plevicë! Në çfarë shtab misterioz bëkam pjesë vallë? Ai thotë se më stërvit mua. Po ç'do të bëjmë? — mendonte Augustoja.

— Pse hesht, Agush? — pyeti Mato Gruda.

— Mendoj topin — tha ai.

— E si e mendon?

— E mendoj topin në shtab. Çfarë shtab është plevica? — tha ai me buzën në gaz.

— Atë e di unë, — tha Mato Gruda.

Në mes të kësaj bisede diku larg u dëgjuan të shtëna pushkësh dhe pas tyre u duk në horizont një flakë. Zara, hallë Esmaja e sëmurë dhe fëmijët dolën në dritare. Mato Gruda dhe italiani vrapuan në oborr. Digjej shtëpia e Murat Shtagës. Mato Gruda ishte mbështetur në kana-

tin e portës dhe vështronte. Qielli skuqte në cep të kodrës.
«Ndoshta edhe unë — mendoj Mato Gruda — jam shkak-
tar për djegien e shtëpisë sate, Murat. Atë edhe mund ta
digjnin, por më vonë!»

— Djegin — tha italiani i menduar.

— Djegin Murat Shtagën, — tha Mato Gruda me
dhembje.

Zara doli me vrap në oborr. Pas saj dolën edhe Zi-
guri me Sadikun.

— I ziu Murat! — tha ajo.

Matoja heshte.

— Të gjitha bazat partizane do t'i djegin, — tha ajo.

— Ah, Mato, ç'bëre!

Augustoja kishte ulur kokën.

Ndërkohë në rrugicë, u ndien hapat e një njeriu që
vraponte. Mato Gruda mbylli shpejt kanatin. Italiani u
spraps instinktivisht. Njeriu ndali te porta dhe trokiti
lehtë.

— Kush është? — pyeti Zara në vend të Mato
Grudës.

— Jam unë! — u dëgjua.

Ishte Murat Shtaga. I parruar, tërë baltë, ai hyri në
oborr. Qentë jashtë lehnin.

— Ç'është kjo gjëmë, Murat? — pyeti Zara.

— Djegin shtëpinë time! — tha ai, duke u munduar
të mbante gjakftohtësinë.

— Po gruaja, po fëmijët? — pyeti Zara.

— Do të shkojnë nga xhaxhai, — tha ai.

Mato Gruda ia hodhi dorën në shpatulla me pikëllim
të thellë. E mbajti për një çast gjersa ndjeu ngrohtësinë
e trupit të tij dhe tha:

— Murat, nëna, gruaja dhe fëmijët le të vijnë tek unë.
Vëlla Murat, mua ata nuk më rëndohen. Do të jetojmë
me ç'të kemi...

Murat Shtaga e vështroi me dhemshuri. Ai vuri re
se në sytë e Matos kishte lotë. Duke ulur kryet, u për-
gjigj:

— Falemnderit, Mato! Xhaxhai është më në gjendje
se ti. Ti e di se ai ka vetëm plakën...

— Si të duash! Neve na vjen keq, Murat! Jemi si vëllezër...

Në këto çaste Zarës iu dhims i shoqi. Ajo e vështronte me një keqardhje të thellë. «Ky njeri i tillë do të vdesë: i dashur, i vuajtur, i munduar me mardhanë e hakmarrjes në gjoks» — mendoj ajo.

Pa folur, ata kaluan nëpër oborr dhe u ngjitën në odë. Pushkën e la në qoshe dhe bërrucin e vari në gozhdë.

— Në fshat janë ballistët, — tha Mato Gruda.

— E di!

— Fetah Shtagën e morën, — tha Mato Gruda.

— E di.

— Tosun Baçi po bën gjëra të ndyra, — tha Mato Gruda.

— Po bën. Edhe këtë e di, — tha Murat Shtaga i dëshpëruar.

Hallë Esmaja rrinte te vatra e verdhë dyllë. Ajo merrte frymë me zor.

— Ti, hallë Esmë, mos je e sëmurë? — pyeti Murat Shtaga.

— Ka ca ditë që jam keq. I gjithë trupi më dridhet. As unë s'di se ç'kam. Le unë, po e zeza nëna jote! Ju dogjën dushmanët, evlat, — tha ajo, duke rënkuar.

— S'ka luftë pa zjarr! — tha Murat Shtaga.

— Nga ke qenë? — pyeti Mato Gruda.

— Nëpër fshatra.

— More vesh për Tosun Baçin?

— Mora.

Zarës i vinte vështirë të rrinte në odë. Ajo mori Zigurin dhe Sadikun dhe doli, duke thënë se djemtë ishin lodhur dhe do të flinin. Murati e vështroi me bisht të syrit pa folur. Ai iu kthye Mato Grudës.

— Krismat kanë qënë një provokim i poshtër. — tha Murati pas një heshtjeje. — Ballistët dhe perakrahësit e tyre kanë hapur fjalë se gjoja Fizët i qëlluan ne...

Mato Gruda rrinte si në gjemba. Kishte frikë se mos Murati dyshonte për të. Frika iu shtua tek kujtoi një bisedë të shkuar me Muratin për topin e humbur në korrje.

— Aq punë na kanë prishur ato të shtëna, sa s'di si të të them. Dëgjova sot se disa nga ata që do të dilnin partizanë, kaluan nga Tosun Baçi, — tha Murati.

— Kot e prishni gjakun! — tha Mato Gruda.

— Ç'kot, more Mato! U hodh në erë gjithë puna jonë!

— Mos të kanë pikasur, more bir! — tha hallë Esmaja.

— Jo, hallë, ju e keni shtëpinë larg të tjerëve, — tha Murat Shtaga.

Ai zbathi këpucët dhe shtriu këmbët pranë zjarrit. Tek shikonte i heshtur flakën, kujtoi shtëpinë e tij që digjej, shtëpinë që me aq mundim e kishin ngritur gjyshërit. Atij i vajti mendja te gruaja dhe tek e ëma dhe psherëtiu. Pastaj i shkuan mendtë përsëri tek të shtënat e topit. Me siguri do ta thërritnin prapë në qarkor për shthurjen e fshatit e për gjendjen e re të krijuar pas gjëmimit të topit. Ai shtrëngoi me pëllëmbë ballin dhe humbi në mendimet e veta. Në odë dëgjohej frymëmarrja e rëndë e hallë Esmasë.

— Murat, po të them edhe një herë, nëna, gruaja dhe fëmijët le të vijnë të jetojnë në shtëpinë time.

Murat Shtaga u zgjua.

— Faleminderit, Mato. Do të jetojnë te xhaxhai. Ashtu e menduam, kur donin të na digjnin pak kohë më parë.

— Si të duash.

— Edhe Baftjari e ktheu fletën, Mato? — pyeti Murati.

— Ashtu tha. Do të dilja partizan, tha, po tani nuk dal, se Murati më qëlloi shtëpinë me top, — shpjegoi Mato Gruda.

Murat Shtaga qeshi hidhur.

— Të marrët! — tha ai. — Dëgjo, Mato. Unë pas pak do të shkoj te Fizët...

Mato Gruda hapi gojën nga habia. Si është e mundur që Murati, në mes të ballistëve, të shkojë te Fizët? Fizët mund ta vrasin.

— Habitem me ty, Murat, — tha ai.

— Duhet takuar sa s'është vonë. — Murat Shtaga

u ngrit, i rrudhi vetullat dhe thirri. — Nuk e lë unë fshatin të shturret! Tosun Baçi e gjithë provokatorët nuk duhet të hipin mbi ne, komunistët, dëgjon ti apo jo? — pastaj ai u ul përsëri pranë vatrës.

— Pse nxelesh, evlat? — tha hallë Esmaja.

— Eh, moj hallë Esma! — dhe iu kthye Matos. — Pas pak do të ngrihem. Mund të vij nga Fizët e të fle sonte këtu. Dëgjo, Mato, kaun tim merre nga xhaxhai dhe mbaje në ahurin tënd. Të duhet. Në mos u pjekshim sonte, ti pasnesër duhet të ngarkosh mushkën time dhe tënden dhe bashkë me Pertefin të shkoni prapa majës së Kokallës. Partizanët nuk kanë bukë. Gjermanët vërtiten këtej rrotull. Priten të vijnë nga dita në ditë...

— Jo, more! — u çudit Mato Gruda.

— Duhet rezerva ushqimi, Mato! — tha Murati.

Ai mori pushkën në qoshe të odës, hodhi bërrucin dhe doli. Mato Gruda e përcolli gjer te pragu i portës.

— Si vete me italianin? — pyeti Murati.

— Djalë i mirë.

— Kemi nja katër a pesë prej tyre në batalion — tha Murati.

— Partizanë?

— Po!

— S'kanë kokë për partizanë ata, — tha Mato Gruda.

— Kur dinë përse luftojnë, janë trima. — tha Murati. — Ka ndër mend të dalë partizan ai italian i yt?

— Bah! — bëri Mato Gruda.

Murati kapërceu pragu e portës dhe mori rrugicën me kalldrëm. Bërruci i tij nxinte në errësirën e natës. Mato Gruda qëndroi gjatë te porta i menduar...

KAPITULLI I SHTATËMBËDHJETË

Topi rrinte i fshehur në kolibe. Para tij ishte lidhur qeni. Mato Gruda dhe italiani vërtiteshin dhe mendjen e kishin tek ai.

Megjithëse çatia e kolibes ishte ndërtuar mirë, kishin frikë se mos pikonte nga shirat e nëntorit. Për djall, ai nëntor kishte ardhur me rrebeshe e po dilte me rrebeshe.

Një natë të tillë me shi e bubullima, ndaj të gdhirë Mato Gruda e zgjoi italianin dhe i tha se topi mund të ishte lagur. Italiani i hapi me mundim sytë dhe mezi erdhi në vete.

— Ngrehu të vemë ta shohim, — tha Mato Gruda. Augustoja u ngrit, u vesh me përtim dhe të dy me të zotin e shtëpisë dolën në oborr. Qiejtë rridhnin. Gjithë vijat dhe gropat ishin mbushur me ujë.

Mato Gruda e hapi derën e kolibes, e nxori qenin jashtë, e hapi derën tjetër dhe hyri brenda. Pas tij hyri edhe Augustoja. E ndezën kandilin dhe filluan ta shikonin nëse pikonte çatia. Topi nxinte. Çeliku i tij ishte i ftohtë.

Kërkuan me kandil ndonjë pikë, por nuk dalluan asgjë.

— S'ka! — tha Mato Gruda.

— Çatia mirë, — tha italianin.

— Po lagështirë ka ama! — tha Mato Gruda, duke vënë dorën në tytë të topit.

— Ushtria e mbulon topi me mushama, — tha Augustoja i menduar.

— Ne s'kemi mushama, — tha Mato Gruda me keqardhje.

— Prishet topi... — tha italiani.

— Ta mbulojmë me jorgan! — tha Mato Gruda.

Italiani nuk e kuptoi, se një gjë të tillë nuk ia merrte mendja.

— Si, Mato?

— Them ta mbulojmë me jorgan...

Augustoja hapi sytë në gjysmerrësirën e kolibes. Katër vjet brodhi ai nëpër Ballkan, por kurrë nuk kishte takuar një njeri të tillë si Mato Gruda. «Ballkani ka njerëz të çuditshëm — tha ai me vete. — Eh, të ishte Salvatorja, do të kishte shkruar një roman për Mato Grudën, për mua, për topin. Po Salvatorja iku me partizanët dhe nuk dihet se ku është. Sikur të shpëtojmë, do t'ia tregoj historinë time në këtë plevicë e në këtë kalibe»...

— Jorgan, them, — përsëriti Mato Gruda.

— Jorgan mirë. Po jorgani, është për njeriun. — tha italiani.

— Mbaje kandilin, — tha Mato Gruda dhe ia dha në dorë. — Më prit pak.

Mato Gruda doli. Italiani mbeti vetëm në koliben e vogël. Shiu oshëtinte dhe herë pas here gryka e topit dhe muret e kolibes ndritnin nga vetëtimat. «Mbeti ky top bashkë me mua. Kështu mbetën armatat tona. E përse do t'i hyjë në punë këtij njeriu? Më thuaj, o «Haufman 59001» — tha italiani me vete dhe mbështeti ballin në grykën e topit si për t'u freskuar nga ftohtësia e tij. Ai me të vërtetë nuk e kishte kuptuar qëllimin e Mato Grudës dhe gjithçka i dukej një fshehtësirë e pazbuluar. Por vetëm për një gjë nuk dyshonte: «I zoti i kësaj shtëpie do të jetë ngarkuar me plane të mëdha nga revolucioni, se kjo krahinë është strategjike, është një kala natyrale...»

Kur hyri Mato Gruda me një jorgan të vjetër nën sqetull, e gjeti Auguston të mbështetur në top.

— Të flihet?

— Jo!

— Na, mbuloje Haufmanin! — tha Mato Gruda dhe ia dha jorganin Augustos.

Augustoja i hutuar e hapi jorganin dhe e mbuloi tytën e topit. Pjesën tjetër të rrobës ia hodhi mekanizmit të shkrepjes. Mato Gruda shikonte. «Hë, e mbuluam si një kalë të dërsirë. Edhe mushkën, kur dërsin, kështu e mbuloj unë, me velenxë» — tha Mato Gruda me vete dhe qeshi.

— A nuk të duket si kalë, Agush? — pyeti ai italianin.

Augustoja u largua pak dhe e vështroi topin. Pa kthyer kokën nga i zoti i shtëpisë, tha:

— Mato ka imaxhinato!

— Çështë kjo maxhinato?

— Si ta themi, përfytyrim, pjell mendja... — tha Augustoja duke qeshur. — Si kali, Mato, si kali...

Mato Gruda ngriti cepin e jorganit dhe uli kokën nën grykën e topit, sikur të shikonte qafën e kalit.

— Jorgani të lidhet me litar pas tytës e pas mekanizmit të shkrepjes, në mënyrë që të rrijë i puthitur, — tha ai.

«Njeri rigoroz dhe këmbëngulës» — mendoi italianin.

— A? Nuk them mirë? — pyeti Mato Gruda.

— Mirë!

— E gjejmë litarin!

Mato Gruda hapi derën dhe shkoi të kërkonte litarin, ndërsa italianin përsëri u mbështet në topin e mbuluar. Eh, Salvatore, miku im! Me siguri ti do të kishe për të shkruar një roman. Po ti nuk di asgjë. Ky njeri me këtë top ka për të hyrë në historinë e vendit. Po të shpëtojme, ne kemi për ta parë në ndonjë muze. Atje Mato Gruda do të ketë shënuar edhe emrin tim. Ndoshta... Por mundet që edhe Mato Gruda, edhe unë, edhe topi të zhdukemi...» — tha Augustoja me vete.

— Lidhe! — u dëgjua nga pas zëri i Mato Grudës, duke i zgjatur litarin.

Augustoja e mbështolli jorganin pas tytës së topit

dhe e lidhi me litar. Pastaj e lidhi edhe mekanizmin e shkrepjes. Topi tani i ngjante një kafshe me qafë të gjatë pa kokë.

— Fli edhe pak nën jorgan, o babaxhan, fli! — tha Mato Gruda.

Italiani e vështroi të zotin. Këtë radhë ai iu duk akoma më enigmatik, akoma më i pakuptueshëm.

— Augusto! — tha Mato Gruda me një zë solemn.

Augustoja u drodh. Ai kurrë nuk e kishte dëgjuar Mato Grudën t'i fliste me emrin e vërtetë, por të shqijpëruar «Agush»

«Kjo do të jetë ndonjë gjë me rëndësi» — mendoi ai.

— Augusto! — përsëriti Mato Gruda.

— Po!

— E ke bërë betimin ushtarak?

Augustoja ngriu. «Ç'kërkon ky njeri nga unë? Ç'janë këto të papritura, si metaforat e Marinetit?» — tha ai me vete.

— Betimin ushtarak, them! — përsëriti Mato Gruda me zërin e tij solemn.

— Po! — tha Augustoja.

— Harroje atë betim, — tha Mato Gruda.

— E kam harruar!

— Ti atë betim ia ke bërë Duçes. Ti do të bësh një betim tjetër, që s'duhet ta harrosh! — tha Mato Gruda.

Të dy ranë në heshtje, si para një teoreme që kërkon përqëndrim të vëmendjes para se të vërtetohet.

— Augusto, vëre dorën mbi tytën e topit. Vëre mbi dorën time, — tha Mato Gruda.

Augustoja shtriu dorën mbi grykën e topit. Zemra ia godiste dërrasën e gjoksit si me çekan.

— Betohu! — tha Mato Gruda dhe filloi: — «Betohem para njeriut që më mbajti me bukë para gjëmës së madhe. Betohem para këtij njeriu dhe njerëzve të tjerë që s'janë këtu. Betohem para nënës qyqare që është në Itali. Betohem para këtij trualli të huaj, që m'u bë dyshek e jorgan. Betohem që, edhe sikur të ma bëjnë copën e mishit sa të veshit, do të jem besnik i Mato Grudës dhe nuk do të tregoj asgjë edhe sikur të heq të

këqijat e skëtërrës. Beto hem që nuk do të kallëzoi as për topin dhe as për gjë. Po e shkela betimin, do të pres dënimin më të madh që ka parë e ka dëgjuar njeriu i kësaj bote. Beto hem!»

Italiani përsëriste betimin i verdhë dyllë në fytyrë. Duke folur, atij i dridheshin buzët.

— Edhe një herë! — tha Mato Gruda. — «Beto hem para njeriut...

— «Beto hem para njeriut...» — përsëriti italiani.

— Augusto, pse të dridhen buzët? — pyeti Mato Gruda i vrenjtur.

Augustoja u hutua:

— Moment solemn, — tha ai.

— Ti duhet ta mësosh përmendsh këtë betim, — tha Mato Gruda.

— Ta shkruaj. Harroj kështu. — tha Augustoja.

— Ta shkruash! — tha Mato Gruda.

— Lapsi, letra në odë.

— Shko merri!

Italiani i çakërdisur hapi derën dhe doli.

— Kështu, Haufman, — i tha Mato Gruda topit, — ti nuk ngrin e nuk lagesh tani, se je i mbuluar. Kur të të thërres unë, ti do të zbulohesh dhe do të dalësh në oborr. Atëherë do ta marrë vesh bota se ç'do të bëjmë ne të dy!

Kur hyri italiani në kolibe, e gjeti Mato Grudën duke folur me topin. Tek dëgjoji, për pak sa i ra lapsi nga dora.

— Flet topit? — pyeti ai me habi.

— Atë e di unë! — tha Mato Gruda.

— Shkruaj unë betimi?

— Shkruaj; «Beto hem para njeriut...»

Augustoja shkruante dhe Mato Gruda i ndriste me kandil. duke i diktuar. Çatia e kolibes kërciste nga shiu. Era godiste muret.

Sa mbaroi së shkruari italiani, Mato Gruda tha:

— Ta mësosh përmendsh!

— Ç'qëllim ka Mato? — pyeti Augustoja me laps e letër në dorë.

I zoti i shtëpisë nuk u përgjigj.

Ata dolën nga kolibja. Italiani shkoi në odën e vet, Mato Gruda u ngjit lart te fëmijët.

Ende nuk kishte zbardhëlluar mëngjesi. Shiu rridhte e rridhte. Të gjithë flinin. Mato Gruda ndezi cigaren. Tek pinte duhan, i erdhi në mend Murati. «Ku do të jetë vallë? Ai sikur kishte ndër mend të vinte e të flinte mbrëmë në shtëpinë time.»

Ai kujtoi porosinë e Muratit për bukën e partizanëve. «Më tha t'i ngarkoj mushkat e t'i shpie në batalion... Të zinjte, s'kanë bukë. Muratit kushedi ç'i ka ndodhur! Edhe ato gjylet e mia sollën shumë ngatërresa... Do të shkoj t'u shpie bukë. Do ta marr me vete edhe italianin.»

Mato Gruda u ul pranë dritares. Prapa xhameve ishte errësirë. «Sikur të vij në fshat gjermanët, kushedi se ç'do të bëjnë!» — tha ai me vete.

Italiani në odën e tij lexonte betimin nën dritën e kandilit. E linte mënjanë dhe qeshte me vete: «Të betohesh para një njeriu, si para një ushtrie a organizate? Ç'i thonë kësaj?»

Ai mori nga çanta një fletore të trashë me kapakë lëkure. E hapi dhe e vështroi i menduar.

«Salvatore, — tha ai me vete — unë, megjithëse nuk di të shkruaj, po shënoj në këtë fletore historinë time, të Mato Grudës dhe të topit. Po e shënoj që të ta jap ty dhe ti të shkruash një roman.»

Augostoja filloi të shkruante. Shiu godiste xhamet...

KAPITULLI I TETËMBËDHJETË

Shiu nuk binte me atë rrëmbimin e mëparshëm. Ai tani vinte i imtë, si mielli që bie nga një sitë nisesh-teje. Mato Gruda vazhdonte të rrinte në dritare i menduar. Atë e shqetësonte porosia që i kishte lënë Murati: Të ngarkonte dy mushkat dhe të shkonte bashkë me Per-tefin prapa majës së Kokallës. Por shiu i imtë vazhdonte të binte. Rrugët duhej të ishin me baltë dhe përrenjtë të pakapërcyeshëm. E shqetësonte edhe vonesa e Muratit. Meqë ai nuk u kthye të flinte në shtëpi, mendja i vente në të keqen. «Mos i kanë ngritur ndonjë kurth Fizët? Mos ua ka mbushur mendjen stërnipërve plaku Mere dhe ata ia kanë hedhur fajin Muratit për të shtënat e asaj nate?»

Po të kishte ndodhur kjo, atëherë Mato Gruda që sonte mbrëma do t'ia hiqte jorganin Haufmanit, do t'i bënte shkumb e hi Fizët dhe do të dilte me partizanët.

Ai u ngrit. Hoqi nga gozhda bërrucin e zi dhe u mat të dilte. Në këtë kohë dëgjoi zërin e Zarës.

— Mato, ku shkon?

— Në mal, — tha ai.

— Do t'u shpiësh bukë atyre?

— Bukë. Mund të vonohem! — tha ai.

Zara kishte dëshirë që i shoqi të lidhej sa më shpejt me malin dhe të ftohej dalngadalë me topin. Bile do ta përcillte partizan duke kënduar. Ndoshta se në shtëpinë e tyre vinte shpesh Murati, i cili ishte një nga partizanët më të vjetër, tek ajo kishte lindur një dashuri e pakup-

tueshme për ata njerëz që rrinin maleve dhe luftonin me një mbretëri të madhe pa pasur as drojtje, as frikë. Gjithë partizanët asaj i dukeshin si Murati: të urtë, të respektuar, të mbushur me një dashuri të madhe për vatanin. A nga zilia e një gruaje, a nga dëshira për t'ia hequr nga mendja topin, a nga të tria së bashku, ajo donte që edhe burri i saj të ishte një partizan si Murati, i mençur dhe i mirë.

— Po prit, Mato, të të ziej nja dy vezë t'i marrësh me vete, — tha ajo.

— Mirë thua. Ziej edhe dy të tjera për italianin, — tha ai.

— Edhe Agushin do ta marrësh?

— Doemos! — tha Mato Gruda. — Ti bëji gati vezët, bukën e djathin, sa t'i them Agushit të pregatitet për udhë.

Kur mori të zbriste shkallët, ai u kujtua:

— Halla si është?

— Keq! — tha Zara. — Kam frikë sa të kthehesh ti...

Mato Gruda psherëtiu:

— Si e kapi përnjëherësh kjo drej sëmundje!

— Eh, ja! E shoh nga sytë që s'është mirë. Ka një vështrim të lig. Më kujton atë mehrumkën, nënën time. Një javë para se të vdiste kështu vështronte... — tha Zara.

— E, moj, se mund të mos ketë gjë... — tha Mato Gruda dhe zbriti shkallët.

Dritarja e vogël e odës së errët të italianit ndriçonte, megjithëse ishte mëngjes. «Ç'bën ky? Tuhaf njeri! Mos mëson përmendsh që sot betimin?» — tha ai me vete.

Ai trokiti në derë:

— Agush, hape!

Augustoja e hapi derën. Mato Grudës i ra përnjëherësh në sy fletorja e trashë në fronin e vogël dhe çanta e hapur e italianit pas krevatit prej dërrase.

— Ç'bën, Agush?

— Shkruaj! — tha Augustoja.

— E çfarë shkruan?

— Historinë time, — tha ai.

— Mirë bën! Historirat duhen shkruar, — tha Mato Gruda i menduar. — Edhe unë, po të dija të shkruaja mirë, do t'i çuditja të gjithë. Di ca gjëra unë, o Agush vëllai, që as ti, as italiani më i mençëm nuk i keni parë as në ëndërr. Çilin keni ju italianin më të mençëm? Italiani nuk e kuptoi mirë pyetjen.

— A?

— Ja, ne, ta zëmë, kemi shqiptarin me të kënduar Naim Frashërin. Kemi edhe Ismail Qemalin...

— A, kuptova. Ne kemi Dante Aligerin, — tha italiani duke qeshur.

— E, që thua ti, as ky Danti nuk i ka parë në ëndërr ato historira që di unë, — tha Mato Gruda dhe u ul në krevatin e italianit. — Eh, more Agush! — psherëtiu ai.

Italiani e vështroi Mato Grudën dhe para tij u hap bota e një njeriu tjetër nga ai që kishte njohur gjer atëherë. «Mato Gruda është botë më vete» — mendoi ai me naivitet.

Mato Gruda zgjati dorën dhe mori fletoren e italianit. E shfletoi ngadalë, i afroi sytë në shkronjat e asaj gjuhe të pakuptueshme dhe tundi kokën me keqardhje:

— Evropa shkruan. Ne mezi bëjmë dy kërraba. Edhe unë vjedhurazi kam mësuar të bëj dy-tri kërraba në letër. Eh, more të uruar!

— S'ke faj, Mato. Gjithë vendi ka mbetur në errë-rë, — tha italiani.

— Ja, një takëm si ju na keni lënë në errë-sirë, — tha Mato Gruda i vrenjtur, sikur tërë fajin ta kishte Augustoja.

Augustoja uli sytë:

— Okupimi i osmanëve la errë-sirë, — tha italiani.

Mato Gruda buzëqeshi hidhur:

— Pse, zotrote, ç'bërë? S'e sheh? E mbushe me shkolla!... Demek erdhe të hapësh shkolla!...

Italiani heshti. Mato Gruda vuri re se Augustoja u skuq dhe nuk e zgjati më tutje. Mato Gruda ishte njeri i mençëm nga natyra. Të gjitha gjërat që dëgjonte, i regjistronte në ndërgjegjen e tij dhe papritur, kur binte

fjala, i thoshte me përpunimin e vet të ri. Njerëzit, kur e dëgjonin të thoshte ndonjë gjë të papritur, hapnin sytë. Ata thoshin se këtë virtyt e kishte trashëguar nga gjyshi Hysen.

— Mato, — tha italiani pas heshtjes, — ti je burrë me mendje...

Mato Gruda nuk ia vuri veshin. U ngrit nga krevati dhe e la fletoren në fronin e vogël.

— Agush, vishu mirë, se do të shkojmë!

— Ku? — pyeti italiani.

— Në mal. Do të kemi pak punë me partizanët...

Augustoja e vështroi drejt e në sy të zotin, sikur donte të zbulonte ndonjë sekret. «Prandaj më vuri të bëj betimin, — mendoj ai — se duhet të ketë plane. Me siguri shkon të marrë udhëzime!...»

— Vish gunën dhe vër qeleshen, — tha Mato Gruda, duke i hedhur një vështrim gunës që varej në gozhdë.

Italiani mbathi këpucët dhe zhvari nga gozhda gunën.

— Kur kthehem? — pyeti Augustoja.

— Mundet edhe sonte.

Ata dolën në hajat. Mato Gruda i thirri gruas të sillte torbën me ushqime.

— Shko e nxirr mushkën, Agush, — e urdhëroi Mato Gruda italianin dhe vetë qëndroi në hajat.

Zara po vonohej, Matoja priste e pinte duhan. Hajati ende ishte i errët. Mato Gruda ecte poshtë e lart truallit dhe mendonte. Kishte për të bërë një udhë të gjatë në një kohë të vështirë. Përpjekja e partizanëve me gjermanët mund ta zinte në mes të rrugës dhe të gjendej ndërmjet dy zjarresh. Në këto çaste ai filloi të mendonte për gruan dhe fëmijët. «Po më ndodhi gjë, i mori lumi të zestë» — tha ai me vete.

Në shkallë u dëgjuan hapat e Zarës. Ajo mbante në dorë torbën e mbushur me bukë.

Mato Gruda, duke marrë torbën, i tha gruas të kish-te kujdes fëmijët dhe të hapte sytë, se mos ndodhte gjë me topin.

— Po të vonohem, mos u bëni merak! — tha ai dhe u nda nga gruaja.

Italiani e kishte nxjerrë mushkën nga porta dhe priste të zotín. Shiu ishte i imtë dhe i ftohtë.

— Na, Agush, vare në mushkë! — i tha Mato Gruda dhe ia dha torbën.

— Hapni sytë, Mato! — thirri gruaja te pragu i portës, kur ata morën rrugicën tatëpjetë. Dëgjoheshin vetëm thundrat e mushkës. Të dy ecnin të heshtur.

Sipas porosisë së Muratit, Mato Gruda duhej të shkonte në shtëpinë e Pertefit, se atje ishte grumbulluar buka dhe priste mushka e Muratit. Pastaj, që andej, bashkë me Pertefin, do të niseshin për në mal.

Duke ecur, ata dëgjuan gulçimin e qenit.

«E ka lëshuar Zara — mendoi Mato Gruda. — Kujton se qeni do të na mbrojë nga rreziku.»

— Hajde, Balo! — i tha ai qenit.

Baloja doli përpara.

Mëngjesi ishte i ftohtë dhe i lagët. Udha ishte plot me pellgje e në mes të gurëve kishte baltë e llucë.

— Larg shkojmë, Mato? — pyeti italiani.

— Larg.

Përsëri pushuan.

Në grykë të përroit kishte rënë mjegulla dhe shtëpia e Fizëve nuk dukej. Pranë saj kalonte udha për në Kokallë. Mato Gruda solli në mend plakun Mere dhe pështyu:

— Tfu! Dreq!

— A, Mato? — pyeti Augustoja.

— Asgjë!

Kur arritën te porta e shtëpisë së Pertefit, shiu i imtë pushoi. Ata qëndruan pak dhe mbajtën vesh. Asgjë nuk dëgjohej.

Mato Gruda mori një gur dhe trokiti në portë. Nga brenda u dëgjua zëri i një gruaje.

— Hape, jam Mato Gruda!

E kunata e Pertefit, gruaja e Nevzatit, e hollë, me gërsheta të zinj, e pashme, e hapi portën dhe u përshëndet me të dy burrat.

— Pertefi u ngrit? — pyeti Mato Gruda.

— Pertefi që dje ka ikur me Muratin. Jemi bërë merak, se nuk e dimë ç'u ka ndodhur, — tha ajo.

Mato Grudës i vajti mendja për keq. Edhe ai e prishte Muratin të kthehej, po gjurmët e tij kishin humbur.

— Ndoshta u ka dalë ndonjë punë! — tha Mato Gruda për ta qetësuar.

— Kur erdhi Murati dje, llafoseshin me zë të ulët dhe ishin të dëshpëruar. Flitnin për një mbledhje — tha gruaja.

— Kushedi ç'hall kanë pasur! — tha Mato Gruda.

— Më duket se gjermanët janë afër, — tha ajo e shqetësuar.

— La Murati ndonjë amanet për mua?

— Të ngarkosh mushkat e të shkosh përtej Koka-llës, — tha ajo.

Mato Gruda dhe italiani hynë në oborr. Gruaja shkoi në ahur për të nxjerrë mushkën e Muratit. Augustoja ishte kërrusur dhe dukej sikur mezi e mbante peshën e gunës së murme.

— Gruaja tha vijnë gjermanët, — tha ai.

— Llafë grash! — e qetësoi Mato Gruda.

E kunata e Pertefit doli nga ahuri me mushkën për kapistalli.

— Bukët janë gati? — pyeti Mato Gruda.

— Kemi mbushur katër thasë, — tha ajo.

Të dy me italianin ata hynë në hajat. Pas murit ishin mbështetur katër thasë me gryka të qepura me spango. Të heshtur ata zunë njërin nga thasët dhe e vunë në samarin e mushkës së Muratit. Si i lidhën, i thanë gruas të mbante anën e barrës, sa të merrnin thesin tjetër.

Auguston e pengonte guna. E zhveshi dhe e hodhi në sofat.

Me t'i ngarkuar mushkat, gruaja u tha të pritnin pak, se do t'u jepte një plaçkë të vogël. Mato Gruda e kuptoi. «Do t'i dërgojë burrit ndonjë palë çorape, e zezë» — tha ai me vete.

— Është e shoqja e Nevzatit, e një partizani, — ia shpjegoi Mato Gruda italianit.

— A, bukur! — tha Augustoja.

— Po ti ç'më rri kështu? Pse s'e merr gunën? —
Shfryu Mato Gruda.

— U, harroj! — tha Augustoja dhe u drejtua në sofatin, ku kishte hedhur gunën.

Gruaja doli me një bohçe me plaçka në dorë. Ngadalë, me një zë që shprehte dhembje e vuajtje, ajo ia zgjati bohçen Mato Grudës.

— Shpjerja Nevzatit, Mato! Kam ca çorape e një fanelë leshi. Po vjen dimri dhe ai është i zhveshur, — tha ajo.

— Mirë, mos ki merak! — tha Mato Gruda.

Ata dolën para mushkave, i kapën për kapistalli dhe u nisën për udhë. Shiu vërtet kishte pushuar, por frynte një erë e ftohtë, që të kujtonte dëborën. Mato Gruda e ndiente se kjo erë së shpejti do të sillte dëborën. Dhe ra në mendime për dimrin me furtunë e të ftohtë. Ai ende nuk i kishte prerë të gjitha drutë, që i duheshin për dimrin e gjatë dhe filloi të shante me vete topin: «Më la pa punë Haufmani i mallëkuar!»

Udha filloi të ngjitej në grykë të përroit pranë shtëpive të Fizëve. Mjegulla tanimë ishte larguar. Italiani u hodhi një vështrim shtëpive e tha:

— Topi këtej goditi!

— Pusho! — ia preu Mato Gruda, se pati frikë mos e dëgjonte ndonjë nga Fizët.

Në oborr të Fizëve nxinte hiri i mullarit të djegur. Xhamet e dritareve ishin të thyera. Mato Gruda ecte e shikonte. «Për tri-katër metra kanë shpëtuar. Breh, breh! Mu në çati do të binin!» — tha me vete, duke kujtuar të shtënat e asaj nate.

— Mullari djegur, Mato! — tha italiani.

Mato Gruda e la mushkën të shkonte vetëm dhe priti Auguston.

— Lidhja në kocaqe kapistallin. Shkon pas së parës! — i tha italianit.

Të dyjat mushkat ecnin njëra pas tjetrës. Përpara shkonte qeni.

— Mullari djegur!... — tregoi italianin.

— Po rri, more malum, se na dëgjojnë! — ia shtrëngoi grushtet Mato Gruda.

Në këtë kohë në oborr të Fizëve u dëgjua një kollë e thatë dhe pas pak që prapa qyomezit doli plaku Mere. Ai u hodhi një vështrim të ftohtë udhëtarëve dhe mushkave dhe u kollit përsëri.

— Plaku! — tha italiani ngadalë.

— Shsht!

Plaku Mere nuk u foli. I ndoqi me sy dhe u drejtua nga hajati, duke murmuritur disa fjalë pa kuptim.

Mushkat ngjiteshin në të përpjetën e këmbëve të Kokallës, duke shkelur në pellgjet me ujë e në gurët e zinj. Spërckat e ujit të ndyrë të baltës u binin në bark dhe në qafë. Mato Gruda dhe Augustoja i kishin zhveshur gunat dhe i kishin vënë në samarët e mushkave mbi thasët me bukë.

Ata u ngjitën në grykë të përroit dhe u kthyen nga krahu i majtë i Kokallës. Gjysmë ore larg tyre gjarpëronte xhadeja qendrore, e cila e linte në krah të majtë Kokallën dhe futej në luginën atje mbi koriye; i afrohej fshatit të Mato Grudës, pastaj vinte duke u larguar gjithnjë e më shumë. Kjo rrugë shkonte për në Dibër të Madhe. Shpesh nëpër kthesat e saj do të gjeje makina të djegura, të përmbysura poshtë shkëmbinjve. Partizanët u zinin prita autokolonave dhe lëvizja nëpër të ishte vështirësuar.

— Në pranverën që shkoi, atje u dogjën pesë makina italiane dhe u vra një majori juaj, — i tha Mato Gruda italianit, duke bërë me kokë nga xhadeja.

— E di, — tha Augustoja, — shumë italianë rob...

— Edhë gjermanët këtej kalojnë, — tha Mato Gruda.

— Gjermani djeg fshatra, po dogje makina, — tha Augustoja.

— Ah jo, more, nuk ke ç'të bësh me të djegur! — tha Mato Gruda.

— Tremb popullatën, — tha italiani.

— Pak dogji ushtria juaj? Mbetët rrugëve, — tha Mato Gruda.

Mushkat u futën në pyllin me ahe të zhveshura. Filloi balta e zezë e ahishtës. Këmbët e kafshëve hynin gjer në gju. Balta bënte atë zhurmën e mbytlur të brumit, kur gatuhen bukët e furrës: «Pllac-plluc, pllac-plluc...»

— Ku janë partizanët? — pyeti Augustoja.

— Janë akoma larg, — tha Mato Gruda.

— Ti, Mato, komunist? — pyeti papritur Augustoja.

Mato Gruda për një çast qëndroi. Pyetja e italianit iu duk e çuditshme, iu duk një pyetje prej një karafili, siç thosh ai vetë. «Sheh ndonjë gjë prej komunisti tek unë ky fyell?» — mendoi ai.

— Komunist? — pyeti Augustoja.

— Atë e di unë! — u përgjigj Mato Gruda pa dashur t'i jepte shpjegim.

Po dilnin nga pylli, kur papritur dëgjuan një fërshëllimë të mprehtë. Të dy qëndruan. Edhe mushkat qëndruan. Geni filloi të lehte. Mato Gruda i thirri të pushonte. Augustoja e vështroi Mato Grudën, si për të kërkuar mbrojtje.

— Kush? — pyeti italiani.

— Tanët, janë tanët, — tha Mato Gruda, duke mbajtur vesh.

Pylli ishte i qetë. Asgjë nuk pipëtinte pas fërshëllimës. Qe prapa aheve të trasha dolën katër vetë të armatosur.

— Nga vini? — pyeti njëri.

— Murati na dërgoi! — u përgjigj Mato Gruda.

— Hajdeni, shokë, hajdeni, — thirri tjetri.

Mushkat filluan të ecnin përsëri nëpër baltën e ahishtës. Mato Gruda dhe italiani ishin djersirë, prandaj hoqën gunat nga samarët e kafshëve dhe i hodhën krahëve.

Të katër partizanët u dolën përpara dhe i zunë për dore.

— Këtej, shokë! — bëri njëri me kokë në të majtë të udhës.

Italiani e kapi mushkën e tij për kapistalli dhe shkoi pas partizanit. Mushka e Mato Grudës ndoqi të parën. Tani ata ecnin nëpër pyll pa rrugë. Fletët e vjetra, të

shtruara palë-palë në tokën e zezë, ishin si një dyshek i madh. Ky dyshek lëkundej nga këmbët e mushkave dhe të njerëzve.

— E di fshati se së shpejti vijnë gjermanët dhe ballistët? — pyeti partizani.

— Po! — tha Mato Gruda dhe mendja i shkoi menjëherë në shtëpi. «Qenka e sigurt!»

— Kur keni dalë nga fshati? — pyeti përsëri partizani.

— Që sa u gdhi, — tha Mato Gruda.

Mato Gruda e kuptoi se ky djalosh i imtë me pak mustaqe nën hundë, do të ishte komandanti.

Komandanti kafshoi cepin e mustaqeve. Ai u hodhi një vështrim Mato Grudës dhe italianit.

— Ju i boshatisët shtëpitë tuaja? — pyeti ai.

— Jo!

Komandanti për një çast heshti. Ai diçka mendoi i shqetësuar.

— Duhej t'i kishit boshatisur. Gjermanët mund të djegin edhe fshatin, — tha ai pas heshtjes.

— Murat Shtaga këtu është? — pyeti Matoja.

— Ç'e ke Muratin?

— Fshatar.

— Këtu është, — dhe komandanti psherëtiu.

— Pse psherëtin? — pyeti Mato Gruda dhe u mundua të buzëqeshte.

— Ngatërresa të mëdha ka nxjerrë fshati juaj. Rrallë ndodhin ngatërresa të tilla... — tha komandanti.

Mato Gruda nuk foli. Italiani mbante sytë për dhë.

Në pyll filloi të frynte një erë e ftohtë. Qielli u hap dhe të gjitha retë u shpërndanë.

Mushkat iu afruan një shkëmbi të madh që ngrihej më të dalë të pyllit. Në shkëmb ishte një guvë e gjerë, sa mund të hynje një tufë e tërë me dhen. Në guvë dilte tym. Rreth një zjarri ngroheshin partizanët. Sa i panë mushkat dhe dy të ardhurit, ata u ngritën.

— Erdhi buka, shokë!

Mato Gruda njohu mes tyre Nevzatin. I gjatë dhe i dobët, ai iu afrua Matos dhe e përqafoi.

— Mirë se ardhë, Mato! Si je? Si i kam unë andej nga shtëpia?

— Mirë, mirë! Të fala. Gruaja jote më dha ca plaçka, — tha Mato Gruda dhe hoqi nga samari bohçen e vogël.

Nevzati e mori, e vërtiti nëpër duar dhe buzëqeshi. Bohçja me plaçka i kujtoi gruan e shtëpinë, i kujtoi tymin në oxhak e zjarrin në vatër. Ai ngriti kokën dhe vuri re italianin:

— A, miku im! Augusto! — thirri ai.

Augustoja e njohu. Nevzati e shpuri atë për herë të parë te Mato Gruda.

— Mirëdita, Nevzati! — tha italianin dhe e zuri për dore.

Partizanët i shkarkuan mushkat dhe i vunë thasët në guvë. Pastaj e ftuan Mato Grudën dhe Auguston të rrinin me ta e të ngroheshin. Zjarri ishte i madh dhe tymin vërtitej në tavanin prej shkëmbi në shpellën e gjerë dhe dilte nga gryka. Italianit i digjnin sytë dhe i fërkonte me dorë.

Komandanti i partizanëve rrinte në krah të Mato Grudës dhe shikonte zjarrin.

Pas pak, në sfondin e drurëve të pyllit, nëpër tymin që dilte nga gryka e shpellës, Mato Gruda vuri re dy njerëz tek afroreshin. Ai i njohu. Ishin Murat Shtaga, dhe i dërguari Xhabir. Partizanët shikuan njëri-tjetrin.

— I dërguari Xhabir...

Komandanti u ngrit më këmbë.

— Hajde ngrohuni, shoku Xhabir!

I dërguari Xhabir nuk foli.

— Rrini, rrini! — tha Murat Shtaga.

— Murat! — thirri Mato Gruda.

Murati dëgjoi zërin e njohur dhe u afrua. Ai i zuri për dore Maton dhe italianin, i pyeti për shëndetin dhe shkoi përsëri pranë të dërguarit Xhabir. Faqet i kishin hyrë në mes të nofullave dhe, kur qeshte, dhëmbët i dukeshin si të vënë. Fytyra e dobësuar tregonte për andralat e për netët pa gjumë.

KAPITULLI I NËNTËMBËDHJETË

Mato Gruda, kur e takoi Murat Shtagën në shpellë, e pa se vetëm ishte i dobësuar. Asgjë më tepër nuk dinte dhe as që mund ta dinte, sepse gjithçka ishte sekrete. Asgjë nuk dinin edhe partizanët e batalionit. E dinin vetëm komisarri, zëvendëskomisarri dhe komandanti i batalionit, i dërguari Xhabir dhe domosdo edhe Murat Shtaga.

Pas plasjeve të gjyleve në oborrin e shtëpisë së Fizëve, në qarkor u nisën pesë veta nga fshati Arun, në formë të një delegacioni. Këta pesë veta në përgjithësi ishin njerëz të ndershëm, ishin nga ata që ne i quajmë fshatarë të thjeshtë. Me ta ishte edhe një nga stërnipërit e plakut Mere, Veseli. Ata u takuan me Kiun, njërin nga shokët e rëndësishëm të qarkorit, dhe nisën të tregonin historinë e dy të shtënave të asaj nate. Treguan me hollësi edhe për mbledhjen që pati bërë Tosun Baçi te sheshi i xhamisë. Nga ata qarkori mësoi gjendjen e shqetësuar dhe përçarëse të krijuar në fshatin Arun. Qarkori i pyeti se ku dyshonin jo vetëm fshatarët, po edhe delegacioni vetë. Atëherë u ngrit Pertef Maruka, që ishte edhe si kryetar i pazgjedhur i këtij delegacioni, dhe tha:

— Unë në mbledhjen që bëri Tosun Baçi

nëpër odë. — Dreqi ta marrë! Provokimet janë të rrezikshme. Përhapen si rrufeja në tërë krahinën. Nuk është puna vetëm e një fshati.

Kiu hapi derën dhe i tha një partizani ta thërriste shokun Xhabir.

Pas pak në odë hyri shoku Xhabir me vetulla të varura.

— Ti e di, shoku Xhabir. Bashkë me Muratin që sot do të shkoni në batalion.

I dërguari Xhabir ktheu sytë nga Murati dhe ia zgjati dorën ftohtë.

— Çështja të zgjidhet medoemos! — i tha shoku Ki.

Ata me Muratin dolën. I dërguari Xhabir mori me vete pushkën dhe u nisën për udhë. Megjithëse e njihnin mirë shoku-shokun, tani qëndronin të ftohtë dhe tek-tuk këmbenin ndonjë fjalë të rallë. Shoku Xhabir ishte si një re e zezë. Dukej sikur ishte i zemëruar me tërë botën, edhe me veten e vet. Ky udhëtim atij nuk i pëlqente. Në këtë udhëtim kishte diçka të keqe. Atij nuk i erdhi mirë që shoku Ki të dërgonte njerëz për të bërë hetime në batalion. Kjo nuk shkonte. Batalionin e kishin vënë në shenjestër armiqtë, tani po e vinin në shenjestër edhe të vetët, dhe ne. «Shoku Ki mund të thërriste komisarin e batalionit dhe të sqarohej me të; ç'ngarkon një të tretë për hetime? Ç'më ngarkon mua?» — mendoi shoku Xhabir duke ecur. Por ai nuk kishte ç'të bënte. Detyrën do ta kryente me gjakftohtësi, pastaj do të shprehte mendimet e veta në qarkor për veprimin e shokut Ki. Këto mendime, këto lëkundje shoku Xhabir nuk mund t'ia thoshte asnjëri, përveçse qarkorit. Bile edhe në Shtabin e Përgjithshëm të Ushtrisë Nacionalçlirimtare do të shkonte nëse do ta shih-te të arsyeshme...

Pesë orë ecën më këmbë nëpër ujëra e bal-

tëra, nëpër driza e dushqe dhe më në fund arritën në batalion. Batalioni ishte në pyllin larg xhadesë.

Në batalion ata u takuan me komandantin dhe komisarin. Këta ishin të dy djem të rinj.

— Ka tri ditë që presim dhe gjermanët s'po vijnë, — tha komisarri.

Ka informata se gjermanët nuk do të kalojnë këtej gjatë kësaj jave. Ne do të zbresim në baza në fshatin më të afërt. Kur të erret, do të zbrehim, — tha i dërguari Xhabir.

Duke i rënë shkurt çështjes së situatës së armikut, i dërguari Xhabir u tha atyre se ai dhe Murat Shtaga ishin ngarkuar nga qarkori për të shkoqitur një punë të rëndësishme.

— Të shkojmë në ndonjë qoshe, — tha ai.

— Shkojmë në kasolle, — tha komandanti.

Kasollja ishte e vogël, e thurur me purteka dhe e mbuluar me kashtë. Të katër hynë brenda. I dërguari Xhabir u kujtua:

— Thirreni dhe zëvendëskomisarri!

Komisari dhe komandanti vështruan Murat Shtagën, si për të pyetur «ç'është kështu?»

— Thirreni, thirreni! — urdhëroi i dërguari Xhabir.

Atëherë u ngrit komisarri dhe doli nga kolibja. Ata që mbetën, heshtnin. Murat Shtaga mendonte për hijen e rëndë të të dërguarit Xhabir. «Ky gjithnjë i tillë ka qenë», — tha me vete ai.

Në kolibe erdhi komisarri dhe pas tij zëvendësi. Ai i zuri për dore dhe u ul pranë komandantit. Ishte më i vjetër nga ata në moshë dhe mbante një kapelë me strehë.

I dërguari Xhabir i vrenjtur, me vetulla të trasha e me fytyrë katrore, mbante duart pas shpine dhe qëndronte më këmbë. Të gjithë pritnin se ç'do të thoshte:

— Para një jave qëlloi me mortajë batalioni juaj në fshatin Arun? — pyeti ai.

Ata të tre shikuan njëri-tjetrin.

— Nuk të kuptuam, — tha zëvendëskomisari i parruar me një puçërr të kuqe në faqe.

— Nuk është pyetje filozofike. Qëlluat me mortajë para një jave fshatin Arun?

— Jo! — tha komandanti.

— Dhe në asnjë fshat nuk kemi qëlluar me mortajë, — tha komisari.

— Nuk keni qëlluar! — tha i dërguari Xhabir dhe ia nguli sytë zëvendëskomisarit.

— Po na fyeri, — tha qetë zëvendëskomisari.

— Për gjylet që ranë në shtëpinë e Fizëve në fshatin Arun keni dëgjuar? — pyeti ai.

— Kemi dëgjuar. Edhe për ngatërresat e tjera kemi dëgjuar, — tha komisari.

— Në qarkor erdhi një delegacion nga fshati. Delegacioni erdhi me plot dyshime për batalionin. Vetë plaku Mere ka dërguar një letër në qarkor. — I dërguari Xhabir futi dorën në xhep dhe nxori letrën. — Ja se ç'thotë në letër: «Batalioni më goditi shtëpinë. Nuk ma merrte mendja që partizanët të djegin shtëpitë e njerëzve të pafajshëm. Stërnipërit e mi do të dilnin partizanë. Tani nuk dalin... Murat Shtaga u zu me mua dhe më qëlloi me top. Të keni turp!» — I dërguari Xhabir e palosi letrën dhe e futi në xhep.

— Është gënjeshtër, — tha komisari i batalionit.

— Ka qëlluar Tosun Baçi dhe shpif, — tha komandanti.

— Tosun Baçi nuk ka as topa, as mortaja, — tha i dërguari Xhabir.

Murat Shtaga nuk fliste. I dërguari Xhabir e vështroi i vrenjtur.

— Ke qenë në batalion para një jave ti, Murat?

— Gjithnjë unë vij në batalion. Edhe para

një jave mund të kem qenë, — tha Murat Shtaga tërë nerva.

I dërguari heshti për një çast. Ai nxori shaminë dhe fshiu djersët.

— Do ta zgjidhim, do ta zgjidhim, — tha ai. — Të mbledhim fakte nëpër batalion...

Këtu u ngrit zëvendëskomisarari, të cilit nga nervat i dridheshin duart. Në fytyrën e tij nuk dukej asnjë shenjë drite. Ishte një fytyrë krejt e zymtë.

— Më fal që ndërhyj. Në qoftë se ju dyshoni për ndonjë gjë, të mbledhim celulën e partisë të batalionit dhe atje parashtrojini kërkesat tuaja, — tha ai.

Shoku Xhabir e vështroi zëvendëskomisararin me keqardhje. Ai nga një anë i besonte këtij njeriu. Por nga ana tjetër kishte urdhër nga shoku Ki që të qartësonte megjullën e të shtënave të topit të padukshëm. Këtë urdhër ai duhej ta zbatonte. Në punë të tilla ai ishte fanatik. Por pastaj mund të polemizonte e të zihej me ata që jepnin urdhra. Edhe këtu në batalion ai do të kryente detyrën si ushtar dhe me tërë rreptësinë e tij do të gjurmonte ngado për të gjetur të vërtetën. Veç kësaj ai do të parashtronte mendimet e tij në qarkor. E quante krejt të padrejtë urdhrin e shokut Ki. Megjithatë mendimin e tij nuk mund t'ia shfaqte as zëvendëskomisararit, as komisarit dhe as komandantit, se nuk donte që ata të kujtonin se në qarkor mund të gabohesh. I dërguari Xhabir ishte i ashpër, por i drejtë. Zëvendëskomisarari atë po e kundërshtonte dhe po i thoshte të mblidhej celula e partisë në batalion.

— E mbledhim! — tha i dërguari. — Por kjo nuk do të thotë që unë të mos kërkoj fakte në batalion.

— Faktet mund t'i mblidhni, por, në fillim, çdo gjë t'u bëhet e njohur shokëve të partisë.

— Edhe atë që thua ti e bëjmë, — tha i dërguari Xhabir.

Pas këtyre fjalëve i dërguari e mbylli mbledhjen. Më vonë ai mblodhi celulën dhe të nesërmen filloi punën nëpër batalion.

Ai shkante nga një grup partizanësh në tjetrin. I mori mënjanë të katër mortajerët e batalionit dhe i pyeti nëse kishin ndonjë hasmëri të vjetër me shtëpinë e Fizëve. Por doli se ata as i njihnin Fizët, se ishin prej krahinave të tjera. Atëherë i dërguari filloi të mësonte gjithë biografisë e partizanëve të batalionit dhe u ndal më shumë te Murati e te Nevzati, meqë ata ishin nga fshati i Fizëve.

— Murati ka pasur një hasmëri të vjetër me Fizët, — i tha i dërguari komandantit.

— E pastaj? — tha komandanti.

— Besim dhe kontroll! — tha i dërguari Xhabir pa dhënë ndonjë shpjegim tjetër.

Komandanti u zemërua. Ai u zbeh në fytyrë dhe filluan t'i dridheshin duart. Balli iu mbulua me djersë të ftohta:

— Ju, ju... me gjithë mend dyshoni te Murati?

— E gjej të panevojshme ta përsërit: besim dhe kontroll! — tha i dërguari Xhabir, pa i lënë shteg komandantit për të menduar se me të vërtetë ai lëkundej.

— Kjo që bëni ju, më falni, nuk është sjellje prej komunisti! — tha komandanti me ballë të djersirë.

I dërguari qëndronte gjakftohtë me duar pra-pa shpine. Në dukje kuptohej sikur ai nuk e përfillte zemërimin e komandantit. Ky zemërim për të ishte diçka e zakonshme. Bile e kishte parashikuar që kur kishte ardhur në batalion se kështu do të ndodhte. Ai ishte njeri i zymtë dhe ishte vështirë të hyje në botën e tij të brendshme për të zbuluar diçka. Qëndronte mes njerëzve si një shkëmb. Murat Shtagën ai nuk e mbante gjithnjë

pranë, por e dërgonte për të verifikuar këtë apo atë problem që i dilte përpara.

— Unë do të ankohej gjer në Shtabin e Përgjithshëm, — tha komandanti.

— Shtëpia e një fshatari u qëllua dy herë me armë të rëndë. Në fshat u bë panik. Në krahinë u mor vesh. Në qark u mor vesh. Batalioni juaj ishte pranë kësaj shtëpie. Në shtabin e zonës u mor vesh. Në Shtabin e Përgjithshëm u mor vesh. Unë jam dërguar nga partia ta zbuloj këtë fshehtësi. Unë mbledh fakte. Shumë fakte formojnë një arsyetim. Unë faktet i mbledh pa zjarrllëk. I mbledh siç janë. Ulem, i bashkoj, i shoshit, nxjerr një arsyetim. Këtë arsyetim bashkë me faktet ia dërgoj shtabit. Ju këshilloj që edhe ju të bëni të njëjtën gjë. Kjo është si ajo llogaria. Ta bëjmë llogarinë. Na doli, mirë, s'na doli, mirë! Ti ke dyqind veta në batalion. Ku ta dish? Njërit i erdhi në majë të hundës, për arsye të ndonjë hakmarrjeje të vjetër, dhe qëlloi në shtëpinë e Fizëve! Pse nxehesh? Unë mbledh fakte. Unë nuk bërtas e nuk shaj. Lufta nuk e pranon fjalën «amin». Partizanët janë të mirë, «amin!» Po sikur të ketë hyrë mes partizanëve të tu ndonjë provokator? Mund të ndodhë kështu? Mund! Provokatori në batalionin N. na e vrau komisararin. Numërohej si shoku më i ngushtë i komisararit. E vrau duke pirë ujë. Ç'të thoshim ne atëherë? Mund të thoshim «amin»? Mbledhëm fakte, e zbuluam vrasësin. Besonte njeri që ai mund të ishte vrasësi? E? Unë mbledh fakte. Shumë fakte bëjnë një arsyetim, — përfundoi i dërguari Xhabir.

Komandanti pas këtyre fjalëve mbeti si i ngri-rë përpara të dërguarit. Zjarri i mëparshëm i tij u shua. I dërguari me gjakftohtësinë e tij e vuri në mendime.

— Por Murati e Nevzati nuk mund të kenë qëlluar... — belbëzoi ai.

— Unë nuk thashë se ata kanë qëlluar. Mbledh

fakte. Shoh, zbuloj. Besim dhe kontroll! — tha po me atë gjakftohtësi i dërguari Xhabir.

Komandanti hapi kutinë e duhanit dhe filloi të dridhte një cigare, megjithëse nuk i pihej. Ai e bëri këtë ngaqë i vinte vështirë të rrinte pa u marrë me diçka në sytë e këtij njeriu të çuditshëm e me karakter të rëndë. Ka njerëz, që me hijen e tyre të rreptë, të bëjnë të vuash e të mos dish se si t'i mbash duart. Kur ndodhesh para tyre, e ndien veten të paaftë të mendosh pa gjetur përkrahjen goftë edhe te një shkop i vogël në duar, apo te një fije bari në buzë.

Duke dredhur cigaren, komandanti mori zemër:

— Ju, shoku Xhabir, gjithnjë këtë rreptësi keni?

I dërguari nuk u dha rëndësi fjalëve të komandantit.

— Më thirrni Murat Shtagën, — tha ai.

Komandanti u largua dhe iu duk sikur u lehtësua nga një barrë e rëndë. Para këtij njeriu ai e ndiente veten ngushtë. Pylli i gjerë i dukej si një kotec.

«Njeri i vështirë» — tha ai me vete, duke ikur.

Pas pak e gjeti Muratin dhe i tha se duhej të shkonte tek i dërguari Xhabir. E vështroi me qëllim në fytyrë për të parë nëse do të trembej. Por Murati kishte në karakter diçka të përbashkët me të dërguarin Xhabir dhe e priti me gjakftohtësi lajmin e komandantit.

— I dërguari vepron sikur do të zbulojë ndonjë provokator në batalionin tonë, — tha komandanti pa ia ndarë sytë Muratit.

— Ka punën e vet. Provokimi duhet zbuluar! — tha Murati me gjakftohtësi.

— Edhe ti? — u habit komandanti.

— Puna që bën i dërguari nuk është e ndarë nga puna jonë. Hendek nuk i vihet. Veprimi i tij

nuk ka asgjë alarmante, — tha Murati dhe u nis për në kasolle.

Të dërguarin e gjeti me duar pas shpine. I zgjati një cigare, por ai nuk e mori.

— Do të shkojmë në fshatin tuaj. Do të vish me ne edhe ti. Ti ke pasur hasmëri me Fizët? — pyeti ai papritur.

— Unë s'kam pasur. Im atë ka pasur! — tha Murati gjakftohtë.

— Ti e kupton pse të pyes?

— E kuptoj. Ju dyshoni se mund t'i kem qëlluar unë Fizët, — tha Murati i qetë.

— Unë dyshoj. Por dyshimi dhe bindja ndahen. Dyshimi kalon në bindje përmes rrugës së fakteve, — tha i dërguari pa pikën e sentimentalizmit.

— Kur do të shkojmë në fshat? — pyeti Murati.

— Që tani! — tha i dërguari pa i hequr duart nga shpina.

— Ju doni të pyetni fshatarët? — tha Murati.

— Jo! Unë dua të bind fshatin se partizanët nuk kanë qëlluar në shtëpinë e Fizëve. Unë dua t'u them atyre se ky ka qenë një provokim i armiqve! — tha i dërguari Xhabir.

— Hë, — qeshi Murati, — ju dyshoni vetë te ne, kurse fshatarëve doni t'u thoni se kanë qëlluar armiqtë tanë. Çuditë!

I dërguari i hoqi duart nga shpina.

— Ti je naiv. Unë, edhe duke u thënë se partizanët nuk kanë qëlluar, nuk i gënjej. Një provokator në batalion nuk është partizan. Ai është armik. Rrjedhimisht nuk kanë qëlluar partizanët, — tha i dërguari Xhabir.

— I zgjuar je! — tha Murati, duke e parë me simpati fytyrën e tij katrore me vetulla të trasha.

KAPITULLI I NJEZETË

Partizanët rrinin rreth zjarrit në shpellë. I dërguari dhe Murat Shtaga bisedonin pranë një ahu. Mato Gruda i vështronte herë pas here dhe mendonte: «Për topin e kanë fjalën.»

Komandanti i bëri me kokë një partizani, që ishte ulur pranë Nevzatit.

— Teodor Gjonomadhi, të lutem!

Teodor Gjonomadhi u ngrit. Koka gati sa i zinte në tavanin e shpellës. Iu afrua komandantit.

— Teodor, — tha komandanti, — arkat duhen shpënë tek ura.

— I shpiem, po do të jetë e kotë. Ne nuk marrim vesh nga ajo punë, — tha Teodor Gjonomadhi.

Komandanti u mendua. Vërtet, asnjë nga partizanët nuk dinte të minonte. Zëvendëskomisari, më aq sa merrte vesh, i kishte bërë një farë «kursi» Teodor Gjonomadh, por ky nuk ishte i sigurt nëse mund t'ia dilte mbanë minimi.

— Mjafton vallë dinamiti? — pyeti komandanti.

— Katër arka mjaftojnë besoj. Ura ka dy këmbë. Dy arka për çdo këmbë, — tha Teodor Gjonomadhi.

Mato Gruda nuk po kuptonte se për çka bëhej fjalë. Katër arka. Një urë. Komandanti u kthye nga Matoja.

— Do t'ju luteshim të na bënit një shërbim. Na duhet të shpiem gjer tek ura, nën fshatin tuaj, katër arka me dinamit.

Përsëri ai nuk e kuptoi se ç'mbanin arkat. Mori vesh vetëm një gjë, arkat duheshin shpënë me mushka gjer tek ura.

— Kot sa t'i shpiem, — tha Teodor Gjonmadhi me keqardhje. — Ne nuk dimë të minojmë.

Mato Gruda e kuptoi. Partizanët do ta minonin urën dhe, kur të afroreshin gjermanët, do ta hidhnin në erë. Për një çast i shkoi mendja te topi. Kot ishte munduar, duke e zvaritur nga korija e duke e fshehur në plevicë. Të kishte gjetur katër arka me dinamit dhe t'i kishte vënë natën në katër qoshet e shtëpisë së Fizëve. Pastaj një shkrepëse dhe lamtumirë! Nuk do të duhej as italiani, nuk do të kishte as telashe, nuk do të gabonte as në shenjë... Eh, kur njeriu s'di!

— Urën ne do ta hedhim në erë, dimë s'dimë, — tha komandanti.

«Megjithatë, — mendoj Mato Gruda — dinamiti ishte vështirë të vihej në qoshet e shtëpisë së Fizëve. Duhej të hapeshin vrima, duhej fitil. Fizët të pikasnin. Topi i qëron hesapet. Ia vesh shtëpisë nga larg. Asnjeri s'të pikas.»

— Ju, Mato, gjer tek ura do t'i shpini — e shtyu atë komandanti me bërryl.

— I shpiem — tha ai dhe iu drejtua Augusto: — Ti merr vesh nga kjo punë?

— Po! — tha Augustoja.

— Çfarë thua? — pyeti komandanti.

— Agushi e di punën e minave, — tha Mato Gruda, duke treguar me kokë italianin.

Komandanti e ndali vështrimin tek Augustoja. Atij nuk i besohej që një fshatar me gunë të zezë e me qeleshe të kishte haber nga minimi i urave.

— Dini të minoni?

— Di!

— Ku keni mësuar?

— Xhenier unë në ushtri. Pastaj artilier... — tha italian.

Komandanti vetëm atëherë e kuptoi se para tij qëndronte një italian.

— A, ju qenkeni italian?... — tha ai i menduar.

Teodor Gjonomadhit, që ishte ngarkuar të minonte urën, i ndritën sytë nga gëzimi. Më në fund u gjend edhe ai që mungonte, minuesi i urave.

— Ju mund të na ndihmoni, shok! — tha Teodori.

— Ndhimoj! — tha italianii dhe u ngrit më këmbë për respekt.

Mato Gruda e ndiente veten krenar, që u kishte gjetur partizanëve një njeri të dobishëm, një njeri me mend.

— Epo, shokë, ngarkoni arkat në mushkat dhe nisuni! — tha komandanti.

Teodor Gjonomadhi me pesë a gjashtë partizanë u ngritën dhe shkuan të merrnin arkat me dinamit, ndërsa Mato Gruda dhe italianii ndenjën me komandantin.

Tek rrinin, vështronin Murat Shtagën dhe të dërguarin Xhabir që ecnin poshtë e përpjetë duke folur me zë të ulët. Komandanti kishte mbështetur bërrylin në gju dhe vështronte zjarrin. Tymi i binte në sy dhe ai herë pas here i fshinte me pëllëmbë. Mato Gruda nxori kutinë e duhanit dhe ia zgjati përpara.

— Ky artilieri te ju banon? — pyeti komandanti, duke treguar Auguston.

Mato Gruda e ndjeu që po zbehej dhe i erdhi inat me veten. Këtë radhë e pushtoi frika. Sytë e komandantit i ngulën Mato Grudës thellë gjer në ndërgjegje. Iu duk sikur ata dy sy kërkonin në kraharorin e tij për të zbuluar diçka që Mato Gruda e mbante të fshehtë. Ai në këtë çast pothuajse u bë gati t'ia tregonte këtij njeriu fshehtësinë: «Unë isha ai që qëllova!» Por atij i vinte turp. Përveç turpit në ndërgjegjen e tij lëvronte edhe një ndjenjë tjetër, ndjenja e hakmarrjes. Fizët po bëheshin fajtorë sipas tij. Plaku Mere kishte dërguar letër në shtabin e zonës. E qartë. Fizët po bëheshin intrigantë. Fizët po futnin spica. Një shkëndijë shkëlqeu në vetëdijen e Mato Grudës: Haufman, ne do t'i qëllojmë përsëri Fizët, se ata po bëhen armiq edhe me partizanët. Ne kemi të drejtë t'i qëllojmë!» — tha Mato Gruda me vete.

— Të pyeta, Mato, ky artilieri te ju banon? — tha komandanti.

Mato Gruda përsëri u drodh.

— Tek unë. Që të kam fjalën, unë e mora, se më erdhi keq... — tha ai.

— Artilier!... — psherëtiu komandanti.

— Është djalë i mirë!

— Qëllon mirë? — pyeti komandanti.

Mato Gruda e humbi krejtësisht. Ai kujtoi se komandanti filloi të dyshonte. Buza e poshtme iu drodh...

— Ndoshta qëllon, ndoshta nuk qëllon. Duhet të qëllojë, meqë ka qenë artilier i një ushtrie me shkollë, — tha Mato Gruda.

Komandanti heshti. Në këtë çast partizanët i sollën të katër arkat e dinamitit. Mato Gruda dhe italiani i afruan mushkat.

Teodor Gjonmadhi dhe Mato Gruda filluan t'i ngarkonin arkat.

Komandanti iu drejtua italianit:

— Mjafton dinamiti?

— Sa këmbë ka ura? — pyeti Augustoja.

— Dy! — u përgjigj Teodor Gjonmadhi, duke lidhur arkën.

— Mjafton, — tha Augustoja.

— Ju do të minoni urën, por, pa u afruar gjermanët, nuk do ta hidhni në erë, — tha komandanti.

— Po gjermanët mund të vonojnë edhe një javë, edhe dy, — tha Teodor Gjonmadhi.

— Le të vonojnë. Ju do të pritni tek ura...

Mushkat u ngarkuan. Komandanti i zuri për dore të gjithë.

— Udhë e mbarë! Ti, Augusto, sa të minosh, mund të ikësh. Fitolin e ndez Teodor Gjonmadhi. Mirë do të ishte sikur t'i mësoje këta shokët se si të minojnë, — tha komandanti.

— Nuk ik. Rri me shokët, — tha Augustoja.

Mato Gruda e vështroi me habi italianin, po nuk i foli. Italiani e kuptoi.

— Hedh urën në erë, vij prapë, Mato! — i tha ai ngadalë Mato Grudës.

— Mirë, Agush, mirë! Ti ke bërë betimin tek unë.

— Betimi? — pyeti ai.

— Betimin në kolibe. S'të kujtohet? — pyeti Mato Gruda.

— Ah, kujtoj! — tha italiani dhe i ra ballit me pëllëmbë.

Mato Gruda futi dorën në xhepin e brendshëm të xhaketës dhe nxori një letër. E vështroi njëherë dhe ia dha italianit. Ishte ai trakti që u bënte thirrje italianëve për t'u hedhur në luftë kundër pushtuesve hitlerianë. Atë letër Mato Gruda nuk ia kishte lënë Augustos ta mbante me vete, se i dukej sikur nuk e meritonte.

— Mbaje me vete, Agush! — tha ai.

Augustoja u prek dhe gati sa nuk qau.

— Mato zemërmirë, — tha ai, duke futur letrën në xhep.

— Mirë, mirë, shko tani! — tha Mato Gruda.

Ata nuk kishin ikur, kur në pyll erdhën dy veta të veshur me xhaketa të oficerëve italianë. Komandanti i njohu.

— Qarkori! — tha ai ngadalë.

Të dy burrat u përshëndetën me të dërguarin Xhabir dhe me Murat Shtagën. Ishin shoku Ki dhe Cezari, të dy nga qarkori. Shoku Ki rrinte i heshtur dhe i mërztitur. Fytyrën e kishte të zbetë dhe dukej i lodhur dhe i dëshpëruar. I dërguari e vështronte herë pas here me një zemërim të përmbajtur. «Na bëre qepaze kot së koti me batalionin! — mendonte i dërguari Xhabir. — Dhe unë e fillova punën me seriozitetin e një pedanti! — tha ai me vete.»

Cezari u hodhi një vështrim mushkave të ngarkuara me arka dhe pyeti:

— Për ku?

Komandanti iu afrova:

— Të minojmë urën, shoku Cezar.

— A, mirë. Gjermanët vijnë pas një jave. Po masa duhen marrë. Shkoni, shokë, shkoni — u tha ai atyre që mbanin mushkat dhe u kthye nga i dërguari Xhabir.

Ndërsa Mato Gruda me italianin dhe partizanët morën udhën, dy të ardhurit filluan bisedën

në pyll. Cezari e vështroi i menduar komandantin dhe tundi kokën:

— Ah, ç'na bënë ato gjyle, ah, ç'na bënë!

Fytyrën e të dërguarit e mbuloi muzgu. Vetullat e trasha i ranë mbi sy.

— Më duket se këta s'kanë bërë asgjë. Na mbetet për të provuar edhe diçka. Batalioni ka katër mortaja të vogla. Unë do të vete të shoh vendin ku ranë predhat. Në bazë të shpërthimeve që janë bërë në oborr të Fizëve, mund të gjej se me ç'armë është qëlluar. Por unë jam i bindur se batalioni nuk ka qëlluar. As provokator me armë të rëndë nuk mund të ketë pasur, — tha i dërguari.

Cezari u ul e mori një copë bluashkë të thatë dhe filloi ta thyente. Megjithëse mundahej të tregojë i qetë, ai kishte shenja të një nervozizmi të thellë. Komandanti atë e njihte për njeri të drejtë e të arsyeshëm, por e njihte edhe për njeri nervoz. Duke thyer bluashkën, ai filloi të fërshëllente një melodi të panjohur, pastaj filloi ta përcillte atë me fjalë:

Bota rënkon nga dhembja dhe mizerja,
bota rënkon nga plumbat...

Përpoqi me nervozizëm thembrat e këpucëve me qafa dhe iu drejtua shokut Xhabir:

— Ju këtë përfundim nxorët?

— Po! — tha i dërguari.

— Tjetër?

— Asgjë! — tha i dërguari.

— Fshati?

— Nuk kemi shkuar.

— Nuk kemi shkuar, — përsëriti shoku Cezar.

— Për atje jemi nisur, — tha Murat Shtaga.

— Ju, Murat Shtaga, duhej të mos ju zinte gjumi për gjendjen e fshatit dhe, mund të themi, të krahinës. Ju i vini pas shokut Xhabir si ordinancë. Ju pse nuk keni shkuar në fshat?

Murat Shtagës iu drodh një nerv në cep të buzëve.

— Ju na thatë të zgjidhnim çështjen në batalion, pastaj të shkonim në fshat... — tha Murat Shtaga.

— Ah, në batalion! Nuk mjaftonte në batalion vetëm i dërguari Xhabir? O njerëz! — thirri ai me zë të lartë. — Gjermanët po vijnë për herë të parë në këtë krahinë. O njerëz! Krahinën nuk duhet ta gjejnë të përcarë...

— Fshatin, jo krahinën, — tha i dërguari Xhabir.

Cezari e vështroi me ironi:

— Skëndija bie në mullar. Mullari digjet. Digjet dhe mullari tjetër që është krah tij. — Cezari ngriti zërin: — (Do ta shuanë shkëndijën, apo do të ngroheni në pyll! S'ka provokim në batalion! Ç'më pritni atëherë? Pse nuk shkonit të sqaroni popullin? — tha ai tërë nerva.

— Ngadalë, — ndërhyri i dërguari Xhabir. — Në një vend shkohet me një pikëpamje të pjekur, në një vend shkohet me njohjen e fakteve dhe me formimin e arsytimit. Ju këtë orientim na dhatë!

Këto fjalë e shpuan si gjilpëra shokun Cezar. Ai i hodhi një vështrim të ftohtë shokut Ki, që kishte ulur sytë, pastaj shikoi këpucët e veta.

— Këtë orientim nuk jua ka dhënë qarkori! Qarkori nuk është një hetuesi e kohëve paqësore, — tha shoku Cezar.

I dërguari Xhabir u zemërua. Atë po e gënjenin sy ndër sy. Ata po e mohonin që e kishin dërguar vetë. Ai vështroi Murat Shtagën. Murati qëndronte si lis i palëvizur.

— Shoku Cezar! — thirri i dërguari. — Ju po gënjeni...

Cezari përpoqi thembrat e këpucëve.

— Nuk gënjej, — tha ai, — qarkori nuk është hetuesi.

I dërguari Xhabir i hodhi sytë shokut Ki.

— A nuk më dërguat ju për hetime në batalion?

Në koriqe ra një heshtje. Shoku Ki vështron te të dërguarin Xhabir që qëndronte i zemëruar. Cezari papritur këndoi:

Botës mizerjen do t'ia zhveshim,
si fereçe mizore,
dhe tok ahere do të qeshim
me tërë qeshjen njerëzore...

I dërguari Xhabir, Murat Shtaga dhe komandanti vështruan shoku-shokun. Cezari, në vend që të përgjigjej, këndonte. Ata kurrë nuk i kishin dëgjuar këto fjalë. Ata instinktivisht filluan të buzëqeshnin. Cezari, pa i vënë re, vazhdoi:

Ne sot mërdhijmë nëpër baltë
dhe frymë marrim nëpër plumba,
po nesër nis një qiell i kaltër
me dallëndyshe dhe pëllumba...

Të gjithë ndien në shpirt një dritë, një kaltërsi të harruar. Edhe i dërguari Xhabir me fytyrë të zymtë u çiltërua dhe bile psherëtiu thellë. Ç'dreq ishte ky Cezari! Nuk merrej vesh. Herë i rreptë, herë ëndërrues!

Cezari heshti. I hodhi sytë në majën e një ahu dhe tha i qetë:

— Kam urdhër nga qarkori që ne të tre, ti shoku Xhabir, ti Murat Shtaga dhe unë të shkojmë në fshatin Arun dhe të normalizojmë gjendjen. Të përpiqemi që edhe ata të lëkundurit pas të shtënave të asaj nate, t'i hedhim përsëri nga ana jonë... Të shtënat!.. Pus! Mjegull. Ku ishte fshehur ai top? Ku ishte fshehur ajo mortajë? Në mes të maleve? Në mes të gërmadhave? Nga ç'botë vinte? Enigmë! — tha shoku Cezar i menduar.

Trupin e të dërguarit e pushtoi një e dre-

dhur. Vetullat e trasha të tij lëvizën. Këtë e vunë re të gjithë.

— Murat! — tha ai papritur.

Murat Shtaga ngriti fytyrën.

— Murat! Të kujtohet, kur dezertuan italianët?

— E? — pyeti Murat Shtaga.

— Mungonte një top!

— Mungonte, — tha Murat Shtaga.

Cezari dhe komandanti i batalionit prenë frymëmarrjen para tyre...

— Mungonte një top? — pyeti Cezari.

— Po! — tha Murat Shtaga. — Ne nuk e gjetëm. Komandanti i baterisë italiane që na u dorëzua tha se duhej të ishte edhe një top tjetër.

— Çudi, ë? — pyeti Cezari.

Shoku Ki hante thonjtë me dhëmbë.

I dërguari Xhabir zuri ballin me dorë, pastaj u kërkoi lejë shokëve dhe u largua nga ata me fytyrë të zymtë. Ai shkoi në pyll, mori dy partizanë me vete dhe, pa i thënë njeriu se ku shkonte, u nis tatëpjetë kodrës.

Dy partizanët e ndiqnin të heshtur. I dërguari me pushkë dhe dy kobure në brez ecte në shtegun e ngushtë mes baltës së kuqe, duke shkarë. Kur u rralluan ahet e gjata e filluan të dukeshin dushqet dhe kaçubat, që nga larg u shfaq shtëpia e Fizëve majë kodrës mbi përroin e thellë të fshatit Arun. Të tre qëndruan. I dërguari vuri dorën në ballë dhe vështroi nga shtëpia.

— Do të shkojmë në atë shtëpi! — tha ai.

— Në shtëpinë e Fizëve? — pyeti njëri nga partizanët.

— Po!

Pas gjysmë ore ata arritën në oborrin e Fizëve. Mullarët, ku kishin rënë gjylet, nxinin. I dërguari qëndronte e vështronte. Pastaj ai u ul buzë një grope të vogël dhe filloi të mendonte. Ishte gropa që kishte hapur gjylja. «Topi ka që-

lluar nga ana e kundërt e vendit të batalionit —
mendoj ai. — Gjylet kanë ardhur nga ana e fshatit.
Batalioni, këto ditë nuk ka qenë nga ajo anë!» Atij
iu kujtua përsëri topi i humbur. «Kush ta këtë
marrë vallë? Po ç'e donte?» — mendoj ai.

Ndërkohë nga dera e vjetër e shtëpisë doli një
plak i hollë, i gjatë, i dobët. Ishte Mere Fizi. Ai
qëndroi para portës me sy nga i dërguari Xhabir. I
dërguari ngriti kokën.

— Njatjeta, xhaxha! — tha ai.

Plaku Mere nuk foli. Vazhdonte të qëndronte.

— Shohim dëmin që të është bërë! — tha i
dërguari Xhabir.

Plaku Mere tha ca fjalë pa kuptim:

— Oot-ka komegej!

— A? — pyeti i dërguari.

— Ai nuk digjet në zjarr! — i shpjegoi plaku
Mere fjalët e pakuptueshme.

— Kush? — pyeti i dërguari me habi.

— Shpirti i keq, që qëlloi mbi mua! — tha
plaku Mere.

— Kush të jetë ky shpirt? — pyeti i dër-
guari.

— Ju, Murati, — tha plaku.

— Gabim e ke. Gjylet kanë ardhur andej, —
bëri me kokë përtej fshatit i dërguari Xhabir. —
Andej partizanët nuk kanë qenë.

Plaku Mere qeshi me zor. Kjo e qeshur dukej
si e qarë.

— Kudo janë ata. Shejtani Mulahimi është
kudo, — tha ai dhe hyri brenda nëpër derën e vje-
tër.

— Dreq, o punë! — tha i dërguari Xhabir.

KAPITULLI I NJËZETENJËTË

Mato Gruda fjeti një natë maleve dhe, pasi i la partizanët dhe italianin tek ura e lumit Krak, u kthye në fshat. Kishte rënë mugëtira e mbrëmjes dhe bënte ftohtë. Ai qëndronte në samar të mushkës, i mbështjellë me bërrucin e zi dhe pinte duhan vetëm për t'u ngrohur pakëz. Mushka tjetër, e lidhur pas kocaqes së samarit të së parës, ecte duke trokitur thundrat nëpër gurë. Ajo mugëtirë e lagët, ato pika shiu që filluan të binin, ato trokitje të thundrave të mushkave, ajo e ftohtë ia shtuan mërzinë dhe ankthin. Mes kësaj mërzie dhe ankthi thellë në ndërgjegjen e tij filloi të ngrihej gryka e topit, që rrinte e mbuluar me jorgan atje në koliben e qenit. A duhej të rrinte ende e mbuluar? Ndjenja e fajësisë e pushtoi Mato Grudën. Kjo ndjenjë u rrit, u rrit dhe doli mbi bërrucin e zi të tij. Ai pak gjëra nuhati në batalion, të tjerat me intuitën e një njeriu të zgjuar i mori me mend, si ai që merr me mend se si do të jetë një shtëpi, duke parë vetëm themelet. Ai i pa themelet. Po, po, i pa. Në batalion mbretëronte një shqetësim, në fshat mbretëronte një shqetësim. Kush qëlloi me top? Arma kishte qëlluar atje ku nuk duhej... Një fjalë e vogël, kur godet atje ku nuk duhet, dhe prish punë, po një armë? Goditja e armës mban me vete edhe fjalën. «Po nesër ç'do të bëhet? — mendoi në mushkë Mato Gruda. — Unë që kisha në dorë një armë e përdora për t'u kënaqur me veten, për të përmbushur disa teke të mia...»

Mato Gruda e hodhi cigaren e trashë. Cigarja ra në një shkëmb dhe lëshoi xixa, pastaj u shua. U shuan edhe gjyret që hodhi ai në mullarët e Fizëve? «U shuan? — pyeti veten Mato Gruda. — Nuk u shuan, — u përgjigj ai — u ndezën në fshat e në batalion. Nuk desha. Desha s'desha, puna që bënë ato është e njëllajtë. Vetëm unë e di që s'desha; vetëm unë e di që jam unë ai që qëllova. . .»

Ai e ndali mushkën, sepse në mendje i erdhi një mendim i paparashikuar. «Të kthehem e t'u them në mal se isha unë ai që qëllova. Ta marr edhe topin dhe të rri me ta, po të më pranojnë.»

Mato Gruda e ktheu mushkën. Mushka që vinte pas, nuk donte të kthehej. Ai i thirri mushkës, u zemërua, u tërbua. Zgjati dorën dhe e tërhoqi për kapistalli. Mushka nuk donte. Dhe Mato Gruda, duke u marrë me kafshët, harroi ç'kishte menduar dhe pse donte të kthehej. Ai tani kthehej për në mal për inat të mushkës. Donte që ajo t'i bindej. Mushka u hodh përpjetë dhe tundi samarin e asaj që e kishte hipur Mato Gruda. Ai u lëkund dhe ra në hendek. Mushkat në fillim u trembën, pastaj qëndruan. Të dyja ishin kthyer me kokë nga mali dhe pritin që i zoti të hipte dhe të niseshin nga deshte ai. Por ai rrinte në hendek i mbështjellë me bërruc. Nuk donte të ngrihej. Shikonte mushkat pa kuptim. Atëherë ai futi dorën në brez. Gishtat prekën hekurin e kobures. Hekuri kishte marrë ngrohtësinë e trupit të tij. E hoqi nga brezi dhe e mbajti në dorë. Njëra nga mushkat hingëlliu dhe përpoqi thundrat e para në gurë. Ishte mushka e tij. Mato Grudës iu kujtua ajo ditë, kur në korije fërshellenin plumbat. Mushka kështu i përpiqte thundrat. Atë ditë ai e pa edhe topin që u rrokullis dhe u mbështet në trungun e lisit. Ai e vuri koburen në dorën tjetër dhe e vështroi. I erdhi në menditaliani i vvarë. Nga brezi i tij e nxori këtë kobure. Pastaj vështroi veten e tij, bërrucin e zi, krahët, këpucët. Dhe u drodh me kobure në dorë. Mushka përsëri hingëlliu. Mato Gruda nga kjo hingëllimë e dytë erdhi në vete. «Mos ki frikë, — i tha ai mushkës — unë ashtu kot mendova. . . Mendova kot. . . dhe mora koburen.» Ai e futi përsëri në brez

dhe u ngrit. E zuri mushkën për kapistalli dhe u kthye përsëri për në fshat. Tani nuk ecte kaluar. . .

Duke tërhequr mushkën për kapistalli, tha:

— U zemërova pak! Ju shava pak! . . .

Përsëri u zhyt në mendime. Këtë radhë i doli para sysh plaku Mere dhe shtrëngoi dhëmbët. Në veshë filloi t'i buçiste gjaku. «Po, — tha ai me vete — unë do të të qëlloj edhe një herë, o plaku Mere, dhe pastaj do të shkoj në shtabin e batalionit dhe do të them: «E qëllova unë!».

Mato Gruda nuk kishte vënë re se i ishte afruar shtëpisë së Muratit. Muret pa çati nxinin si katran. Që ditën që e dogjën, në të ishte shuar jeta. Gruaja e Muratit, e ëma dhe fëmijët, kishin ikur me kohë. Mato Gruda i ndali mushkat para mureve të shkreta. «Breh! — tha ai me vete. — S'ka gjë më të dhemshur se shtëpia e djegur. Breh!» — dhe thirri papritur:

— Murat, o miku im!

Zëri i tij u përplas në mure dhe bëri jehonë.

«Ku e gjen ky Murat Shtaga gjithë këtë fuqi — mendoi Mato Gruda. — I la të gjitha dhe iku. I la me grua e fëmijë, me nënë e shtëpi. Me një kobure të vogël në brez nuk la vend pa shkelur e nuk la portë pa trokitur. As trembet e as druhet. Po di edhe të flasë ama. I lidh ato fjalët aq mirë, sa të gjithë hapin gojën. Edhe ata që nuk e duan i heqin kapelën.»

— Murat, o miku im! — thirri ai përsëri para mureve të nxira.

Zëri prapë bëri jehonë: «Murat, o miku im!»

Pastaj Mato Grudën e pushtoi një ndjenjë fajtori dhe gjaku iu ngjit me forcë në fytyrë. Tëmthat filluan t'i rrihnin me të madhe.

«Mirë, mirë, do të më shohin!» — tha ai me vete, po me zë të lartë.

Ndërkohë lehu qeni i tij dhe ai pastaj pa se si një gjë e murme u hodh para mushkave.

— Të harrova, Balo! — tha Mato Gruda.

Me kapistall në dorë ai mendoi të shkonte nga shtëpia e Nevzatit dhe t'i thoshte gruas së tij se ia kishte takuar

të shoqin dhe ia kishte dhënë atë plaçkën e vogël. Ai ishte njeri i sjellshëm dhe amanetin e tjetrit kurrë nuk e harronte. Kur e shpinte këtë amanet në vend, kthehej tek ai që ia kishte lënë dhe i thoshte se puna kishte mbaruar. Për gruan e Nevzatit i vinte keq, se ishte e re, e urtë, e mirë. «Eh, more, si shkuan punët! Nusët e reja mbetën në shtëpi. Burrat morën malet. Pa ca vriten e nuk kthehen më! Ç'bëhet, more, ç'bëhet!» — tha Mato Gruda.

Dritaret e shtëpisë së Nevzatit ndritnin si në gostira të mëdha. I ndali mushkat para portës. Qëndroi për një çast në këmbë dhe mbajti vesh. Dëgjoheshin zëra, thirrje, sharje. Pastaj çdo gjë binte në qetësi, sikur të mos kishte njeri të gjallë. Ai mori një gur dhe trokiti në portë.

Mato Gruda priste. Duke pritur, u pendua që trokiti. «Ndoshta zihen për topin tim! — mendoi ai. — A është e udhës të futem brenda? Më mirë të iki! Nesër shkoj dhe i them që e takova Nevzatin.» Por në këtë çast u hap porta dhe doli gruaja e Nevzatit.

— Urdhëro, Mato! — tha ajo.

— Erdha të të them se e takova Nevzatin... — tha Mato Gruda, duke u mbajtur pas kapistallit të kafshës së lodhur.

— U, hajde, Mato! Ata të kanë pritur, — tha gruaja.

— Ata? Cilët? — pyeti ai.

Atë përsëri e pushtoi mërzia që e kishte ndjekur tërë udhës. Ç'të bënte që të hynte brenda? Njerëzit do të flitnin për një gjë që nuk e dinin. I vetmi që e dinte, do të ishte Mato Gruda. Ai do t'i dëgjonte tek do të ziheshin me njëri-tjetrin për një gjë që nuk e dinin. Atëherë mërzia e tij do të dyfishohej. «Po mirë, — mendoi ai — të vete të dëgjoj. Po të mos përmbahem, t'u them të vërtetën.» Dhe, tek qëndronte para portës, mendte i shkuan në kolibe, ku mbulohej gryka e hekurt. «Mirë thoshte Zara! Ta kisha mbuluar në tokë, ose t'ia kisha marrë rrotat e me to të kisha bërë një qerre. Vërtet, qerre të atillë nuk do të kishte parë fshati...»

— Cilët? — pyeti papritur Mato Gruda. Kjo ishte një pyetje e vonuar.

— Murati me tre partizanë, — tha gruaja.

— I dërguari Xhabir?

— Nuk e di se cili është!

Mato Gruda psherëjtju.

— ~~Ka të tjerë?~~

— Pothuajse gjysma e burrave të fshatit, — tha gruaja.

Mato Gruda zuri kokën me pëllëmbë, sikur t'i dhembte.

«Prapë për topin!» — tha ai me vete.

Ia la mushkat gruas së Nevzatit dhe u drejtua për në odën ku ishin mbledhur burrat.

Ngjiti ngadalë shkallët e drunjtja dhe qëndroi para derës, sikur të kishte frikë të hynte. Nga oda dëgjohej zëri i trashë i një njeriu të panjohur.

«Po, po! I dërguari Xhabir duhet të jetë!» — tha Mato Gruda me vete dhe balli iu mbulua me djersë, si në pyll para komandantit të batalionit. Ai vazhdonte të qëndronte pa guxuar të hynte. Gruaja e Nevzatit e pa dhe i tha:

— Pse nuk hyn, Mato?

Mato Grudës i erdhi papritur ky zë dhe u hodh përpjetë.

— Ndoshta edhe nuk dua të hyj. E kam fjalën, që thua ti atje, që pse t'i bezdis. Ndoshta edhe mund të hyj, — tha ai.

Gruaja e Nevzatit e vështroi me habi.

— Ç'thua, Mato!

— Ndoshta nuk kisha në mend të thosha asgjë, — tha Mato Gruda në një konfuzion të plotë.

— Ti nuk je njeri i paftuar. Ty të presin! — tha gruaja.

— Atje qëndron puna, se jam i ftuar.

— Asgjë s'marr vesh.

— Ndoshta dua të çlodhem pak para se të hyj, — tha Mato Gruda dhe u ul në dysheme para derës së odës. Gruaja shtangu.

— Po ti hajde çlodhu në ashef, — tha ajo.

Mato Gruda u ngrit.

— E di që mirë thua?

Në këtë çast nga oda doli Murati. Ai e vuri re Mato

Grudën dhe e përqafoi. Mato Gruda e shtrëngoi në krahët e tij të fortë dhe e puthi, sikur të mos e kishte parë me vite.

— Eh, Murat! — tha ai.

— Tuhaf! — tha Murati. — Hajde!

Mato Gruda hyri në odën e mbushur plot e përplot me burra. Ai, pa vënë re asnjëri, gjeti një vend të ngushtë dhe u ul. Pastaj ngriti sytë dhe pa një burrë me një trup të madh, që rrinte në bash të vendit pranë oxhakut. Ishte i dërguari Xhabir.

Murati u ul pranë të dërguarit dhe diçka i tha në vesh.

— A, Mato Gruda! — tha i dërguari.

— Po, Mato Gruda! — tha ai pa kontrolluar veten.

— E, ku e lamë, shokë? — e mori fjalën i dërguari.

— Nga e nxorët ju, Adnan, se me top kanë qëlluar partizanët? A mund t'i bësh fajtorë të tjerët me hamendje? Ta zëmë se u vra një njeri në fshat. Pa pasur të dhëna të sakta, pa gjetur gjurmë, pa parë diçka, a mund të thuash se filanin e vrava unë apo Murati? A mund të behohet fjala pa faktin?

Në odë ra një heshtje. Mato Gruda i hodhi sytë rreth burrave. Vërtet ishte mbledhur gjysma e fshatit. Në mes të të tjerëve ishin edhe Asllan Maruka, Pertefi, Abedini, Alushi, Aliu dhe Fahremudinaliu, stërnipi i parë i plakut Mere.

Heshtjen e prishi Adnan Pinxhoja:

— Ti, partizan vëllai, pse më drejtohesh mua? Nuk e them vetëm unë që gjylet i hodhën partizanët. E thonë edhe të tjerët...

— Kush? — pyeti i dërguari.

— Vetë i zoti i shtëpisë.

— Plaku Mere? — pyeti përsëri i dërguari.

— Edhe stërnipi i tij i parë, Fahremudinaliu, — tha

Adnani.

Fahremudinaliu luajti nga vendi. Ai e mori cigaren e pandezur dhe e vuri në vesh.

— Ju, Fahremudin? — iu drejtua i dërguari Xhabir.

— Si urdhëron! Gjyshi i madh dhe unë mejtojmë se

kanë qëlluar partizanët. Ka shkak të kenë qëlluar. Mirë bënë që qëlluan. Gjyshi i madh ka pasur miqësi me Tosun Baçin. Katër ditë para se të qëllonin në shtëpinë tonë ka qenë Tosun Baçi. Partizanët kujtuan se ne fshihnim Tosun Baçin dhe qëlluan. Mirë bënë. Edhe unë, po të isha në vend të tyre, ashtu do të bëja. Unë u jap hak, por vetëm se nuk është mirë kështu, se përçahet fshati, trembet fshati. Por, me një fjalë unë ju jap hak! — Ai pastaj iu drejtua Adnanit: — Unë, o Adnan Pinxhua, a i kam sharë partizanët që qëlluan në shtëpinë time?

Adnani goditi me thonjtë e gishtërinjve kutinë e duhanit.

— Nuk i ke sharë. Ke thënë se na qëlluan partizanët, — tha Adnani.

— Kaq. A është sharje kjo? — pyeti Fahremudinaliu dhe e vështroi me buzëqeshje të dërguarin Xhabir.

Në odë ra përsëri heshtje. Njerëzit pritnin se si do t'i përgjigjej i dërguari.

I dërguari ngriti vetullat, e pushtoi me vështrimin e tij tërë odën e tha:

— Mund të shash edhe pa thënë asnjë fjalë të keqe. Ti Fahremudinali, je shumë i zgjuar. Duke u dhënë hak partizanëve, ti në të vërtetë i shan. Fjalën me helm e përhap edhe duke thënë: «Po të isha në vend të tyre, ashtu do të bëja!» Por ne nuk e kemi qëlluar shtëpinë tuaj. Dhe nuk do ta kishim qëlluar, edhe sikur ti vetë të ishe komandant Balli, sepse do të bënim krime, do të vritnim gra e fëmijë, siç vret gjermani. Më thuaj, a ka rënë ndonjë gjylja jonë në shtëpinë e Tosun Baçit? Ti nuk je ballist. Tosun Baçi është ballist. Kur nuk i kemi vënë topin shtëpisë së Tosun Baçit, si do t'ia vëmë topin shtëpisë sate?...

— Ashtu është! — thanë përnjëherësh burrat.

— Topin nuk ia vutë, po shtëpinë ia dogjët, — qeshi Adnan Pinxhoja. — Aty-aty!

— Po, ia dogjëm, se edhe na dogji? Por «atyy-atyy» nuk është. Ne nuk ia vramë fëmijët, as vëllezërit, as pleqtë, as gratë! Ia dogjëm shtëpinë për t'i dhënë mësim: Po të djegësh, të djegin. Edhe ti, po të merrje rrugën e Tosun Baçit, po të ishe aq i egër e aq i ndyrë, ashtu do ta pësoje.

Duhet të dish edhe një gjë. Ne djegim shtëpitë e kriminelëve, por jo të ballistëve të thjeshtë, se shumica e tyre janë të gënijer dhe ne kemi besim se do ta kuptojnë gabimin e tyre. Ti, Adnan Pinxhua, ke dëgjuar që ne të djegim ndonjë shtëpi të ballistëve të thjeshtë? Sa ballistë ka fshati juaj?

— Tre! — tha Adnani.

— A ke parë që të dalë tym mbi çatitë e tyre, përveç tymit të oxhakut? — pyeti i dërguari Xhabir.

Të gjithë qeshën. Fahremudinaliu uli kokën. Adnani rrinte i kuq si flaka. Murati buzëqeshte.

Adnan Pinxhoja e kroi kokën, si për të gjetur ndonjë mendim. Pastaj buzëqeshi me zor dhe iu drejtua burrave:

— Hé-hé! Demek ju bëri për të qeshur! Ju vret, pastaj qesh, duke fshehur koburen. Hé-hé!

Ali Maruka, që ende e kishte të freskët plagën që kishte hapur në shtëpinë e tij Adnan Pinxhoja me vrasjen e vëllait, Kamberit të shkretë, mezi qëndronte. Ai herë anohej nga një krah, herë nga krahu tjetër, duke fshirë murin e odës me kurriz.

— Ti, Adnan Pinxhua, nuk e ke vendin në këtë odë! Fjalët e tua pëlcastin më shumë se gjylet e një topi. Pëlcastin dhe përçajnë fshatin. Mos të ka dërguar këtu Tosun Baçi? — tha Ali Maruka, duke shtrënguar dhëmbët.

Adnan Pinxhoja nuk e vështroi Aliun.

— Ne, kur erdhëm në këtë odë, i lamë në oborr hasmëritë. Ne të dy kemi hasmëri. Por këtu në këtë odë flasim për ca gjëra të tjera që janë më të mëdha. — tha Adnan Pinxhoja.

Ali Maruka u nxeh:

— Flasim kundër partizanëve! Dhe këto ti m'i quan gjëra të mëdha! Zhabë batak!

Adnan Pinxhoja lëvizi nga vendi. Ai u mat të fliste, por ndërhyri i dërguari Xhabir:

— Ne, Ali, e njohim mirë Adnan Pinxhon. Ai nuk duhet të ishte në këtë odë. Po s'ka gjë, le të rrijë, që ju ta njihni më mirë. — I dërguari Xhabir, iu drejtua Fahremudinaliut: — Ti kujton se e ke mik Adnanin? Ai edhe

Shegën tuaj donte ta turpëronte. Vajzën ia hoqi nga thonjtë Mato Gruda.

Adnan Pinxhoja u bë i verdhë si meiti. Filluan t'i dridheshin edhe duart, edhe buza. Mato Gruda e vështronte me përbuzje. Fahremudinaliu shtrëngoi dhëmbët. Ai kish-te dëgjuar ngjarjen mes Shegës dhe Adnanit, por kujtonte se ishin thashetheme.

— Ia dimë edhe pehlivanllëqet me Tosun Baçin, po le të rrijë në këtë odë, që ta shohin të gjithë se cili është. Në mos dhëntë sot hesap, do të japë nesër! — tha i dërguari Xhabir.

— Unë nuk kam qenë kurrë miku i tij. As i Tosun Baçit nuk kam qenë. Mua më vjen keq që qëlluan partizanët. Më mirë të kishte qëlluar Tosun Baçi, se do të ngrihesha të luftoja kundër tij. E kundër partizanëve nuk ngrihem. Ndryshe është puna ime, ndryshe e Adnan Pinxhos. — Fahremudinaliu iu kthye Adnanit: — Ti, Adnan, ç'ke që hidhesh në mbrojtje të shtëpisë sonë? Kaq t'u dhembka shtëpia jonë?

— Bëni ç'të doni! Unë flas për të mirën tuaj, — tha Adnan Pinxhoja, i ndodhur mes kryqëzimit të vështrimeve. Ai nuk e priste që edhe Fahremudinaliu ta kundërshtonte dhe të mos pranonte asnjë ndihmë.

Në këtë kohë trokiti dera. Në prag të saj u duk plaku Mere, i hollë dhe i gjatë, me shkopin e tij në dorë. Të gjithë u ngritën më këmbë. U ngrit edhe i dërguari Xhabir.

Plaku Mere e zuri për dore të dërguarin dhe u ul në bashin tjetër të odës.

— Si je, plaku Mere! — iu drejtua i dërguari.

— Bereqatversën! — tha plaku Mere.

— Mbahesh zotrote, mbahesh.

— Bereqatversën! — tha plaku Mere.

Pas këtyre përshëndetjeve në odë ra përsëri heshtje. Plaku Mere i rrotulloi sytë burrë me burrë dhe i ndali te Mato Gruda. Mato Gruda u mundua të përmbante veten, por zemra iu drodh dhe filloi t'i godiste me forcë në dërrasë të krahavorit.

— Na ka ardhur keq që ju kanë goditur me top të

ligjtë, ata që nuk na e duan të mirën, — i tha i dërguari, duke e ngritur zërin, siç e duan pleqtë.

— Fjalët i flet mirë zotrote! — tha plaku Mere.

Të gjithë u ndodhën ngushtë. Ata e ndien thumbin e plakut Mere.

— I flas siç i ndiej, — tha i dërguari.

— Qëllon me top, qëllon edhe me pambuk, — tha plaku Mere dhe qeshi me zë të lartë, qeshi, sikur ta gulduliste njeri: — Ha, ha, ha!

Njerëzit aty per aty shtangën, pastaj edhe ata filluan të qeshnin, sikur të ishin infektuar nga e qeshura e plakut Mere. I dërguari i rrudhi vetullat, si një njeri që ndodhet në kulmin e zemërimit. Ai priti sa u qetësua oda.

— Ti, plaku Mere, e di edhe vetë që nuk ta kemi qëlluar ne shtëpinë. Ato dy gjylet qorre që ranë në oborrin tënd i kape me të dyja duart dhe tani po mbahesh fort. Ti kujton se ato dy gjyle do të ta mbrojnë shtëpinë nga një gjyle tjetër një mijë herë më të madhe?... — dhe i dërguari heshti për një çast.

Burrat shikuan njëri-tjetrin si në konfuzion. Plaku Mere trazoi zjarrin me mashë për t'u treguar i qetë.

— Nuk e shpëton dot! Katër stërnipërit e tu kanë kërkuar të vijnë në batalion me partizanët. Ti nuk mund ta drejtosh më shtëpinë e madhe. Nuk ke më fuqi! Sado të mbahesh pas atyre dy gjyleve, do të humbësh. As fshatin nuk e ngatërron dot. Bile edhe ky do të të lërë vetëm! — I dërguari tregoi me gisht Fahremudinaliun. Ai pastaj iu drejtua burrave: — Shokë, ne duhet të zgjerojmë njësitin e fshatit. Kush nga ju dëshiron të hyjë në njësit?

Burrat nuk e pritnin këtë ndryshim të temës së bisedës. Murati e kuptoi. I dërguari me këtë kthesë donte të çarmatoste përfundimisht plakun Mere dhe ata që i besonin. I pari u ngrit Aliu:

— Unë! — tha ai.

— Unë! — tha Asllan Maruka.

— Unë! — tha Alushi.

— Unë! — tha Qemali.

— Unë! — tha Fetahu.

Në odë u dëgjua «uni» i dymbëdhjetë burrave.

I dërguari Xhabir dhe Murati shikonin me buzëqeshje.
— Kush nga ju dëshiron të dalë partizan? — pyeti i dërguari Xhabir:

— Unë! — tha Pertefi.

— Unë! — tha Aliu.

I dërguari lëvizi krahun e tij të trashë.

— Ti shfaqe dëshirën të bësh pjesë në njësitin e fshatit. Dy detyra nuk mund të kesh!

— E ndërrova mendjen! — tha Aliu.

I dërguari qeshi.

— Duhet të mbeten edhe ca në njësitin e fshatit, shokë! — tha ai.

Sa e mbaroi fjalën i dërguari, në odë hynë katër djem. Plaku Mere ktheu kokën. U duk sikur qafa i mbeti e ngrirë nga dera. Ishin të katër stërnipërit e tij.

— Shkruani edhe katër emrat tanë! — tha stërnipi i dhjetë.

— Në njësit, apo në batalion? — pyeti Murati.

— Në batalion! — tha Veseli.

— Emrat! — tha i dërguari me fletore në dorë.

— Vesel Fizi.

— Abazi

— Rahmiu

— Baftjari!

I dërguari u ngrit përsëri. Ai i vështroi të gjithë burrat e fshatit një nga një. Pastaj me një zë bindës tha:

— Topi ose është në fshatin Arun, ose është te Tosun Baçi. Kur mblidhnim armët e italianëve të dorëzuar, mungonte një top. . . Unë shkova në oborrin e shtëpisë së plakut Mere. Gjylet kanë ardhur nga fshati juaj. . .

Mato Gruda u pre në fytyrë. Po zbulohet topi i tij. Ai, sikur të ishte edhe pak më i guximshëm, do të ngrihej dhe do të thoshte në mes të burrave se topi që kërkohej ishte në koliben e tij, i mbështjellë me jorgan. Por këtë ai nuk e bënte dot. Atë e pushtoi një ankth. Kishte frikë se mos fillonte t'i dilte gjak nga hundët a nga goja. Mato Gruda kishte dëgjuar se vrasësit i pushton gjaku.

— Topi në fshatin tonë?! — tha me habi Fahremudinaliu.

— E pamundur! — tha Aliu.

— O në fshatin tuaj, o te Tosun Baçi, — tha i dërguari Xhabir me bindje të patundur.

Plaku Mere heshtte në vatër. Fjalët e shokut Xhabir dhe ardhja e katër stërnipërve sikur ia mbyllën gojën. Nuk mund të fliste më për zemërimin e shtëpisë së tij ndaj partizanëve, se nuk do ta besonte njeri.

— Me ne do të vijë edhe një njeri tjetër nga Fizët, — tha Baftjari. — Pret te dera.

Plaku Mere u drodh. Ai ia nguli sytë Baftjarit.

— Kush?

Baftjari nuk iu drejtua plakut Mere, po të dërguarit Xhabir.

— Të hyjë?

— Të hyjë! — tha i dërguari.

Baftjari u ngrit dhe hapi derën. Të gjithë kthyen kryet. Dhe përnjëherësh në odë filloi një gumëzhitje, një «uuu» e gjatë. Në prag të derës u rrit figura e një vajze të gjatë me gërsheta, me një shami të verdhë mbi flokët e zinj. Ishte Shega, stërmbesa e plakut Mere, e motra e Fahremudinaliut. I dërguari u ngrit më këmbë. Ai kaloi përmes burrave për ta përshëndetur e për ta zënë për dore. Njerëzit filluan të pëshpëritnin me njëri-tjetrin. Fahremudinaliu u zbeh dhe mbuloi faqet me pëllëmbë të duarve. I dërguari ia dha dorën vajzës dhe e ftoi në krye të vendit pranë vetes. Shega, e skuqur, buzëqeshte me navitet, e hutuar, e turpshme.

— Jo, kjo nuk durohet! — i belbëzoi Adnani Mato Grudës.

— Çuditëm, çuditëm! — tha Mato Gruda ngadalë.

Fahremudinaliu, i vëllai i Shegës, i hoqi duart nga fytyra dhe u ngrit.

Burrat ulën kryet nga turpi.

— Ç'bëhet, xhanëm? — pyeti Mato Gruda.

Fahremudinaliu qëndroi për një çast më këmbë me sy të ngulur në fytyrën e së motrës dhe thirri:

— Nga kush more lejë ti. Dil jashtë, se me këto duar do të të mbyti! — Ai zgjati duart përpara dhe i bëri gishtërinjtë në formën e kthetrave të skifterit. I tëri dridhej

dhe nga goja i dilte shkumë. Shega rrinte pranë të dërguarit me sy përdhe.

— Ulu, shok, ulu! — tha me gjakftohtësi i dërguari.

Fahremudinaliu iu drejtua plakut Mere, si për ta qortuar:

— O gjysh i madh! Jeto, o gjysh i madh, jeto të shohësh se ku katandisi shtëpia jote! O gjysh i madh! Stërmbesa jote dhe motra ime dhe kushërira e parë e këtyre, — ai tregoi me gisht të katër djemtë e Fizëve, — dhe motra që sot e tutje mori udhën e vajzave pa nder!...

Atij iu mor fryma nga zemërimi. Ndërkohë u ngritën dy nga fizët, Baftjari dhe Abazi, dhe e zunë për krahu për ta detyruar të ulej.

— Të të vijë turp, vëlla, për fjalët! Ulu! — thirri Baftjari dhe e shtyu me forcë të kushëririn.

Fahremudinaliu i ra me bërryla të dyve dhe liroi krahët.

— Ju e shputë motrën time gjer në këtë ditë! — vetëtiu sytë ai dhe u mat t'i godiste.

Oda zhurmoi.

I dërguari u ngrit:

— Të ndaloj të flasësh me këtë gjuhë!

Fahremudinaliu u drodh. Kjo nuk ishte një dridhje nga frika, po nga zemërimi dhe urrejtja.

— Është motra ime dhe ç'të dua mund të bëj me të. Ti, ti, ti... mos fut hundët! — thirri ai.

— Ti s'ke të drejtë ta shash! Ajo nuk varet nga ti. — Ai u drejtua nga burrat. — Më falni! Kjo është bija jonë, bija e vendit tonë!

Fahremudinaliu pështyu përpara këmbëve, u hodhi edhe një vështrim të egër së motrës dhe burrave që ishin mbledhur në odë dhe doli me rrëmbim, duke përplasur derën.

Shega rrinte pranë të dërguarit dhe Muratit. Me vështrësi i ngriti sytë dhe vështroi odën. Njerëzit heshtnin. Skandali i Fahremudinaliut krijoi një gjendje të vështirë, një gjendje të ethshme. Askush nuk e priste ardhjen e Shegës, askush nuk e priste se puna do të vinte gjer këtu.

Bile këtë nuk e kishte parashikuar as Murati. Edhe ai e vështronte i çuditur Shegën.

Me të dalë vëllai, ajo u ngrit e tha ngadalë:

— Mua më kanë thënë se në mal, me partizanët, ka edhe vajza. Mejtova të shkoj edhe unë në mal. Fahremudinaliu nuk ka të drejtë, por ai është i mirë! — dhe ajo u ul në vendin e saj.

Plaku Mere rrinte e dëgjonte, sikur e gjithë kjo skenë të ishte diçka e zakonshme, diçka e njohur.

Në këto e sipër u ngrit Adnan Pinxhoja dhe u nis të dilte. Por te pragu i derës ai qëndroi dhe iu drejtua burrave:

— Ky është turp! Njerëz të mirë! Këto i ka kurdisur Murati. E shihni atë? He-he! Ai, burrë me grua e fëmijë merr më qafë një vajzë të re. Ai e tërheq me vete për ta pasur si grua, se është pusht!

Oda u elektrizua. Trupat e të gjithëve u mbushën me mornica nga këto fjalë. Atëherë u ngrit Abazi dhe u lëshua mbi Adnanin. E përfshiu për jake, e shkundi dhe e qëlloi me pëllëmbë në fytyrë me sa fuqi që pati. Pastaj i ra me këmbë derës dhe e shtyu Adnanin në korridor.

— Ndyrësirë! — tha Abazi, duke u ulur.

Në këtë çast ndodhi diçka e jashtëzakonshme. Plaku Mere u ngrit, duke u mbështetur në shkopin e tij, dhe i hodhi një vështrim odës. Shega u step pranë të dërguarit.

Plaku Mere qëndroi një copë herë më këmbë. Njerëzit pritnin se ç'do të thoshte. I dërguari Xhabir lëvizti nga vendi. Mato Grudës i rrahu zemra me të madhe. Atij i vajti mendja te topi. «Po sikur të bëjë gjë?...»

Plaku Mere ngriti shkopin.

— Gjylja e madhe plasi! Mirë the zotrote! — iu drejtua ai të dërguarit.

Burrat e prenë frymën. Plaku Mere vështrroi edhe një herë dhe për çudi të të gjithëve filloi të qeshte përsëri me zë të lartë.

— Ha, ha, ha! Oot-ka komegej! Oot-ka komegej! Ai qeshte, sikur ta ngacmonte njeri me gisht nën sqetull. Kjo nuk ishte një e qeshur e shtirë, por një e qeshur e natyrshme, e ethshme gjer në histerizëm. Duke e

dëgjuar, njerëzit ulën kryet. Atyre u erdhi vështirë dhe turp nga kjo e qeshur.

Pas kësaj gajasjeje plaku Mere u zbeh më shumë se një qiri, u lëkund mbi këmbët e holla dhe ra në dyshe me pa ndjenja.

Burrat u derdhën mbi të. E kishte zënë sëmundja e tokës. Katër stërnipërit e tij e ngritën dhe e shpunë në hashef. Atje gruaja e Nevzatit e shtriu në dyshek dhe e mbuloi me jorgan. Ajo, megjithëse kishte dëgjuar që plakun Mere e zinte ndonjëherë sëmundja e tokës, u shqetësua.

— Mos vdesë! — belbëzoi gruaja.

— Nuk vdes, motër, nuk vdes! — tha Rahmiu.

Të katër stërnipërit e plakut Mere hynë pastaj në odë.

— Na falni, — tha Rahmiu, — plaku është i padurueshëm. Ai e ka të vështirë të pajtohet me Luftën Çlirimtare. Ndoshta edhe nuk mund të pajtohet. Pa le pastaj me Shegën! Na falni. Unë kam besim se ai me Tosun Baçin nuk mund të pajtohet... Ju nuk e dini!

— Po, po, keq shkoi puna... — tha Aliu.

I dërguari ngrii vetullat e tij të trasha:

— Unë do të thosha se shkoi mirë. Ju, djemtë e Fizëve, si mendoni për plasjen e gjyleve në oborrin tuaj? — iu kthye ai papritur Fizëve.

— Në fillim ne menduam se do të kishte qenë ndonjë gabim i topçinjve të pamësuar partizanë. Ndonjë gabim... Pastaj, kur në fshat disa ua hodhën fajin partizanëve, sikur gjoja këta e kanë qëlluar me dashje, e kuptuam se këto ishin llafe të armiqve për ta hedhur shtëpinë tonë kundër Lëvizjes, — tha Rahmiu.

I dërguari e vështroi Shegën, që e kishte pranë:

— Po ti, vajzë!

— Partizanët nuk kanë qëlluar! — tha ajo pa u lëkundur.

— Unë ty të besoj — tha i dërguari.

Mato Gruda gjatë gjithë mbrëmjes pothuajse nuk kishte folur asnjëherë. Atij iu kujtua papritur shpella ku u fsheh ditën që u thyen italianët në koriye. Flitej

në fshat se plaku Mere ka në mend të braktisë shtëpinë dhe të shkojë në atë shpellë. Edhe dyshekun, edhe dollapin e melhemrave, edhe kandilin do t'i shpjerë në shpellë. Shtëpia iu mërzit plakut Mere. Kështu flitej në fs'hat. Tani që Mato Gruda e pa se në ç'gjendje ndodhej plaku Mere, mendoj për shpellën. Mendoj dhe qeshi me vete...

— Pse qesh, Mato? — pyeti Murati.

Mato Gruda u kujtua.

— A, kot. Ç'vajti sonte, ore, ç'vajti! — tha ai.

I dërguari u vrenjt. Ndoshta atij nuk i pëlqeu kjo shprehje.

— Pse ç'vajti? — pyeti ai.

— Dua të them se shumë gjëra morën udhën e mbarë, — tha Mato Gruda i skuqur.

— Ke të drejtë! — tha i dërguari. — Megjithatë ne ende nuk e kemi zbuluar topin. Kush qëlloi? Nga? — përfundoi ai i menduar.

Mato Gruda uli sytë përdhe si grua. Ai e parandiente se qëndrimi i topit në koliben e qenit sa vinte e po bënej më i vështirë. Veç kësaj ai kishte frikë nga italianii.

«Mos i shkasë gjuha, gomarit» — tha me vete.

— Ne, shokë, — tha Murati, — duhet të jemi të pre-gatitur. Këto ditë vijnë gjermanët. Njësi duhet të bëjë rojë. Batalioni andej do të luftojë, por edhe njësi nuk do të rrijë duarkryq.

— Patjetër, patjetër! — thanë burrat.

Llamba ndriste në oxhakun e odës së Nevzatit. I dërguari Xhabir ndihej i lodhur. Tërë atë ditë, bashkë me Muratin, ai kishte shkuar shtëpi më shtëpi dhe kishte folur një për një me fshatarët. Edhe kjo mbrëmje me tërë ato trazira e lodhi dhe e shqetësoi. Ai e ngriti kokën e tij të madhe dhe iu drejtua përsëri burrave.

— Ju falem nderit, shokë! Sonte ne mbaruam. Udha e mbarë, juve që do të shkoni partizanë. Vdekje fashizmit.

— Liri popullit! — u dëgjuan zëra.

Burrat dolën të gjithë. Në fund mbetën vetëm Mato Gruda dhe Shega, stërmbesa e plakut Mere. Ajo nuk mund të kthehej më në shtëpinë e saj, se kishte frikën e Fahre-

mudinaliut. Për këtë arsye iu lut gruas së Nevzatit që të flinte në shtëpinë e saj gjersa të shkonte në batalion me partizanët. Veç asaj ajo donte të kujdesej edhe për plakun Mere, që dërgjej i shtrirë në hashef, i dërrmuar nga sëmundja e tokës. Shega tha se plaku Mere do të ishte një barrë për gruan e Nevzatit tërë atë natë.

— Gjyshi i madh është njeri i mërzitshëm dhe do të lodhesh, — i tha ajo.

— S'ka gjë. Një natë do ta durojmë, — qeshi gruaja e Nevzatit dhe ia hodhi Shegës krahun në qafë.

Në odë mbetën i dërguari, Murati dhe Mato Gruda.

— E, si t'u duk muhabeti i sotshëm? — pyeti i dërguari Xhabir.

— Mirë... — tha ngadalë Mato Gruda.

I dërguari iu kthye Muratit:

— Mato Gruda është në njësitin e fshatit? Sikur s'ma zuri veshi emrin e tij.

Murati e vështrroi Mato Grudën dhe përnjëherësh i hoqi sytë. Ai nuk donte ta fyente shokun e vet dhe i tha të dërguarit:

— Po, po, është!

Mato Gruda, uli sytë.

— Mato, si u bë halla? — pyeti Murati.

— Nuk e di. Kam ikur nga shtëpia që dje, — tha Mato Gruda.

— I dërgova disa kokrra aspirina... Nuk pata kohë të shkoja ta shihja, — tha Murati.

— A, ti ishe në batalion! — tha i dërguari. — E shputë dinamitin tek ura?

— E shpumë, — tha Mato Gruda.

Murati i ra me pëllëmbë ballit.

— Bah! Po ata nuk dinë të minojnë! Më pritnin sonte të shkoja unë...

I dërguari u ngrys. Ai e vështrroi Muratin me vetulla të vrenjtura.

— Po ç'më rri atëhere! Nisu tek ura! Neglizhencë, neglizhencë! — tha ai tërë inat.

— Unë ua lashë atyre italianin, — tha Mato Gruda.

— E, ç'e duan ata italianin? Për ballo? — tha i dërguari.

— Italiani është usta për mina... Di të hedhë në erë ura. Ashtu tha me gojën e tij.

— A, epo... — bëri i dërguari dhe nga fytyra e tij filluan të largoheshin retë e zemërimit.

Mato Gruda qëndroi edhe pak dhe mori të dilte.

— Po shkoj. Natën e mirë! — tha ai.

Pas ikjes së Mato Grudës, ata të dy ndenjën gjatë pranë zjarrit. I dërguari nxori fletoren e vogël të tij dhe filloi të shkruante, si zakonisht pas ngjarjesh të rëndësishme. Murati pinte duhan dhe trazonte zjarrin me mashën e gjatë. Gruaja e Nevzatit nuk hynte në odë, se e dinte që ata nuk kishin dëshirë t'i shqetësonte njeri...

Murat Shtaga kishte pakënaqësi ndaj shokut Ki, njeriut të qarkorit që e kishte dërguar shokun Xhabir të shqyrtonte veprimet e batalionit territorial, lidhur me goditjen e shtëpisë së Fizëve, por nuk kishte guxuar t'i hapej. Tani, pranë vatrës së shtëpisë, ai vendosi t'ia shfaqte mendimet e veta të dërguarit. Por ai priste sa të mbaronte së shkarravituri në fletorkë shoku i tij i zyrtarë. I dërguari nuk po mbaronte dhe Murat Shtaga nevríkosej. Më në fund ai tha me kokë të ulur në vatrë:

— Nuk e shoh të udhës kërkesën e shokut Ki. Më duket se dyshimet e tij për batalionin nuk janë me vend. Dyshimi për çdo gjë nuk është shpirt komunisti...

I dërguari ngriti kokën nga fletorka. E vështroi Muratin si nëpër mjegull, pastaj kafshoi lapsin, e vërtiti atë në dhëmbë, e hoqi nga buzët dhe e vuri në mes të fletores.

— Ashtu mendon ti, Murat? — pyeti ai.

— Po! — tha Murat Shtaga.

— Edhe ti mund të gabosh, edhe shoku Ki mund të gabojë. Ti mund të gabosh në sentimentalizëm, ai mund të gabojë në thatësi, — tha i dërguari. — Po nejtë. Topi ka qëlluar nga fshati. Ai është në fshat...

Murat Shtaga e la mashën. Ai e dëgjoj këtë mendim të të dërguarit Xhabir në mbledhjen që sapo mbaroi, por kujtoi se ishte thjesht një rrugëdalje taktike. Kurse tani po e dëgjonte përsëri, por të thënë me bindje të plotë nga një njeri që i peshon fjalët përpara se t'u japë udhë.

— Ti je i çuditshëm, — tha Murat Shtaga.

— I çuditshëm është ai që mban të fshehur një top, — tha i dërguari Xhabir.

KAPITULLI I NJËZETEDYTË

Dy gjëra nuk i largoheshin nga mendja Mato Grudës: shfaqja e Shegës në odën e Nevzatit dhe sëmundja e plakut Mere. Duke u kthyer në shtëpi natën vonë, ai i përfytyronte të dyja këto ngjarje të çuditshme, që ndodhën para syve të tij. Në të gjitha këto gjëra, që ai as që mund të mendonte se do të ndodhnin, duhej të kishin gisht i dërguari Xhabir dhe Murati. Ata ua kishin mbushur mendjen njerëzve të merrnin anën e partizanëve dhe të linin grindjet. Por Mato Gruda çuditej se si i dërguari Xhabir dhe Murati arritën të bindnin një femër nga shtëpia e Fizëve, ta bindnin dhe ta bënin që ajo të merrte pushkën e të shkonte bashkë me burrat në mal. Edhe cilën femër se! Stërmbesën e plakut Mere! Ky i dërguari Xhabir duhet të jetë njeri me rëndësi! — mendonte Mato Gruda rrugës për në shtëpi.

Ai kishte një parandjenjë se së shpejti do të ndodhte ndonjë gjë e jashtëzakonshme. I dërguari Xhabir dhe Murati atij iu dukën tepër të shqetësuar, sikur të fshihnin në shpirt diçka të padëgjuar e të paparë. Pse, xhanëm, me kaq ngut duan të mos ketë asnjë keqkuptim në fshat? Pse? Po të mos pritej të ndodhte gjë këto ditë, ata do ta merrnin punën shtruar-shtruar dhe dalngadalë do t'i bindnin njerëzit për drejtësinë partizane.

«Duket sheshit! Gjermanët nesër i ke në fshat!» — tha me vete ai.

Mato Gruda e kishte harruar mushkën që mbante për

kapistalli. U kujtua për të vetëm atëherë kur kafsha nguli këmbë para një grope dhe nuk donte të lëvizte.

— Yrrsh! — bëri Mato Gruda dhe tërhoqi kapistallin.

Ai tani qëndronte para portës së tij. Errësira kishte mbuluar shtëpinë. Ndriste vetëm dritarja e vogël e odës.

Mato Gruda lidhi mushkën në qilar dhe doli në oborr. Disa hapa larg tij nxinte kolibja e qenit. Baloja qëndronte në bisht pranë këmbëve të Mato Grudës dhe shikonte nga kolibja.

— Eh, Balo, s'dimë se si do të vejë puna! Keq e kemi edhe me topin!

Qeni lehu, si për t'i dhënë përgjigje.

— Të mirët e Fizëve dolën partizanë. Ashtu? Nuk dihet nëse janë të mirë, por dolën. Ama të ligjtë mbetën pa dalë...

Plaku Mere dhe Fahremudinaliu mbetën. Si thua, Balo, t'ia veshim edhe një herë shtëpisë së Fizëve? Dhe le ta marrë vesh i dërguari Xhabir, se kush qëlloi. Të gjithë le ta marrin vesh dhe të mos ua hedhin fajin partizanëve dhe Muratit!

Qeni lehu përsëri.

— Ta qëllojmë shtëpinë e Fizëve para se të vijnë gjermanët dhe ua shpiem topin partizanëve... Eh, Balo! — psherëtiu Mato Gruda dhe u drejtua nga kolibja.

Atij filloi t'i rrihte zemra si atëherë kur mendoj të qëllonte Fizët nga plevica. Me zemër të dredhur e hapi derën e kolibes. Asgjë nuk dukej. Zgjati dorën dhe preku jorganin që mbulonte grykën e topit.

— Fli, Haufman, fli! — tha ai në errësi.

Në këtë kohë ndjeu prapa shpine zërin e Zarës.
— Mato! Lëre, Mato! Hallë Esmaja është keq! — tha ajo e trishtuar.

Mato Grudës përnjëherësh i vrapoi nëpër trup një dridhmë dhe iu duk sikur iu prenë gjunjët.

«Eh! Gjermanët vijnë!... Ku të shkosh me një të sëmure për vdekje?» — mendoj ai.

— Mato, hajde! — tha Zara.

Mato Gruda u kthye nga gruaja, ia vari duart në qafë dhe mbështeti kokën në gjoksin e saj. Ai qëndronte ashtu

i tulatur me kokë në gjoks, si një njeri i lodhur dhe i munduar pas një udhe të gjatë. Këtë gjë Zara e ndjeu. Ajo i futi gishtërinjtë në flokët e tij dhe filloi ta lëmonte me dhëmshuri, siç lëmon nëna një fëmijë.

— U lodhe, Mato i zi, u lodhe! — tha ajo ngadalë.

Por ai nuk donte të dëgjonte asgjë, donte vetëm të prehej në gjoksin e Zarës atje në oborrin e asaj shtëpie të vetmuar mes maleve. Në atë shtëpi të veçuar nga të tjerat, Mato Gruda kishte jetuar pa njerëz e shokë. Të vetmin shok kishte pasur Murat Shtagën. Dhe në jetë kish-te pasur vetëm një synim: të priste sa t'i rriteshin pak fëmijët dhe të merrte hak ndaj Fizëve. Sa erdhi dita e hakmarrjes, ndodhën ngatërresa të tjera të mëdha. Njerëzit po e linin hakmarrjen e po merreshin me ca gjëra më të rëndësishme, siç thoshte Murati. Veç asaj vërtitej një gjëmë e madhe për të gjithë, gjëma e gjermanëve...

— Shkojmë, Mato!

Mato Gruda e ndjeu këtë zë si nëpër ëndërr. Ai ngriti kokën dhe mbylli derën e kolibes.

Të dy me Zarën hynë në odë. Ziguri rrinte te koka e hallë Esmasë. Në oxhak ndriçonte kandili. Herë pas here halla lëshonte një rënkim të mbytur.

Ziguri, kur e pa të atin, u ngrit.

— E? — pyeti Mato Gruda.

— Është shumë rëndë, — tha Ziguri ngadalë.

Këto fjalë Mato Grudës ia prenë tërë shpresat, se ato dolën nga goja e një të vogli. «I vogli është profet — mendoi Mato Gruda. — Fjala e tij është e vërtetë.»

Mato Gruda u ul më gjunjë para trupit të hallë Esmasë. Fytyra e saj ishte e verdhë, e verdhë. Mollëzat e faqe-ve i kishin hyrë brenda dhe ishin formuar dy gropëza të thella si brendësia e filxhanit. Merrte frymë me zor dhe damarët e qafës i kishte të tendosur. «Mbarove, moj e zezë!» — mendoi Mato Gruda.

Zara rrinte më këmbë dhe shikonte të shoqin. Ajo e ndiente dhembjen e Matos. Hallë Esmaja atë e kishte rritur dhe ai e kishte në vendin e nënës.

— Nuk flet? — pyeti Mato Gruda.

— Ndonjëherë flet mirë, ndonjëherë përçart, — tha Zara.

— E shkreta! — psherëtiu Mato Gruda dhe e ndjeu që po i mbusheshin sytë me lotë!

Në këtë çast hallë Esmaja rënkoi dhe filloi të lëvizte.

— Hallë Esma! — tha Mato Gruda.

Hallë Esmaja ngriti nga jastëku kokën dhe u mundua të çohet. Mato Gruda ia vuri krahët dhe e ngriti. Pastaj ia afroi jastëkun për ta mbështetur. Ajo rrotulloi sytë nëpër odë e tha:

— Ja, erdha. Pse nuk gëzohesh ti, vëllai im i vogël? Ty, Jusuf, të flas. Afrohu! Më prite shumë edhe ti, Zigur, po erdha. Hajde te motra edhe ti, Sadik! Po ti, Xhemal, të keqen motra, mos je lodhur? Po Serveti ku është? Hajde, Xhemile, hajde, nuse, se pastaj i mjel dhentë! Erdha unë! Ju nuk e kenë marrë vesh? Matua i ra me top plakut Mere dhe tani në gërmadhat e tij këndon kukuvajka. Ta shihnit si digjej! Sa xhephane u zbraz, more të uruar! A, ti, gjysh Hyseni, e paske marrë vesh! Ja ku po të them, nipi yt, Mato Gruda, mori hakun e të gjithëve! Me top mori hak. Gjylet brenda në shtëpi të Fizëve i hodhi. . . Unë erdha t'ju tregoj dhe do të shkoj prapë. Do të pres pak sa të takoj edhe Servetin dhe do të shkoj. Po ç'u vonua ky Serveti? Në korije është? S'ka gjë, le të vonohet. Plaku Mere nuk jeton më. S'ka kush ta vrasë Servetin! . . .

Hallë Esmaja fliste, duke ndenjurr në dyshek, fliste qartë, bukur.

Mato Gruda, Zara e Ziguri dëgjonin të heshtur.

— Flet me të vdekurit, — tha Zara.

— Edhe për topin! . . . — tha Mato Gruda.

— E zeza! — tha Zara.

— Pse, e zeza? — tha për çudi të të gjithëve hallë Esmaja. Zara kapuliti sytë.

— Shtrihu, hallë Esma, u lodhe! — tha Zara.

Hallë Esmaja erdhi në vete. Ajo ktheu kokën dhe pa Maton që i rrinte pranë. Atëherë zgjati dorën dhe ia lëmoi flokët.

— Mato evlat! Ki kujdes fëmijët dhe Zarën. Halla do

të vdesë, — tha ajo ngadalë tanimë me një zë të mekur e të lodhur.

— Jo, hallë, ti do shërohesh. Unë do të gjej ilaçe. Do shkoj edhe në qytet të marr doktor Kristofor Boshon. Po shtrihu pak, shtrihu...

Hallë Esmaja u shtri. Pas një heshtjeje të gjatë ajo psherëtiu:

— S'ka ç'më bën doktori, Mato evlat!

Ndërsa në odë merreshin me hallë Esmanë, jashtë në oborr kërciti porta dhe lehu me të madhe qeni. Zara dhe Mato Gruda shikuan njëri-tjetrin.

— Porta? — pyeti Mato Gruda.

— Porta! — tha Zara.

— Mato Gruda u ngrit. Zara e ndali:

— Po shkoj ta hap unë, — tha ajo.

Zara doli. Në oborr u dëgjua një zë burri. Pyeste për Mato Grudën.

Mato Gruda, sa dëgjoi këtë zë, doli nga oda.

— Kush është? — pyeti Mato Gruda.

Në prag të portës, nëpër errësirë, ai dalloj fytyrën e Baftjar Fizit, stërnipit të plakut Mere.

— Më dërgoi Murati, — tha Baftjari. — Nesër vij në gjermanët. Gjithë fshati duhet të ikë në mal. Kjo të bëhet pa u zbardhur mëngjesi.

— Ashtu? — pyeti Mato Gruda.

— Njësitë do të mblidhet më të dalë të fshatit. te rrapi, pranë bërrylit të lumit Krak. Vëllezërit e mi ikën që sonte në batalion. Mua më ndaloi Murati dhe më tha se duhet të rri hëpërhë me njësitin. Ti shpjere familjen në mal dhe, po të duash, pastaj hajde te bërryli i lumit Krak me njësitin. Po të mos kesh armë, kam unë një dyfek të vjetër austriak, — tha Baftjari.

Ardhja e Baftjarit në fillim e çuditi. Si guxonte Baftjari të vente në shtëpinë e tij? Edhe kush i fliste Mato Grudës për njësitin dhe dyfekun e vjetër austriak pa! Atij iu kujtua sheshi i xhamisë, kur Baftjar Fizi i penduar qau para Tosun Baçit. «Kur u bind ky që të kthehet përsëri me Murat Shtagën? Apo njëherë qau para Tosun Baçit dhe njëherë bëhet trim para Murat Shtagës?...»

— Si the? — pyeti Mato Gruda.

— Thashë që të vish në njësit dhe, po të mos kesh pushkë, të jap unë një «austriak», — tha Baftjari.

— Unë, o Baftjar Fizi, do të pres sa të të thahen lotët që derdhe para Tosun Baçit, pastaj do të vij ta marr «austriakun» tënd... Edhe dëgjo këtu. Fizët mua nuk do të më mësojnë se si të luftoj e me cilin të luftoj. Dëgjo këtu... Unë ju nuk dua t'ju... — Mato Grudës iu mor goja. Zara e tërhoqi për krahu..

Baftjar Fizi psherëtiu. Ai nuk donte të ashpërsonte marrëdhëniet me Mato Grudën.

— Unë të thashë ato që më porositi Murati! — tha ai dhe iku.

Mato Gruda mbylli portën. Zara kishte kryqëzuar duart dhe qëndronte në oborr.

— Do të më shesë mend! — tha Mato Gruda.

— Eh, Mato! Zihesh kot! — tha Zara.

Ai, pa i dhënë përgjigje së shoqes, hyri në qilar. Zara i ra pas. Burri zgjidhi mushkën dhe e nxori në oborr. Pastaj iu afrua kaut. E fërkoj me dorë në kurriz dhe i tha ngadalë:

— Eh, Kazil! Erdhi koha të ikim në mal. Ti më ke rritur dy fëmijë, Zigurin dhe Sadikun. Dhe unë nuk të lë ty në dorë të gjermanëve.

— Ç'do të bëjmë, Mato? — pyeti Zara në errësirën e qilarit.

— Nuk e dëgjove se ç'tha ai? Vijnë gjermanët. Do shkojmë në shpellë...

— Po hallë Esmaja?...

— Edhe atë do ta marrim.

— Po do të vdesë rrugës, — tha Zara.

— Të shpresojmë! Shko vishe hallë Esmanë...

Zara shkoi të pregatitej, ndërsa Mato Gruda hyri edhe në plevicë për të parë Larën, lopën barsë. Lopa mund të pillte edhe atë natë dhe ai e ruante si sytë e ballit. Gjithë shtëpia e kishte mendjen te Lara, te kjo lopë e bukur me një pullë të bardhë në ballë.

— Edhe për ty, moj e shkretë Larë, erdhën kohë të vështira. Mos u tremb, Larë! Po të trembesh, dështon, moj e gJORë. Mitralozat do kërcasin, gjylet do gjëmojnë, po ti

mos u tremb. Unë do të të lë këtu, se ti nuk ngjitesh dot në mal, se e ke barkun të madh, po do të të fsheh, që mos të të gjejnë gjermanët, — tha Mato Gruda, ndërsa lopa filloi të pëlliste.

Ai pastaj mendoj se çfarë duhej të merrte me vete në shpellë. Domosdo, duhej të merrte bukë, miell, gjalpë, kripë, qepë, piper... Me një fjalë duheshin ato gjëra që nevojiteshin për të jetuar. Por të gjitha menjëherë nuk mund të shpiteshin në shpellë. Duhej të shkonte e të vinte disa herë.

Mato Gruda iu afrua dritares së odës e thirri:

— Zarë!

— E!

— Bukën që kemi hidhe në thes. Në thesin tjetër hidh kusinë, tiganin, sahanët. Merr edhe gjërat e tjera që na duhen, — tha Mato Gruda.

— Ku i shpiem dot! — tha Zara.

— S'ka gjë! Ca i vëmë në mushkë, ca i mbajmë në kurriz, — tha Mato Gruda.

Pastaj ai ia vuri samarin mushkës dhe ia përgatiti litarët.

Qeni vërtitej nëpër oborr dhe vraponte pranë kafshëve, duke luajtur me to. Mato Gruda thoshte nëpër dhëmbë:

— E gjete kohën të lozësh! Luaj, o Balo, luaj!

Baloja lehu, si për t'i dhënë përgjigje.

— E gjithë kjo zallamahi ty të duket si lodër, se aq tru ke, — tha Mato Gruda ngadalë.

Kur ia vuri qenglën dhe pallëmin mushkës, erdhën Ziguri e Sadiku, duke mbajtur një thes.

— Lëreni në sofat. E veshi Zara hallë Esmanë?

— E veshi, po ajo mezi merr frymë, — tha Ziguri. Mato Gruda nuk foli. Ai e ndjente vdekjen e hallë Esmasë dhe zemra i pikonte gjak. Atë nuk duhej ta gjente vdekja në shpellë, në një kohë kaq të egër. Nëna e babai iu dogjën. Halla vdes në shpellë. Ç'ishte ky mallëkim për Grudët?

Djemtë sollën edhe thesin tjetër.

— Baba, hajde ta ngremë hallën! — tha Ziguri.

Mato Grudën këto fjalë e trishtuan. Iu duk sikur e ftonin të ngrinte e të zbriste nga shkallët një trup të vdekur.

Ai ngjiti ngadalë shkallët. Pa hyrë në odë, ndjeu ankimet e hallës.

— Ku më shpini? . . . Më lini të vdes këtu. Nuk dua të vdes udhës. . .

Ai qëndronte në prag të derës i pikëlluar dhe shikonte hallën. E veshur me të zeza, ajo rrinte e shtrirë në dyshek. Ishte venitur krejt. Këmbët i ishin tretur dhe i tërë trupi i saj kishte mbetur sa një gusht.

Mato Gruda iu afrua. U ul më gjunjë para saj e tha:
— Do të ikim, hallë. Gjermanët vrasin ç'gjejnë. Ne nuk do të rrimë shumë në shpellë. Prapë do të kthehemi.

Hallë Esmaja, pa e kthyer fytyrën nga i nipi, tha:
— E ç'më duan mua gjermanët! Unë e vdekur jam. Le të vdes këtu! . . .

— Gjithë fshati do të ikë! — tha Mato Gruda.

— Le të ikë. Më lini një gotë ujë te koka, sa të lag buzët.

— Hallë Esma, ti e ke plot shtëpinë me njerëz. Ne do të jemi bashkë. Ku të venë të gjithë, edhe ti. . . — tha Zara me duar të kryqëzuara në gjoks. Ziguri dhe Sadiku kishin ulur kokat e qëndronin më këmbë para saj. Sadiku, më i vogli, mbuloi fytyrën me dorë që të mos ia shihnin lotët. Hallë Esmasë i shkuan sytë nga ata dhe psherëtiu thellë:

— Mos qani, bijtë e gjyshes. . . Kështu qenka e thënë. Do të vijë gjyshja. Ngremë, Mato.

Mato Gruda e zuri hallë Esmanë dhe e ngriti si një fëmijë me krahët e tij. Këmbët e saj vareshin të pafuqishme. Ajo ishte e lehtë si një njeri prej kashte. Atëherë ai nuk i përmbajti lotët. . .

Hallë Esmanë i nipi e vuri në velenxën e samarit të mushkës dhe Zara ia hodhi përsipër jorganin. Plaka qëndronte në samar në mes të dy dengjeve me dyshekë e bantaje.

— Ti, Zarë, mbaje për krahu. Unë po marr thesin me

enët e me zahirenë. Ti, Zigur, tërhiqe për kapistalli mushkën. Ti, Sadik, ngite nga pas Kazilin.

— Po marr edhe unë thesin e vogël, — tha Ziguri...

Ata u nisën malit, si muhaxhirë, nëpër natën e ftohtë. Zara mbante për krahu hallën, Ziguri me një thes në shpinë tërhiqte për kapistalli mushkën, Mato Gruda ecte me një thes në kurriz e një torbë në krah dhe Sadiku ngiste kaun. Ishte ftohtë dhe era fërshëllente dushk më dushk. Tutje dëgjoheshin të lehurat e qenve. Fshati Arun ikte...

Mato Gruda ecte i zhytur në mendime. Mbartin njerëzit duke ikur hasmëri të lashta e të reja, grindje për hiçgjë me njëri-tjetrin, por a nuk e ndiejnë se përpara një gjëme të madhe të gjithë janë të barabartë? E çfarë se ai, Mato Gruda, ka një hasmëri me Fizët? Edhe Mato Grudën e vret gjermani, po ta zërë, edhe Baftjar Fizin e vret gjermani, po ta zërë... Matos i erdhën në mend fjalët e Muratit: «Një hakmarrje kemi, hakmarrjen ndaj armikut!» Ash-tu është. Po a i bën zemra Mato Grudës të rrijë në një sofër me Baftjar Fizin? Hë! Po ç't'i thuash kësaj, që ata në këtë natë janë të barabartë?

Rruga nëpër korije kishte baltë dhe ata mezi ecnin. Hallë Esmaja në samar të mushkës rënkonte e mallëkonte veten, si nuk vdiq një javë më parë. Qeni ecte përpara e herë pas here lehte.

— Pusho, Balo! — thoshte Mato Gruda, duke ngulur e hequr këmbët nëpër baltë.

Të këputur nga udha, ata, me bagëtitë e plaçkat, iu afruan shpellës. Tanimë kishte mbetur vetëm një e përpjetë.

Kur e ngjitën të përpjetën, u kthyen nga ana e majtë dhe dolën te shpella. Atëherë, mu në grykë të saj, e zbritën hallë Esmanë. Plaka mezi mbante shpirtin. Kishte edhe të ftohtë, megjithëse ishte mbështjellë me një jorgan të trashë. Ajo ishte aq e sëmurë, sa edhe fjalët që fliste, nuk i merreshin vesh.

Mato Gruda e mori në krahë. Këtë radhë ajo iu duk më e lehtë se në odë, sikur të kishte bërë firo udhës. Me hallën në krahë ai u drejtua në grykë të shpellës. Duke hyrë brenda, vuri re se në një qoshe të shpellës diku thellë

ndriste një kandil. Pranë kandilit mezi dallohej fytyra e palëvizshme e një njeriu. Zara që vinte pas të shoqit, me ta parë kandilin dhe fytyrën e palëvizshme të njeriut, pada-shur bërtiti dhe kafshoi dorën për të mos lëshuar edhe një britmë tjetër.

— Shsht — tha Mato Gruda.

Atëherë Zara e ndezi kandilin e saj dhe errësira rreth tyre u largua. U duk sikur në shpellë u hap një vrimë e madhe e ndritur. Nën dritën e kandilit ata vunë re një kënd të shtruar me kashtë. Burri e lëshoi ngadalë hallë Esmanë në këndin e shtruar me kashtë dhe mori frymë thellë.

— Arritëm! — tha ai.

Zara nuk ia ndante sytë kandilit dhe fytyrës së palëvizshme. Ajo fytyrë asaj i dukej e njohur. Dhe përnjëherësh në vetëdijen e saj ndriti një kujtim, si një shkëndijë elektrike:

— Plaku Mere!

— Ai është! — tha i shoqi.

Burri doli nga shpella dhe shkarkoi nga mushka den-gun me dyshekë. Pastaj e mori në krahë dhe e lëshoi pranë hallë Esmasë.

— Shtroje dyshekun atje! — tha ai.

Tek Zara shtronte dyshekët, në shpellë erdhën të gjithë. Ata qëndronin më këmbë para trupit të hallë Esmasë. Asnjeri nuk fliste. Ziguri e Sadiku shikonin kandilin në qoshen e largët dhe i bënë me shenjë njëri-tjetrit.

— Uluni, se u lodhët, — tha Mato Gruda.

— Baba, kush është ai atje? — pyeti Sadiku, duke treguar me gisht fytyrën e palëvizshme.

— Njeri, si ne, — tha ai.

Nga qoshja, ku ndriste kandili, u dëgjua kolla e thatë e plakut Mere.

— Brr! — u drodh Zara.

— Ai nuk ha njerëz. Edhe ai iku nga gjermanët! — tha i shoqi.

— Kush është, baba? — pyeti përsëri Sadiku.

— Plaku Mere! — tha Ziguri ngadalë.

— Shëndoshë të jetë! — tha Mato Gruda.

Ndërkohë hallë Esmaja lëvizi dhe u kthye në krah.

— Mato, ç'janë ata sy që më shikojnë atje në qoshe?
— pyeti ajo papritur.

Mato Gruda ia vuri dorën në flokët dhe u përkul pakëz pranë saj.

— Fshatarë që fshihen nga gjermanët, — tha ai.

Hallë Esmaja përsëri ra në qetësi dhe humbi në ëndrën e saj.

Që nga qoshja, në fund të shpellës, u dëgjua zëri i plakut Mere, që dukej sikur dilte nga një grykë e thatë e një njeriu që jeton vetëm me duhan dhe kafe, pa e lagur atë as me një pikë ujë. Ai zë të kujtonte një njeri që ishte ngritur herët në mëngjes, pasi kishte pirë gjysmë oke duhan:

— Avyçka kurtfa-ka ersimez! (Vdekja bile nuk ka mëshirë as për pleqtë dhe as për plakat.). — Ai pastaj shtoi:
— Kudreti birle ufan kadir jumurdi barçasyn. (I plotfuqishmi me forcën e tij i zhduku!)

Këto fjalë u hapën në shpellë dhe mbetën të pakuptuara.

Vetëm ato që erdhën pas u kuptuan:

— Gjëmë e madhe po vjen. S'janë gjë ato gjëma që kemi parë gjer më sot! Allah!

Zëri erdhi i mbytur nëpër shpellë. Zara kafshoi përsëri dorën që të mos bërtiste.

Mato Grudës padashur i vajti dora në revolverin italian. Atë revolver ai e mori në koriye bashkë me topin. Edhe revolverin, edhe topin kishte menduar t'i zbrazte kundër plakut Mere e shtëpisë së tij. Në këtë natë të errët të dy janë në një shpellë. Të dy kanë një shtëpi të përbashkët me një çati të përbashkët. Si erdhi puna! Të dy kandilët ndritën: njëri këtej, tjetri andej. Po të kishte një kandil të madh në mes të shpellës, nuk do të kishte nevojë për dy kandilë. Do të mjaftonte ajo dritë edhe për plakun Mere edhe për Mato Grudën. A do të besonte ai sikur t'i thoshin se do të vinte një ditë që të dy shtëpitë hasme do të rrinin bashkë? «Po sikur ta dinte hallë Esmaja se pranë saj rri dhe plaku Mere? Nejse, — mendoi Mato Gruda, — në gjëma të tilla hasmëria edhe mund të falet, por, sa të ikë gjëma, ajo prapë mbetet hasmëri.»

Ai e hoqi dorën nga revolveri. Jashtë u dëgjua pëllitja e kaut. Mato Gruda mendoj: «Mos ftohet i ziu Kazil. Po Lara ç'bën vallë në plevicë? Po dështoi, mbetëm pa qumësht. Dimri pa qumësht, behari pa qumësht!...»

— Zigur, — iu kthye të birit, — i lidhe kafshët?

— I lidha! — u përgjigj i biri.

— Sikur ta lidhim Kazilin këtu në shpellë?

— Mirë thua, jashtë është ftohtë, — tha Zara.

— Kam frikë se do të vijmë edhe njerëz të tjerë nga fshati, — mendoj Mato Gruda.

— Të presim — tha Zara.

— Unë e Ziguri do të shkojmë përsëri në fshat, të sjellim bar për kafshët dhe ca gjëra të tjera për ne. S'dihet se sa qëndrojmë këtu, — tha Mato Gruda.

Pa e mbaruar fjalën burri, jashtë shpellës u dëgjuan zëra grash e të qara fëmijësh.

— I mbledh kjo shpellë, i mbledh!... — tha plaku Mere nga fundi i guvës.

Në shpellë po vinin të gjitha gratë dhe fëmijët e fshatit. Burrat i sillnin gjer në grykë të saj, i linin dhe iknin përsëri të heshtur. Asnjëherë banorët e fshatit Arun nuk ishin mbledhur bashkë si këtë radhë. Fëmijët qanin bashkë, gratë zhurmonin bashkë. Errësira dhe drita e shpellës ishin të përbashkëta. Të pesë fiset e fshatit Arun, si pesë gishta dore, përbënin një pëllëmbë...

Mato Gruda takoi Aliun, që sillte gruan dhe fëmijët e tij dhe të vëllezërve. Pak më tutje njëri nga fisi i Pinxhove sillte fëmijët dhe plakat. Afër grykës së shpellës ishte e ëma e Murat Shtagës me nusen dhe dy vajzat e vogla.

Shpella zhurmonte nga zërat e fëmijëve dhe të grave. Nga gryka dukeshin kandilët, si xixëllonja të vogla.

— Po ai kush është? — pyeti gruaja e Aliut, duke shikuar nga kandili në fund të shpellës.

— Plaku Mere! — tha ngadalë Zara.

— Uh, si s'e ha një mortje. Dyqind vjet u bë dhe prapë i dhimset shpirti! — u hodh gruaja e Ngvzatit.

— Halla si është? — pyeti e shoqja e Pertefit.

— Keq! — u përgjigj Zara.

Mato Gruda rrinte më këmbë.

— Do të vij edhe unë me ty, Mato! — tha Zara.

— Po hallën? — pyeti ai.

— Ja, le ta ketë kujdes Bajamja, — iu kthye Bajames, gruas së Nevzatit. — Të sjellim ndonjë gjë, se do të vdesim për të ngrënë.

— U, posi, shkoni! — tha Bajamja.

— Kujdes, Bajame, edhe djalin e vogël! — tha Zara.

— Mos ki merak!

Mato Gruda zgjidhi mushkën dhe mori tatëpjetë korijes bashkë me gruan e të birin.

Kishte kaluar mesi i natës...

KAPITULLI I NJËZETETRETË

Shumica e fëmijëve e grave dhe e pleqve të fshatit kishin shkuar në shpellë. Në fshat kishin mbetur burrat dhe ata pleq e plaka, që, si i thonë, e kishin marrë vdekjen në sy. Edhe ata që ishin në shpellë, edhe ata që kishin mbetur në fshat, pritnin nga çasti në çast të vinin gjermanët. Por ata po vonoheshin dhe në zemrat e njerëzve ndizeshin shpresat: ndoshta gjermani ka ndërruar mendje, a ndoshta ia ka zënë shtigjet andej thellë Brigada e Parë partizane, nami i së cilës ishte hapur si vetëtimë në çdo grykë e mal. Kishte njerëz që thoshin se nja dy batalione të saj bile kishin ardhur dhe kishin zënë gjithë kodrat e fshatit Arun dhe do t'i bënin pluhur dhe hi gjithë gjermanët që do të guxonin të ngjiteshin andej. «More, hiç, as lëvizim nga fshati! Këtej kemi batalionin teritorial, andej Brigadën e Parë, në fshat njësitin tonë. Hiç, o s'kanë ç'na bëjnë!» — thoshin burrat më të urtë të Arunit që kishin mbetur nëpër shtëpitë.

Edhe Mato Grudën e përkëdhelnin këto shpresa, por sidoqoftë ai ishte përgatitur edhe për ditë të zeza. Ai, pasi shpuri shumë ushqime në shpellë, ushqime edhe për fëmijët e Muratit dhe të Nevzatit, filloi të fshihte ato pak plaçka e orendi, që, edhe sikur të digjej shtëpia, të kishte ku të fuste kokën. Por atë më shumë e shqetësonte Lara, së cilës po i vente barku gjer në tokë dhe nuk po pillte. «Më mirë të mos mbarsej, e zeza! Lufta nuk është as për fëmijët e kafshëve, as për fëmijët e njerëzve! E ku të

shkojë kjo e zezë me një viç pas vetes, kur të fërshëllejnë plumbat? Gjynah i madh! Breh!» — mendonte Mato Gruda duke përkëdhelur Larën në plevicë.

Nëpër të çarën e gardhit të plevicës hyri një tufë rrezesh dhe ra para hundës së Larës. Lara filloi të tundte kokën e të lozte si një mëshqerrë e vogël. Mato Gruda e pa dhe qeshi. «Ah, ç'lozonjare është, ah, ç'lozonjare! Me gjithë këtë bark, që i ka vajtur gjer në thembrat, dhe lot sikur të ishte njëvjeçare!»

Si e pa që Lara i gëzohej diellit, ia zgjidhi litarin dhe e nxori në lëndinë prapa plevicës. «Le të gëzohet e bekuara» — tha ai dhe e la vetëm.

Ai shkoi në odë e u tregoi Zarës dhe Zigurit për lopën që i ishte gëzuar diellit dhe që e kishte nxjerrë në lëndinë.

— Mos largohet shumë, se ndien erën e bagëtive të tjera që kanë ikur nga fshati, — tha Zara.

— E ku lëviz dot me tërë atë bark, — tha Mato Gruda.

Pastaj ata mbushën një kade me misër dhe nja katër a pesë qype me miell që i kishin futur në një gropë në oborr. Mato Gruda vuri mbi kaden dhe mbi qypin ca dërrasa dhe mbi to hodhi kashtë. Mori lopatën dhe filloi ta mbulonte gropën me dhë të njomë.

— T'i hedhim përsipër edhe ca gurë e ndonjë plis me bar që të mos u shkojë në mend gjermanëve, — tha Ziguri, si një i madh me përvojë.

Mato Gruda ngriti kokën, i mbështetur pas lopate, dhe qeshi. «U rrit — mendoi ai. — Kjo qerrata luftë i rrit shpejt edhe fëmijët.»

— Zarë, e di që mirë thotë Ziguri? — iu kthye ai së shoqes.

— Ziguri është një nga trarët e shtëpisë, — qeshi Zara.

Ziguri mori belin dhe shkoi në lëndinë për të prerë plisa. Mato Gruda e ndoqi me sy të birin.

— Ai mund ta zbrazë edhe topin! — tha ai pa iu drejtuar njeriut.

— Mendja tek ai i shkretë të shkon, — tha Zara.

Mato Gruda nuk foli. Nën strehë, pranë gropës ku mbulohej zahireja për ditë të zeza, ngrohte dielli i dobët

i dimrit. Burrë e grua qëndronin në këto rreze dhe mendonin për shtëpinë, fëmijët, fshatin, topin e hallë Esmatë që dergjej në një dyshek në shpellë.

Ndërkohë trokiti porta. Mato Gruda vrapoi ta hapte. Para tij doli Augustoja i parruar, me një pushkë të shkurtër italiane në krah.

— Agush! — thirri Mato Gruda dhe e përqafoi.

— Erdha t'ju shoh, Mato, — tha Augustoja.

Italiani hyri në oborr dhe e zuri për dore Zarën që qëndronte para gropës së mbuluar.

— Zara mirë? Ziguri mirë? Halë Esma mirë? Sadiku mirë? — pyeti ai një për një për të gjithë.

— Mirë, Agush! Ti si je? — tha Zara, duke parë njëherë pushkën e Augustos, njëherë fytyrën e tij të parruar.

Në këto e sipër vrapoi Ziguri me bel në dorë.

— Baba! — klithi ai tërë gaz. — Baba! Lara ka pjellë! Pu-pu, ç'viç të madh ka bërë!

— Për hajër të jetë! — thirri Mato Gruda.

— Gaz! — tha Zara.

— Bukur Lara! — tha Augustoja dhe përpoqi shuplakat.

Të katër nxituan për të marrë Larën dhe viçin e porosalindur. Pas tyre vraponte qeni, duke lehur.

Viçi ishte ulur dhe Lara e lëpinte me gjuhën e saj të gjatë. Rreth lopës dhe të voglit ishin mbledhur harabelët me cicërime. Mato Gruda e puthi Larën në ballë, në atë trekëndëshin e bardhë.

— Të të rrojë, Larë, dhe shyqyr që shpëtove! — i tha ai. Pastaj u ul dhe e mori në krahë viçin, siç mernte fëmijët.

— O kolopuç, sa paske ngrirë! — i tha ai të voglit, pastaj iu kthye Zarës e Zigurit: — Merreni atë shtratin dhe mbulojeni në tokë! — e u drejtua nga Augustoja; — Që thua ti, Agush, shtrati, ja ajo lëvozhgë e madhe prej mishi, e përgjakur, që mbështillte viçin në bark të nënës,

duhet mbuluar në tokë, se bën vaki që e ha lopa dhe nuk pjell tjetër. E di ti, apo s'e di?

— Di, — tha Augustoja.

— E shihni? Edhe italianët këtë adet paskan, — tha Mato Gruda me vësh në dorë.

Ai ecte, lopa e ndiqte pas, duke mos ia ndarë sytë vicit, pjellës së saj. Mato Gruda qëndroi dhe e lëshoi ngadalë vëcin në lëndinë. Lara filloi ta lëpinte përsëri. Të katër shikonin me një gëzim e mall në fytyrë.

— Me atë demin e mirë duhet ta ketë, — tha Mato Gruda me vështrim nga vici.

— Me atë, po me kë? — tha Zara.

— Mos është mbarsur më parë sesa ta bashkonim me atë demin e sojit të mirë, — tha Mato Gruda, duke i ngulur më tepër sytë në vëcin që lëpinte lopa.

— Nuk e sheh sa i bëshëm është? — tha Zara.

— Mirë thua. Goxha vëc. Me atë dem duhet ta ketë.

Lara nuk na turpëron.

Lara ngriti kokën dhe vështroi nga i zoti. Vici hodhi dy këmbët e para, u mbështet në këmbën e pasme dhe u ngrit. U ngrit me zor dhe qëndroi me këmbë të hapura. Lara i shkoi pranë dhe lehtë-lehtë e lëpiu, duke pasur frikë se mos e rrëzonte. Mato Gruda buzëqeshte.

— U ngrit! Mbaroi puna. Tani ai gjithnjë do të ecë me këmbët e veta! A dëgjuat? U ngrit, — tha ai.

— E mjaft, de! Si fëmijët bën! — tha Zara.

— U ngrit! — thirri Augustoja pak me vonesë dhe u hodh përpjetë, duke përplasur si zakonisht shuplakat.

Vici shkoi pranë lopës dhe ajo ia afroi gjirin. Atëherë Mato Gruda thirri:

— Zarë, shtrydhja sisët. Ato kanë qumësht të trubullt, të përzier me gjak. Shtrydhja, se nuk bën ta pijë atë qumësht. Dëgjove, Agush? — iu kthye ai italianit.

— Mato njeri madh! — tha italiani.

— Atë e di unë, — tha Mato Gruda.

Zara u ul dhe futi duart në gjinjtë e lopës. Ata ishin të fortë, të mbushur me qumësht dhe nuk mund të mileshin pa i lagur pak me ujë të vakët. Prandaj i tha Zigurit të sillte kusinë e vogël me ujë. Ndërkohë Augustoja përkë-

dhelte viçin, që qëndronte më këmbë indiferent ndaj gjithçkaje që ndodhte rreth tij. Këto dy qenie të gjalla në këtë lëndinë i bënë njerëzit që për një çast të harronin shqetësimet dhe tragjeditë që po ndodhnin mes këtyre maleve.

E shoqja e Mato Grudës mori kusinë e vogël me ujë të vakët që ia solli i biri dhe lagu sisët e lopës. Pastaj i shtrëngoi dhe i shtrydhi. Qumështi i trashë, herë i verdhë e herë i kuqërremë, mezi dilte.

— E shihni? Nuk duhej të pinte viçi. Qumështi ka edhe gjak, — tha Mato Gruda.

Fjala «gjak» atyre ua hoqi mendjen nga lopa e viçi dhe i hodhi përsëri në luftën. «Ama, edhe unë me çfarë po merrem!» — mendoi Mato Gruda dhe u vrenjt. Mendja i fluturoi te topi, pastaj te Murat Shtaga dhe te shpella, ku ishin fshehur njerëzit.

— Ti, Agush, nuk do të kthehesh më në fshat? — pyeti ai.

— A? — bëri Augustoja.

— Them, a do të qëndrosh këtu, apo... — tha Mato Gruda.

Augustoja u mendua.

— Komandant partizan më mban në mal, — tha ai.

— Demek, nuk kthehesh, — tha Mato Gruda.

— Vij shoh. Ik prapë, — u përgjigj italiani.

Mato Gruda vrenjti vetullat, sikur të mos i pëlqenin këto fjalë. «Ky mendon sikur unë do të rri tërë jetën këtu. Prit, o italian vëllai, edhe pak, pa të më shohësh se ç'kam për të bërë!» — mendoi ai.

— Si thua ti, e gjen gjë topin nga lagështia? — pyeti përnjëherësh Mato Gruda.

— Po të rrijë shumë brenda, gjen. Nuk shkrep, — tha Augustoja.

Mato Gruda u drodh sikur të shkelte në gjemba.

— Tek ura rri ti, Agush? — pyeti ai, duke e lënë topin.

— Tek ura. Gjermani vonon. Erdha të përcillem. Shkoj tani tek ura. Pret fitili.

— Po dëgjove të shtëna topi, kujto se jam unë! — tha Mato Gruda i menduar.

— Ç' thua, Mato! — pyeti gruaja, duke i shpëtuar dora nga sisa e lopës.

— Atë që thashë, — u nxeh Mato Gruda.

— Qëllim madh Mato. Hero nacional Mato, — tha Italiani.

— Atë e di unë! — tha Mato Gruda dhe mori vëcin në krahë.

Bari ishte bërë i verdhë nga qumështi. Mato Grudës nuk i erdhi mirë që e shoqja e kishte mjelë lopën drejt e në bar.

— Ta kishe mjelë në kusi. Është gjynah ta hedhësh qumështin në bar. Zigur, mbuloje me ca dhë qumështin. Nuk duhet ta shkelin njerëzit. Aq më keq sikur të vijnë gjermanët e ta shkelin me këmbë! Apo doni të na shkojnë ters punët. — tha Mato Gruda dhe u nis nga plevica me vëç në krahë.

Lopa ecte pas Mato Grudës rëndë-rëndë si një damë.

Kur hynë në oborr, Lara filloi të pëlliste nga frika se mos ia fshihnin vëcin. I zoti e qetësoi duke i folur me zë të ulët dhe ajo e kuptoi, se e dinte gjuhën e tij.

Në plevicë Mato Gruda e la lopën të zgjidhur. I hodhi një vandak me jonxhë të thatë dhe e fërkoji në kurriz. Vëci iu afrua gjirit të nënës dhe filloi të pinte. Ai, duke pirë, e tundte bishtin e vogël. Dhe atëherë Mato Gruda e vuri re se fundi i bishtit ishte i bardhë.

— I ngjan demit të mirë, — u kënaq ai. — Tani t'i lëmë vetëm nënën dhe birin.

Ata dolën dhe mbyllën derën e plevicës.

Augustoja tha se duhej të nisej tek ura, se koha po kalonte dhe shokët shqetësoheshin. Por Mato Gruda donte ta mbante për drekë, se do të bënin një qumështor të mirë me kulloshtër.

Nuk mund, Mato! — tha Augustoja.

Mato Gruda kroi kokën nga që nuk gjente fjalë të tjera për t'ia mbushur mendjen.

— Mos harro betimin, Agush! — tha ai.

Italiani hapi gojën nga këto fjalë që nuk i priste. Gjithnjë, sa herë që Mato Gruda i kujtonte betimin, ai habitej.

— Qëllim madh Mato! — tha italiani dhe e përqafoi të zotin ashtu siç ishte me pushkë të shkurtër në krah.

Zigurin e pushtoi zilia. «Ky italian me pushkë po shkon në mal, babai vërtitet pas një lope e pas një viçi» — mendoj ai. — Të vjen të pëlçasësh.» Atëherë atij i erdhi në mend ta fyente të atin. Po, po, ta fyente, se e kishte hak.

— Baba, do të shkoj edhe unë, me Agushin, — tha Ziguri, i bërë prush në fytyrë.

Zara e përqafoi. Të atit nuk i erdhi mirë.

— Vogël, — tha Augustoja.

— Nuk jam i vogël, — tha Ziguri, — të gjithë ju më thoni se jam i vogël. . . Nuk dua të rri as në shtëpi, as në shpellë.

Mato Gruda u nxeh.

— Pa fjalë! Duhesh këtu!

— Nuk duhem! — tha i biri.

— Atë e di unë! — tha Mato Gruda.

— Agushi ka pushkë, ti. . . — u hodh Ziguri.

— Unë kam top dhe në atë pushkë dy pëllëmbë e gjysmë nuk dua as të pështyj, se nuk e ka hak pështymën, — thirri me zë të lartë Mato Gruda.

— Mato nxeh, — u tremb italiani dhe iu kthye Zarës. — Zara, mbyll gojën Zigurit. Mato nuk ka qejf fjalët tani...

Mato Gruda e pa me përbuzje, se nuk donte të ngatërrohej ky i huaj në punët e tij e të fëmijëve të tij.

— Sus, Agush! — thirri ai përsëri.

— Pusho, Mato. Ik unë, — u skuq Augustoja.

Të gjithë heshtën. Mato Gruda filloi të mblidhte gurë nëpër oborr dhe t'i hidhte mbi gropë. Pastaj i urdhëroi edhe të tjerët të bënin siç bënte vetë. Dukej sikur nuk ia kthente sytë Augustos, që qëndronte i druajtur më këmbë. duke mos ditur se ç'të bënte.

— Mato, ik unë! — tha Augustoja.

— E mirë, ik! — tha ftohtë Mato Gruda.

Po, kur italianin po dilte nga porta, Mato Gruda i thirri ta priste. Atëherë Augustoja e kuptoi se i zoti ishte zbutur.

— Agush, udha e mbarë! — tha Mato Gruda dhe e përqafoi.

Augustoja u përlot dhe fshiu sytë me mëngë.

— Mirë, mirë, u nxeha pak, — tha Mato Gruda.

— Mato njeri madh, — tha Augustoja.

— Atë e di unë, — tha Mato Gruda dhe u ndanë.

— Babai është tuhaf! — i tha Zara të birit.

— A? — pyeti i shoqi, duke u kthyer.

— Hiç, Mato, hiç! — tha Zara.

Dhe në oborr ra qetësia...

KAPITULLI I NJEZETEKATËRT

Me të ikur Augustoja, Mato Gruda mendoi të ngjitej edhe njëherë në shpellë për të shpënë ushqime e për ta parë hallë Esmanë. Ai i tha së shpejtës të mbushte thesin me roshnica, se ato ziejnë lehtë dhe pa ndonjë mundim të madh. Por, kur Zara po bënte gati thesin, u dëgjuan nja dy të shtëna pushkësh. Mato Gruda ngriu.

— Erdhën, — mendoi ai.

— Si do vejë puna jonë? — tha Zara.

— Si puna e të gjithëve, — ia preu Mato Gruda.

Në këtë çast u dëgjua një gjëmim i tmerrshëm. Pas gjëmimit u ngrit një tym i madh. Goditja ishte aq e fortë, sa u duk sikur u lëkund oborri. Zara zuri veshët me duar. Ziguri u zverdh.

— Ç'është kështu? — tha Zara.

— Ura u hodh në erë! Gjermanët erdhën! — tha Mato Gruda.

— Të ikim, Mato! — u lut Zara.

Një breshëri mitralozi e ca plasje granatash çanë ajrin e ftohtë të mëngjesit.

— Të ikim! — përsëriti gruaja.

— Nuk ikim dot. Andej tani qëllojnë gjermanët! — tha burri.

Atij iu kujtuan fjalët e Baftjar Fizit: «Njësitë të zërë vend te bërryli i lumit Krak». Breshëritë e mitralozave dhe plasjet e granatave vazhdonin. Dëgjoheshin edhe krisma pushkësh. «Këto janë të njësitit» — mendoi ai.

— Ju fshihuni në bodrum. Unë po shkoj, — tha ai.
Zara e vështroi me habi.

— Ku?

— A nuk më lajmëroi Baftjari për njësitin? — tha ai. Zara e ndjeu se emrin e Baftjarit i shoqi e shqiptoi me një theks të veçantë.

Andej thellë nga fshati doli një flakë.

— Po digjet fshati! — tha Mato Gruda.

— Pupu!

«Gjer këtu s'besoj të vijmë, Shtëpia jonë është larg fshatit» — mendoi Mato Gruda.

— Fshihuni! Po iki unë! — tha burri.

Ai ktheu krahët dhe u drejtua në portë. Pastaj qëndroi:

— Mos lëvizni gjersa të vij unë!

Mato Gruda doli nga porta e oborrit dhe mori vrapin nëpër rrugicën me gur të zinj. Në veshët e tij gjëmonin bombat dhe krismat e mitralozave që sa vinin e bëheshin më të forta e më të mprehta. Ai qëndroi. Ku të shkante? «Të pres njëherë. Të marr vesh se nga janë gjermanët e nga tanët!» — tha ai me vete.

Sai qëndroi një copë herë, përsëri filloi të vraponte. Ai kaloi nëpër gjerdhet e kopshteve e nëpër oborret e shtëpive të zbrazëta dhe u drejtua për në qendër të fshatit. Te rrapi i madh, në mes të sheshit të xhamisë, pa një grumbull me burra e plaka. Këta ishin fshatarë e fshatare që nuk kishin arritur të iknin në shpellë. Rreth grumbullit qëndronin njerëz të armatosur, me feste të bardha. Me t'i parë, Mato Gruda ndali.

— Hajde! Ç'më rri atje? — thirri një nga njerëzit e armatosur.

— Ç'thua, ore? — pyeti Mato Gruda.

— Futu atje! — dhe ballisti tregoi me kokë grumbullin e burrave. Ç'po ndodhte? Ç'donin të bënin? Ai u drodh si purtekë, kur pa në shesh para njerëzve një trup të shtrirë, të gjakosur e të sakatuar. Disa hapa larg trupit qëndronte një gjerman dhe pas tij një burrë i hollë me mustaqe. Mato Gruda e njohu. Ishte Tosun Baçi.

— Cilin kanë vrarë? — pyeti njërin Mato Gruda.

- Muratin! — pëshpëriti ai.
- Jo, ore! — u pre Mato Gruda.
- Gjermani diçka i tha në vesh Tosun Baçit. Ky i fundit u ngrit në majë të këmbëve dhe thirri:
- E dini ju se cili është ky i vrarë? E?
- Asnjëri nuk përgjigjej.
- Atëherë ai iu drejtua njërit, një burri të thyer:
- Cili është? Po të pyes ty!
- Ju që e vratë e dini! — tha burri.
- Tosun Baçi e vështroi me përbuzje burrin dhe iu drejtua një tjetri, Adnan Pinxhos:
- Cili është ky, Adnan?
- Komunisti Murat Shtaga! — tha Adnani.
- Bravo! — tha gjermani.
- Tosun Baçi e kërcënoi burrin e thyer:
- Po ti, kërric i vjetër, pse nuk u përgjigje?
- U përgjigja, s'u përgjigja, njëlloj është, ju e dini!
- Atëherë kapërceje! — tha Tosun Baçi.
- Nuk të mora vesh! — tha burri i thyer.
- Kapërceje. Ja kështu... — dhe Tosun Baçi iu afrua trupit të Muratit dhe e kapërceu vetë, si për të demonstruar një ushtrim gjimnastikor.
- Zotrote je më i mençëm se unë, por ç'do të thotë të kapërcesth një njeri të vdekur? — pyeti burri.
- Tosun Baçi përpoqi këmbët.
- Ç'do të thotë? Po ta kapërcesth, unë marr vesh se ti nuk ke dashur as Muratin, as komunistët! — tha ai.
- Mohon komunistët! — tha gjermani.
- Unë nuk e kapërcej! — tha burri me vendosmëri.
- Tosun Baçi kërkoi me sy në grumbullin e njerëzve. Mato Grudës i ngriu gjaku. Kapedani ballist e ndali vështrimin tek Adnan Pinxhoja.
- Adnan, kapërceje Muratin, që të shohë ky kërric i vjetër!
- Adnan Pinxhoja, i mbytur në djersë, doli nga turma dhe hodhi një hap drejt trupit të Muratit. I zverdhur në fytyrë si meit, qëndroi pranë kufomës, me sy përdhë. Njerëzit e prenë frymën. Mato Gruda vështronte pa i lë-

vizur sytë. Adnan Pinxhoja hodhi ngadalë edhe një gjysmë hapi.

— Do ta kapërcejë, i poshtri, — tha Mato Gruda me zë të ulët.

Por Adnani qëndroi.

— Adnan! — thirri Tosun Baçi.

— Më vjen si... si... siklet, — tha Adnani, duke iu marrë goja.

— Adnan! — thirri përsëri Tosun Baçi.

Adnan Pinxhoja i mbylli sytë dhe u hodh me një shpejtësi të çuditshme. U hodh dhe ra. Në qetësinë e përmortshme ai në fillim fshehu fytyrën nën krah dhe u tulat në shesh disa hapa larg trupit të Muratit.

— Adnan! — thirri Tosun Baçi.

Adnani u ngrit ngadalë. Qëndroi pak dhe vështroi njerëzit. Por njerëzit kishin ulur kokat. Atëherë ai ia dha vrapit, duke shtyrë turmën. Vraponte e vraponte tatëpjetë sheshit. Gjermani qeshi me zë të lartë, pastaj pushoi dhe urdhëroi Tosun Baçin të kapej i ikuri.

Dy ballistë filluan ta ndiqnin Adnanin tatëpjetë sheshit.

Gjermani i bëri me kokë Tosun Baçit dhe ky filloi të kërkonte përsëri me sy nëpër turmë. Sytë e kapidanit ballist vajtën te një burrë i gjatë dhe i vrenjtur. Ishte Fahremudinaliu.

— Fahremudinali! — thirri Tosun Baçi. — Unë e di që ti e kapërcen Muratin, se shumë të këqija u ka sjellë Fizëve ky njeri. Ai ta qëlloi me top shtëpinë, të prishi vëllezërit dhe të mori më qafë motrën. Fjalët që janë hapur për motrën tënde, nuk janë të kota... Ti mos e kapërce, po zëre për flokësh dhe përplasja kokën përtokë, që edhe i vdekur të mbetet i turpëruar... .

Të gjithë lëshuan një «ah» dhe filluan të lëviznin. Gjermani vështronte me indiferencë, sikur të ndodhte diçka e zakonshme. Fahremudinaliu, i gjatë si plep, me vetulla të ngrysur, vështronte nga Tosun Baçi dhe heshte.

— Fahremudinali! — thirri Tosun Baçi.

Fahremudinaliu shtyu me bërryla dy plaka që ia kishin zënë udhën dhe doli në sheshin ku shtrihej trupi

i Murat Shtagës. Gratë kishin nxjerrë shamitë e qanin, duke tundur kokat.

— Jazëk! Jazëk!

Fahremudinaliu iu afrua trupit. Nguli këmbët e gjata në tokë dhe qëndroi pa folur asnjë fjalë.

— Fahremudinaliu u ul më gjunjë. Turma heshti. Dëgjohej vetëm e qara me dënësë e grave. Mato Gruda fërkoj me dorë ballin e djersitur.

— Përplasja kokën! — thirri Tosun Baçi.

Fahremudinaliu iu afrua më gjunjë trupit, pastaj ia vuri njërin krah nën shpatull dhe e ngriti Muratin, duke e vënë ndenjurazi. E afroi nga vetja dhe e përqafoi.

— Më fal, o Murat Shtaga! Unë gjer tani kam qenë i verbër. Kam qenë i vdekur. Tani jam i gjallë. Edhe ti je i gjallë. Një i gjallë flet me një të gjallë!

Pastaj ia ktheu kokën Muratit nga ana e gjermanit dhe e Tosun Baçit dhe tha:

— Ti je i gjallë, ndaj këta ta kanë frikën! Më lejo t'i pështyj një herë!

Dhe Fahremudinaliu, stërnipi i parë i Mere Fizit, hodhi një pështymë drejt gjermanit dhe Tosun Baçit:

— Tfu!

Në këtë kohë gjermani nxori revolverin dhe qëlloi mbi Fahremudinaliun. Fahremudinaliu e lëshoi ngadalë trupin e Murat Shtagës dhe u ngrit. Ai hapi këmbët dhe u drejtua nga gjermani. Gjermani qëlloi përsëri. Fahremudinaliu u lëkund në këmbët e gjata, por nuk ra.

— Tfu! — pështyu ai përsëri.

Turma thirri. Ca filluan të vraponin, ca filluan të shtynin njëri-tjetrin. Mato Gruda qëndronte krejt i hutuar dhe i tronditur.

Gjermani qëlloi për të fundit herë dhe Fahremudinaliu ra pranë Murat Shtagës i mbytur në gjak. Ai ngriti edhe një herë kokën dhe dha shpirt.

Nga të gjitha anët filluan njerëzit të bërtitnin e të vraponin, pa ditur nga të shkonin. Gjermani, Tosun Baçi dhe ballistët sokëllinin dhe qëllonin.

Ndërkohë nga ana e sipërme e sheshit u dëgjuan

breshëri automatikësh e pushkësh. Pas këtyre breshëri-
ve u ndien thirrjet e njohura partizane.

Ishte njësitë e fshatit.

Gjermani dhe ballistët lanë turmën dhe vrapuan për
të zënë pozicionet e tyre. Mato Gruda u lëshua tatëpjetë
sheshit dhe hyri në rrugicën mes kumbullave të zhveshura
e mes ferrave. Ai vraponte sa i hanin këmbët. Pas e ndiqte
qeni duke lehur e angullirë. Mato Gruda nuk shikonte
as gurë, as gjerdhe, as ferra. Ai vetëm vraponte. Kurrë në
jetën e tij nuk kishte provuar çaste të tilla kaq të ashpra,
kaq të shqetësuar, kaq tronditëse. Ç'po ndodhte, ç'po
ndodhte?...

Mato Gruda vraponte e vraponte drejt shtëpisë së tij
të veçuar, atje ku fillonte korija.

Breshëritë oshëtinin në këtë anë e matanë lumit. Ai
qëndroi në një vend të fshehur mes rrapave. E hodhi vësh-
trimin nga pllaja ku gjarpëronte xhadeja dhe pa se ma-
kinat gjermane lëviznin ngadalë. Gjermanët kishin arri-
tur të ndërtonin një urë të përkohshme dhe t'i nxirrnin
makinat matanë lumit. Ato, të ngarkuara me municion,
duke tërhequr nga pas topa të mëdhenj, vazhdonin t'i
ngjiteshin pllajës.

Mato Gruda përsëri nisi vrapin... Si i shkalluar, ai e
shtyu portën e oborrit dhe u derdh në bodrum, ku fshi-
heshin gruaja dhe i biri.

Kur hyri në bodrum, e shoqja mezi e njohu. Fytyra
e tij kishte marrë ngjyrën e dheut. Nuk mbahej dot më
këmbë. Erdhi dhe u platit në truallin e ftohtë, si një njeri
që kishte udhëtuar një javë të tërë pa gjumë e pa bukë.
Zara e Ziguri, të trembur, i ranë përsipër, duke kujtuar
se do të ishte i plagosur.

— Mato, ç'pate, Mato? — thoshte gruaja.

— Baba! — thërriste i biri.

Ai e mblodhi veten dhe u ngrit. I erdhi turp dhe qën-
droi më këmbë në mes të truallit, sikur të kishte bërë
ndonjë faj të rëndë. Heshtte në mugëtirën dhe në lagësh-
tirën e bodrumit. Zara e Ziguri kishin frikë t'i flitnin.
Papritur ai foli:

— Hajdeni pas meje!

Ata shikuan njëri-tjetrin.

— Mato, çlodhu! — tha Zara.

Pa folur ai hapi derën e bodrumit dhe doli. Pas e ndoqën e shoqja dhe i biri. Me hapa të gjatë kaloi nëpër oborr dhe doli nga ana e përparme e kolibes. Qëndroi. Qëndruan edhe Zara e Ziguri. Ai ngriti kokën dhe drejtoi sytë nga faqja e malit. Makinat vazhdonin të ngjiteshin me përtësë. Nga fundi i kodrës, në breg të lumit dëgjoeshin krismat e pushkëve dhe të mitralozave.

— I shihni? — tregoi ai me gisht.

— Pupu! — tha Zara. — Mjerë ne!

Ziguri nuk foli. Me kokën lart ai vështronte makinat e rënda në xhade. Zhurma e tyre vinte e mbytur, si një zhuzhitje mizash. Ato ngjiteshin njëra pas tjetrës dhe ecnin ngadalë si breshka të mëdha të murme. Bile krahasimin me breshkat e gjeti Ziguri.

— I sheh? — tha i ati.

— I shoh!

Pas këtyre fjalëve, përballë makinave, andej nga fillonte mali i Kokallës, shpërtheu një breshëri e dendur pushkësh e mitralozash. Për një çast makinat ndalën. Pastaj nga ato filluan të kërcenin ca pika të vogla.

— Si pleshta! — tha Ziguri.

Mato Gruda nënqeshi. Pikat e vogla hidheshin dhe rrëkëlleheshin në faqe të malit, duke u zhdukur nëpër drizat e dushqet. Atëherë nga dushqet e drizat gjëmuan mitralozat e mortajat.

— Filloi! — tha Mato Gruda.

Ziguri e pa me përbuzje të atin. Ai i mblodhi buzët dhe në të dyja anët e hundës së vogël iu formuan dy rru-dha të thella.

— Pse ike nga njësitë? — i tha ai të atit me gjakftohësinë e një të rrituri.

Zara e ndjeu afrimin e furtunës. I biri kishte kohë që grumbullonte një zemërim të heshtur për të atin. Edhe kur u nis për në njësit, duke i lënë ata në bodrum, u kthye përsëri dhe tani qëndron te dera e kolibes dhe u tregon makinat gjermane, sikur ata nuk i shohin! Zara e zuri për floku të birin dhe qeshi me zor për ta kthyer bisedën në

shaka. Por Mato Gruda u skuq dhe u vrenjt si mjegulla në majë të Kokallës. Ai hodhi dy hapa drejt të birit, e zuri me dorë për mjekre, ia ngriti kokën lart dhe e vësh-troi me zemërim. I biri nuk lëvizi nga vendi, as Zara nuk lëvizi. Mato Gruda i pa të dy me inat, se nuk i pëlqeu heshtja e tyre, ktheu shpinën dhe qëndroi me fytyrën nga kolibja ku fshihej topi. Me flokë të lëshuar mbi ballë e sy, hapi derën e kolibes dhe iu afrua topit. E zuri cepin e jor-ganit që mbulonte grykën e ftohtë dhe e tërhoqi me forcë. Topi nuk donte të zbulohej. Mato Grudës iu kujtua se e kishte lidhur me litar atë natë me shi, kur e zgjoi Augu-ston, kur pati frikë se mos topi merrte lagështirë. Futi dorën në xhep dhe nxori thikën. Kërkoi nyjet e litarit, i gjeti dhe i preu. Pastaj urdhëroi Zarën:

— Hiqe jorganin!

Zara e hoqi jorganin e vjetër, që mbante erë lagësh-tirë, dhe para saj doli i zhveshur topi. Gruaja e kuptoi se kishte ardhur koha që ai të zgjohej. Me jorgan nën sqe-tull e shikonte topin fare pranë. Çështë e vërteta e kishte parë shumë herë në plevicë, por atëherë ankthi që i shoqi mbante të fshehur një gjë të llahtarshme, nuk e linte ta vështronte me vëmendje. Për atë tani ky hekur kishte një kuptim tjetër.

Mato Gruda e kapi pjesën e fundit të shtratit të topit dhe e ngriti. Pastaj u bëri me kokë gruas e të birit.

— Shtyjeni!

Zara e Ziguri dolën prapa topit dhe vunë duart në hekurin e ftohtë. Mato Gruda e tërhoqi shtratin, dhe arma e fshehur në kolibën e qenit, duke u lëkundur mbi rrotat, doli ngadalë në sheshin e kodrës së pjerrët të shtëpisë së stërgjyshërve. Dalja e tij i dukej Zarës diçka solemne. Ankthi që e mundi me muaj të tërë, kur ai rrinte i fshe-hur nën kash të në plevicë dhe nën jorgan në kolibe, tani doli nga kraharori i saj, doli bashkë me topin. Ajo e dinte se kjo dalje ishte e vështirë, e lodhshme dhe, mbi të gji-tha, e rrezikshme për jetën e tyre, por nuk i shembëllente daljes në atë natë të llahtarshme, kur i shoqi qëlloi Fizët. Ajo natë Zarës i dukej e kobshme, i dukej sikur pas atyre

dy të shtënave do të ngjallehin shpirtrat e liga dhe do t'i mblihdeshin ta mbytnin.

Kur ishin në fundin e lëndinës, Mato Gruda e la topin.

— Harruam Larën, — thirri ai.

— Lëre Larën. E ç'do t'i bësh? — tha e shoqja.

— Ajo do të ngordhë për një pikë ujë. Do të shkoj t'ia mbush koritën dhe kusitë, që, kur t'i pihet, të pijë. Lopët e sapopjella pinë shumë ujë, se i kthehet në qumësht, — tha Mato Gruda dhe mori vrapin. Qeni me të lehura vente pas tij.

— Pusho, Balo! — urdhëroi Mato Gruda.

Ai mori koritën, kusitë dhe i shpuri në plevicë. Pastaj futi kovën në pus dhe filloi të mbushte kazanin. E kapi me të dyja duart e fuqishme, e shpuri në plevicë dhe e derdhi në koritë.

Atë rrugë, nga pusi gjer te plevica, e bëri disa herë, gjersa i mbushi të gjitha enët. Lara, me të parë ujin, erdhi me vrap dhe filloi të pinte me etje të madhe. Gurmazi i saj gurgullonte si çesmë.

— Paske vdekur për ujë, moj e zezë — tha Mato Gruda.

Lara e piu gjysmën e kazanit. Atëherë Mato Gruda e mbushi përsëri, se duhej t'i linte rezerva të bollshme.

— Në shpëtofish, këtu e ke ujin gjersa të kthehem. Më vjen keq, por po të lë, moj Larë. Po ti je e zonja për veten tënde e për këtë kolopuç që e polle në ditë të zeza — tha Mato Gruda, duke e vënë faqen e tij në barkun e Larës.

Ashtu, me faqen në bark të lopës, ndenji një copë herë, sikur të donte të çlodhej nga andrallat dhe hallet. Në këto çaste ai ndjeu Zarën që po e thërriste. Kushedi që kur kishte që thërriste gruaja e Mato Grudës që andej nga lëndina pranë topit!

— Po vij! — thirri ai, pa e hequr faqen nga barku i lopës.

Lara u tremb dhe u hodh përprjetë.

— S'ka gjë, — tha Mato Gruda, — është zëri i Zarës. Ti nga gjermani ruhu.

Mato Gruda e mbylli me kyç derën e plevicës dhe nxitoi nga topi.

E ngriti përsëri shtratin e hekurt dhe filloi të zbriste tatëpjetë lëndinës.

— Për pak sa bëmë një mëkat. Lara patjetër do të ngordhte, se do t'i thahej buza për një pikë ujë, — tha ai, duke e hequr topin.

Lëndina po bëhej gjithnjë e më e pjerrët. Tri veta hiqnin pas një top. Qeni i ndiqte.

— Tani mos e shtyni. Tërhiqeni nga pas. Frenojeni, se është tatëpjetë, — tha Mato Gruda përpara topit.

Ai e drejtoi tërthorazi kodrës; anës gorrivicave e drizave, që të mos vihej re nga gjermanët. Bile i urdhëroi gruan e të birin të përkuleshin, për të mos u dukur.

Topi i zbriste kodrës herë me shpejtësi, herë ngadalë. Atje ku nuk kishte driza dhe vendi ishte i zbuluar, Mato Gruda si një artilier i regjur vraponte; atje ku pemët pengonin vrojtimin e gjermanëve, ai ecte ngadalë. Gjer te përroi kjo ishte një vozitje e lehtë. Në përrua filluan edhe vështirësitë e tërheqjes, se vendi ishte me gurë e kaçuba. Rrotat pengoheshin. Ferrat grisnin e gjakosnin këmbët. Zara i kishte bërë gjak pulpat dhe e kishte shqyer fustanin. Ziguri çalonte, se i kishin hyrë në këmbë gjemba.

— Mato, ku do ta shpiem? — pyeti Zara.

— Atje në mes të atyre dy shkëmbinjve, — bëri me kokë Mato Gruda.

Zara pa shkëmbinj të binjakë pranë shoku-shokut. Në mes të tyre ishte një lëndinë e vogël, që gjithnjë ishte e mbuluar me bar. Kur ishte vajzë, ajo lozte me shoqet në atë lëndinë. Ajo hipte atëherë herë në një shkëmb, herë në tjetrin dhe pastaj shtrihej në lëndinë. Edhe Mato Grudën që nga ai shkëmb e kishte parë, kur i kishin thënë se Matoja do të ishte burri i saj. Mos vallë po në atë lëndinë do të shihte Maton për herë të fundit? A nuk e ndiente Zara se ç'po ndodhte rreth saj? Duke sikur faqja e malit karshi po digjej. Kërciste si misrat pufka në një qebap kafeje. Dhe Zara ndjeu një dridhmë në trup. Ajo, duke shtyrë topin, e vështroi Mato Grudën. I gjatë, i fortë, i

pashëm ai tërhiqte para saj topin. «O zot! — tha ajo. — Po sikur?...»

— Shtvjeni edhe pak! — tha Mato Gruda.

Topi ngjitej në të përpjetën mbi përrua. Rrotat gërvishnin në gurët, si rrotat e një qerreje. Mato Gruda qeshi me vete: «Si tha Zara, kur e mora topin nga korija? T'ia heqim vetëm rrotat e ta bëjmë qerre? Tani nuk mund të bëhet topi qerre... Po Murati i zi që u vra? Vallë do të dinte gjë për topin tim? Murat, ti do të çuditeshe, po të më shihje sot mua! Po Fahremudinaliu? Kujt ia priste mendja? Murat, ti bëre punëra të mëdha!»

— Eh, Murat! — tha ai padashur me zë të lartë.

Zara i hoqi duart nga topi dhe vështroi të shoqin.

— Pse t'u kujtua Murati? — pyeti ajo.

— E kishin sjellë në shesh të xhamisë. I vinin nierëzit ta kapërcenin e t'ia përplasnin kokën përtokë. Ishte një gjerman e ca ballistë... — tha Mato Gruda, duke tërhequr topin.

— Ç'thua, Mato? Si e kapërcenin Muratin? — pyeti Zara e dëshpëruar.

— E vranë Muratin, Zarë! Lëre, se nuk tregoj dot. — tha Mato Gruda dhe për një çast e ndali topin.

— Muratin e vranë? Muratin? — thirri Zara dhe shkoi pranë Matos për ta dëgjuar më mirë.

— E vranë, Zarë! Edhe Fahremudinaliun e vranë! — tha Mato Gruda.

— Edhe Fahremudinaliun? Po ç'patën me të?

— Lëre, Zarë! Gjermani e Tosun Baçi pritnin që Fahremudinaliu t'ia përplaste kokën Muratit për truall. Por ai e përqafoi Muratin e vranë. Dhe atë e vranë, Fahremudinaliun! — tha Mato Gruda.

Zara ngriu. Ajo tani nuk i urdhëronte dot as këmbët, as duart.

— Ishe atje ti, Mato?

— Isha!

— Po ti e kapërceve?

— Ta merr mendja ty?

— Jo! — tha Zara.

— Unë ika. Shtvjeni! — tha ai dhe e tërhoqi topin.

Një gur i madh i doli rrotës përpara. Topi mbeti. Mato Gruda i dha tërë trupit përpara, po topi nuk lëvizte.

— Shtyjeni! — urdhëroi ai.

— Një gur në rrotë, — tha Ziguri.

— Hiqe, djalë!

Topi përsëri filloi të lëvizte. Ata iu afruan lëndinës së vogël mes dy shkëmbinjve. Mato Gruda e la topin dhe shkoi te lëndina për të parë. Prej andej dukeshin si nëpër mjegull makinat gjermane. Njerëzit nuk viheshin re. Ai vuri në ballë dorën dhe vështroi, si një komandant baterie. «Hë, — mendoi Mato Gruda — Augustua si thosh? Hero nacional! Ç'njeri! — Mato Gruda qeshi me vete. — Po Fizët, vallë, mendojnë si më parë? Xhanëm edhe mendojnë pak. Po më vonë do të zgjidhen gjërat. Për ç'arsye të ketë lindur hakmarrja? Murati i shkretë thoshte se hakmarrja doli që në kohën e lashtë dhe ishte si sherr mbrojtjeje. Fisi mbronte një njeriun e tij nga të tjerët. Ka qenë, siç duket, një lloj drejtësie. Vrave një, vras një! Po ta zëmë se ishte e vetmja drejtësi. Po pse njeriu ta ndajë drejtësinë nga padrejtësia vetëm me hakmarrje? Mund të vritet njeriu për një gjë të vogël? Kaloj lopa në arën tënde, të prishi grurin. Ti del e shan të zotin e lopës. Ai nuk e duron sharjen dhe të vret. Nuk mund të zgjidhej kjo padrejtësi me diçka tjetër? Për një sharje ndizet një zjarr i madh dhe ec pa shuaje! A do të zgjidhet kjo punë ndonjëherë? E? Murati i zi thoshte se do të zgjidhet» — mendonte Mato Gruda të lëndina e vogël.

Ai u kthye nga topi:

— Këtu!

Ata e vunë topin në mes të dy shkëmbinjve. Pastaj rrëkëllyen dy gurë të mëdhenj dhe në ta mbështetën dy rrotat e topit. Ishte një llogore natyrale. Mato Gruda hodhi përsëri vështrimin nga makinat. Ato vazhdonin të qëndronin. Përleshja ishte ndezur akoma më shumë. Batalioni partizan ua kishte prerë udhën gjermanëve dhe vazhdonte t'i godiste.

— Në shesh të xhamisë e vranë Muratin? — pyeti Zara.

Mato Grudës nga fjalët e Zarës përsëri i doli përpara Murati i gjakosur.

— E kishin vrarë më parë. Fshatarët thanë se e kishin rrethuar. Në shesh të xhamisë e sollën të vrarë E kishin sakatuar. Lëre, lëre!

— Po pse donin që ta kapërcenin? — pyeti Zara.

— Për të parë se kush e do e kush nuk e do — tha Mato Gruda, — edhe për t'i trembur! Lëre, lëre!

— E kapërceu ndonjëri?

— Adnani! — tha Mato Gruda.

— I poshtër paske qenë!

— E kapërceu, por luajti menç, — tha Mato Gruda

— Si?

— Iku me vrap, duke u lebetitur. U çmend. Po të mos e kenë vrarë, do të mbetet i çmendur... Lëre, lëre, — tha Mato Gruda.

— Gjylet, baba! — tha Ziguri.

— Vrap, se u vonuam! — tha Mato Gruda.

Të tre, duke vrapuar, morën të tatëpjetën, ranë në përrua, pastaj u ngjitën përsëri në kodër.

Mato Gruda u fut i pari në kolibe dhe zvariti njëren nga arkat. Ai e nxori jashtë dhe ia dha Zarës e Zigurit.

— Zëreni të dy! — tha ai.

Vetë u fut brenda në kolibe dhe vuri në sup arkën tjetër. Ajo ishte e rëndë, më e rëndë se një kosh i madh me rrush. Iu kujtuan rrushtë dhe qeshi me vete.

Mato Gruda ecte duke u përkulur rrzëzë kodrës. Gjëmimet dhe krismat ishin shtuar. Atij iu kujtua komandanti i batalionit në malin e Kokallës. Iu kujtua edhe shqetësimi i tij dhe i partizanëve për ato dy të shtënat e asaj nate. «Ishte mërziur i ziu. Khanëm, edhe unë, po të isha në vend të tij, do të mërziqesha. Po tani ai do ta marrë vesh se kush qëllon atë natë. Unë, që do të qëllon sot, qëllon edhe atë natë. Kështu punët!» — tha Mato Gruda me vete, duke iu afruar topit.

Zara e Ziguri kishin shkuar te topi përpara Mato Grudës. Ata ishin ulur nën dëllinjë dhe pritnin. Ai e hoqi nga supi arkën dhe e lëshoi në lëndinë. Në kolibe tani kishte mbetur edhe një arkë, por nuk mund ta merrnin dot. E

mati me sy largësinë nga topi te makinat gjermanë, u përkul në mekanizmin e shenjestrës dhe diçka lëvizi me dorë, sipas mësimeve të Augustos. Mori nga arka një pre-dhë, e futi në top dhe tha:

— Gati!

Zara zuri veshët me duar dhe shikonte të shoqin me një vështrim të përmallshëm. Ai i dukej asaj i munduar, i lodhur, i mirë. Ziguri vajti në krah të të atit, si numërues në një skuadër baterie.

— Haufman, — i tha Mato Gruda topit, — të mora në korije e të shpura në plevicë, të mbulova me kashtë e me jorganin tim. Ne dolëm bashkë përsëri. Haufman, për të gjitha mundimet e mia e të Zarës, për të gjitha mundimet e fshatit tim, për të gjitha vuajtjet e vendit tim, për gjakun e Muratit e të shokëve të Muratit, unë, Mato Gruda, marr hak dhe le të jetë ky një hak i drejtë!..

Mato Gruda tërhoqi kanxhën e mekanizmit të shkrepjes dhe topi gjëmoi. Lëndina e vogël mes dy shkëmbinjve u mbush me erën e barutit. Andej larg në xhade, në kolonën e makinave gjermane, u ngrit një flakë dhe u dëgjua një shpërthim tjetër. Një gjëzim të tillë nuk kishte dëgjuar ndonjëherë as Mato Gruda, as fshati. Pas këtij shpërthimi u duk sikur beteja pushoi. U prenë edhe shpërthimet, edhe krismat e mitralozave, edhe plasjet e mortajave.

— Mori zjarr — tha Ziguri.

— Ç'zjarr! — tha Zara.

— Duhet të ketë qenë makinë e mbushur me municion e armë, — tha Mato Gruda.

I biri u përkul në arkë dhe i dha të atit edhe një predhë tjetër. Mato Gruda e futi në top dhe përsëri tërhoqi kanxhën e mekanizmit të shkrepjes. Zara e Ziguri panë se si në xhade u hodhën mes flakës e tymit ca gjëra të zeza të çrregullta. Dy makina filluan të lëviznin së prapthi.

— Tërhiqen! — tha Mato Gruda. — Një gjyle tjetër, Zigur!

Shpërthimi i tretë i çoroditi krejt makinat në xhade. Mato Gruda dogji edhe njëherë nga ato që donte të tër-

hiqej. Gjermanët ende nuk merrnin vesh se nga vinin këto predha dhe ku gjendej kjo artileri e maskuar, e paparashikuar. Atyre nuk u vente në mendje se mes maleve në këto fshatra të humbura, përveç jataganit, kobures, dyfekut dhe automatikut, fshihej edhe artileria. Kjo ishte diçka e pabesueshme.

Breshëritë partizane tani u bënë më të dendura e më të ashpra. Dukej sikur batalioni ishte afruar në korije anës xhadesë dhe qëllonte pa mëshirë.

Gjermanët, të orientuar vetëm nga zhurma e topit, filluan të qëllonin me mortaja, për të dalë nga rrethimi, siç mendonin vetë. Për ata ky rrethim ishte i paparashikuar. Por hedhja në erë e urës, gjëmimi i «artilerisë», i bëri të dyshonin për forcat e shumta partizane. Mortajat e tyre qëllonin me hamendje. Predhat binin rreth topit të Mato Grudës, por larg tij. Mato Gruda urdhëroi Zarën e Zigurin të fshiheshin nën shkëmb dhe vetë priti sa hesh-tën mortajat gjermane. Pas pak u ngrit përsëri dhe qëlloi. Plasja e predhës u shoqërua me breshërinë partizane.

Mato Gruda e kuptoi se topi do të zbulohej. Këtë gjë ai e vuri re nga predhat e mortajave që po afroheshin. Ai e vështrroi Zarën e fshehur pas shkëmbit dhe me një zë që kurrë s'ia kishte ndier gruaja tha:

— Zarë, ja, më pe mua partizan. Në këtë lëndinë më pe... Unë e kisha vënë re që ti doje të më shihje partizan për të më larguar nga marrëzitë që doja të bëja... Zarë, tani shko u thuaj partizanëve... Thuaju se po luftojmë me top. Le ta mësojë edhe shoku Xhabir se burri yt, Mato Gruda, ndodhet këtu... Ja, kalo andej përroit e përroit dhe dil mbi shpellën ku kemi lënë hallën. Shikoje edhe hallën. Thuaji shokut Xhabir të dërgojë një skuadër partizane këtu... Eh, po të kishim edhe një mortajë... Shko, Zarë, gjermanët nuk të vënë re... Ti, vërtet, kishe qejf që unë të dilja partizan, Zarë?... — tha ai dhe sytë iu mbushën me lotë.

Zarës iu mbush trupi me mornica nga këto fjalë. Ajo doli nga shkëmbi, ku ishte fshehur, dhe ra në gjoks të Matos. Ziguri nuk i kishte parë kurrë të përqafoheshin

dhe uli kokën. Ai vuri re se nga këmbët e nënës pikonte gjak. Ato ishin çjerrë nëpër ferra.

— Shko, Zarë! — përsëriti Mato Gruda.

— Mato, mos ndodhë... — belbëzoi ajo.

— Kam Zigurin. Ziguri u rrit... — tha Mato Gruda me fytyrë të nxirë nga tymi i barutit.

Zara u shkëput nga krahët e burrit. Me gjoks të grisur e këmbë të çjerra u nis nëpër dushqet e ferrat tatëpjetë kodrës. Ajo ktheu edhe një herë kokën nga i shoqi dhe i biri dhe u zhduk. Mato Gruda psherëtiu thellë.

— Kështu punët, Zigur, kështu! — tha ai ngadalë me gjyle në dorë. — E sheh ti, se si ndodhi? Për njeriun, Zigur, qënka vështirë të qëndrojë sehixhi. E? Pse, more Zigur, unë, Mato Gruda, a mund t'i kisha qejf këta që vijnë me makina? E? Kështu punët. Po ti nuk e pe Muratin... Ti, po ta kishe parë, do të rriteshe e do të bëheshe në moshë më i madh se unë... Përnjëherësh do të rriteshe!... Kam frikë se do të na mbarojnë gjyiet... Kështu punët...

Atë e bir mbetën vetëm pranë topit në mes të dy shkëmbinjve. Faqja e malit dukej sikur ishte ndëzur. Gjithçka gjëmonte e oshëtinte.

Ai futi predhën e shtatë. Këtë radhë iu kthye të birit:

— Afrohu, Zigur!

Ziguri u afrua.

— Shkrepe! — tha i ati. — Ja, këtë tërhiqe!

Ziguri tërhoqi kanxhën e mekanizmit të shkrepjes dhe topi përsëri gjëmoi.

Binte erë e thartë baruti. Frynte erë dhe koha ishte e vrenjtur. Retë kishin mbuluar majën e Kokallës.

Pas një heshtjeje filluan prapë mortajat gjermane. Mato Gruda e urdhëroi të birin të fshihej dhe vetë i vuri edhe një predhë tjetër topit.

— Kështu, Haufman, ata që të gatuan ty andej nga Gjermania, nga ti do të gjejnë vdekjen! Të mbajta shumë në plevicë, të shpura në kolibe, të mbulova me jor-

gan dhe tani të nxora të shëndoshë! — tha Mato Gruda dhe qëlloi.

Në këtë kohë fërshëlleu një predhë dhe plasi para tytës së topit. Mato Gruda mbuloi fytyrën me krah. Por ai diçka ndjeu në gjoks. U kollit dhe iu morën mendtë. E zuri grykën e topit me dorë. U mbajt pas tij, hodhi dy hapa drejt Zigurit e ra. Ziguri u derdh mbi të atin i frikësuar.

— Baba! Baba! — thirri ai dhe e shkundi pas jakës së xhaketës.

Fytyra e Mato Grudës kishte marrë ngjyrën e zbotë, si të një flete plepi në vjeshtë. Gjëmimi i luftës për një çast kishte heshtur dhe në dushqë shushurinte era. Mato Gruda ishte shtrirë nën dëllinjën e kaltër dhe gjaku i rridhte nga gjoksi.

— Zigur... bir, vëmë një gur nën kokë! — tha ai ngadalë.

Ziguri i dëshpëruar gati më të qarë mori një gur. Pastaj zhveshi xhaketën e tij prej shajaku, e mbuloi gurin duke e bërë si jastëk, dhe ia vuri të atit nën kokë.

Dushqet shushurinin nga era dhe retë vraponin në qiell. Dy zogj të mëdhenj, nga ata që duken në fillim të dimrit, fluturonin lart nën retë. Mato Grudës iu kujtuan mëllenjat që zinte, kur ishte sa Ziguri; pastaj i erdhën në mend dy turtuj që i zuri në një guvë lisi dhe i liroi; pastaj iu kujtua Zara e re...

«Atëherë unë i thosha Muratit — mendoi Mato Gruda. — «Jeta? Të kujtohet shpella jonë mbi korije? Kur ishim të vegjël, ne qëndronim përballë grykës së saj dhe thërritnim: «Rrofsh, moj shpellë» dhe ajo na përgjigjej: «Rrofsh, moj shpellë.» Pastaj i ktheheshim dhe i thërritnim: «Plaç, moj shpellë!» dhe ajo na përgjigjej: «Plaç, moj shpellë!» Jeta i shembëllen asaj shpellës. I thua: «Rrofsh», të përgjigjet: «Rrofsh». I thua: «Plaç», të përgjigjet: «Plaç. Ja, kështu janë punët, që thua ti.» Murati më thoshte: «Gjer në një farë mase mirë e ke ti, po megjithdrejt. Jeta, thonë ata, duhet ndërtuar. Është luftë jeta». Mirë e kishte Murati i zi» — qeshi ngadalë Mato Gruda.

— Zigur! — tha Mato Gruda. — Unë nuk mbeta borxhli ndaj teje, edhe ndaj vendit... Ti më vure re si i futja unë gjylet? Hiqe pas llozin dhe fute gjylen... Pastaj shkripe... Ja, atje... S'ka gjë, Zigur, unë po çlodhem nën dëllinjë, ti qëllol!...

Mato Gruda vuri re se korija dhe maja e Kokallës morën ngjyrën e portokallit. Gjithçka mori ngjyrën e portokallit. Pastaj ai ndjeu një gjëmim. Ngriti kokën dhe përmes kësaj ngjyre portokalli pa Zigurin pranë topit.

— U rrit... Qëllon... — tha Mato Gruda rrëzë dy shkëmbinjve të murmë.

Tirazhi 30.000 kopje

Format 78x109/32

Stash: 2204-72

Shtyp. Drejtoria Qendrore Poligrafike
Shtypshkronja «8 NENTORI» — Tiranë, 1975